

Sulejman Mato

Zarfi me mizë

Tregime të zgjedhura

Tiranë, 2010

Princi i vogël

Pa zbardhur ende mirë princi i vogël na u fanit në kuzhinë këmbëzbathur, me kanotiere e byreçka dhe me atë të qarën e tij të zakonshme, pa asnjë pauzë.

- Do ta kemi zgjuar ne, ose do ketë parë ndonjë ëndërr të keqe, - e justifikoi ime shoqe si gjithmonë.

- Çfarë të të bëj nëna ndonjë gjë të mirë?- e pyeti ajo për ta qetësuar. – Të të bëj nëna palaçinka?

- Jo.

- Po omëletë?

Në vend të përgjigjes ai ia dha së qarës edhe më fort, si një sirenë alarmi që me siguri kishte çuar nga gjumi edhe pushuesit më gjumashë të Golemit.

-Po shpullë do? –e pyeta unë me shaka, për ta zbutur.

Princi i vogël fillimisht buzëqeshi djallëzisht, pastaj me shpejtësi rrufe rrëmbeu garuzhdën në lavaman, e drejtoi atë si shpatë dhe u nis drejt meje me të në dorë...

-Mos! - i bërtiti e ëma sa e pa, dhe nxitoi e ia hoqi nga dora në kohë.

Princi i vogël shtypi përsëri butonin e sirenës së alarmit. Vajza na i bëri me shenjë që ta shpërfillnim. Kur ndjeu që askush nuk po shqetësohej më për ulërimat e tij ai m'u afrua mua e më këputi një fjalë banale të cilën ia kisha mësuar unë vetë. Unë bëra sikur nuk e dëgjova dhe shpresoja të mos e kishte dëgjuar ime bijë që edhe pse e dinte që e doja aq shumë, më kritikonte shpesh për tolerancën ndaj tekave të tij.

- Je edhe mut, edhe kak...! - e ngriti zërin princi im i vogël edhe dy shkallë muzikore më lart. Ime bijë nuk duroi dot dhe ia këputi një pëllëmbë...

Tashmë princi ynë i vogël kishte një shkak të fortë për të ulëritur më shumë. Ama, ime shoqe e gjeti kohën t'i afrojë pjatën me omëletë... e cila në çast fluturoi mbi kokën time dhe u përplas në dysheme me zhurmë, duke u bërë çikë e thërrime.

-Për të gjitha këto t'i e ke fajin! Ti e ke përkëdhelur. - m'u drejtua ime bijë.

Edhe pse tekat e tij më lumturonin, për një çast i dhashë të drejtë.

- Ky fëmijë ka nevojë të rrijë ca kohë larg jush.

- Tani ta shohësh shtëpinë e gjyshërve me dylbi..., - iu drejtua ajo princit tim të vogël duke e rrëmbyer si një plaçkë tregu dhe, pa pyetur për ulërimat e tij, e çoi në dhomën tjetër...

* * *

I dashur princi im i vogël. U bënë plot katër ditë që s'jemi parë. Me sa duket mamaja jote gjithë inatin e paska me mua se, me demek, unë të paskam prishur, të kam llastuar dhe hardallosur, gjoja nën ndikimin tim qenke bërë një rrugaç i vogël, që kundërshton çdo gjë, përplas këmbët dhe shan me fjalë të pista... Sipas mamit tënd unë qenkam mësuesi i të gjitha fjalëve të pista që ti kohët e fundit paske filluar t'i përdorësh pa masë. E pranoj, fjalën "m..." ta mësova unë, por jo që ti ta thoshe atë me zë të lartë. Mora vesh se ti e paske përdorur atë dhe në shtëpinë e shefes së mamit..? Kur shoqet e mamit të pyetën si të quajnë...Ti... Duhet ta pranosh, ke bërë një gabim të madh. Nuk e di ç't'u tek në atë çast t'u këpusje atë fjalë të pistë e ta bëje mamin të skuqej në sy të shoqeve? Por edhe ajo sa u kthye në shtëpi më telefonoi e nervozuar: "E more vesh ç'u tha shoqeve të mia, yt nip? dhe frap, ma mbylli telefonin.

Tashmë i dashur Neo, Neush, bukurush, vesh... (siç e shqipton ti me atë zërin e hollë?) "ves lapush..." u bënë katër ditë, ti pa luajtur kubash me mua dhe unë pa dëgjuar zërin tënd. Katër ditë për ty ndoshta nuk është ndonjë ndarje e gjatë, aq më tepër që unë e di që në mungesën time ti i kalon orët para televizorit duke u argëtuar me aventurat e Tomit dhe Xherit. Të përfytyroj tani duke qeshur me gjithë shpirt kur Xheri ia punon Tomit dhe nuk e kuptoj përse ti nipi im i dashur bëhesh gjithmonë me Xherin mistrec dhe kënaqesh ndërkohë që mund të bëheshe me Tomin e padjallëzuar? Kur mbushe dy vjeç më kërkove të të tregoja një përrallë, dhe unë, ngaqë nuk dija asnjë përrallë që mund ta tregoja deri në fund, të tregova përrallën e ujkut dhe kecape..

Mirëpo ti më kërkove çdo natë nga një përrallë të re. Ku ti gjeja unë përrallat e reja? Ndaj nisa të të tregoja përralla koti, të sajuara në çast, vetëm e vetëm që ti t'i mbyllje ato syçkat e bukura dhe djallëzore... Meqë ato ditë ne ishim në plazh, fillimisht të sajova një histori koti, *me një peshk të kuq i cili banonte me nënën e vet në fund të detit, në një shtëpizë të vogël prej druri të ngritur mbi një pemë...*

Atë pasdite e shtrydha të gjithë fantazinë time të plakur për një histori të cilën nëna jote e quajti "stropio". - Ç'domethënë stropio?- pyete ti.

Stropio...?!...Stropjo do të thotë kur mbi çatinë e peshkut të kuq në fund të detit, do të ndezim një qiri...

Kur të tregoja përrallën e peshkut të kuq që banonte në fund të detit, kur unë harroja të ndizja qiririn ti ndërhyje në çast : "Po qiriri?" Kështu, për çdo natë unë të tregoja të vetmen përrallë, me pak ndryshime, një herë tjetër shtëpizën prej druri e ngritëm mbi një pemë të lartë, të lartë... "Për të mos hipur ujku..?" – ndërhyre ti . "Natyrisht" u përgjigja unë.? (personazhin e ujkut e krijove ti...

dhe na ngeci. Për çdo natë do të përmendej dhe ujku, si personazh negativ.)

Një mbrëmje unë të tregova se si princi imi i vogël, domethënë ti, zbritte gjer në fund të detit, i shoqëruar nga shtatë marinarë , të gjithë të veshur me bluza të kaltra. Mamaja e peshkut, sa e pa princin tim të vogël, thirri gjithë gëzim: “Eja mor xhan...Eja mor zemër...” Ty të ndritën sytë nga gëzimi.

...- Në shtëpinë e peshkut të kuq, kishte aq shumë lodra... kishte një dhomë të madhe ku ishin grumbulluar lodrat e fëmijëve të të gjithë botës. “Po motor kishte..?” –pyete ti. - Dhe motor , dhe anije, dhe motos kaf, dhe biçikletë, dhe veturë, dhe ekskavatorë, dhe vinç, dhe... betonierë...dhe helikopter, dhe...” Ndërkohë që përpiqesha të sillja ndër mend të gjitha emrat e lodrave, ty të kishte zënë gjumi dhe unë heshta i lehtësuar.

* * *

Qysh prej asaj dite, gjithmonë kur niste të të davariste gjumi- gush pëllumbi, ti thërrisje: “Dua gjysin..!Dua gjysin..!” Unë mbështesja kokën pranë teje dhe nisja të tregoja krijimin tim të vetëm: ”Na ishte një herë një peshk i kuq që jetonte në një shtëpizë druri në fund të detit... Vazhdoja të llomotisja ç’më vinte ndër mend , veç të të zinte gjumi...” Një ditë peshku i kuq erdhi për vizitën në shtëpinë tonë ... dhe, meqë peshku nuk ka këmbë u ngjit shkallëve me bisht, “tak-tak-trak...” Vura re që ti u gjallërove: ”Mos!- thashë me vete. Nga ai çast nxora një mësim të mirë: në çastet e gjumit fëmija duhet të dëgjojë gjëra monotone, dhe zëri të jetë i zvargur”. Ti më pyete: “Po pastaj? Me se trokiti peshku i kuq? Ai nuk ka dorë”

- Trokiti me kokë, - i thashë unë , pa e ditur se ky detaj do të pëlqente shumë.

Ditën tjetër i the mamit: “Dua të fle me gjysin... se gjysi më tregon “përralla me stropio”. Në të vërtetë unë u ndjeva paksa krenar, duke menduar se, gjithsesi, përralla ime me peshk të kuq ia kishte kaluar përrallës së Hirushes që ta tregonte mami, dhe përrallës së Pinokut që ta tregonte gjyshja.

Një herë unë të tregova “përrallën e Neos” i cili u ngrit një ditë gjer në qiell me krahët e shqiponjës që gjyshi t’i kishte blerë në një super market. “Do më marrësh edhe mua në qiell? “- të pyeta unë. Dhe ti ma bëre qejfin.

... Ditët e tjera ne të dy nisëm fluturimet, fluturoam mbi male e mbi fusha, mbi dete dhe oqeane...Sa të lumtur e ndienim veten në ato fluturime të shkurtra... gjersa ty të zinte gjumi në krevatin e mamit.

Dhe unë e kuptova se jeta bëhej e bukur, duke shëtitur me princin tim të vogël e duke lundruar përfund detit. Kështu filluan aventurat tona dhe lulëzoi tek unë ajo pranverë e shkurtër në mes të pleqërisë së vonuar. Vetën e ndieja si një ylber që lidhte dy këmbë mali, malin e dukshëm të jetës me malin e padukshëm të amshimit.

Mirëpo, ç't'i themi mamit tënd, e cila më akuzon, kinse të paskam shkalluar nga trutë, madje paska thënë për ty se "pasi kthehesh nga vizita e të dielave në shtëpinë e gjyshit, ti shndërrohesh në një kafshëz të vogël, nuk i dëgjon këshillat e mamit dhe ulërin me të madhe për çdo gjë që s' të pëlqen. Gjepura. "Dua ta bëj kakën në dush, - i paske thënë mamit, - siç më ka mësuar gjyshi..." Ne vetëm një herë bëmë një eksperiment të vogël, ndërsa luanim në mes të dhomës me kuba? "Kaka! Kaka!" thirre ti. Të ngrita hopa dhe të çova në banjë. Ku ta gjeja unë oturakun? Të thashë ta bëje te dushi.. Dhe ti shkon e i thua mamit: "Më ka mësuar gjyshi ta bëj k...në dush." "Ah, mashtrues i vogël...E shoh që të qenka mërziur oturaku..."

Po atë gafën tjetër? Paske ngulur këmbë të veshësh katër bluza njëherësh...Edhe këtë, unë ta kam mësuar? Unë të kam mësuar të dalësh në rrugë me katër bluza, veshur njëra mbi tjetrën? Kur këtë histori ma tregoi mami yt në telefon, qeshte nga inati dhe mallkonte fatin që kishte lindur një fëmijë tekanjuz dhe qaraman... Dhe për këtë gjë unë e paskam fajin?

* * *

Një ditë më pyete "Je plak ti?" Unë çudita. Si të lindi kjo ide? I dashur nip, ti je në një moshë që ngatërron çdo gjë, ndaj të duhet një mësues i qetë dhe i duruar si unë, që të t'i mësojë të gjitha me durim dhe të të durojë kur bën ndonjë zullum, si atë ditë kur më flake telekomandën në një qoshk të dhomës për të provuar ulërimat e mia. Po kur fluturove pjatën me gjithë supë mbi parket, për të provuar ulërimat e nënës? Sikur të isha në moshën tënde, edhe unë të njëjtat veprime do të bëja. Po kur flake tutje pjatën me gjithë koko vezën, dhe nëna thërriste "Gabim! Gabim!" dhe për këtë unë e kisha fajin? Nëna mblodhi copat e thyera të pjatës, t'i u fshehe nën tavolinë, të zuri syri një cifël porcelani dhe thirre: "Nëna...Ja dhe një gabim.." ' Dhe ne i kërkojmë të kuptojë gabimin, - tha nëna duke qeshur".

* * *

“Ky fëmijë është plot fantazi”, - i thashë një ditë sime bije. Ndërkohë ti pyete: “Ç’është fantazia.?” Unë ngeca keq:

“Fantazia? Fantazia është diçka, si për shembull, kur qesh njeriu kot...” “Po “kot” ,ç’është?” “Kot? Kot domethënë ...Asgjë...” “Po asgjë ç’është?” “Asgjëja është...asgjë? Një kohë kur gjyshti s’do të jetë më. “Po “më”-ja ç’është? “E , mjaft se e teprove tani...”. Do të vijë një ditë që do t’i mësosh të gjitha fjalët e gjuhës së bukur shqipe dhe, sigurisht, do të pëlqejnë shumë se, që ta dish ti, gjuha shqipe është gjuha foshnjore e njerëzimit. Ndërkohë që dërdëllisja ti dëgjoje me vëmendje, si një lepurush, me syçkat që të ndrinin. Do më kesh kuptuar thua?

* * *

Nipi im i dashur, sot mora vesh se ti ia paske plasur shpirtin mamit:”Ky djalë është prishur fare! Është bërë tekanjor, qan vend e pa vend, kundërshton pa arsye, ka nevojë për t’u edukuar!” –më tha në telefon. Unë mendova se kushedi ç’kishe bërë. Mami yt më tregoi që ti nuk ke dashur të veshësh bluzën blu me pinguinë. Në këtë pikë më ke ngjarë mua, unë nuk kam pranuar kurrë të më urdhërojnë të tjerët dhe as të më flasin me tone të ashpra. Edhe ti, si unë, kupton vetëm kur të flasin qetë, me durim e me fjalë të bukura.

I dashur princi im i vogël! Ti më zgjove fëmijërinë që flinte. Në shoqëri me ty unë nisa të krijoj përralla të bukura, ti më çove në moshën kur ngatërrohet fantazia me realitetin dhe realiteti me fantazinë.

Ne të dy nisëm të lumturohemi duke jetuar me aventurat e peshkut të kuq në fund të detit, dhe të shqiponjës së artë që jeton në një shpellë, buzë oqeanit blu... Sa herë kemi shëtitur nëpër dete, ti si kapiten e unë një marinar i thjeshtë , ti mbaje dylbitë në sy për të parë balenën e bardhë, unë ngrija lart, çdo mëngjes, flamurin e anijes. Kur na merrte malli për kaltërsitë i merrnim hua krahët e shqiponjës dhe ngjiteshim lart, lart... I kundronim qytetet nga lart. Kur fluturonim mbi Tiranë, vetura e dajës na dukej si buburrec e njerëzit na dukeshin si miza...

* * *

Njeriu në pleqëri ka një rini të vogël, por tek unë ndodhi ndryshe. Tani që i kujtoj të gjitha aventurat tona më vjen të qaj. Sa ditë të bukura ishin ! Kur uleshim në gjuhë pranë cepit të krevatit, luanim me kuba me orë të tëra...Dilnim te lulishtja pranë shtëpisë për t’u hedhur thërrime pëllumbave... Po kur lëkundeshim në kolovajzë?

Unë lart, ti poshtë...unë poshtë, ti lart.... Ty të dukej sikur kapje qiellin me dorë mua më dukej sikur prekja fund-tokën me kokë...Po kur hipnim në veturë? Ti mbaje timonin...sigurisht timoni ty të takonte, unë shkelja gazin, po kur hipnim në motor..? Ti bëje zhurmën e skapamentos, ndërsa unë bëja uturimën e motorit...Po kur ktheheshim nga lodrat dhe hipnim gjithë gëzim mbi krevet? Unë bëhesha kalë, ti kalorës me shufër në dorë:"Xhio kali...! Xhio Kali...!" Të nesërmen gjendeshim qysh herët përballë detit të madh që shushurinte i brengosur. Të kujtohet si i futnim këmbët në ujë dhe thërrisnim të gëzuar:"Erdhi dallga...!Erdhi dallga!?" Ndërkohë ti fshiheshe i lumtur te këmbët e mia. Po kur dilnim së bashku përgjatë bregut..? Ti shëtisje lakuriq midis çadrave, me bibilush përjashta, duke sfiduar kështu obskurantizmin e shekujve. Ca teta të reja të shihnim me habi, ca teta të moshuara të shihnin me kërshëri, ndërsa unë krenohesha me nipin tim nudist. Të hidhja kolopuç mbi krahë dhe ti, edhe pse më lodhje, më jepje kaq shumë gëzim dhe aq lumturi... Ato ditë të bukura mbaruan shpejt...Por aventurat tona s'do mbarojnë kurrë, se tani unë kam shumë nevojë për ty, ndaj pres me padurim të mbarojnë këto katër ditë ndarjeje, që të takohemi sërish dhe, sigurisht, të rinisim çdo gjë nga e para.

Në lidhje me një mi

Na lajmëruan me celular se një mi ishte ngjitur gjer në katin e tretë të pallatit dhe ishte futur në apartamentet e dy komshinjve tanë. Lajmin unë e prita qetësisht, ime shoqe u alarmua: “Duhet të nisemi sa më parë, -tha,- do të ketë hyrë dhe në apartamentin tonë”. Hapësirën poshtë derës unë e kisha konstatuar qysh ditën kur blemë apartamentin, ishte aq e vogël sa që në rastin më të keq mund të hynte vetëm një miush. S’kishim asnjë muaj që e kishim blerë atë apartament. Javën e parë e pajisëm me gjithçka i nevojitet një apartamenti të ri; dhomën e gjumit e blemë sipas shijes së sime shoqeje, kuzhinën e sistemuam më së miri, dy kolltukë, një divan që hapej, ku mund të flinte vjehrra kur të vinte për vizitë, dy televizorë, edhe një për dhomën e gjumit, frigorifer dykatësh, kondicioner dymbëdhjetësh, enët e kuzhinës i blemë në super marketin “Vitrina”. Dhe të mendosh që mysafiri ynë i parë do të ishte një mi...

Duhet të jetë një mi i vogël, ngushëllova veten, ndërkohë që ime shoqe fliste në celular me përgjegjësën e pallatit. E pyeste nëse miu në fjalë kishte hyrë dhe në apartamentin tonë.

- Duhet të nisemi, -tha jo. Për çështje të tilla vendimet i marrin gratë. Veturën e ngiste ajo, Wolksvagen, katër piston. Unë jo vetëm s’kam patentë, por, sipas saj, “ gjatë udhëtimit më kullosin sytë gjithandej, dhe më mungojnë dhe reflekset” .

* * *

Kur po ngjisja qetësisht shkallët e katit të dytë kur dëgjova zërin e saj gërricës: “Ka hyrë! Ka hyrë!”

Punë e madhe..thashë me vete, sigurisht , ka qenë një miush i vogël. Në kësi rastesh, një profesori filozofie, siç jam unë, i vjen në ndihmë përfytyrimi. Ndërkohë që ajo vërtitej nëpër dhomën e gjumit, duke lëshuar pa pushim ca thirrje të frikshme :”Ka hyrë...Ka hyrë..!” unë mendova se duhej qetësuar pak gjendja shpirtërore, pasi, në orën dymbëdhjetë jepej ndeshja e futbollit “Inter- Milan”. Sakaq, te dera e kuzhinës u shfaq ime shoqe me sirtarin e dollapit në duar. “Ja,- thirri,- këto janë të ndyra miu..”

Më tregoi ca pikëza të vogla të cilat ma përforcuan dhe më tepër bindjen se kishim të bënim me një miush të vogël. Dhe dëmi duhet të ishte i parëndësishëm, një arsyetim i thjeshtë, të cilin unë e bëj shpeshherë në kësi rastesh, për të ruajtur qetësinë shpirtërore.

Sa hapa televizorin, ime shoqe u shfaq sërish te dera e kuzhinës me mbulesën e kuqe të krevatit në duar: “E sheh?”- tha ajo, duke më treguar dy vrima të hapura brenda saj. “E shikon apo jo?!” E nervozuar nga qetësia ime e ngriti zërin një oktavë më lartë gjë që në atë çast mendova të bëhesha me miun. Solla ndër mend poezinë

e Marin Soreskut, “Unë jam me demin”... Gjithë stadiumi bënte tifo për toreadorin, i strukur midis ulërimave, ndërsa poeti bënte tifo për demin e gJORË. ...Sakaq te dera u shfaq administratori i pallatit.

- Në apartamentet e komshinjve ka bërë kërدينë, - tha ai. Donte të dinte në kishte hyrë edhe në apartamentin tonë..

-Ka bërë vetëm një vizitë të shkurtër.” -i thashë unë. Në raste të tilla duhet pak humor.

Sa i dëgjoi zërin erdhi ime shoqe duke mbajtur bishtin e fshesës lart, në atë çast m’u duk si Tomi i filmave vizatimorë. Unë dhe im bir gjithmonë kur shohim filma vizatimorë bëhemi me Xherin trazovaç, për këtë arsye nuk e mora inat miushin e vogël i cili kishte menduar të kalonte ca çaste relaksimi në apartamentin tonë të ri.

- Komshinjtë tuaj kanë vënë nën derë një pllakë mermeri,- tha administratori i pallatit, doni t’i sjell punëtorët dhe te ju?

- Aman të keqen, - thirri ime shoqe. - Silli sa më parë”.

- Miun e vramë dje, - tha ai krenar. - Çudi e madhe, hë?! - m’u drejtua mua,- Një mi aq i vogël të bënte kërدينë?

* * *

Atë mesditë ndikova dhe unë në zhdukjen e pasojave të miut, mbusha tre herë kovën me ujë, në çezmën e banjës, dhe i ndihmova punëtorët që na sollën pllakën prej mermeri, me disa mendime konstruktive. Nuk e kuptova pse u larguan aq të lumturuar. Duhet t’i ishin paguar më mirë nga sa e kishin menduar. Ime shoqe është ca dorëlëshuar. Në këtë pikë ndryshojmë shumë. Njeriu nuk duhet bërë bërë pre e disa emocioneve të çastit, sidomos për çështje parash. Emocionet duhen për çështje më të mëdha, si për shembull, kur je duke ndjekur një ndeshje futbollit, fjala vjen; Chelsi-Liverpul. Njeriu duhet të jetë edhe pak altruist, vjen tjetri e të shet mend “E vramë miun!” “Po kë vratë mor zotni?” “Një miush të vogël...? Paksia aventurier, E pranoj. Një mi që guxonte të ngjitej gjer në katin e tretë, i nxitur nga një dëshirë e marrë, për të mësuar se si jeton raca jonë njerëzore në apartamente, ndërkohë që raca e tij mijore jeton nën tokë, nëpër ca tunele të errëta dhe plot lagështirë. Nuk të vjen keq, hë? Nuk të vjen keq vërtet për këto qenie fatkeqe? Duhet të jesh një njeri shpirtkazmë! Njeriu duhet të shqetësohet për fatin e të gjitha qenieve që e popullojnë këtë tokë. Se ja, mendo edhe vet... Sipas teorisë së transgresionit... Ju nuk e dini çdo të thotë transgresion ? Jua shpjegoj unë. Është fjala për një teori e cila pranon që shpirti i njeriut pas vdekjes hyn në trupin e një qenieje tjetër.. Imagjinoni dhe ju, sikur shpirti i administratorit tonë, vrasës, pas vdekjes të hyjë në trupin e një miu?

Ndërkohë që unë abstragoja gjëra të pazakonta për mendjet njerëzore, shoh time shoqe me legen në duar:

- Do hamë sot, apo jo?"- m'u drejtua mua.

Bukën e blej gjithmonë unë, ushqimet e tjera i blen ajo. Sipas saj , unë edhe bukën nuk di ta blej. Nuk blej bukë të mirë. Unë nuk di as si t'i vendos librat nëpër raftet. Unë nuk di çmimet e sheqerit, të vajit, të orizit, të qumështit, makaronave...Unë nuk shoh as afat skandencat e tyre..." Sipas saj, nuk jam për asgjë. Më porositi për të blerë dhe diçka tjetër, që unë e harrova . "Do më ketë porositur për birrë.?"-mendova. U nisa drejt marketit dhe u ktheva me dy simite dhe një birrë familjare "Amstel". "Po orizin ku e ke?!"- thirri ajo kur më pa me birrë në dorë. "Birrën për vete e more, pa të porositur njeri...". U detyrova të zbres shkallët sërish e të nisem drejt marketit...

* * *

Nga Durrësi u kthyem në mbrëmje vonë. Gjatë rrugës ajo ngiste makinën unë kundroja ndërtimet e shumta të ngritura përgjatë autostradës Durrës-Tiranë...Gjithmonë kur udhëtoj, e kam zakon të sodis ndërtimet e ngritura në mënyrë kaotike majë kodrave e nëpër ara, dhe ndjehem keq kur mendoj se sa pak kujdes tregon shteti ynë për anën vizuale të atdheut. Hera-herës më kap një nostalgji njerëzore, kur meditoj për çështje të mëdha.

Edhe pse kjo ditë ishte e pa programuar nga ana ime, nuk e kaluam keq. Ndeshjen Chelsi -Liverpool e ndoqa nga fillimi në fund , ndërkohë që ime shoqe lau pllakat, sistemoi orenditë , vuri në punë lavatriçen, gatoi vetëm për dy vetë e të tjera punë të rëndomta si këto që përmenda më lart, të cilat për momentin s'po më bien ndër mend. Në fund të çdo dite unë e kam zakon të nxjerr konkluzionet e ditës. Kaluam një ditë me variacione.

Vdekja e bardhë

Kur u dëgjua krisma e ortekut, unë gjendesha në hyrje të galerisë, hiqja me lopatë gjithë atë masë dëbore që kishte zënë hyrjen e galerisë, Gjeta ishte në kabinën e buldozierit. Në të dhjetën e sekondës konstatova qetësisht, një masë të madhe dëbore, vinte drejt nesh me një shpejtësi marramëndëse.

Sa u përmenda, ndieva insitktivisht, gjendesha brenda ortekut të dëborës, i mbërthyer duar e këmbë ... Errësirë...

U përpoqa shumë gjersa u çlirova duart, disi. Ndërkohë që përpiqesha të hiqja dëborën nga sytë ndieva me tmerr... Më kishte humbur shikimi. Pra, gjendesha brenda ortekut...Dhe duhet të isha fundosur thellë.Sa thellë? Më duhej t'i jepja kurajo vetes , të luftoja me vdekjen e të çaja një tunel për të dalë në sipërfaqe.

Duke gërmuar me duar dëborën e ngrirë, ndieva tmerr , gishtat pak nga pak po më ngrinin...Ishte ditë e shtunë .Të shtunat zakonisht unë kthehesha në shtëpi, në Tiranë.

Kujtova time shoqe ,më tepër për të hequr nga mendja tmerrin që më kishte kapluar.”

Pra, është dikush që më pret...Eshtë dikush që shqetsohet për mua...Eshtë dikush që më jep forcë të dal me çdo kusht në sipërfaqe.Eshtë dikush për të cilën ia vlen të jetoj...”

Në gjendje të errët dhe të pashpresë siç isha , ndieva erën e parfumit të veçantë të gruas sime. Sikur të më urdhëronte : ”Ti duhet të jetosh! Ti duhet të jeetosh! Ti duhet të dalësh në sipërfaqe!” Gërmova me gishtërinj një tunel i cili më dukej se nuk do të mbaronte kurrë. E ndieja me intuitë që gjendesha vertikalisht dhe lëvizja, gjithësesi me ngadalë, por drejt sipërfaqes...Nuk e di se sa kohë m'u desh të gërmoja nën dëborë, pandërprerje.Duhet të kisha përshkuar një distancë rreth 16 këmbësh.Gishtërinjtë nuk më bindeshim më. As gjymtyrët e duarve dhe të këmbëve.Si një njeri në prag të largimit të përjetshëm, mendova :”S'duhet të jepem!...Do të luftojgjersa kam frymë...gjersa kam forcë...Eshtë dikush që më pret ..Eshtë dikush që mendon për mua.”

Sipërfaqja e tokës nuk duhet të ishte larg. E ndieja nga që dëborë sa vinte e bëhej më e shkrifët

* * *

Së fundi ia dola mbanë.Dola mbi dëborë. Hapa sytë; para meje u shfaq një shkretëtirë të bardhë.E mrekullushme. Po jetoja përsëri. Jeta qënka kaq e bukur! ...Dhe piezazhi i ngrirë...shumë i bukur.Dhe Hëna e madhe, e bardhë që rrinte pezull mbi krye , ishte një mrekulli e natyrës. Frynte një erë me uturimë që ta priste fytyrën si me brisk. Nuk shikoja dot asgjë ,as të ngrihesha në

këmbë. Ndieva një erë nafte ...në çast kujtova që buldozierin e Gjetës duhet ta kisha fare pranë. Ndoshta nën dëborë .Po Gjeta? Thua të ketë shpëtuar? Thirra disa herë si një i pashpresë dhe prita, prita përgjigje. Por më kot. Kuptova se gjendesha në një luginë, larg botës, larg njerëzve që mund të më dëgjonin.I mjerë, i braktisur dhe i pashpresë.

S'pata kohë as për të thirrur "Ndihmë!", pasi një ortek tjetër më i shpejtë se i pari, u shkul nga mali dhe u nis drejt meje me shpejtësi plumbi. Unë hapa me shpejtësi një gropë dhe u zhyta përsëri brenda ortekut tim të dashur. Mirëpo ...as kësaj here nuk i shëpova dot ortekut të dytë...Orteku i dytë, ndonëse me më pak rrapëllimë se i pari, më paskej përparë edhe atje ku isha fshehur.Por unë tashmë nuk isha më ai i pari. Unë tani kisha eksperiencë për të jetuar dhe për të dalë jashtë orteqeve....Unë tashmë e dija ç'duhet bërë në një rast të tillë. E nisa punën me lëvizjen e duarve duke hequr dëborën nga sytë. Herën e dytë errësira nuk më tmerroi aq shumë. Mendova se s'duhet të gjendesha aq thellë sa në ortekun e parë.

Luftova me guxim me dëborën e ngjeshur gjersa ndieva me gëzim që dëborë sa vinte dhe bëhej më e shkrifët. Po i afrohesha sipërfaqes. Këtë eksperiencë të re do t'jua mësoja shokëve ,thashë me vete, në se do t'u ndodhte të provonin fatin tim, dhe natyrisht, në se do të jetoja.

U desh një orë gërmim intensiv për të nxjerrë kokën përsëri mbi dëborë. Erë nuk frynte. Kishte pllakosur mbrëmja. Një mbrëmje e bukur, e bardhë me një hënë të argjendë që lundronte në një qiell të blu. Sa e bukur ishte jeta!...Pak më tutje shtrihej një pyll me filiza pishash , i rralluar. Degët e mbuluara me dëborë dukeshin si tantella, ose si bluza gri e sime shoqeje.

"Nuk duhet të fle,- mendova, -duhet të lëviz...të ngjitem lart ." Ndërkohë dëgjova ca krisma pushke. Ishin shokët që na kërkonin. S'i kishte zënë gjumi gjithë natën. Kjo gjë më dha forcë.

Nisa të lëviz me vështirësi midis shpatit me filiza pishash , por ndjeva me tmerr që këmbët nuk më urdhroheshin. As gishtrinjte e duarve. Ndërkohë që i isha afruar pishës së parë m'u prenë këmbët dhe rashë në dëborë.

* * *

U zgjova afër mëngjesit. Ndjeva me gëzim se si gjatë orëve të gjumit më kishte shpëtuar zoti, zhytja në dëborë më kishte shpëtuar nga ngrirja.

Një Hënë e argjend më bënte shoqëri. Lundronte e vetmuar në qiellin blu dhe i kundronte të gjitha gjërat që ndodhnin në heshtje. Nuk frynte më erë. Ishte një ag i bukur dhe i ftohtë. Pas pak nisi

të fryjë erë. M'u desh të futesha sërish në strehën time të dashur e të prisja aty edhe gjatë gjithë ditës së dytë, herë duke dremitur e herë gjysmë i zgjuar. Provova disa herë të thërrisja “Ndihmë! Ndihmë!...” por më kot. Kisha humbur çdo shpresë, dhe te kordat vokale.

Kohën e kalova si munda, duke u marrë me thellimin e gropës e duke rregulluar ambientin përreth .Nuk dihej. Kjo gropë mund të ishte edhe varri im ...

* * *

Kur u përmenda ndjeva që gjendesha në spital. Përreth krevatit tim qëndronin shokët dhe gruaja...E lumturuar ajo më lëmonte herë pas here flokët. Më uruan të gjithë për jetën time të dytë, duke më dhënë edhe një lajm të keq; mjekët kishën vendosur të më prisnin dy gishta të dorës së djathtë.

Kanë kaluar njëzet e shtatë vjet. Gjatë kësaj kohe kam menduar shpesh; falë kurajës kam mbetur gjallë dhe sot e kësaj dite.

Pas asaj ndodhie vendosëm të lindnim fëmijë. Tashmë kemi dy fëmijë të rritur, një vajzë dhe një djalë. Të dy janë martuar dhe kanë ikur jashtë shtetit. I madhi në Amerikë i dyti në Kanada. Vetëm unë me gruan kemi mbetur ata që kemi qenë. Të vetëm si dikur dhe të dashuruar si dikur, kur punoja si gjeolog në zonat e veriut.

Shumë gjëra s'kemi mundur t'i rregullojmë. Edhe apartamentin e kemi të ngushtë, 62 metra katrorë. Kam pasur shumë dëshira në jetë, të cilat më kanë mbetur të porealizuara. Për shembull; të kisha një apartament pak më të madh , të kisha një studio... të kisha një pension pak më të mirë dhe të mbaja pranë njërën prej fëmijëve. Para ca viteve m'u dha titulli “Doktor i shkencave gjeologjike”, por ç'e do? Më parë kam qenë më kurajës dhe kam luftuar për të realizuar diçka, ndërsa tani sikur jam bërë më i shtruar dhe më i butë.

Por tani unë e di se çfarë i duhet një njeriu në jetë:

Të ketë një shtëpi të ngrohtë...t'i dojë njerëzit...dhe të jetojë gjatë.

Mushkonja

Nuk mund ta kujtoj me saktësi , isha në një gjendje mes gjumit dhe dremitjes, ndërkohë që ndjeva zhaurimën e një mushkonje mbi fytyrën time...? Prita si gjahtari që pret gjahun e vet, që të ulej përsëri mbi mollëzat e mia ose mbi ballë...dhe pasta vrik, e qëllon me një shuplakë të fortë, vertikalisht.

Shuplaka më bëri të kuptoj se kisha qëlluar mbi fytyrën time. Të paktën sikur ta kisha shulatur mbi ballë, por jo ... një si zhurmë avioni u dëgjua përsëri rreth fytyrës sime.

Herën e dytë u tendosa i tëri në pritje. Ishte errësirë dhe unë nuk mund të orientohesha dot, sa larg meje zhuzhinte kjo mushkonjë e mallkuar. Por s' pata kohë të mendoj gjatë pasi ndjeva se si një sulm i dytë ishte nisur drejt meje më me vrull. Me një kujdes të veçantë ngrita dorën në ajër ... ndërkohë që po bëhesha gati për goditjen vdekjeprurëse (kuptohet, mbi faqen time), ajo e ndjeu dhe u largua.

Si ka mundësi? Turfullova. Një insekt kaq mikroskopik, të vjen tinës e tinë dhe jo vetëm të prish gjumin, por të bën të hash dhe një shuplakë të dytë? ...As në fëmijërinë e largët nuk mbaj mend të kishte vënë njeri dorë mbi mua .

I zhytur në imazhet e humbura nuk pata kohë për kujtime, pasi një sulm tjetër dhe më i befasishëm se i pari ishte nisur drejt meje me uturimë avionësh.

Insekti i çuditshëm mikroskopik, që nuk dihej nga vinte dhe nuk dihej përse kishte bujtur në dhomën time të gjumit, me sa dukej ngulte këmbë të thithte me çdo kusht gjak nga gjaku im i pakët, qoftë dhe me flijimin e vetë , në këtë aventurë.

Herën e tretë sulmin e saj e prita qetësisht, me dorën ngritur lart, si një njeri i mësuar me sulme të tilla.

E ndjeva në çast. Vetëtimthi mbërriti dhe m'u ul mu mbi majën e hundës...I këpus një tjetër shuplakë... Sa sytë më nxorën xixa.

"Dreq o punë! Jo. Po kjo nuk durohet! ...Ose të ngrihem të nder dritën dhe ta kërkoj gjithandej ose të tërhiqem nga beteja i mundur , duke futur kokën nën batanije.

Nga dy variantet e mundshme unë zgjedha të dytin, në përputhje me karakterin tim tolerant.

Mirësjelljen time insekti misterioz nuk e kuptoi si tolerancë, por si një tërheqje nga beteja. Nisi të trimërohet e të më turfullojë mbi krye, ndërsa unë turfulloja nën batanije duke dëgjuar zukamën e saj. Më ngucte me ngulm që t' i dilja në duel. Më provokonte që të nxirrja kokën nga batanija e të dilja në shesh të burrave..

S'mbaj mend sa kohë qëndrova kështu, me kokë nën batanije, pasi më kishte zënë gjumi.

24 orë më vonë.

U futa në dhomën e gjumit dhe u shtriva për të fjetur. Përsëri e njëjta zukamë... Përgjumësh siç isha m'u krijua përshtypja se kjo mushkonjë nuk duhej të ishte një mushkonjë e zakonshme... dhe se s' bëhej fjalë për një rastësi. Zukatja e saj më kujtoi avionin me dy kamikazë që rrëzoi përtokë dy kullat binjake të Nju-Jorkut.

Në këtë mënyrë dhe me këtë shpejtësi e po kaq beftë u shfaq edhe avioni kamikaz i cili i rrëzoi përtokë dy kullat më të larta të Nju-Jorkut. Po të vazhdoja me këtë paralelizëm, unë isha superfuqia njeri ndërsa ajo.... Kush ishte ajo? Një insekt mikroskopik i mjerë.

"Kësaj here s'ke si më shpëton...i thashë.-Do ta ndreq paq!"

Qëndrova pak çaste në pritje të saj, por ajo, me sa dukej gjendej një cep të dhomës, duke përgjuar me ankth dremitjen time.

Mirë pra. Fillojmë. Sa të të dëgjoj zhurmën në afërsi të fytyrës do të të zgërlaq.

Nëse e quan veten insekt inteligjent, tani do ta marrësh vesh që me mua s'bëhet shaka!

Por insekti misterioz nuk duhej të ishte dhe aq inteligjent , gjersa rrekej të më ulej mbi faqe, pa e kuptuar fare se çfarë e priste.

-"Sidoqoftë nuk duhet të nxitohem, -mendova, -ta lë gjersa të nisë të futi thumbin në mish...kur ta teprojë di unë ç'i punoj." Po mushkonja kamikaz duke përfituar nga hutimin im i rastit , u ul mbi qafën time dhe gjilpërën e nguli në mish.

Po unë ç' bëra? Ç'bëra unë? Unë hëngra sërish një shulakë.

Herën e katër isha tepër i nervozuar, u ngrita, ndeza dritën e dhomës dhe si i çmendur nisa ta qëlloj me jastëk gjithandej, duke bërë një rrëmujë të paparë. Me që jastëkët nuk bënë punë, shkova në banjë, mora shkopin me leckë me të cilin pastrojmë pllakat dhe nisa të qëlloj; në tavan, nëpër mure , kudo ku ajo përpiquej t'i fshihej furisë sime...mirëpo, kur pashë se zemërimi im s'kishte bërë gjë tjetër veçse kishte katranosur muret, u dorëzova përfundimisht.

E mirë pra, me që më vjen shumë gjumë po e praaj dhe kësaj radhe humbjen.

Mbylla dritën dhe si një njeri i arsyeshëm praktikova edhe natën e dytë variantin e natës së parë. Atë të nën batanijes.

* * *

Natën e tretë më doli gjumi në të njëjtën orë që kamikazja kishte orarin e sulmeve.

Ndjeva me tmerr...Ajo nuk ishte larguar. Vërtitej përsëri në dhomën time të gjumit, shëtiste lirshëm si të ishte në shtëpinë e saj. Gjatë ditës unë ia kisha lënë hapur dritaren dhe derën e ballkonit, me qëllim që ajo të largohej. Për një çast kujtova mos ajo sillej në këtë mënyrë me mua me që kërkonte të dilte nga dhoma ime. Por jo. Ajo as ditën e tretë nuk kishte dashur të dilte nga shtëpia ime. E pse të

dilte? Dhoma ime i ka të gjitha mundësitë për të jetuar sa më mirë një mushkonjë. Mos vallë ajo dëshironte të bëhej banore e përhershme dhomës sime? Ndoshta i ka pëlqyer komoditeti dhe ngrohtësia e dhomës së gjumit dhe ka vendosur të mos të largohet më prej saj? Ushqim ka...Gjaku im. "E mirë pra! Të shohim kush do të fitojë...Ti apo unë? Se nuk ka ndodhë kurrë që një njeri i arsyeshëm dhe inteligjent si unë të dorëzohet para një... mushkonje. Është turp ta thuash. Kur e mendon sa e vogël që është! Duhet të ketë një tru tepër mikroskopik. Shumë herë më të vogël se trurin tim. E mbase nuk ka tru fare. Atëherë si ka mundësi ta ndjejë dorën time kur i afrohet? Si ka mundësi ta ndiente fshesën ose shkopin me leckë të banjës?"

Nëse do të përpiqej të më sulmonte përsëri unë do ta lëvizja dorën aq ngadalë... do ta afroj qetësisht pranë saj, pastaj do ta gjuaj. Duhet ta vras. Patjetër. Ndryshe s' më zë gjumi. ..."

Ndërkaq zukama e saj u ndie përsëri fare pranë meje, u rrotullua pak dhe iku sikur bëri rikonjicion terreni U vërtit nja dy herë në lartësi, gjysmë metri mbi fytyrën time, pastaj nuk e di pse vendosi të largohej me aq shpejtësi? Ndoshta u ul vetëm një sekondë mbi flokët e mi. E çuditshme, por , gjithsesi ,duhet të ishte më e zgjuar se unë... gjersa më rrinte larg."

Po qëndroja gati 20 minuta me dorë në ajër, në pritje të bishës së vogël gjakësore. E ndjeja dorën si të mpirë. Dhe çudi? Ajo vepronte kështu për t'u tallur me mua. Sigurisht, duhet ta kishte parë dorën time të zgjatur lart. Dhe për çudi? Me dorën lart unë paskisha dremitur pak... Ç' nuk i ndodh njeriut në gjumë.

"Nuk ia vlen të rri më zgjuar,-mendova, i dorëzuar përfundimisht para insektit të mallkuar. Futa kokën nën batanije dhe ia këputa gjumit.

Netët e tjera u përsërit e njëjta histori. Por unë, si njeri i arsyeshëm dhe me eksperiencë . e ula pak atë krenarinë njerëzore, zbatova taktikën vetëmbrojtëse:" Koka nën batanije".

Nuk e di sa net kalova kështu, me kokën nën batanije..... Kishim bërë një aktmarrëveshje të heshtur. Ajo pranonte të banonte për ca kohë në dhomën time dhe unë pranoja të flija për ca kohë me kokën nën batanije...Sigurisht, një njeri inteligjent si unë, dhe një kafshëz mikroskopike si ajo mund të gjenin një "konsensus",fjalë e re, e mësuar nga politikanët tanë.

Dhe erdhi një ditë që kafshëza gjakpirëse u largua nga dhoma ime e gjumit, në kërkim të viktimave të tjera njerëzore. Dhe unë nisa t'i harroj ato netët tona të bukura të betejave.

Po mbase s'është larguar përfundimisht? Ku i dihet?! I teket të vijë përsëri...? Dhomën time e di. Ia njeh të gjitha orenditë dhe këndet e fshehta. Nuk i dihet. Jo. Jo. Kthehet përsëri, dhe pastaj betejat tona nisin sërish nga e para.

Koha e manave

Ishte muaji maj, koha e manave. Pemë dhe ujëra fshati ynë kishte plot, por mielli mungonte në çdo magje. Gjirokastrën e kishim larg, tre male kaptuar. Fshatarët merrnin rrugën me mushka nëpër male, që herët, pa u shuar yjet. Ishte *koha e Koçit*, thoshin. Kush ishte ky farë Koçi, që e kishte zhytur vendin në dhembje dhe mjerim? Atëherë unë e mendoja si një përbindësh të zi... të zi dhe të fuqishëm si djalli. Shpeshherë na zinte gjumi pa futur gjë në gojë, të lodhur nga lodrat e ditës në një cep të magjërisë, nën dritën e zbehtë të një kandili të vendosur në parvazin e oxhakut. Mëngjeseve na këndonin zorrët. Gjyshja nga nëna, e cila ishte ditë e natë para provimit të urisë, nuk mbante dot me bukë dy burra të rritur dhe katër fëmijë, dy të dajës e dy të tezes, pa llogaritur mua, që shpesh më zinte dreka duke luajtur në Bezhanaj. Nëna më kishte porositur që sa të shihja që shtrohej sofra, të nisesha me vrap e në shtëpi. Mirëpo, gjyshes s'ia bënte zemra të djalin e vajzës nga të tjerët, edhe pse gjyshi shpesh merrte një pamje të ngrysur. Ajo na mblidhte rreth një çanaku. Pesë lugë lëviznin ngutshëm brenda një pjate prej druri ...

- U ngopët?

- Jo! - thërrisnim të gjithë në kor.

- Atëherë dilni dhe mbushni barkun me mana.

Ishte maji i gjelbërimit, i ujërave dhe i manave. Fshati ynë kishte shumë mana. Dhe sikur të dua, s'besoj se mund t'i mbaj mend emrat e tyre. Ata më të lartët i mbaj mend mirë: mani i Hadëre, mani i Lone, mani i Gjonajve, mani i Korkutajve, mani i Eleze, mani i Brahajve, mani i Mehmetajve, mani i Zanajve, mani i Arif Kurupit, mani i Bezhanajve...

Nuk kishte familje pa manin e vet. Edhe pse në familjen e gjyshit kishim manin tonë, një man shtatlartë e degëgjërë, nuk e di pse na pëlqente të hipnim në manat e komshinjve. Në kalldrëmin e ngushtë të Bezhanajve, shfaqej madhështor mani i Kurupe, i lartë gjer në qiell e i mbushur me degë të gjera. Atëherë ai na dukej si mani më i lartë dhe më i bukur i botës. Poshtë tij gurgullonte me zhurmë rrjedha e Ngurrzës, një ujë i ftohtë që rrëshqiste nëpër guriçka e fletë duke reflektuar dritën e diellit.

Mani i Kurupe gjatë gjithë verës mbushej me zogj: çerçele me mijëra, mëllenjat venin e vinin, grifshat na vizitonin më rrallë, vareshin nëpër degë të gëzuara, na shikonin me habi, sa të hapje e të mbyllje sytë, fluturonin, nga mani i Kurupe te arra e madhe dhe e lartë e xha Hivziut. Ndër zogjtë që kam parë në jetë ju them me bindje se cirkoja duhet të jetë shpendi më i bukur i botës. Tani që e sjell ndër mend, kam idenë se është një zog bishtkuq, me një të kuqe si e Onufrit, pendët, diku blu në të e verdhë, diku ngjyrë mimoze..... Zog më të bukur s' më kishin zënë sytë. Lëshonin ca tinguj hyjnorë, tinguj që mund t'i dëgjosh vetëm në maja malesh

dhe maja lisash. Edhe ata që ishin mjeshtër në vrasjen e zogjve, e pranonin që cirkoja ishte një zog i bukur dhe i zgjuar.

Manin e Kurupe e vizitonin më rrallë. Vinin si me ngut, qëndronin pak sekonda në majat e larta të degëve, aq sa të na çmendnin me bukurinë e tyre qiellore. Nga vinin? Ku shkonin? Askush nuk dinte më shumë. Kam dashur disa herë ta kujtoj ligjërimin e tyre dhe mund t'u them vetëm kaq; ligjërimi i cirkove është diçka e rrallë, një melodi ku përzihet trishtimi dhe lumturia...Muzikë parajse.

Sa shumë zogj kishte fshati ynë! I tërhiqnin manat ... Hanin zogjtë...hanim dhe ne, fëmijët e uritur të atyre maleve. Kishim zënë shoqëri me zogjtë. I njihnim dhe na njihnin, vërtiteshin të gëzuar nëpër degë, duke na hyrë në pjesë, sidomos çerçelet me të cilat kishim krijuar marrëdhënie të veçanta. Vinin grumbuj-grumbuj me cicërima të gëzuara duke u hedhur nga njëra degë në tjetrën, vareshin kokëposhtë si artistë cirku me një këmbë. Midis tyre merreshin vesh me dy-tri pasthirrma të gëzuara. Qysh atëherë kam kuptuar që zogjtë komunikojnë me njëri-tjetrin njësoj si ne njerëzit, veçse përdorin pak tinguj dhe i kanë zhdukur pjesët gramatikore, lidhëset, parafjalët, ndajfoljet dhe mënyrat foljore.

Kam qenë gjithmonë kureshtar për ta kuptuar gjuhën e tyre, në ato mëngjese kur ngrihesha herët, pa zbardhur dita hipja në man me llastiqe në duar, guralecët i mbaja në xhepat e pantallonave të shkurtra, prerë nga një beze e trashë. Sa isha i vogël u mburresha shokëve, gjoja dhe unë kisha vrarë ndonjë zog, të them të drejtën nuk kam mundur të vras as edhe një. Një çerçele mund ta kisha vrarë, pasi ato nuk e ruanin veten. As çerçele nuk kam vrarë. E ndieja veten të pazot dhe më vinte inat pse isha kaq i pafat? Një verë kam qëndruar mbi një degë mani, e prapëseprapë s'qulloja gjë...Atëherë ua hidhja fajin llastiqeve, më vonë, sa herë sillja ndër mend këtë fakt, e kuptoja se kjo gjë kishte ndodhur pasi unë i doja shumë zogjtë. Hutohesha pas cicërimave dhe akrobacive të tyre dhe lumturohesha aq shumë nga cicërimat e cirkove aq sa harroja qëllimin pse gjendesha aty, përse e kisha prishur gjumin e mëngjesit. Hera- herës bëja çudi me këto qenie fluturake që siguronin ushqim me mundim të madh, dhe të shikonin në sy, sikur të ishin njerëz.

Kur hyra në klasë të parë dhe nisa të shkruaj me dorën e majtë, kuptova që unë nuk qenkësja mëngjarash dhe i lindur në një familje që s'kishte pushkë.

* * *

Njeriu ka një çast në jetë që i mbetet në kujtesë. Ai çast ka ndodhur kur unë, i ulur mbi degën e manit prisja zbardhjen e një dite të re....Pemët zhvisheshin ngadalë, dilnin nga misteri i errësirës, dhe

unë i fshehur midis gjetheve, në atë fshat të përgjumur e të harruar, falënderoja Zotin që më kishte sjellë në këtë botë. Drita përhapej nëpër fletë, dhe mani vishej në purpur drite. Në ato çaste unë e kam ndier veten zot të qiellit dhe të tokës, zot të manave dhe të cirkove, zot të mëllenjave dhe të grifshave të malit. Mani mbushej me cicërima. Dielli ngrihej mbi ujëra, gjelat zgjoheshin nga dremitja e natës e bashkë me gjelat zgjoheshin zilet dhe këmborët e bagëtive dhe zërat e stanarëve...

Një ditë erdhi në Bezhanaj Efraimi, një kushëri nga nëna. Shtatartë e sykaltër. Sytë i kishin marrë diçka nga ngjyra e qiellit. Godajt kishin stanin më të madh të fshatit, numëronin mbi tetëqind kokë dhi, pa përmendur kopenë e deleve të cilën e kishin në qinosi me stanarë të tjerë. Nomenë e kishin në një shpat mali, thurur me thupra e mbuluar me kashtë. Po të flije ndonjë natë atje, gjatë verës, të dukej se do të merrte era me gjithë nome, dimrave gjëmonin bubullimat. Një natë që kam fjetur në stanin e Drerit më është dukur vetja sikur gjendeshim në luftë, nën një bombardim ajror.

Efraimi kishte marrë nam në vrasjen e grifshave. Atë mëngjes një mëllenjë se nga erdhi me nxit mbi manin e Bezhanajve, qëndroi vetëm dy sekonda, sakaq ai e rrëzoi përtokë me një të shtënë.

-Shko, merre! - më tha, pa lëvizur nga dega e manit

Shkova dhe e gjeta tek përpëlitej, e gjora. Në duart e mia dha shpirt. Më erdhi kaq keq, kaq keq që dha shpirt në duart e mia... Ishte hera e parë që mbaja në duar një mëllenjë të vvarë. E çova me vrap në shtëpi dhe ia lash nënës. Të nesërmen, kur shkova në Bezhanaj, mora vesh që Efraimi ia kishte falur llastiqet Lanit, si më i madhi që ishte. I madh i thënçin... (gjashtë muaj më i madh).

- Tani, - tha Lani, sikur brenda një nate të na ishte bërë mjeshtri më i madh i llastiqeve, mëllenjat dhe grifshat do m'i vras unë. Ju qëlloni mbi çerçele. Si mund ta pranoni një vendim të tillë? Kur pamë llastiqet e reja të tij mbetëm të shokuar. Folla dhe furkaqja ishin ndryshe nga tonat, rripat hapeshin aq shumë sa mund të vrisje një gomar.

- Ju rrini këtu, - tha Lani, vetë kërceu nga një degë në tjetrën dhe zuri një sheshpamje shumë më të mirë nga jona. Sakaq një grifshë erdhi dhe u ul vetëm një çast në një degë që valëzonte lehtë nga era... iu duk se dega nuk e mbante peshën e saj, hodhi një shikim të shpejtë nga ne. (Ç'kërkojnë këta fëmijë në man?!) U ngrit sërish në fluturim. Ne, sikur ta kishim bërë me fjalë, qëlluam të tre njëherësh. Grifsha lëshoi një klithmë çjerrëse, u lëshua dhe ra në ca ferra të dendura, në shkallën e xhaxhait. (shkallë ne u themi rripave të arave). Të gëzuar ne u hodhëm nga mani, gjersa u gjendëm te ferra ku grifsha e gjorë luftonte me fatin e saj të zi..

E zumë, por na doli për hundësh: Midis nesh plasi grindja: “Jo e vrave ti, jo e vrava unë...!”.

- Ashtu? Ua tregoj unë!- tha Lani duke na lënë te ferra si guhakë. Atë çast unë vendosa të mos shkelja më kurrë te shtëpia e gjyshit. Pas disa ditëve në shtëpinë tonë erdhi vetë gjyshi.

-Ku është? - pyeti nënën.

-Ka dalë qysh herët. E ke në majë të manit...

E vura re qysh së largu. Vinte drejt meje me atë ecjen krenare, kishte veshur një xhamadan të zi dhe kilota të leshta, bastunin e mbante të hedhur pas shpine, për të mbajtur trupin drejt. Sa më pa në majë të manit më drejtoi shkopin në mënyrë kërcënuese:

- Pse s’vjen te shtëpia e gjyshit ti malukat? Të ka mbetur hatri, hë? E mora me mend se zënka jonë ishte bërë problem në Bezhanaj. Nisa t’i justifikohesha thatë.

- E mora vesh edhe atë punën e grifshës..., - tha ai sikur të ishte në mendjen time. - Unë them që ti e ke vararë.

Hodhi shkopin pas shpine si të ishte pushkë

Atë mëngjes rastisi të vinte te ne një kushërira e babait, për të qepur një fustan. Ne ishim e vetmja familje me makinë qepëse. Na e kishte lënë një ushtar italian. Gjatë kohës që jetoi te ne, ai e mësoi nënën si të qepte në makinë, kur iku na e la dhuratë.

- Shyqyr që erdhe, - i tha nëna -Unë do të qep fustanin ti do më gjesh një palë llastika për djalin. I është bërë fiksim. As ha e as del nga shtëpia.

Llastiqet erdhën në kohë. I mora dhe i vërtita në duar. Një mrekulli! Tani ta shohë Lani...! Tani ta shihni ju çerçele, ju mëllenja dhe ju grifsha!... Nxitova për në Bezhanaj. Gjatë ditëve të mungesës sime kishte plasur sherri. Gjyshi kishte thirrur me zë të lartë: “O gjeni llastiqe fëmijëve o lanetisuni të gjithë!” Ishin hedhur të gjithë në aksion. Gjyshja kishte shkuar te fisi i vet, në Elezaj: “Na gjeni ca llastiqe se na u çmendën fëmijët”.

Brenda tri ditëve u pajisëm me armë të reja. Të nesërmen drejt e në degë të manit. Binte një diell i bukur, fletët përkundeshin lehtë nga era, çerçelet çuçurisnin gëzueshëm. Llastiqet tona të reja tashmë preferonin mëllenja, grifsha dhe cirko. Sakaq mbërriti një grifshë budallaqe, u ul mbi një degë, përballë llastiqeve tona, hodhi një shikim të trembur dhe ndërroi degë, u ngjiti pak më lart.

- Radhën e kam unë, - tha me zë të ulët Lani.

Bëra sikur pranova, ndërkohë që kisha vendosur të qëlloja unë i pari..Në atë çaste ne mendonin si t’ia punonim njëri-tjetrit. Tri llastiqe qëlluan njëherësh. Na u duk se kishim qëlluar në shenjë.

U hodhëm të tre nga dega e manit dhe frymën e lamë ferra. Lëshonte një klithmë mallëngjyese e gjora, sa të ngjethte mishtë.

-E vrava unë! -thirri Lani.

- Unë! Unë! -thirri Besoja

Unë s'fola fare. Pse të flisja? Isha i bindur që grifshën e kisha vrarë unë.

Besoja e mori grifshën në dorë dhe ia shkeli vrapit duke na lënë të shushatur. Edhe unë vrapova drejt shtëpisë sime: "Hëm! Ta shohësh te gjyshi..."

Premtimin e mbajta vetëm një javë. Ditët nuk rridhnin si më parë. Mëngjeseve qëndroja në manin tim gjersa dielli mbulonte shtëpitë e fshatit. Ditën e tetë e lashë vrapin në Bezhanaj. Më pritën si hero.. Gjyshja ngriti zërin për ta dëgjuar dhe gjyshi... "Erdhi, erdhi!"... Gjyshi nuk doli nga dhoma. Ishte sëmurë. Gjyshja lëshoi një mufkë të madhe, gjoja unë isha më nishanlliu nga gjithë nipërit e saj. Ditët e tjera, bukë e djathë dhe në majë të manit. Në një nga këto ditë gjyshi më përkëdheli flokët gjithë dashuri : "E di ti si e quanin mbretin e zogjve?"- më pyeti "Jo."- thashë. "Solomon.-tha ai. -Ti ke emrin e tij. - Solomoni ka qenë njeriu i vetëm në botë që e njihte gjuhën e zogjve.

Ndaj s'paskam fat në llastiqe.- mendova. Unë paskam emrin e mbretit të zogjve.

* * *

Gjithë verës llastiqet nuk i hoqa nga dora, por fati nuk më eci. Të gjithë e kishin marrë vesh që unë s'ia thosha në llastiqe. Një pasdite hipa në man dhe zura pozicion midis dy degëve. Sakaq, sikur më pruri Zoti një çerçele të vogël, fare të vogël. Erdhi e u ul mbi një degë, dy tri metra sipër meje.

Nisi të hidhej nga dega në degë me cicërime ankuese. E qëllova. Guri i parë i kaloi anash, edhe i dyti. I treti dhe i katërti fluturuan në ajër. Çerçelja nisi të më ankohej me cicërime. Nuk donte të largohej nga dega, bënte ca lëvizje të befta për t'u shpëtuar gurëve të mi dhe ulej sërish.

Sakaq errësira zbriti me shpejtësi. Dridhjet e fletëve nisën të lëshojnë hije të frikshme. Më kapi një ndjenjë paniku...Mos ishte një engjell?... Engjell ose djall?...

Trupin ma përshkoi një rrëqethje e lehtë. Zbrita me nxit nga degët e manit dhe theva këmbët kalldrëmeve.

* * *

Iku dhe koha e manave. Zogjtë nisën të rralloheshin. Ato pak kokrra që kishin mbetur, rastësisht, në majat e larta të manit nisën të thahen e të nxihen.

Mbanin llastiqe të gjithë, mbaja dhe unë, unë që i doja zogjtë. Çerçelet vinin enkas për mua, lëshonin cicërime të gëzueshme dhe bënin lëvizje akrobatike, për të më çuditur. Unë isha vrasësi,

ndërkohë që zogjtë ishin gëzimi im i fshehtë. Unë s'mund të luaja dy role njëherësh: lojën e dukshme të vrasësit dhe lojën e fshehtë të adhurimit. Të gjithë më këshillonin t'i lija llastiqet. Kishte ardhur koha e shkollës.

Ngurza

Ka kohë që unë dhe miku im takohemi çdo mëngjes në një orë të caktuar duke medituar para filxhanit të kafesë, si dy njerëz të letrave të mallkuar me art, flasim për temat e mëdha, për mikrobotën dhe makrobotën letrare, dhe unë, duke dëgjuar mikun tim, kam kohë që verifikoj me kujdes nëse mund të quhet temë e madhe një shkrim nostalgjik për Ngurzën e fshatit tim?

Më është bërë fiksim, sa herë do të shoh mbi tavolina shishe me etiketat “Ujë Trebeshine”, “Ujë Gline” ose “Ujë Tepelene”, Ujë Lajthize, do të më shkojë mendja te Ngurza e fshatit tim, të cilën kam 23 vjet pa e parë. Një ditë vendosa të shkruaj diçka për të: u ula dhe hodha në letër vetëm dy fjalë: “Ngurza...Ngurza ime ! “ Më shteroi frymëzimi sapo u bëra i vetëdijshëm se kështu mund të shkruhet një letër dashurie. E grisa letrën copë-copë dhe e hodha në kosh.

Tani kam ndër mend rrjedhën tënde të qetë nën reflekset diellore, në atë fshat të braktisur dhe të panjohur nga bota...E heshtur dhe pa lavdi gurgullon nën fikun e lashtë të Matajve (në qoftë se ende nuk është tharë...) zbret poshtë duke kënduar, për t’u bashkuar me burimet e tjera të fshatit tim që vrapojnë drejt detit.

Gurgullon pa bujë në të dalë të fshatit Fterë, mbush plot për plot me ujë një rrethore qarkuar me gurë të lashtë të mbuluar me myshk, lëshon një shushurimë të këndshme nën gurë dhe fletë.

* * *

Fshati ynë shquhet për burimet e shumta. 23 burime dhe gurra, nuk janë pak. Ato dalin nga zgavrat e shkëmbinjve si një bekim i vetë Zotit, për këto vende të begata. Por uji i Ngurzës dallon nga ujërat e tjera, së pari, ai është ujë shkëmbinjsh, së dyti, ua kalon të gjithëve jo vetëm për ftohtësi, por dhe për cilësi kurative. Fshatarët e mi e quajnë uji mbret. Ky ujë mbretëron në kujtesën tonë.

Mund të pish sa të duash nga ky ujë dhe s’do të ngopesh kurrë. Do ta ndjesh stomakun bosh, ndërsa në fyt ndien shijen e papërsëritshme të një uji të rrallë.. Mbase dhe e ekzagjeroj pak, meqë unë kam pesëdhjetë vjet që kam ikur nga fshati, por këtë mendim kanë dhe fshatarët e mi që, jetojnë aty, dhe ata që si unë kanë ikur nga fshati prej vitesh e që shkojnë atje herë pas here, për të provuar shijen e këtij uji mbret.

Nëse ju bie rruga nga fshati im, Fterë e quajnë është shumë afër Borshit,pra, nëse ju rastis të kaloni nga ato anë, mos e shuani etjen në burimet e shumta të Borshit, as te burimi i Zonjës...rezistoni dhe pak, gjersa të gjendeni te Ngurza ime e dashur, pastaj hajdeni të më thoni, kisha apo s’kisha të drejtë.

Një mëngjes takova një fshatar që kishte qenë ca ditë te vëllai i vogël, në fshat. Sa më pa, i ndritën sytë: “E more vesh? Ujin e Ngurzës do na e marrin italianët..!. Italianët! Për një çast m’u kujtua koha e luftës. -Janë bërë analizat dhe paska dalë uji më i mirë në Shqipëri...”tha ai. Mos u çuditni, kështu flasin fshatarët e mi. Ne fshatarët kemi një zakon, ekzaltohemi kur dëgjojmë që nga fshati ynë del një profesor i zoti, një mjek i zoti ose një shkrimtar i zoti. Figura të njohura fshati ynë ka nxjerrë boll, po Ngurzës ka vetëm një.

* * *

Dhe të mendosh ; për të tjera burime bëhen reklama televizive, për të tjera ujëra shtypen poste e ngrihen banderola të stërmëdha në kodrat ndanë autostradës, për të tjera burime hidhen paret në erë në kokteje të ndryshme, ku tavolinat mbushen me shishe plastike, me etiketat: “Ujë Selite”, ”Ujë Trebeshine”, “Ujë Tepelene”, “Ujë Lajthize”, Ujë Qafështame”, (uji që pinte vetë mbreti), ndërkohë që, uji i vërtetë mbretëror i Shqipërisë është Ngurza. Po të ishte fjala për punë emrash, mund të shtonim edhe Ujin e Zonjës, që rrjedh në afërsi të Krizës, afër Borshit, dhe që, për mua, është pak a shumë i njëllojtë me ujin e Ngurzës.

Dhe të mendosh që për Ngurzën nuk është bërë asnjë reportazh dhe unë vetë, si njeri i letrave, s’ bërë asgjë për ta reklamuar në gazeta këtë ujë

Sa e sa gjallesa ka mbajtur gjallë, sa e sa pemë ka ushqyer me lëngun e vet të veçantë, sa kuaj e mushka, qe dhe gomarë, dele e dhi, zogj e pula, sa udhëtarë kanë ndalur të pinë te ky burim i freskët , ndërsa ai bën punën e vet, pa lavdi, rrjedh ditë e natë, nuk ndalon kurrë, dimër e behar, në kohë të mirë e në kohë të keqe...S’ dihet kur ka filluar e s’ dihet kur do të mbarojë.

Nëse Ngurza jonë do të kishte sy dhe veshë dhe do të më shikonte aty, sigurisht, do të gëzohej ,por më shumë do të gëzohej po të më shihte së bashku me shokët e fëmijërisë të mbledhur tok , si dikur, duke mbushur kungujt dhe mataratë.

Gurgullonte Ngurza gëzueshëm, posa dëgjonte gugatje zërash fëmijërorë. Një ditë maji bashkësia jonë primitive, “gjaku ynë i shprishur”, me banim në Tiranë vendosi të bëjë një ditë përkujtimi. Vendi i takimit u la te kodrat e Tiranës, pranë sheshit të frashërllinjve. Erdhi dhe dita e takimit me përqaftime, të qara e përmallime, një gëzim i rrejtshëm vezullonte në sytë e të pranishmëve, sidomos më të rinjve. Në një çast nga tavolina e presidiumit u ngrit kryeplaku i fshatit me dy shishe në duar: “A ju ka marrë malli për ujin e Ngurzës?”- tha ai. Për të gjithë ne kjo ishte një surprizë. U sulëm drejt tij me gota plastike në duar, gati e mbytëm. të parët që ia mbërritën të mbushin gotat me ujë Ngurze

shkonin nëpër tavolinat e tyre të gëzuar duke përplasur gotat me ujë “bromb! me ata që kishin nisur rakinë. Në çast të fundit ia mbërrita dhe unë të mbush një çerek gote. Sa e vura në buzë, duke parë shikimin dinak të kryeplakut, m’u prish çehrja, nuk m’u duk si uji i Ngurzës që ruaja në kujtesë. Diçka kishte ndodhur...Mos ndoshta kryeplaku ynë duke ardhur për në Tiranë ishte kujtuar në Lushnjë për të na e bërë këtë surprizë? Largqoftë nëse i ka shkuar mendja në Kavajë... ku uji bie erë dheu. Gjatë kohës së ushtrisë prej këtij qyteti ruaj një kujtim të trishtë, shkova të mbushja ujë te çezma e repartit, një bretkosë e vogël rrëshqiti nga çezma dhe më ra drejt e në gavetën time.

* * *

E mblodha mendjen. Do ta zgjidhja problemin me një kronikë televizive për fshatin tim të lindjes. Me këtë rast do të kishte edhe disa sekuenca filmike me pamje nga Ngurza, për këtë bisedova me një mikun tim, redaktor i TVSH-së, i cili mbulonte kronikat me rrethet.

Ai e priti me interes propozimin tim, lamë dhe ditën e nisjes, e cila, për fat të keq, takoi ditën e varrimit të shkrimtarit tonë të madh, S. K, i cili jetonte në emigracion. Kishte pësuar një infarkt sa kishte zbritur nga avioni, në Rinas. Lajmin e dhanë të gjitha stacionet televizive, si një humbje e madhe për gjithë popullin shqiptar. Komiteti i nderimit të figurave u mblodh në mesnatë. Ceremonia e varrimit do të bëhej të nesërmen në ora 11.00 në sallën e Akademisë së Shkencave. E lamë kronikën për Ngurzën për të asistuar në ceremoninë e varrimit. Në të vërtetë unë nuk kisha ndonjë kureshtje të veçantë për të parë si i përcjell figurat e njohura një shtet i dobët ekonomikisht, dhe as e çoja fare ndër mend të më bëhej dhe mua një përcjellje e tillë, pasi, kush isha unë, një ish-fshatar që edhe pse kishte 20 vjet që jetonte në kryeqytet nuk kishte qullor asgjë për t’u përcjellë me madhësi. Kishin ikur nga kjo botë qindra dhe mijëra figura të njohura pa ceremoni të tilla, pastaj, a i duhet të vdekurit të dijë si e nderojnë të gjallët në çastin e largimit të përjetshëm nga kjo botë? Trupi i shkrimtarit të madh ishte vendosur në mes të sallës, para kamerave dhe personaliteteve shtetërore të veshur me kostume të zinj dhe tepër të pikëlluar. Pjesa më e madhe e tyre nuk kishin lexuar asnjë vepër prej këtij shkrimtari të madh, por, siç e do zakoni: “vdis pa të të dua.” Shkrimtari i madh ishte larguar në vitin 1990, kur vendi kishte shumë nevojë për të dhe ishte kthyer dhjetë vjet më vonë, kur vendi nuk kishte nevojë për të, mbase, pikërisht për këtë gjë fryma e kombit ia kishte rezervuar oksigjenin, duke i bërë një pritje të ftohtë.

-Po Ngurza?, -mendova. Dreq o punë, në një çast kaq solemn të të shkojë mendja te një gurrë uji..? Mbase nga keqardhja që Ngurza ime e dashur vazhdonte të rridhte pa lavdi.

* * *

Tri ditë më pas mora në telefon mikun tim , vendosëm ditën dhe orën e nisjes, por...s'qenkej e thënë. Në Televizionin Shtetëror kishin ndodhur ndryshime. Kishin pushuar drejtorin nga puna, në vend të tij ishte emëruar një djalosh i ri, anëtar i P:D-së, i cili e kishte nisur ditën me planet e punës të redaksive. Kur kishte lexuar "Reportazh për fshatin Fterë" kishte kapsallitur sytë: "Ku bie ky fshat?" "Diku në Jug" "E ç'rëndësi ka ky fshat për t'u pasqyruar në kronikat televizive?" Miku im nuk kishte ditur ç't'i përgjigjej. "E kuptova. tha.- Ja. Kështu i hidhni në erë paratë e shtetit...Me një të rënë të lapsit dhe ëndrra ime ftohu.

Kronika s'u bë dhe tregimi dështoi qysh në fjalinë e parë. Tani që sjellë ndër mend Ngurzën mendoj se çdo njeri e ka një fund, ndërsa Ngurza nuk ka as fillim, as fund.

Punë e madhe se nuk e njeh askush. Ngurza është atje. Gurgullon ditë e natë. Gurgullimën e saj e bekojnë kopshtet dhe arat, e bekon dielli me reflekse ylberesh, e bekojnë njerëzit fisnikë të atyre anëve dhe stanet e bagëtive, e bekon deti që e pret me mall, e bekojnë retë që e presin me padurim, e bekon toka që e pret me brohorimë, sa herë zbret nga qielli uji i saj i konvertuar në borë dhe shi, e ka bekuar vetë Zoti.

Dashuri me shikim të parë

Hyra në sallën e lartë e plot dritë të postës së qytetit të Korçës dhe tërhoqa një fletë telegrami. "Doni të shkruani? - dëgjova zërin ankues të një vajze, në krahun tim të djathtë. Ktheva sytë dhe për një çast m'u duk se krisi diçka në zëmrën time. Pranë meje qëndronte një vajzë flokëverdhe me sy të të kaltër, tepër të ndritshëm. Në atë çast s'ia përcaktova dot ngjyrën e syve. Dy gjimnaziste që qëndronin fare pranë meje, në pritje t'u liruar vendin.

-Sarandë?!- shprehu habinë njëra prej tyre kur patë shkruaja adresën e qytetit tim.

Po.- I thashë. Ktheva kokën dhe sytë më mbetën të shtangur, për një sekondë të vetme, te ngjyra e syve të saj, gurkali, si ngjyra që merr deti gjatë ditëve dimërore me diell.

-Saranda është qytet i bukur.-tha shoqja e vet, sportive, veshur me tuta të kuqe.

-Sigurisht,- I thashë unë me një ndjenjë krenarie.

-Jeni nga Saranda?- pyeti vajza me sy ngjyrë deti.

-Po. Por banoj në Tiranë. Jam student.

I falënderova dhe njëherë për stilografin dhe si rastësisht i pyeta për emrat."Majlinda"- tha vajza me sytë ngjyrë deti. Emrit të vajzës tjetër nuk i dhashë rëndësi.

Në çastin e ndarjes vura re flokët e saj, bishtkali si të lyer me lëng trëndeline, të gjata gjer në bel. Harrova t'ju them, unë atëherë punoja si zhalonist me një ekip topografësh në Rehovë . Kishim zbritur në Korçë për të blerë ca gjëra.

Shokët e ekipit më prisnin në makinë. Rruga gjer në Rehovë ishte e keqe por shumë e bukur. Ajër i freskët, pisha, male...Tokat e porsa çara shkëlqenin si pasqyra që avullonin nën diell.

Ato ditë punuam 12 orë, pa pushim. Dëlnim herët dhe ktheheshim në mbrëmje, të dërmuar. Mbrëmjet i kalonim duke lozur me letra. Lojën me letra unë nuk e kisha qejf. Shakara s'dija të bëja , që qëndroja si i huaj në shoqërinë e tyre.

Herë pas here kujtoja atë...Majlindën. Profili i saj më ngatërrohej me siluetën e një bajameje të lulëzuar.

Në një nga këto mbrëmje pyeta inxhinier Faikun :

-Kur do të kthehem?

-Të dielën në mbrëmje jemi në Tiranë.-tha ai.

Kjo gjë më mërzi shumë. S' do të ndalonin në Korçë, s'do të kisha mundësi ta shikoja Majlindën. Ditën e tretë punuam nën një diell përvëlues. Faiku tha se një ditë e tillë e nxehtë ndillte shira, ndaj duhej të nxitonim.

Ditën e tretë punuam në një faqe mali, nën një pyll me pisha të reja. Tek lëvizja nën to me zhalon në supe, ndjeja rrezet e diellit të krijonin rreth nesh një mjegull drite.

Mbrëmjen e natës së katërt u ndjeva keq. Më kapi një mërzi, kot. Fillimisht mendova se më kishte marrë malli për familjen. Por jo. Më

kishte mbetur në mend Majlinda dhe nuk ushqeja asnjë shpresë se mund ta takoja. Kujt t'i hapja zëmrën?

Ditën e pestë punuam poshtë, te lumi.

-Drejt...Anash...Nga e djathta...Edhe pak... Aty! A-aty!

Urdhrat e inxhinierit i dëgjoja si i mpirë. Kisha disa ditë që reagoja plogët.

Majlinda më kishte rënë në kokë. Si nuk ia mësova mbiemrin, as adresën...? Atë mbrëmje, gjatë rrugës për në fjetore gjendjen time shpirtërore ia rrëfeva inxhinier Faikut. Ishte një tip që s'kishte haber nga këto punë. "Të mbarojmë punë, dhe në kthim u themi shokëve të ndalim disa orë në Korçë."-tha ai.

Të shtunën pasdite mbaruam piketimet. Gjatë mbas ditës hodhën në planshet gjithçka kishte të bënte me terrenin dhe të dielën në mëngjes u nisëm për në Korçë. Shqetësimin tim Faiku nuk ia tregoi askujt, as të nesërmen dhe as më vonë.. Kjo gjë më pëlqeu, dhe më bëri ta respektoj dhe më shumë. Më vonë kam menduar se ai mund ta kishte harruar fare atë histori romantike.

Sa mbaruam së drekuari në restorant "Moska", i kërkova leje inxhinierit për të dalë në qytet. Ishte një mesditë me diell të fortë..U vërtita rrugicave karakteristike të Korçës, me shpresë, mos rastësisht e takoja... Majlindën ose shoqen e saj me tuta të kuqe.

Nisi të më brente shqetësimi se po më ikte dhe shansi i fundit për ta parë. Në një moment më pëlqeu fakti që ajo, në një orë të tillë nuk endej rrugëve. Vendosa të pyesja ndonjë kalimtar të rastit. Po ç'dija unë më tepër veç emrit të saj?

Tek afishet e kinemave vura re një çunak truphollë, kishte ndalur dhe vërente me kujdes fotot e aktorëve. Iu afrova, i kërkova ndjesë që po e shqetësoja dhe i hapja zëmrën.

-Majlinda..?!- u bë kureshtar ai.-Një bionde?

-Po. -Me sy të kaltër ? -Po. Po. Ka një shoqe me tuta të kuqe.- nisa t'i shpjegoj unë me gjallëri. -Ah! Veronika, -tha ai. Duhet të jetë. Majlinda Treni. Atë ka shoqe të ngushtë. Po ju çfarë kërkoni? Shtëpinë e saj? -Po. I thashë.

Djaloshi u tregua i gatshëm të më ndihmonte. U shkëputëm nga rruga kryesore dhe iu ngjitëm një rrugice që të çonte për nga Panda. Në fund të saj është një plep i vetmuar, prej andej të shfaqen para syve çatitë e kuqe të dy vilave të vetmuara, të ngritura në kodër, me një sheshpamje nga ku duket gjithë Korça.

Rrugës mësova që djaloshi quhej Goni (Agron) dhe ishte në vit të dytë gjimnaz. Ndërsa Majlinda në të tretë gjimnaz, vajzë e vetme e një tekniku në uzinën mekanike, nëna e saj edukatore në kopsht. Ndërkohë që kishim arritur në fund të rrugicës, djaloshi ndali befas dhe më pa me shqetësim.

-Harrova të të them...Do të gjeshe belanë me Noken...

-Kush është ky Noke? Vëllai ?

-Kjo është e keqja ,tha ai. -S'ka një vëlla që t' ia bënte hundët përshesh.

-Kujt?

-Atij pra. Nokes.

-Po pse?

-Si pse? Ai është i tmerrshëm. Apo s'ka një grusht të rëndë. Një herë të të qëllojë të lë shakull në tokë. Dëgjomë mua. Më mirë hiq dorë nga Majlinda. Do gjesh belanë me Noken...Para disa ditësh ai bëri hundët përshesh një maturanti, te porta e gjimnazit.

I tha: " Mos të të shoh më ta shoqërosh Majlindën se të piu e zeza!"

-Po ai ç'ka me të?

-Hiç. E do vetë. Para një viti u rrah me një aktor të teatrit që vinte për të takuar Majlindën. Për këtë gjë e përjashtuan nga shkolla.

-Po Majlinda?

-Majlinda, hiç...Ç'të bëjë? E ka frikë sa s'bëhet. Por dhe nuk ia prish. Kur del nga shkolla e thërret. Ajo ndalon dhe shkon si delja te ujku. Apo s'ka një surrat...tërë puçra , me nofulla të dala si shimpanze, si Kuazimodoja i Parizit . A do të dish se çfarë i thotë kur e takon.?

-Po. Po.

- E shikon si trim, pastaj i thotë: Të ka ngacmuar njeri? Jo.- i thotë ajo...-Po të preku ndonjë nga ata kërrmat, më thuaj mua. Ua bëj hundët përshesh!" Rrotullon kokën duke parë i krekosur gjithë qytetin, sikur gjithë qyteti të kishte hallin e Majlindës.

Nga sa po dëgjoja më ra plotësisht ai entuziazmi i parë. M'u errësua pamja. Ndërkohë që s' dija si mund të më priste ajo. Ja dhe Nokja tani. E pyeta për prindërit. Ç'qëndrim mbanin.

Ç' të bëjnë?. -tha ai. -I ati i saj ka folur disa herë të ëmën e Nokes. Babai i ka vdekur. Ç'është e vërteta, Nokja është njeri i ndershëm dhe zemërmirë. Fundja kujt i bën keq në se i është tekur të mbrojë Majlindën? Të atit të saj jo.

-Ama, Majlindës po ia bën jetën skëterrë..

- As Majlinda dhe as shoqet e saj nuk e kanë dhe aq frikë. Nokja e mban veten si më të fortin e qytetit. Dhe vërtetë, për grusht ia thotë. Po e ngacmove të piu e zeza!

Kishim mbërritur te fundi i vilave dykatëshe, kur ai tha: "Ja shtëpia e Majlindës".

Një vilë e vjetër me një kopsht të vogël ku lulëzonin trëndafila dhe tulipanë. Atë çast ndjeva emocion. Gjendesha aq pranë saj. Mund edhe të na shikonte, në se na vërente nga dritarja. Me një shikim të shpejtë rroka gjithë atë pamje; gardhin e drunjtë, deriçkën, lule dredhëzat që vareshim mbi murin e oborrit dhe mbi portë ...Dritarja e saj ishte e mbyllur. S' pipëtinte asgjë. Thuajse në këtë shtëpi, mes gjelbërimeve nuk jetonte askush. Ecëm më tutje për të mos rënë në sy. S'kishim bërë as 50 metra, kur Goni më shkundi nga krahu:"Nokja!" Pëshpëriti zë të ulët. Aty te gardhi ishte Nokja me

dy shokë të tjerë. Mbështetur pas gardhit me cigare në buzë. Kur u kaluam pranë na vërejtën me kujdes.

I hodha një shikim të shpejtë kundërshtarit tim dhe e fiksova mirë. Kishte pamjen e një qeni të rrahur e të lagur në shi, hundështypur e me mollëza të kërcyera, i shkurtër por i lidhur fort mirë në trup.

Më erdhi pështirë kur mendova se ai shëmtirë mund të quhej kundërshtari im e që e donte dhe ai Majlindën sipas mënyrës së vet, duke rrahur me grushte të tjerët.

"Po Majlinda ?"... Një ndjenjë xhelozie më përshkoi trupin kur mendova se unë isha i pazoti të hyja në psikologjinë e një vajze të bukur. Kur u kthyem sërish nga kishim ardhur u dëgjua zëri i njerit prej tyre:

-E Goni, pse s'flet?

-S'të pashë.- u shfajësua Goni.

Ai tundi kokën i pakënaqur, sikur të thoshte "mos m'i hidh mua ato I vetmi ngushëllim për mua mbetëj Agroni, të cilit nuk di pse, ndoshta nga kureshtja apo dhe keqardhja, në ato pak minuta njohjeje i kisha hyrë në zëmër dhe e kisha bërë të jetonte me shqetësimet e mia.

-E gjeta,- gati sa s'thirri Goni, kur ne kishim lënë rrugicën dhe po ecnim drejt rrugës kryesore.- Do të më lësh adresën. Qysh nesër do të gjej rastin t'i flas për ty.

-T' i shkruaj një letër?

-Letra bie në sy...Ndoshta s' e pranon fare.

* * *

Muajt e tjerë i kalova në Sarandë. Dielli i verës në Sarandë është verbues. Mbrëmjeve ngushëllohesha me murmurimat e detit dhe madhështinë e tij. Shpesh e braktisja qytetin, vrapoja në drejtim të Çukës të ngopja sytë me detin e grunjërave. Pas dy muajve më erdhi një letër nga Goni. Më shkruante se e kishte kryer porosinë që i kisha lënë. Kishte takuar Majlindën dhe ia kishte treguar të gjitha. Ja ç'më shkruante :

Ajo në fillim u çudit .Pastaj më dëgjoi me vëmendje, kur unë i tregova për varavingon e asaj të diele.."-Uaa!, Sa keq po më vjen...Tani po më kujtohet kush është...Po unë s'i dhashë asnjë shkak....Sa keq po më vjen..."(këto ishin fjalët e saj) Kur deshi të largohej i thashë: Sikur t'i dërgonit një kartolinë? Ajo e trembur ngriti supet "po unë nuk e njoh fare..."

-Mirë atëherë, po i shkruaj unë një letër...Po çfarë t'i them ?

-Unë vërtet mund t'i kem pëlqyer atij, por kjo s'ka lidhje me mua. Në do ta dish ti, unë ju pashë atë ditë që ju kaluat nga shtëpia ime.. tha ajo dhe vrapoi pas shoqeve që e prisnin pak më tutje.

Letra më gëzoi dhe më dëshpëroi. Vrava mendjen përse fillimisht ajo kishte bërë sikur ishte çuditur, ndërkohë që na kishte parë atë mesditë. Këtë shqetësim e zgjidhi letra e dytë:

I dashur si vëlla, Gëzim!

Sot që po të shkruaj këtë letër më kapi Majlinda në korridor të shkollës. Bisedën me të po ta shkruaj fjalë për fjalë:

-E Goni, ç'kemi?-Hiç.-Ftohtë unë sikur i mbaja mëri.

-Ia dërgove letrën atij?

-Kujt?

-Atij pra. Sarandjotit.

-Aa, e ditke që qenka nga Saranda?

-Ti vetë the...-Mundet.

-S'mbaj mend..Po ti pse pyet?

-Çfarë i shkrove për mua?

-Ke interes ta dish?-Natyrisht...

-Shumë mirë. Do t'i dërgoj një letër tjetër dhe do t'i them që dhe ti interesohej për të.

-Po ti, nga e njeh atë?

-E njoha atë ditë, kur vinte vërdallë të të takonte.

-Pra, as ti nuk e njihke mirë....

-Unë atë e kam si vëllanë tim,- i thashë i vendosur.-Ashtu?! - u prek ajo.-Po si e quajnë?-Gëzim. Po ti pse pyet? Do t'i shkruash?

-Jo. Jo. Shkruaji ti,-tha ajo dhe vrapoi për në klasë.

Letra e dytë më gëzoi shumë. Agronit i ktheva përgjigje qysh atë ditë.. I futa brenda dhe një letër për Majlindën. Kishte hyrë muaji qershor. Gjatë gjithë qershorit nuk mora asnjë përgjigje. Në ditët e para të korrikut mendova të shkoj vetë. I hipa një kamioni mallrash , përmbi karroceri, dhe në mesditë u gjenda para dyerve të gjimnazit. Për fat, ora e fundit e mësimit ende nuk kishte mbaruar. Ra zilja. Te porta iu luta një nxënësi të më lajmëronte Agronin , ndërsa vetë u vërtita rreth territorit të shkollës me një ndjenjë ankthi. Pas pak ndjeva nga pas zërin e Agronit.

-Po ti!?- tha ai pa u besuar syve?

U përqaftua si dy miq të vërtetë.

-Bëre mirë që erdhe, -më tha.

Unë drejt e në temë:"Majlinda ç'bën?"

-Mirë. Tani do të dalë...

Vura re grumbullin e nxënësve që lëviznin drejt portës dhe trupin ma përshkoi një valë e ngrohtë:" Kishte ardhur çasti ta shihja përsëri."

-Mos të rrimë këtu. Të ecim pak më tutje.

Ashtu bëmë. Ecëm para në qetësi drejt rrugës nga ajo do të kalonte. I lamë të tjerët të na parakalonin dhe ndaluam në kthesë..

-Ja. Po del! -tha Agroni, duke ma bërë me sy të shikoja nga deriçka e murit rrethues të shkollës.

Vërtet...Majlinda po vinte drejt nesh duke rrezatuar përreth dritë dhe gjallëri.

-Si thua ti?

-Unë them ta ndalësh. Jam i sigurt që do të ndalojë.- tha ai.

Ndërkohë Majlinda na kishte dalluar qysh së largu. U kuptua nga ngadalësimi i hapave.

U zbeh në fytyrë. Nisi të lëkundej. Kur ajo ndaloi hapat dy shoqet e saj që e shoqëronin diç pëshpëritën midis tyre, pastaj bënë para drejt kthesës ku i prisnim ne, sikur të mos kishte ndodhur gjë.

S'ishte nevoja të shqetësoheshim fare, nëse do të ndalonte ose jo, pasi ato të tria kishin vendosur të na takonin. Kur nuk na ndanin as shtatë- tetë hapa unë i dola para.

-Si je, Majlinda?

Ajo s'foli fare. Më hodhi një shikim të shpejtë, më pas uli kokën e u bë lulëkuqe.

-Kur paske ardhur?- pyeti pas pak ajo, si mblodhi veten, me një zë të hollë e të bukur.

-Ja, tani.- I thashë unë.-Të kam dërguar një letër me Gonin.

-Po .-Tha ajo. Një "po" e bukur, e pastër e tingullt. Vura re që dy shoqet e saj kishin kohë që më vërenin me kureshtje dhe dashamirësi.

-Kur do të ikësh?- mundi të pyeste ajo.

-Nesër.- I thashë unë.

Përsëri heshtje. Njëra prej shoqeve të saj e tundi lehtë në bërryl. Atëherë ajo zgjati atë dorën të hollë dhe delikate dhe tha:

-Po iki.

-Si? Kaq shpejt?...u gjallërova unë.

Ajo vuri re trishtimin tim, por nuk foli fare, veç e la për ca kohë dorën e saj të lirë në dorën time.

-Nuk do të dalësh ?

-S'e di. Do të mundohem.- tha ajo dhe përherë të parë ngriti sytë. Rrudhi vetullat me një trishtim të lehtë dhe më pa me dhimbsuri. Ishte po ajo pamje që më përshkruante Goni në letër.

-Mirupafshim!- I thashë unë.-Të pres...

U ndamë dhe me dy shoqet e saj dhe i përcollëm me sy gjersa të tria vajzat humbën pas kthesës së pallatit.

-Mirë...Hë.-ia bëri Goni i kënaqur nga ky takim i këndshëm. Në këtë mes shihej dhe ndihma e tij.

Ende s'e kisha mblodhur veten nga lodhja e gjatë e rrugës, nga tallandisjet e kamionit dhe tortura e arsyetimeve kur, si për çudi, gjithçka kishte përfunduar me sukses. Më dukej sikur më kishte

përshkruar gjithë qenien një puhizë e lehtë, më kishte lehtësuar, qetësuar, freskuar e lumturuar kaq shumë, kaq shumë.

-Si? Domethënë dhe ajo më dashka?!-mendoja me vete tek ecja rrugës së bashku me Agronin, i lehtësuar plotësisht nga ndjenja e vjetër e ankthit. Pas pak u ndava me Gonin. E lamë të takoheshim pas një ore. Për çudi, ai erdhi para kohe dhe më gjeti te kafja nën hotel..

-Ah! Lere...E kemi piks punën. Sa u ndava me ty më kapën shokët e Nokes.

-Edhe?

-A nuk e di ti mor gdhe, më thanë, se sa t'ia çojmë në vesh Nokes ke për të ngrënë një dru...Bashkë me atë tironsin...

Mua më ra humori krejt. Vesha xhakëtën dhe pas pak u gjendëm së bashku në rrugë.

I ramë shëtitores përmes, kaluam midis pallateve të reja me tulla të kuqe dhe iu ngjitëm një rrugice të asfaltuar anash me shtëpiza të ulëta. Sa u futëm në rrugicën që të çonte te vila e Majlindës na dolën shokët e Nokes dhe na prenë rrugën.

-Hë, mo Goni...Nuk ia paske dhënë porosinë mikut.

-Lëre Gonin!- thirri ndërkohë Nokja, që po vinte drejt nesh me një pamje të krekosur.

-Me ty kam pak punë.-M'u drejtua mua gjithë mllef.

-Ikim! Tha Goni. S'pati kohë të lëvizë pasi Nokja e kapi për mënge dhe e flaku tutje.

-Këtu urdhëroj unë! Me ty kemi punë më vonë...Tani mbathja!...Ti tjetri mos lëviz!

Unë qëndrova në pozicion të qetë , i gatshëm për t'u ndeshur në çdo çast.

-Pse e nget Majlindën?

-E kam të njohur,- u mundova të shpjegohem unë.

-Të njohurën e sat ëme!- ma priti ai duke më kapur nga jaka e këmishës.

Ndërkohë po mundohesha t'i shkëputesha nga duart hëngra një grusht të mirë turinjve sa më nxorën sytë lot.

"-Unë të marr shpirtin! Lepur! Teveqel..."Deshi të ndërhynte Goni por një goditje e papritur e bëri të fluturonte tre-katër metra larg nesh.-Ngordhësirë...Këllirë...! Kur të shohësh majën e veshit ke për ta parë Majlindën. Pa le, na shitke dhe mend se qenke çun tirane...Keni rënë nga qielli ju, tironsit.

Ç'të bënim? Deshëm s'deshëm u kthyem përsëri nga kishim ardhur, gjithë vrer."Të të dalë një i marrë dhe të të thotë: "Do ajo po s'dua unë... Kësaj ç'i thonë?"

-S'thua që shpëtuam paq...-tha Goni.-Para nja jave, ja ky Nokja, ia bëri turinjtë përshesh një tekniku gjeolog që desh t'i vardisej Lindës.

"Mirë ia ka bërë, thashë me vete. I keq, i keq ky Nokja, por ca gjëra i bën mirë. Ja. Nesër unë iki ...Eshtë Nokja që s'lë njeri t'i vardiset

.See... Ua bën hundët përshesh...Sa të ishte gjallë "bobi" mund ta bëja gjumin rehat. Majlindën nuk do të ma trazonte askush.

Atë mbrëmje e humbëm shpresën për ta takuar. Të nesërmen dolëm që herët te stacioni i pritjes së udhëtarëve. Kisha një shpresë se ajo do të vinte .Sigurisht. Dhe kështu ndodhi. Në çastet e fundit, kur e kisha humbur fare shpresën, e pashë që larg. Po vinte drejt nesh e shqetësuar...e shoqëruar me atë shoqen me tuta të kuqe.

I dola para dhe i shtrëngova dorën fort, gati për t'ju hedhur në qafë.

-E dija që do të vije...

-Ua!- tha shoqja e saj,-Lindën nuk e ka zënë gjumi, tërë natën.

Majlinda nuk foli asnjë fjalë. Dukej që ishte më autoritarja ndër shoqet...Dhe më e bukura. Fytyra i kishte marrë një nuancë të kuqërremtë, sytë i dukeshin si të mbuluar nga vesa e natës, plot shkëlqim. Përparësja e zezë prej gjimnazisteje ,me atë jakën e bardhë i kishte kaq shumë hije...dhe ai bishti i kalit, i gjatë gjer në bel, i lidhur nga pas me një fjongo të bardhë. Dukej e bukur dhe e urtësuar. Hoqi nga gjoksi i saj një stemë që mua nuk më kishte rënë në sy dhe ma vendosi mbi xhaketë

-Faleminderit....- Do ta ruaj si një kujtim të shtrenjtë.-Në ndarje i thashë:-Do të më marrë malli...

-Më shkruaj,- tha ajo, në adresë të Gonit.

Për herë të parë më thirri në emër....

-Të ndahemi, Gëzim...

E ndoqëm me sy gjersa ajo ktheu kokën dhe na përshëndeti për herë të fundit me dorë.

Si qenka dashuria! Mendoja me zëmër të lehtësuar. Ja, ajo vajzë e bukur me flokët bisht kali që po zhduket në sfond, është imja.

* * *

Gjatë qershorit s' mora asnjë letër . Në fillim të Korrikut mora letrën e saj të parë. E hapa me një frymë. Shkrimi i saj , fjalët e saj...Por s'qe e thënë të mbyllej kështu .

Ishte data 15 gusht...Sa isha kthyer nga fshati. Letrën e saj e gjeta mbi komodinën time. E hapa dhe e lexova me një frymë. Më shkruante se ishte mërziur shumë dhe se ditët i kalonte mbi qëndisma dhe mbi libra...Dhe se, ai Nokja ishte bërë tepër i bezdisshëm. Në shoqërinë e tij kishte futur një djalosh me kitarë, vinin e këndonin pranë shtëpisë së saj, me ca zëra qaramanë, këngën e Magdalenës: "O Magdalena, Magdalena..." Babai i saj ia baskishte bërë benë se do të lajmëronte policinë.

P.S: *Babai vazhdon të ngulë këmbë në fejesën time me një komshi... Eshtë një oficer marine...Kam shumë frikë...Eja më shpëto...! Të lutem! Të uth. M..."*

Në fund të letrës vijonte një shënim i shkurtër me një P. S. përsipër : *"Prindërit duan të më fejojnë..."*

Çudi. Ajo vajzë aq e druajtur më puthte në letër.

Në përgjigje unë i shkrova një letër moraliste, të gjatë, më të gjatë se e para, ku i thosha se duhet të duronte, dhe se prej saj varej e ardhmja jonë. ...e të tjera si këto..Kërkesës së saj për t'u takuar s'iu përgjigja fare. Ne atëherë ishim ngushtë ekonomikisht. Gjashtë fëmijë...Vetëm me një rrogë të babait. Nëna s'kishte punuar kurrë në punë të shtetit. Unë, si më i madhi, e që mund t'u vija në ndihmë, synova studimet e larta. Pas një jave më ktheu përgjigje. Një letër e shkruar nxitimthi dhe pa kujdes.:

I dashur G....Eja sa më parë! Letrat e tua m'i ka gjetur bab.Është bërë si i xhindosur. Mbrëmë deshi të më qëllonte, por s'e la mami. "Ah! Kjo qenka...- tha.-Ndaj s'të pëlqen djali që të kemi gjetur...Atë do të marrësh dhe pikë! " Sot, tërë mëngjesin kam qarë. Kam shumë nevojë për ty...Eja sa më parë..."

Kaq . Asnjë fjalë më tepër. Ç'të bëja? Unë, siç ju thashë, nuk mund të shkoja dot. Dhe as që mund ta ndihmoja ndryshe, veç t'i shkruaja një letër tjetër moraliste, duke e këshilluar të kishte durim dhe të bëhej e fortë. Se kështu dashuria jonë vihej në provë...Shumë mirë. Por unë dërdëllisja kot, duke kujtuar se e ndihmoja duke i thënë: Forca! ...Forca! Aq më tepër kur mendoja Noken...Më kapte një trishtim që s'di si ta shpjegoj. Herë-herë më dukej se kjo dashuri, pikërisht prej tij, do të kishte një fund të keq. Por jo. Nuk ndodhi ashtu.

* * *

14 shtator. Kjo datë më është ngulitur në mend si një ditë tërmeti ose si diçka më tepër. Ishte pikërisht data 14 shtator kur unë mora një letër prej prindërve të mi. S' kishte kaluar as dy javë që isha larguar nga shtëpia për në fakultet. E hapa me padurim. Brenda saj një letër tjetër. Ma dërgonte Agroni...Hëm! Ç't'ua zgjas më tepër këtë histori trishtimi. Më shkruante se ajo ishte martuar...Po. Po. Kishte marrë fund gjithçka. Dhe dashuria ime dhe letrat e mia...dhe Nokja...dhe ai gjeologu...dhe kitaristi i fundit...Kishim marrë fund të gjithë. Majlindën e kishte rrëmbyer një oficer marine, ai që kishin dashur t'i jepnin prindërit e saj. Si mund të ndodhte një gjë e tillë, mund të thotë secili nga ju...Mund të mos gjendet asnjë arsye, por ja që kjo ndodhi. Në letrën e vet Goni nuk jepte asnjë shpjegim.

Çfarë trishtimi. Kur mendon se e gjithë kjo histori do të më mbetej enigmë për një kohë të gjatë. Nisa ta ngushëlloj veten duke menduar: "Zëmër vajze...kush i njuh gjithë labirintet e tua...". Por jo. Diçka tjetër më e madhe duhet ta kishte shtyrë atë vajzë aq të mirë të shtyhej drejt një aventure të tillë. I vetmi ngushëllim në atë qytet

ishte Nokja. Ikjen e saj edhe ai duhet ta kishte ndjerë me dhimbje , si unë. Ndofta ai dinte diçka më shumë. Po ç'rëndësi kishte kjo? Ajo tashmë quhej një vajzë e martuar, dhe unë duhet ta hiqja nga mendja. Ta harroja përgjithmonë. T'i harroja të gjitha, të gjitha....Kujtimin e saj.... Sytë e saj ngjyrë deti dhe atë bishtin e kalit... Duhet të gjeja një mënyrë harrimi për të mos e torturuar më veten me imazhin e saj. Ah! Diell marsi, që lind me rrokopujë shirash dhe vdes në vjeshtë, si kjo histori e shkurtër e dashurisë sime të parë...

* * *

Rasti e solli të takoheshim sërish. Kjo ndodhi 20 vjet më vonë, pikërisht në qytetin e Sarandës.

E njoha rastësisht në plazh ,mes qindra pushuesve të tjerë dallova profilin e saj. Ishte e shtrirë në rërë,i kishte kthyer fytyrën diellit.

Pasi u takuam dhe pas disa bisedave të rastit, kur unë e pyeta për atë veprim të pamenduar të 20 vjetëve më parë, ajo më hodhi një shikim dashamirës, heshti një hop, më pas tha:

-A e di si më duket?

-Si?

-Sikur gjithçka thoni ju ka ndodhur vetëm në ëndërr...

Sytë i kishte të përqendruar diku, në një pikë të pacaktuar mbi sipërfaqen e ujit, ose në horizontin blu. Më pas sikur u gjallërua, më tregoi me dorë dy vajzat e saj të rritura që loznin me valët, ndiqnin njëra-tjetrën përgjatë bregut.

Çfarë mund ta ruajë një kujtim kaq gjatë,veç një dashuri që lind me shikim të parë...?

Arsimtare e Lurthit

Lurthi është një fshat malor, i rrethuar nga male gjithandej, me lisa të lartë e shtëpi me çati druri, tepër të pjerrëta, për të përballuar peshën e dëborës gjatë muajve dimërorë.

Rruga automobilistike nuk kishte shkuar gjer në fshat, kështu, mua m'u desh të bëja disa kilometra në këmbë, nën një shi të imët e me erë të vazhdueshme. Rruga ishte krejtësisht e zhveshur nga pemët, nuk gjeje strehë për të futur kokën. Kur mbërrita në qendër të fshatit isha qullur tërësisht. Ndërkohë që u futa në dyqanin e kooperativës, njëkohësisht me mua hynë me vrull dhe tri vajza, duke shkundur flokët e qullura mbi banak, tërë gjallëri.

-U munduat më kot,- dëgjova t'u thotë shitësi i dyqanit.- Nuk kemi pasur furnizim.

-Kur vjen?- pyeti njëra prej tyre me një aksent shkodran.

-Presim.-tha ai duke rrudhur ballin. Pastaj shtoi.- Mësuesi i fizikës s'ju ka ardhur akoma?

-Jo.- ia ktheu vajza me aksent shkodran.

Vajzat kthyen kokën nga unë dhe më panë me vërejtje. Mos isha unë ai mësuesi i fizikës që prisnin të vinte nga qyteti? Njëra prej tyre u afrua te banaku dhe e pyeti shitësin zë ulët.

-Ky shoku kush është?

-Jam një gazetar nga Tirana,- ndërhyra unë për t'ia shuar kureshtjen.

- Keni ardhur të shkruani për fshatin tonë? Sa mirë. - tha ajo që kishte qëndruar larg meje, duke kërkuar me sy diçka, në xhamin e banakut.

-Ua ! Ju jeni bërë qull...Si do t'ia bëni...?

Unë heshta në mëdyshje.

Të njihemi.- tha vajza me aksent shkodran.-Ne jemi tre arsimtare e Lurthit. Mua më quajnë Angjelina. Kjo është Lumja , kjo tjetra Vjollca.

-Edhe unë jam nga Tirana, -tha Vjollca e gëzuar, duke më shtrënguar dorën për zemërsisht, si të kishte takuar një të afërmin e vet.- Jam mësuese letërsie. Sa mbarova fakultetin më emëruan në Shkodër. Me që në qytet s'kishte vende më emëruan këtu, në Lurth. Po hë! Ç'kemi nga Tirana? -pyeti ajo e mallëngjyer,-Kam gjashtë muaj pa ardhur.

Ajo që më bëri përshtypje në atë çast ishte vajza që e quanin Lume. Vinte më e ndrojtur se dy shoqet e tjera, kishte një shprehje fëmijërore dhe një hundë të bukur, me majucë.

-Në s'ju vjen rëndë ejani nga ne, -më ftoi Vjollca.

-Ah! Po.- u kujtua tjetra. -Ne kemi dhomën e Elezit.

Propozimin e tyre e pranova pa drojë. Shi në atë çast kuptova që isha nisur nga Shkodra kuturu, pa ditur kush më priste dhe ku do të sistemohesha.

Vajzat u gëzuan. U përshëndetëm me shitësin dhe u bënë gati të dilnin. Te dera Angjelina më zgjati çadrën e vetë.

Çadrën mbajeni ju,-tha ajo.

-Në asnjë mënyrë,-kundërshtova unë.-S' kam ç'të lagem më tepër.
E para doli tiranasja.- Ejani goca! - U thirri shoqeve.-Ejani dhe ju.-
Pastaj m'u drejtua mua. Po ju... s'na thatë asgjë për veten tuaj? Si ju quajnë?

-Besnik, -i thashë unë.-Besnik Dafa.

-Ah. Po .Kemi lexuar diçka nga ju. Nuk e mbaj mend çfarë. Do të na e kujtoni ju më vonë. E po, ejani, goca,- u thirri vajzave të tjera që hezitonin të dilnin në shi. Ejani dhe ju, shoku Besnik, tha ajo dhe, pa e zgjatur, më futi krahun natyrshëm. Papritur u gjenda nën çadër, në mes të tri arsimitareve. Kur mbërritëm pranë ndërtesës së shkollës Vjollca me Angjelinën u shkëputën dhe vrapuan të parat. Mbeta në çadër vetëm me Lumen.

-Pse më lanë mua në çadër?- u ankua ajo. Fliste sikur këndonte.

-Të gjetën si më të vogël. - I thashë unë pa menduar.

Ishte diçka e mrekullueshme të ndjeje shikimin e saj depërtues me bishtin e syrit.

Kaluam prapun e oborrit dhe u futëm në një korridor të ngushtë. Vjollca na doli para dhe ma bëri me dorë.

-Ja, kjo është banesa jonë.

Një dhomë e thjeshtë vajzash me tri krevat druri, të rregulluar me kujdes. Në mes të dhomës ishte një tryezë e vogël, e mbuluar me një mbulesë të thjeshtë por të pastër. Mbi të ishte vendosur një vazo druri me lule artificiale.

"Dhomë vajzash të kujdesshme", mendova.

-Këtu i kalojmë ne ditët dhe netët, -tha Vjollca me një ndjenjë faji. Kur jashtë bie shi ose dëborë, lexojmë libra, qepim, përgatitim ditarët e orëve të mësimi. Angjelina më zgjati një palë pantallona, një kanotiere dhe një bluzë gocash me lule.

-Mos ki turp, tha.-Merri dhe shko vishu te dhoma e Elezit. Ne po merremi me përgatitjen e drekës.

Vjollca më shoqëroi gjer në korridor. Kjo është dhoma ku do të qëndroni ,-tha ajo. Elezi ka dy muaj që është transferuar në Shkodër dhe nuk është kujtuar të tërheqë plaçkat.

Mbeta vetëm me teshat e tyre në duar dhe me ndjenjën e respektit për këto vajza të mira që po silleshim me mua si motra. Ndërkohë që po bëhesha gati të zhvishesha trokitën sërish në derë.

-Të solla peshqirin,- tha Vjollca .Po ta lë pas derës. Në atë dhomë çdo të fliste për Elezin. Emri i këtij djaloshi ishte shkruar në faqen e brendshme të dollapit. Disa libra të shpërndara në dritare, një palë nallane te dera, krevati i parregulluar, një tel kitare mbi komodinë, ca bishta cigaresh në tavllën mbi tryezë. Natën e tij të fundit duhet të kishte qenë i shqetësuar.

Pas dhjetë minutash trokita unë në dhomën e tyre. Kur më panë të veshur në mënyrë qesharake, u gajasën së qeshuri, më duartrokitën sikur të isha duke interpretuar një rol komik.

-Qenka simpatik "pula e lagur"- tha Angjelina.

-Kaq shpejt ma ngjitët nofkën!?

-Angji e ka zakon,-tha Vjollca. Këdo që sheh në fshat nuk e lë pa ia ngjitur një nofkë.

Angjelina e cila gjer më tani ishte marrë me ndezjen e sobës më ftoi të ulesha pranë saj. "Urdhëroni, si në shtëpinë tuaj. Me çfarë t'u qerasim? Liker, konjak, raki...?"

-Raki, thashë unë.

-Shumë mirë! -Tha gjithë gëzim ajo. Nga dy të parat nuk kishim. I thashë për reklamë.

Rakinë ma solli Lumja, në një tabaka të bukur të cilën e ktheva me fund, sa më nxorën sytë lot.

-Dukesh që nuk e pi rakinë.-tha ajo.

Unë pohova me kokë.

-Edhe Elezi fillimisht nuk e pinte rakinë, pastaj u bë esnaf i saj.- tha Vjollca.

-Kush është ky Elez ? -Pyeta unë për të ditur diçka më shumë rreth ish mësuesit të fizikës.

E kishim si vëllanë tonë,- tha Angjelina. - Një tip i gëzuar. Këndonte bukur, i binte kitarës, i tregonte shumë bukur barsoletat...Ne e donim si vëllanë tonë...Deshi të shtonte dhe diçka por, pa nga dy vajzat dhe preferoi heshtjen.

Tavolina u shtrua me të gjitha të mirat. "Epo gëzuar!" i urova unë.

Bisedat tona u gjallëruan duke kaluar sa në një çështje te tjetra. Ndërkohë vija re me kënaqësi se si në gjithçka që të shihte syri rreth e rrotull, kishte një shije të hollë vajzash.

Puna jonë është e vështirë por ka dhe kjo kënaqësinë e vet, -tha Vjollca. -Fëmijët e këtyre anëve e duan shumë shkollën. Kjo na bën që jemi të përkushtuar në punën tonë. Ata vijnë nga larg. Udhëtojnë rreth dy orë për të ardhur gjer në Lurth. S'pyesin për vështirësitë e rrugës, as për shirat. Ndodh shpesh që në ditët me shi të prishen orët e mësimit...Kur fëmijët vijnë të lagur i marrim në dhomën tonë, u ndezim sobën u zhveshim rrobat e tyre dhe i veshim me rrobat tona. Presin sa pushon shiu dhe i nisim për në kullat e tyre të largëta.

* * *

Të nesërmen ra shi pa pushim. Unë dola nga kryesia e kooperativës për të marrë disa të dhëna rreth reportazhit që duhet të shkruaja, më pas i rashë nga sektori, për të takuar personazhet e mi të ardhshëm. Atë mbrëmje më çuan për të fjetur në një kullë të moçme.

Lart në brinjë, në krye të fshatit ngrihej kulla e Tul Vatës, një plak i dëgjuar, i asaj zone. 111 vjeçar. Kulla nga larg ngjante me një karakoll, brenda ishte gjithë blozë. Blozë në trarë, blozë në mure, blozë në mushkëri. Familja përbëhej me 25 vetë, por unë pashë vetëm tre të moshuar, ishin të tre të moshës 80-85 vjeç. Ishin djemtë

e Tulës me grua të tretë. Më i vogli në atë kullë ishte 2 vjeç. Atë natë mblodha shumë histori e kujtime nga e kaluara të cilat do më duheshin për reportazhin. Në mesditë u ktheva te doma e arsimitareve. Gjeta vetëm Lumen. Sa e bukur ishte!

Nuk di se si ta shpjegoj, por, ka një moment kur njeriu përshkohet nga një vetëtimë ngazëllimi. Kjo ndodhi me mua në çastin kur sytë tanë u ndeshën me njeri tjetrin.

Ajo e ndjeu, sigurisht e ndjeu që unë u turbullova. Mua m'u duk se dhe ajo seç pati një ngërç, kur më pa mua. U skuq pak, ndonëse ne nuk kishim dhënë asnjë shenjë njeri-tjetrit. Më ftoi të ulesha. Dhe unë u ula në kanape si një nxënës i ndrojtur. Kur më qerasi me një gotë raki mua m'u lidh gjuha. Nuk isha i zoti të hapja një bisedë për të qenë.

Nesër do të ikni?- pyeti ajo sa për të çelur bisedën.

-Po .- I thashë unë. - Shënimet që më duheshin i mblodha.

-Nesër është e shtunë,-tha ajo. Do të ikim dhe ne.

-Ashtu? Atëherë do të ikim së bashku, u gëzova unë pa masë.

Ishte po ai zë i ëmbël, pak melankolik, por, kësaj radhe se si 'u duk më i afërt, më i dashur. Sytë, zëri që i këndonte dhe ajo diçkaja e butë e që përbënte qenien e saj, më shqetësonin ende.

Sakaq u dëgjuan zërat e dy shoqeve të cilat hynë vrullshëm në dhomë.

-E more "pulë e lagur" thirri Angjelina,-ne të prisnim për darkë, nga brodhe mbrëmë?

-U shpjegova që bujta në kullën e lashtë të Vatajve.

-Elezi ka dërguar telegram. - Nesër vjen në Lurth. Do dalësh ti ta presësh.- i tha Vjollca Lumes.

-Unë? -Bëri të habiturën ajo.

-Si të duash,- tha Vjollca.- Telegramin në emrin tënd ka ardhur. Ne nuk na ka kujtuar...Po ti mos u nervozo...Ja tek e ke . Lexoje!

Ajo as që e preku telegramin me dorë. U largua për në dhomën tjetër.

Përsëri Elezi,- thashë me vete..I gjallë dhe në mungesë.

-Sa pa ardhur Lumja shkonim shumë mirë. tha Angjelina, -e donim si vëlla.

Ta shpjegoj unë me dy fjalë,-tha Vjollca. -Elezi u dashurua me Lumen dhe...na prishi shoqërinë, shoqërohej vetëm me Lumen.

Një të shtunë erdhi të merrte vetëm Lumen për të shkuar në Shkodër,Lumja s'pranoi të ndahej prej nesh. Pas dy javësh i erdhi transferimi. Iku për të mos u kthyer më.

-Ja. Po kthehet nesër,-tha Angjelina.

-Le ta pres Lumja.- tha Vjollca.

-Lumja? Mos e diskuto..Ka një kokë ajo...- tha Angji.

* * *

Të nesërmen vajzat biseduan sërish me Lumen. Ato vetë e kishin vendosur. Do të niseshin më këmbë; malit e malit gjersa të dilnin në Bogë, atje do të kapnin autobusin e zonës. Variantin e tyre ma propozuan dhe mua. Unë pranova. U gëzova dhe më tepër kur pranoi Lumja.

Nga Lurthi u nisëm në mesditë, pas orës së fundit të mësimet. Iu ngjitëm një tërthoreje rrugë pa rrugë. Koha dukej e vrenjtur dhe e mpirë. Prag bore. Poshtë nesh dukeshin si buburreca shtëpitë karakteristike të Lurthit, të shpërndara aty-këtu në luginë. Lumi i Shalës që gjarpëronte nëpër gryka shkëlqente plot reflekse drite si luspa të ndritshme.

- Hidhini këmbët, vajza! -Thirri Vjollca që printe e para në rresht. Unë vija pas saj. Pas meje vinte Angelina. E fundit vinte Lumja. Kisha një dëshirë kaq të madhe, kaq të madhe që këtë udhëtim ta bëja në shoqëri me Lumen...por historia e Elezit ma mpinte trurin.

-Nëse do të ecim shpejt, Elezin do ta takojmë në rrugë,-tha Vjollca. Çudi,si s'na kishte shkuar ndër mend, ai tashmë ishte nisur nga Shkodra dhe, mund të shkëmbeheshim në rrugë. Si do ta priste Lumja një takim të tillë dhe si do të ndjehesha unë, tashmë që, isha dhe unë një Elez...Nisi të frynte erë. Rruga sa vinte dhe bëhej më e vështirë.

Sfondi i qiellit nga veriu nidipo mjegullohej gjithmonë e më tepër. Kishte të ngjarë të na zinte bora në rrugë, ende pa dalë në qafë të Bogës. Pas një gjysmë ore, rrugë në ngjitje, e pamë punën pisk. Ishim plotësisht të dërmuar. S'na lejohej të ndalonim për asnjë çast, ndryshe mund të na bllokonte dëbora pa mbërritur në qafë. Mbi të gjitha ishim të gjithë të djersitur.

-Goca,-tha Vjollca.-Po e takuam Elezin a do t'i flasim?

-Pse jo,- u përgjigj Angelina.

Lumja s'foli fare."Sa mirë sikur të mos e takojnë fare...", mendova unë." O Elez! O njeri mosmirënjohës. Ti që ua prishe shoqërinë këtyre vajzave. Harroje Lumen!

Pas pak gjendja u bë alarmante. Nga që ecnim nëpër një rrëpirë, hera- herës kallkan, Angelina kishte kapur Lumen për dore. Ecnin me vështirësi. Vjollca ecte para të gjithëve duke thirrur: "Kujdes! Mos shkëlqeni këtu...Këtu është një pishë e vogël. Goca, hidhini këmbët..." Shpesh herë interesohej dhe për mua."Hë...Dhe pak,vëlla, sa të dalim në qafë."Pa mbërritur ende filloi të shtronte një dëborë e dendur.

-Goca, unë s'eci dot më, -tha Lumja .

Ky lajm na ra të gjithëve si bombë. Më tepër mua. Nisi t'i zihej fryma, ndonëse pikërisht në atë çast i kishte rënë një nur në fytyrë që s'përshkruhet dot me fjalë. I mata pulsën. Dëgjohej me vështirësi. Bulëza djerse ai kishin mbuluar ballin. Ç'të bënim? Dëbora u bë më kërcënuese. Binte flokë- flokë, me fërtymë. Një ndalesë sado e vogël

na e bënte dhe më të vështirë udhën. Lumja u ul mbi çantën e saj .Vura re që i kishte rënë një çehre e verdhë.

Ndërkohë më lindi një ide e marrë, ta ngrija mbi shpinë gjer në një farë vendi. Po. Po. Kjo gjë duhej bërë patjetër. Në fund të fundit, unë isha i vetmi mashkull që mund të bëja diçka...

-Sikur ta mbajmë në krahë...? Ta provoj unë këtë gjë!?!...Nuk mund të rrimë kështu..Apo jo vajza?- u thashë unë.

"Pse jo..." -thanë ato.

Çfarë fati? Çfarë fatiii! Unë një çast të tillë kisha ëndërruar. Përkula shpinën, dy shoqet e saj më erdhën në ndihmë për ta sistemuar mbi shpinë.

-Mos ki turp. -i tha Angji Lumes, -Veç mbaju fort...Sa të dalim në qafë. -Rëndon?- Më pyeti mua.

Aspak.-iu përgjigja unë.

Hodha hapat e para i emocionuar. Po mbaja mbi supe një peshë të lumtur. Pranë veshit ritmika e frymës së saj të ngrohtë. "-Ju vumë dhe ju në mundim..." "S'ka problem..."-thosha unë me gëzim prej kafshe..

Pa pak nisën të më dridheshin gjunjët. Doemos, djalë qyteti.

" Si më ra në shpinë kjo peshë kaq e brishtë dhe kaq delikate? Cili njeri i pamëshirshëm e hodhi këtë zanë mali të jetojë midis atyre maleve? O zot! Më jep forcë !..O zot! Më jep shpresë! Një ditë mund të bëhet e imja!"

* * *

Pas pak mbërritëm në qafë. Lumja m'u shkëput nga krahët me një falënderim domethënës. Ndjesinë e frymës së saj e ndjeja akoma .

-Eh! Dhe ky Elezi, na mori shpirtin.-Thashë unë kot. Për të kuptuar si do të reagonin ndaj shakasë sime.

-Mund dhe mos ta takojmë fare,- ma priti Lumja .

Për herë të parë unë ia ngula sytë gjatë dhe me admirim të pafund.

Mos kjo duhej kuptuar si një përgjigje e cila kishte lidhje me mua?!

Sigurisht Lumja s'duhet ta kishte dashuruar. Kishte qenë thjesht një miqësi kalimtare. Për këtë gjë duhet të falënderoja shoqet e saj, të cilat nuk e kishin lënë të trashej më tej kjo miqësi. Eh! Sikur të ishte vërtetë ...Ndërkohë kishim zbritur në rrugën automobilistike.

-Goca...Dëgjoj zhurmë makine, -thirri Angjelina.

Të gjithë heshtëm. Ishte vërtetë zhurmë makine. M'u drodh i gjithë trupi dhe më kapi një ankth i paparë. Elezi...Po vinte Elezi... A do ta takonin vajzat? Po Lumja...? Si do të reagonte Lumja kur të gjendeshin ballë përballë...?

Një makine e tipit Tatra sa çeli turirin. Vinte drejt nesh. S'kaloi pak kohë që brenda kabinës të dallohej me lehtësi udhëtari që kthehej në Lurth. Makina ndaloi me vrull disa metra larg nesh. Nga kabina doli

një djalosh i imët, me sy të kaltër e me një buzëqeshje të çiltër. Ishte vërtet simpatik. Pavarësisht nga çfarë ishte thënë, Angjelina vrapoi e para për ta takuar. Më pas dhe Vjollca. U përqaftuan gjithë mall, si të kishin takuar vëllanë e tyre të vetëm, që u kishte munguar prej kohësh. Kjo gjë më dëshpëroi pa masë.

Shpresa ime e vetme ishte Lumja. Si do ta priste? S' besoja që dhe Lumja t'i hidhej kaq lehtësisht në qafë, këtij njeriu plang prishës.

Kishte arsye për të mos e bërë një veprim të tillë. Lume, rezisto! Mos e përqafo! Ti duhet t'i rezistosh këtij çunaku të lezetshëm, se sidoqoftë, të ka fyer shumë me heshtjen e tij të gjatë.

Dhe ai... Sikur të mos kishte të tjerë aty, u shkëput vrulltas prej tyre dhe iu drejtua Lumes.

-Nuk më mban mëri? Me këtë pyetje ai tentoi ta zbuste sado pak qëndrimin e saj të ftohtë.

Jo. Pse?

U duk qartas se atij nuk i pëlqeu kjo përgjigje. Iu duk mjaft e ftohtë. Por e kaloi pa i dhënë rëndësi.

-E morët telegramin?

-E morëm.-I tha Angjelina.-U gëzua që nuk na paske harruar.

-Si ka mundësi?- tha ai. Si mund t'ju shkonte ndër mend një gjë e tillë?.- Pastaj shtoi.-Dhe unë kujtova se ju do të më prisnit në Lurth...

-Ti e di,- i tha Angjelina me qortim .-Të shtunave kthehem në Shkodër.

-E di, e di...tha ai me një ndjenjë fajësimi.-Por, mendova se...Kushedi. Do të më prisnit. Ditët e tjera jam në punë. Vetëm të shtunën kam pushim. U bë një pauzë e fortë. Si për të thyer heshtjen ai vijoi.-Pra, unë kot që shkoj në Lurth...Kushedi si do të më duket Lurthi pa ju. I shkretë.

-Se mos shkon për ne. -i tha Lumja.

-Si? – As ju nuk më besoni?

Kishte një ndjenjë të përvajshme në shpirt. Dukej qartas, ky djalosh kishte një shpirt artisti. Po mirë le t'i bëhej. Kur nuk di t'i vlerësojë gjërat në kohë.

-O mësues!- u dëgjua zëri i shoferit.-Nisemi !

-Erdha! -Iu përgjigj ai, ndonëse këmbët s'i bënin për më tutje. U zbeh pak, kur ndjeu fundin e kësaj historie...Por nuk donte ta jepte veten. Por ato e njihnin mirë. S' kishin si të mos ia kuptonin pezmin dhe nervozizmin e brendshëm që e kishte kapluar. Në raste të tilla atij i shfaqej një si hendek në hapësirën midis vetullave.

-Për besë, nuk e kisha menduar kurrë një ndarje të tillë, -tha ai, duke i shtrënguar fort dorën Lumes. U nis tutje kuturu, pa kthyer kokën. E pamë kur hipi në kabinën e shoferit. Makina rrëshqiti tutje gjersa nisi të zvogëlohej në horizont. Lumja kishte ulur kokën ndërsa sytë i mbante gjysmë të mbyllur.

* * *

Si mbaroi kjo histori? Ashtu si mbarojnë shumë histori të tjera kur futet midis një njeri fare i panjohur, dhe shkatërron pa mëshirë çdo ndjesi njerëzore.

Dy muaj më vonë më telefonoi Vjollca. "Nga flet?"- e pyeta. "Nga Tirana", -më tha. U gëzova pa masë dhe i thashë:"Dua të të takoj urgjentisht."Ajo më priti në shtëpinë e saj me shumë dashuri dhe me gjithë të mirat. Kujtuam ato çaste të paharrueshme.

"E di,- tha ajo. -Do të më pyesësh për Lumen."

Më sqaroi me qetësi për gjithçka kishte ndodhur. Dhe unë, ç' t'u them, o miq të dashur! Kur mora vesh që Lumja ishte martuar me një shofer që bënte rrugën atyre anëve, çakërrita sytë nga habia. E quanin Lekë. Kurrë s'do më shkonte ndërmend një gjë e tillë...Po ja që kjo gjë paska ndodhur. Ajo kishte lënë punën .Në vitin e ri shkollor nuk ishte kthyer më në Lurth. Në atë çast ngushëllova veten dhe Elezin...

Zarfi me mizë

Çdo gjë rrjedh bukur dhe qetë ; dielli i marsit ngroh, lumi ka shtënë dashuri me detin, sakaq, nga an tjetër e trotuarit kalon një njeri që i njohur, i fryrë, mendjemadh, kokëbosh, servil... Ai bëhet gati të më përshëndesë por, ndjen indiferencën time dhe tërhiqet i fyer.

Dikur ky njeri ka qenë eprori im, tashmë ka dalë në pension, dhe unë, në vend të hakmarrjes vetëm kaq mund të bëj për të..Ai ecën ngadalë, sikur kërkon të ruajë me çdo kusht rëndësinë e dikurshme. Posti i tij... Drejtor i ndërmarrjes së stopave, me 20 punëtorë. Të guxoje t'i kundërviheshe në sy të kolektivit? Kurrë. Një gjë të tillë mund ta bënte vetëm një kokëkrisur si unë. Ia nxiva jetën me ankesat e mia me shkrim, në ministri : Kërkoja me çdo kusht për ta hequr nga ajo detyrë për njëqind arsye, i paaftë, inatçi, servil me shefat dhe arrogant me punëtorët, por ajo që e rëndonte më shumë ishin raportet vjetore shifra të falsifikuara. Ishte një marifetçi i madh, me farefis e shoqëri, i rrethuar nga një klan i fortë brenda ndërmarrjes dhe nga një taraf , dhe më i madh, në Ministri.

Shpesh herë tallej me mua .Më kishte ngjitur nofkën: "inxhinier i vitit 2020". Ndërmarrja jonë ishte pranë lumit, nga që dritaret shpesh herë i linim të hapura, zyrat mbusheshin me miza. Drejtori zotëronte një vrasëse të madhe mizash ,të cilën e demonstronte edhe gjatë mbledhjeve të mëngjesit. Mjafton të mos i pëlqente diçka, në shenjë nervozizmi kapte vrasësen e mizave dhe na e tundte para syve, në formë kërcënimi.

Tani ai ka dalë në pension. Eshtë një njeri pa vartës dhe pa atë : "Mirë mëngjes drejtor!" dhe "Si urdhëron, drejtor!" Dikur më prishi specializimin jashtë shtetit dhe ma hodhi poshtë shpikjen time për prodhimin e stopave plastikë.

"Përse t'i ndryshojmë !? Për një teke të dikujt? Kush drejtin ma psonisi në ndërmarrjen time atë teveqel?"(thoshte për mua) Fjalën "time" ai e përdorte njësoj sikur të bëhej fjalë për shtëpinë e vetë.

Kishte përhapur fjalë gjithandej që unë isha zevzek dhe mendjemadh. Në betejat tona të pashfaqura ai kënaqej me proverbin "shpif ,shpif se diçka do të ngelet." ndërsa unë i besoja shprehjes popullore : "I duruari, i fituari." Vitet e fundit ai llogariste largimin tim, ndërsa unë prisja me ankth daljen e tij në pension.

Gjashtë vjet rresht unë e përballova me heroizëm "zemërimin e Akilit", gjersa doli në skenë historia e mizës që i kishin dërguar në një zarf. Ishim në mbledhjen e mëngjesit kur hyri sekretarja dhe i la një zarf mbi tavolinë. Ai e preku atë letër të çuditshme, pa adresë dhe fare bosh. I grisi anët, siç e kishte zakon dhe, për çudinë e të gjithëve, prej zarfit doli një mizë, një mizë e madhe e gjallë. U rrotullua dy herë mbi kokat e tyre , më pas doli nga dritarja që gjendej pranë tavolinës së drejtorit.

Të gjithë mbetën të hutuar. Ç'të ishte kjo..? Një mizë? Ha-haa ! Kush ia dërgonte?! Po përse një mizë? Po përse e gjallë? Qetësinë e çastit e prishi gajasja pa dashje e ekonomistes së bukur e cila s'kishte një muaj që kishte ardhur në ndërmarrje, thoshin që ishte kushërira e gruas së drejtorit.

-Ç'ka këtu për të qeshur,-thirri drejtori. Rrëmbeu nga tavolina vrasësen e mizave ,e mblodhi zarfin shuk dhe e flaku në koshin që mbante poshtë këmbëve.

Pas mbledhjes të gjithë nisëm të mendonin; kush mund ta ishte ai që kishte guxuar t'i dërgonte këtë mizë- mesazh, drejtorit tonë të nderuar?

S'vonoi dhe drejtori na thirri në zyrën e tij. Dukej tepër i nervozuar. Fillimisht u vërtit në disa probleme të parëndësishme , më pas hapi problemin e asaj letrës së çuditshme.

-U bëra 55 vjet dhe kurrë nuk kam dëgjuar të të dërgojnë një mizë në zarf...Ndërkohë hodhi shikimin na unë..

Po ç'ne unë? Unë luftoja me të në shesh të hapur. Ndërsa shpikësi i mizës ishte diçka tjetër.Ai kishte kishte përdorur një armë më të sofistikuar. Ajo po.Ajo mund të quhej një shpikje e madhe... Po unë, ç'ne...? Dhjetë vjetë luftë pa kurrfarë rezultati. Unë isha si Akili në ndeshjen me drejtorin, ndërsa ai i letrës ishte si Uliksi ... "Ai" po. Mund të ishte dhe një "ajo"...

Si thoni ju? Kush mund ta ketë bërë?

Po kush e dinte këtë gjë? Vrava dhe unë mendjen, si të gjithë punëtorët e tjerë të ndërmarrjes, gjoja në mbrojtje të tij, i kalova në paradë punonjësit e ndërmarrjes , të gjithë njerëz të thjeshtë, si i thonë : "Ku rafsha mos u vrafsha". S'kishte dyshim, mizadërguesi s'duhet të ishte punëtor i ndërmarrjes sonë.Letra ishte sjellë dorazi se. Dhe zarfi nuk mbante vulën e postës...

Drejtori ynë atë mëngjes u betua se do ta gjente mizadërguesin, gjallë a vdekur. Ditën tjetër thirri shefen e kuadrit në rolin e ekspertes shkrimore , i kërkoi të studionte me imtësi të gjithë shkrimet e punonjësve të ndërmarrjes, të shfletonte në dosjet sekrete autobiografite e tyre, të shkruara me dorën e vetë. Shefja e kuadrit, një grua serioze dhe e moshuar, e qetësoi aty për aty:

"Jo o drejtor, letrë dërguesi ...(për pak sa nuk tha mizadërguesi) Nuk duhet të jetë nga ndërmarrja jonë. Do të jetë ndonjë..., gjersa...

-Gjersa? Çfarë gjersa? ! Çfarë do të thuash me këtë gjersa?!- u nxeq keq ai.

Në fillim ajo hezitoi të përgjigjej pastaj tha

-Po ja, t'i dërgosh drejtorit një mizë në zarf..Ky është një guxim i madh. Kjo është çmenduri, shoku drejtor. Ju gëzoni respektin e të gjithë punëtorëve të ndërmarrjes sonë. Ky njeri do të jetë ndonjë inatçi jashtë ndërmarrjes. Mund të jetë dikush , jashtë ndërmarrjes që ju e keni pushuar nga puna,

Jashtë ndërmarrjes? Miza në zarf ishte shpikje e një njeriu të brendshëm. Ishte dikush që e njihte drejtorin tonë si një miza vrasës profesionist.

Pikërisht për këtë gjë, mizadërguesi i kishte drejtorit një mizë të madhe për ta ekzekutuar.

Lajmi u përhap me shpejtësi dhe ndërmarrjet për rreth.U mor vesh nga të gjithë dhe në ministri, disa prej tyre ,kur e morën vesh këtë gjë ishin gajasur me të madhe, të tjerë e quajtën një shaka miqësore.

Ja dhe miza tani!-mendonte drejtori . Ndërkohë që në Ministri kishin shkuar dhe dy-tri letra të tjera me ankesa për padrejtësit e tij në ndarjen e pallatit të ri të ndërmarrjes, të ngritur me punë vullnetare. Kontrolli i shtetit që kishte ardhur dhe ikur, kishte relatuar për abuzime dhe me pagat e punëtorëve. Me sa më kanë thënë, ata që rrinin pranë tij, e që më donin mua, zarfi me mizë

atij iu bë fiksim, gjersa doli në pension. " Kush t'ia kishte dërguar? " Kush të ma ketë bërë një gjë të tillë xhanëm...!?" Herë pas here e hidhte dyshimin te unë, tek inxhinieri i vitit 2020.

Kush mund t'ia ketë dërguar atë mizë drejtorit tonë? Kjo gjë kohët e fundit më është bërë fiksim . Jo thjesht për shpikjen e ndritur, por edhe pse; si nuk doli dikush të mburrej me autorësinë e saj.

Një histori me qen

Atë mëngjes kur qenushja me Emrin Xheni hyri te porta e vjetër me hark guri e Xhomallarëve, unë u ndodha atje. E shoqëronin dy dy qen të tjerë të fshatit, të sertë e shtatlartë, dukeshin si bodiguardët e saj. Ajo ishte një qenushe e vogël e shtatlartë që s'i kishte mbushur ende dy vjeç. Shikimi saj ishte si i një drenushje. Lëkurën e kishte me push të ndritur, kafe në të kuqërremtë. E ëma e saj ishte racë australiane.

Stefi Xhomallari kishte disa ditë që kishte ardhur nga Amerika, së bashku me të shoqen, Vasen, për shkak të vdekjes së vëllait të tij të madh, Mihalit, ndarë nga jeta në moshën 83 vjeçare Çiftit të porsaardhur nga Amerika Dhimua, i vetmi që nuk kishte lëvizur nga fshati, u liroi shtëpinë e vjetër të prindërve, vetë kaloi në shtëpinë e re. Të vetmen kërkesë që kishte Stefi ishte ta mbanin ata qenushen Xheni.

Pas martesës së dy vajzave, në dy qytete diametralisht të kundërt, çifti Xhomallari e pati të vështirë të jetonte në vetmi. Stefi shkoi në "Animal shop" i pëlqeu një qenushe e bukur me lëkurë kafe të çelur dhe bleu. Si janë amerikanët! "Do ta quajmë Brixhita,- i tha Vasia, në kujtim të aktores së njohur Brixhid Bardo.

* * *

Në mbrëmje u shkova për mirëseardhjeje. Me Stefin jemi bashkëmoshatarë dhe kushërinj të tretë. Na pritën gjithë gëzim, në dhomën e madhe me zjarr, me pamje nga kopshti , që e kishin sistemuar për të pritur mysafirë. Unë kisha kohë që nuk kisha shkelur në shtëpinë e tyre të vjetër, qysh se djali i vetëm kishte emigruar për në Greqi. Vura re që s' kishte ndryshuar asgjë. Po ajo tavolinë qysh e paraluftës, me tre karriget gjatoshë, dy mindere në të dy anët e murit pranë dritareve të vogla, qilimi i vjetër i punuar në avlimendin e tyre me figura gjeometrike, drutë digjeshin në oxhak, , për shkak të atij dimri të hidhur. E vetmja gjë e re në atë shtëpi të vjetër ishte qenushja e vogël Xheni e cila, sa na pa m'u sul me potere , dhe nuk reshti së lehuri me zë të lartë, dhe kur Stefi e kritikoi në mënyrë urdhërore për t'u larguar pa vonesë. M'u lidh nëpër këmbë, duke më bërë një kontroll të imët, nga poshtë lart, siç bëhet nëpër pikat doganore për mbajtje sendesh metalike. Ndërkohë që Stefi më vinte në provë kujtimet e përbashkëta të fëmijërisë, prania e saj m'u bë bezdisëse. I ulur në minderin pranë dritares, unë duhet ta kisha mendjen sa nga Stefi e sa nga qenushja , e cila kishte guxuar të fitonte territor mbi të gjithë qenien time. "Nuk të ha, jo!" thoshte Vasia, duke vënë re nervozizmin tim.

Xheni ishte një qen race, nga familja e njohur Renard. Të ëmën e saj e kishte blerë Dhimua. Doli në qytet me dyqind dollarët e Stefit në xhepin e brendshëm të xhaketës, do të blinte një kostum për ta veshur ditën e nisjes për në parajsë . Sakaq i zuri syri qenushkën, në krah të një zonje. Sa e pa ia bëri zemra brambl! .”Sa e mban, moj zonjëzë” “Dyqind dollarë.” “ Si shumë...” “Eshtë racë australiane.- nguli këmbë ajo,- Qenushe të tillë nuk të zë syri sikur të kërkosh në të gjithë Shqipërinë? E ëma e Xhenit, qenushe për kokën e qenushe, sylarme , ezmere, elegante, kryelartë. Kishte një shikim ngulues , tipare të zgjuara, e dashur me të zotët e shtëpisë dhe vigjilente me të panjohurit që trokisnin te dera. Nuk do ta hante bukën kot. “Australiane?!” -tha Dhimua... Në çast e vendosi. Nxori nga xhepi dy kartmonedhat njëqind dollarë dhe ia rrsi zonjës në pëllëmbën e dorës së djathtë, sakaq ia tërhoqi nga duart qenushen e vogël në mënyrë të tillë sikur do ta peshonte me duar. “Si e quajnë?- u kujtua ta pyeste zonjën në çastin e largimit. “ Pushi.”, - i tha zonja. Pushi do t’i thërrasim dhe ne, mendoi Dhimua duke u kthyer për në fshat i gëzuar, me qenushen australiane në duar. “ Emrin nuk ka pse t’ia ndërrojmë, kishte thënë dhe Katerina. –Ai është fati i saj.” Fat i Pushit paskishte qenë mynxyrë. S’ mbushi as dy vjeç, kur u ajo mbars dhe nxori në dritë shtatë kalamaj. Pesë të parët s’ ia pa njeri: Kur i lindi ? Si i lindi? Me kë i ngjizi dhe si i vdiqën? Rënkonte e zeza në hajat për pikën e qumështit të gjirit, po kush ia kuptonte gjuhën? Se mos rënkonte australisht. Qenushet nuk duhet të mbarsen pa u ardhur gjiri . Nga gjithë fëmijët e saj mbeti gjallë Xheni, dhe një këlysh mashkull të cilin e shitën qysh ato ditë. Pas gjëmës që i ndodhi lehte e gjora, pa pushim , ditën e natën. Ditët e para s’ vuri gjë në gojë: Më vonë u duk sikur e mblodhi veten, nisi të lëvizë, jashtë e brenda, hera-herës bënte lëvizje të pa pritura. E kishte humbur toruan...e gjora. Lehte më kot, për hiçmosgjë, “Sa për të na vënë në siklet. Ndërkohë që hajduti mund të të hynte në shtëpi pa teklif e ti të flije për shtatë palë qejfe. Ditët e para ia lanë portën të hapur dhe asaj iu ëmbëlsua kjo liridalje. Harroi detyrën, dhe lehjet i bënte pa shpirt. Fat i Pushit, nisi t’i ngjajë fatit të atyre vajzave që bëhen prostituta për shkak të një dhimbjeje të madhe ose të një dashurie të humbur. Ditët e tjera e braktisi detyrën. Doli te sheshi i fshatit duke ekspozuar vithet para qenve të tjerë. I kishte plasur cipa. E huaj ishte. Asnjeri nuk e njihte. Ra pre e urisë seksuale të qenve baritorë të fshatit tonë. Qentë e fshatit tonë sa e shihnin australianen e bukur, duk lëvizur bishtin me lezet, nisnin të ndërseheshin në zinxhirë. Qenushe më të

bukur dhe më provokuese se Pushi nuk u kishin zënë sytë. Dhe asaj, si një qenushe me tradita liberale, ditët e para i bëri përshtypje maskulizmi i qenve të sertë dhe leshtorë, ndaj, në ditët që pasuan e lëshoi me të dyja duart. Nuk mblidhej më në shtëpi. Nga mëngjesi gjer në orët e vona të natës bënte seks, hera-herës me shtatë njëherësh. Në mëngjes kthehej në shtëpi e pistë, e lodhur dhe e drobitur. Dhimua dhe Katerina e kishin pikasur ndryshimin që ndodhte te qenushja e tyre. "Lere, të këpusë qafën! -'Sokëllinte Dhimua.- Haram paratë për këtë racë laviresh..." " Nesër do ta mbyll në katoq e nuk do ta lë të dalë- ulërinte Katerina...-Kurva e dreqit! Dhe ti...Nisesh për të blerë kostum, e na kthehesh me një putanë australie." Po zënkat nuk zgjatën shumë. Një mëngjes morëm hatanë. Persona të panjohur e kishin qëlluar me gurë dhe trupin e saj e kishin hedhur në lumë. Kujt nuk i erdhi keq për të huajën e gjorë: Edhe pse kohët e fundit kishte filluar të krijohej një opinion jo i mirë për të.

* * *

Mirë thonë , paç fatin e qenit. Qenushja e vogël me emrin Xheni, s' mund të kishte një fat më të mirë se ai i të ëmës së vet. Australia e vogël pati një fëmijëri jetime. Mirë i ati që nuk u njihet qenusheve të gjora, por e la dhe e ëma pa mbushur vitin..

Kush është marrë me racat e qenve e njohin racën renard. Kanë një lëkurë të shndritshme, në të argjendtë. Xheni e vogël, e bukur te zoti, por dhe paksa e sertë, sa mori detyrën e re nuk lejoi më askënd t' i afrohej portës së Xhomallarëve, edhe sikur vet skllavopronari i saj t' a kërcënonte me mungesë ushqimi..., i hidhej për gryke çdo të huaji që trokiste te porta e tyre. Mysafiri më i shpeshtë në atë familje isha unë , pasi, siç ju thashë, me Stefin kemi qenë shokë fëmijërie. Qysh në mbrëmjen e parë m' u sul me një shpejtësi të paparë. Për një çast dyshova mos kishte ndonjë inat me mua. Një pritje e tillë përjetova dhe pas dy ditëve. M' u hodh përpjetë me kërcëllimë duke mos më lënë të bëja një hap më tutje. Një fjalë i tha Stefi dhe ajo nisi të lëvizë bishtin në shenjë mirëkuptimi ndaj padronit të saj të ri. Të mërkurën shkova sërish nga shtëpia e tyre, nuk e pashë të dilte gjer te porta e të më ndalonte hyrjen. Ku është Xheni? I pyeta qysh te dera. ' ' Ka lindur shtatë këlyshë dhe rënkon e zeza , -tha e dëshpëruar Vasia. I ngjau tëpkë së ëmës. - As ha as pi..Ka dy net që vetëm rënkon e s' dimë ç'të bëjmë.... Kuis ajo kuisin

dhe këlyshët e gjorë. Na e këputën shpirtin. ‘ ‘ Nuk e dimë ç’ ‘kanë’ ‘,- tha Stefi. -Na ka lënë gjithë natën pa gjumë.’ ‘
‘Atë ditë unë kisha marrë me vete dhe një shishe rakie, ua lashë mbi tavolinë. I shtyrë nga kureshtja, futa kokën te dera e kthina e kuzhinës prej nga vinin rënkimet e tingullta të këlyshëve. Dhe ajo sikur atë çast priste, m’ ‘ u hodh në grykë me një tërbim të paparë duke më gërvishtur dorën. ‘ ‘ Mos e ngacmove! –pyeti e shqetësuar Vasia. Eshtë nervoze e do të kafshojë!’ - E dëgjojmë që rënkon e na këputet shpirti që s’mund t’i vijmë dot në ndihmë.’ ‘ Veterinerin e zonës sonë e lajmërova me celular qysh atë mbrëmje, të nesërmen mbas dite ai më mori në telefon për të më dhënë lajmin më të keq.. ‘ ‘Dëgjo tani...I ka munguar qumështi.- tha ai. Ka ndodhur e njëjta gjë si me Pushin-Me keqardhje po të them se, nga shtatë këlyshët e saj kanë mbetur vetëm dy. Por dhe ata nuk do ta kenë të gjatë. Ngushëllime!’ ‘ Mos! -gati sa nuk klitha nga ky lajm i papritur. Nuk e di pse më erdhi aq keq për atë qenushe të gjorë. Isha gati t’ia krisja vajit, edhe pse ajo kishte një armiqësi të hapur me mua? Kush mund të futet në mendjen e një qeni? Fatkeqe e ëma , fatkeqe e bija. Ky fat po i ndiqte pas, qysh nga Australia. Për një çast dyshova; mos vallë nuk ishte qen race dhe ajo zonjëza e kishte shitur sapunin për djathë ? Po kush ishte ky qen, bir qeni, që mbars një foshnjë, pa mbushur dy vjeç !? I shqetësuar sa s’ka më , atë mbas dite mora dhe time shoqe dhe u bëmë një vizitë të shkurtër Xhomallarëve duke lutur Zotin gjatë gjithë rrugës, për të mos marrë rrugët e së ëmës.

Qysh te porta, ndjehej hija e rëndë e një mortit në shtëpinë e vjetër të Xhomallarëve. As lehje qeni as pritja karakteristike te porta...Te dhoma e ndenjjes vura re Stefin, i veshur me kostum e kravatë, i ulur te cepi i miderit pranë, na ftoi të uleshim pa u ngritur nga vendi, me një gjest që zakonisht e bëjnë vetëm në raste mortit. ‘ ‘E morët vesh?’ ‘-tha Vasia duke u takuar përzemërsisht me time shoqe, -Ikën të shtatë... ‘ ‘Ç’ thua?’ ‘- Bëri sikur u shqetësua ime shoqe, e cila gjatë gjithë rrugës më çau veshët me llafë.‘ ‘Ç’do të thotë kjo? Të shkojmë për mort këlyshësh... Këtu vdesin njerëzit dhe s’e çan kokën kush..?’ ‘ ‘ Ku e keni Xhenin? -pyeta Stefin. ‘ ‘
‘ ‘I dhamë liridalje.’ ‘ ‘,- u përgjigj ai qetë.

‘ ‘Rënkonte e zeza... Dy ditë e dy net. Pa pushim...Po kush ia kuptonte hallin? Faleminderit juve, që lajmëruat zooveterinerin e zonës.- m’u drejtua Vasia. - Ai erdhi pa vonesë por, ç’ e do.... Gjatë natës ikën pesë të parët. Para dy orësh ikën dy të tjerët.’ ‘ Për një çast deshi të thoshte ‘ ‘

ngordhën' , por s' i bëri zëmra të përdorte një fjalë të tillë, përbuzëse.

Kuptohej nga mënyra si rrinin dhe si flisnin, vdekjen e shtatë këlyshëve të saj ata e kishin përjetuar si një gjëmë të madhe, mbase ,nga që dhe vet ishin në moshë të thyer, përditë e më pranë vdekjes. Ose, nga që amerikanët janë më të ndjeshëm se ne. 'Ç' qante e zeza!... Ç' qante e gjora...!' - fliste si me vete Vasia. Kur i morëm pesë të parët dhe i çuam te kazani i plehrave na ndoqi pas duke rënkuar si të ishte njeri...'Ç' njeri, thua? Ngriti zërin Stefi.-Rënkimi i saj ia kalonte rëngës njerëzore. Atë çast krijova bindjen se njerëzit me mirëqenie duhet të jenë më të ndjeshëm se ne të varfrit.. 'E zeza ajo! E zeza ajo! -Kryqëzonte pëllëmbët Vasia, me sytë në tavan. -Të bësh shtatë njëherësh e të mos të të rrojë asnjë.' '

- 'Në çastin kur ngrita thesin për ta hedhur në kazan lotët i vareshin faqeve.' - tha Stefi qetë. Dhe hajde e më thuaj tani që qentë nuk ndjejnë''

- A e di ti?- shtova unë, për të ndërruar bisedë.-Kam lexuar në libra, se shpirtrat tanë pas vdekjes hyjnë në trupat e qenieve të sapolindura... ' Mos do të thuash në trupin e një qeni? '-tha Stefi ,dysgues për këtë shaka të hidhur. '- E kam lexuar në libra.- i thashë unë. E di ti? Një natë unë kam parë në ëndërr sikur isha qen? Një qen rruge, një langaraq. Natyrisht në ëndërr. Kam përjetuar një tmerr të vërtetë....Shihja sikur vrapoja si qen në rrugët e një qyteti të madh e të panjohur, midis lumit të veturave. Ndërkaq ca djelmossa më ndiqnin pas duke më qëlluar me gurë. Ç'gëzim ndjeva kur u zgjova.' 'Çfarë nuk sheh njeriu në ëndërr.' - Ndërhyri ime shoqe, më hodhi një vështrim qortues, për të mos e zgjatur më me llomotitje të tilla.

* * *

Dhe ju, o miqtë e mi, më ndjeni nëse gjithë këtë histori me qenushë ua tora kaq gjatë, vetëm për t'u treguar se si fati i Xhenit rrodhi ndryshe. Ditët që pasuan u mbyll në vetvete, u bë më reflektues, më e shtruar dhe më e urtë. Mbrëmjen e fundit që unë isha te Xhomallarët, vura re që ajo e kishte humbur jo vetëm vigjilencën por dhe dëshirën për të lehur. Më tundi bishtin në formë miratimi, nisi të më lëpinte këpucët me mirënjohje, ishte kjo një mënyrë pajtimi. Kur u ula në minder, hipi dhe ajo mbi minder,zgjati kokën e bukur dhe e vendosi mbi gjunjët e mi. Pa e larguar vëmendjen nga bisedat tona të rëndomta, nisa t'i përkëdhel kokën butësisht, sikur po e vija në gjumë. U tulat në prehrin tim. Me hyrje-

daljet e shumta në familjen e tyre isha bërë dhe unë pjesë e jetës dhe e dhimbjes së saj. “Kemi menduar ta marrim me vete,- tha Stefi,- ndërsa po vërente me kënaqësi të veçantë marrëdhëniet tona të reja.-” Nuk do ta lëmë këtu, jo.-Ndërhyri Vasia.-Nuk duam të pësojë fatin e së ëmës.” –“Do të bëni mirë.” u thashë unë. Pra, Xhenit po i ndrinte fati. Ky ishte një gjest human që i bëhej një qenusheje dhe nuk i bëhej një familjeje të varfër me shumë fëmijë. Si janë amerikanët! Tregojnë më tepër kujdes për jetën e një qeni se për jetën e një njeriu. Xhenit po i projektohej një jetë luksoze, jeta- ëndërr e Pushit dhe e gjysh stërgjysheve të saj. ”Do të na ndihmosh dhe njëherë, për të lajmëruar veterinerin e zonës, -m’u lut Stefi,- S’ mund ta marrim pa një sërë analizash.”” Me ndjesinë se po jepja dhe unë një ndihmë modeste veterinerin e zonës e mora në celular qysh në atë çast.

* * *

Njëzet dhjetori ishte dita e largimit të përjetshëm nga shtëpia prindërore. Si janë amerikanët! Njerëz praktikë. S’e vrasin mendjen vendin ku kanë lindur. Mbrëmjen e fundit moti u ftoh papritur. Gjatë natës ra dëborë pa pushim. Sa u zgjova hodha sytë nga kopshti. Drurët e mollëve ngjasonin si nuse me duvak. Mali përballë ishte veshur me fërtymë dëbore. Transparent si xham. Jo vetëm mali përballë por gjithë malet që ishin për rreth dukeshin si të veshur me frymën e gjallesave që e mbanin gjallë jetën, në atë vend malor.

Mësimet e para të seksit

Atë ditë në shtëpinë tonë ndodhi një ngjarje e pazakontë. "Çohu! thirri nëna,-sot vjen yt at me tët vëlla nga Gjirokastra, do të zëmë gjelin për ta therur.

Gjelin? Gati sa s'thirra unë i tmerruar. Për mua dhe motrën time të vogël gjeli ishte gjëja më e shtrenjtë dhe më e gëzuar e familjes. Veç gjelit ne kishim dhe 5 pula që i shkonin pas, të bindura si skllave, kishim një mushkë grivë, një gërdallë ushtrie, që na e kishte sjellë babai nga Gjirokastra, atë vit kur italianët ishin larguar nga Grihoti, një mushkë dembele dhe aspak e zgjuar, kishim në qinosi me të tjerë dhe pesë dele të cilat nuk i kishim parë kurrë me sy, por, gjeli për ne fëmijët ishte gëzimi ynë dhe ora jonë e murit.

Me gjelin tonë kokëkrisur ne mburreshim para shokëve të mëhallës. Ai ishte një gjel laraman i një race të veçantë, një gjel kapadai e mburravec, ecte duke tundur bishtin si trimosh, i kapardisur para pulave si të ishte kryezoti i tyre, kokën e mbante gjithmonë lart dhe në lëvizje, ndërsa sytë në vëzhgim të përhershëm, pendët i kishte si në të kuqe, me një xhufkë të zezë në majë të kokës. Të gjitha këto cilësi të tij s'do të kishin rëndësi nëse nuk do të kishte një zë i fuqishëm, bariton. Niste i pastër dhe nga fundi përfundonte i çjerrë. Ishte gjeli më i parë i fshatit që përshëndeste agimin me ki-ki-ri-kun e tij entuziast: paksa të mallëngjyer, ai komunikonte i pari me kozmosin, duke lajmëruar atë pak qiell të fshehur midis malesh, se po zbardhte një ditë e re për të gjithë.

Fshati kishte shumë gjela. Çdo shtëpi kishte gjelin e vet. Veç jo të gjithë gjelat ngriheshin aq herët dhe e zvargnin zërin drejt yjeve të mëngjesit.

Më ka mbetur në kujtesë ai çast magjik, ende nuk ishin shuar yjet në qiell, kur në qetësinë e gjysmë errësirës mëngjesore, ndizej "Ki-ki-ri-kuu!" i kokoshit tonë: Ki-ki-ri-ku! Ki-ki-r-kuuu! Zgjohuni o njerëz se iku nata! Zgjohuni o njerëz...! Kokoshi ynë griste errësirën shekullore të majëmaleve, ndërkohë që nga mëhalla e përtejme e Gjofterajve ia jepte me "Ki-ki-ri-kun" e një gjeli i dytë, e pasonte një i tretë, nga mëhalla e Hamzarajve, me një zë basi përgjigjej gjeli i Mehmetajve, ndërkohë ngrinte zërin mbi të tjerët gjeli i Gjonajve, me ngut e si i vonuar, ...e pasonte ai i Godajve, i Kokajve, i Zanajve, i Gjonikajve, i xha Muhedinit, i xhare Merjos, i xhare Fatimesë, i Lonajve...një kor i tërë zërash ndizej si zjarr ndërkohë që njerëzia flinte, vetëm ne fëmijët sa dëgjonim zhaurimën e tyre nxirnim kokën nga nën jorganët, dhe ndiheshim të lumtur.

Gjithmonë kam menduar se në këtë zgjim gjelash të menatës ka diçka mistike, ende të pa shpjegueshme nga njerëzimi. Gjithsesi, kjo kërkon një shpjegim, në mos shkencor, të dimë se çfarë komunikojnë gjelat me njeri tjetrin, çfarë sekreti dinë ata që nuk e dimë ne njerëzit?

Unë isha mësuar me zërin kokoshit tonë dhe s' më kishte shkuar kurrë ndër mend se do të vinte një ditë që ai të binte theror i një mirë se

ardhjeje. Në djall të shkonte dhe ajo drekë , kur qysh të nesërmen familja jonë do të mbetej pa gjel, dhe fshati ynë do të mbetej pa lajmëtarin e famshëm mëngjesor, pa këngëtarin e parë që me atë zërin e tij të mrekullueshëm griste çdo mëngjes napën e kaltër të natës të mbushur me yje. Unë u ngrita plogët nga krevati, i bëra zë dhe motrës për lajmin e kobshëm që pritej të ndodhte. Jo! -thirri ajo dhe nisi të qante, më tepër nga që nuk i kishte dalë ende gjumi. Mundet dhe të ishte prekur për ekzekutimin e tij. Në ndarjen e detyrave të përditshme ushqimi i pulave i ishte caktuar motrës. Ishte detyra e saj të kujdesej çdo ditë për ushqimin e tyre, të ngrihej herët në mëngjes dhe t'u hidhte në oborr thërrime buke, të binte govatën e madhe me ujë, të kujdesej për t'i futur në katoq .Në këtë detyrë ajo kishte kuptuar një sekret, mjafton të bindte gjelin, më pas pulat shkonin vetë të bindura pas tij , me një bindje të çuditshme.

Po gjeli ynë ishte dhe një seksoman i pashoq. E kam e parë me sytë e mi, një mëngjes ia hipi Bardhoshes,(të gjitha pulave ne u kishim vënë nga një emër, sipas ngjyrës së pendëve), iu sul me tërbim, e ndoqi pas si një feminist i vërtetë, gjersa e kapi. Bardhoshja fillimisht bëri ca naze pastaj u duk sikur u bind , qëndroi pak çaste në shërbim të tij gjersa ai, le ta themi, mbaroi punë, ta themi më troç, e përdhunoi shpejt e shpejt e pastaj, sikur të mos kishte ndodhur asgjë, u largua i kënaqur dhe krenar duke bërë ca vokalica gjelore. Unë me motrën e vogël këtë skenë e pamë me qetësi, e kishim parë të përsëritej sa e sa herë. Motrës së vogël i vinte inat kur shikonte që gjeli ynë sillej me të pesë pulat, pa dallim, si të ishte pashai i haremit, u hipte sipër sa herë donte dhe kur të donte. Dhe ato të gjorat, që bënë shpesh herë sikur nuk donin, vraponin të fshiheshin sa herë ai iu sulej, unë mendoj se luanin të ndershtmen sa për sy e faqe, pasi sa herë atij i tekej t'u hipte, qëndronin të bindura, dhe prisnin në heshtje gjersa gjeli ynë i dashur të mbaronte punë. Skena të tilla ne i shihnim së bashku , unë nuk e di ç'mendonte motra ime e vogël në atë moshë, ndërsa unë thosha me vete "Sa i fortë qenka!", ndërkohë që për marrëdhëniet arrogante me seksin femër kishim dëgjuar shumë histori me burrat e fshatit.

Motra kujdesej më shumë për pulat.

-Dhe ky gjeli ynë...si një aga i madh,- m'u ankua një ditë,- ha , pi dhe atë punë di... Pulat e shkreta bëjnë vezë, lindin zogj...

-Gjeli është gjel, i thashë unë me seriozitet! Vezët janë detyrë e pulave.- Nëna po të dojë le të therë një pulë.

-Pse pulë? -u nervozua ajo.

Ndërkohë u shfaq në oborr nëna , pa shkarkuar ende drutë që mbante mbi shpinë pyeti:

- Hë? E zutë ?

-Jo, i thamë njëzëri.

-U pa puna...Do ta zë vetë.- tha ajo.- Nesër sa të zbardhi, do ta lë të këndojë pak, pastaj do ia pres kokën.

Seç kisha një besim se gjelin ajo nuk do ta zinte kurrë. Një fshatar që kaloi në mbrëmje pranë shtëpisë sonë na tha se babai do të vinte pasnesër. Kjo gjë na gëzoi pa masë.

Të nesërmen, ndërkohë që motra e vogël kryente ritualin e përditshëm të ushqimit të pulave, unë nisa t'i vërej me kujdes lëvizjet e gjelit.

Çudi e madhe, si nuk i shkonte mendja ç'e priste? Vazhdonte të tregohej kapadai dhe kokorosh me të pesë pulat. Sa pa motrën që i thirri Bardhoshes me bukë në dorë: "Tuk-tuk-tuk..!" , u sul i pari drejt ushqimit të saj ,duke ua prerë rrugën pulave të tjera, nisi të mbllaçitej si i babëzitur dhe nuk lejonte askënd t'i afrohej , herë duke iu kanosur pulave me sqep , herë duke tundur bishtin e herë duke i fryrë pendët si gjel deti.

"Gjel, ti këndon aq bukur po ne do të të hamë një ditë.", mendova atë çast, kur ai, pasi e mbush barkun mirë e mirë, u largua duke tundur bishtin i vetëkënaqur .

Do ti... Pas ushqimit iu tek të bëjë dhe pak seks. Iu sul Zezkës me një vrull të papërmbajtur, fillimisht e qëlloi me sqep në çafkën e kokës, bëri sikur u largua me indiferencë ,por u kthye sërish ,vrulltas,duke i kërcyer mbi shpinë pa i bërë tër syri. Me lëvizje të paprera po kryente në sytë tanë një veprim të turpshëm. E përdhunoj Zezkën e gjorë brenda pak sekondash, pa pyetur për shkopinjtë që motra ime ia shkrepse në kurriz .

* * *

Unë me një kushëririn tim vendosëm t'i bënim babait një pritje të paparë. . Atë mëngjes u ngritëm më herët se ditët e tjera, hipëm në tavan dhe nxorëm prej andej dy shpata të vjetra , qysh të kohës turke, kushedi sa vite kishin që qëndronin të fshehura aty.

Ju lutëm nënës të na jepte dy çitjane të vjetër.

"Çfarë i doni?" -u çudit ajo. Kur i treguam planin tonë të fshehtë , që do visheshim si prosopulla për t'i dalë para vëllait tonë të madh, ajo pranoi. Morëm me leje dy gomarë, vetëm për disa orë, gomaricën e xha Mehdiut dhe gomarin e Belul Agos Pas dy orëve ne ishim veshur gjer në grykë me çitjane. Fytyrat i kishim katranosur me kongjij. Rrokëm shpatat , hipëm mbi gomarë dhe u ngjitëm gjer në xhade, si dy kalorës të vërtetë .

Eshtë një moshë ku fëmijët kanë nevojë për aventura. Aventura jonë e vetme që do të mbahej mend , ishte ky udhëtim mbi gomarë, i cili u bëri përshtypje të gjithëve, veçanërisht kalamajve të mëhallës, të cilët sa na panë mbi gomarë të veshur çudshëm, nxituan drejt nesh si drejt një shfaqjeje të pa parë. Nisën të na shoqëronin me thirrje, u binin gomarëve me shkop, të tjerë kërkonin t'u hipnin gomarëve, së bashku me ne... Ndërkohë gomari i Belulit iu ndërsye gomaricës së Mehdiut. Kërkoj ta përdhunonte në sy tonë, tentoi t'i hidhte këmbët mbi kurriz,

pa menduar për mua. Për pak më hodhi në rrugë. Gomarica e Mehdiut rendi tërë naze, duke shkundur Beson e duke e rrëzuar për tokë, si për t'i thënë: "Mjaft ua bëmë qejfin! Tani kemi qejfin tonë!" Besoja u vra keq, unë i rezistova hovjes së parë, mirëpo, me sa duket, gomarit të Belulit i ishte tekur për të bërë seks me çdo kusht, pa asfarë respekti për personin tim. U turr sërish më me hov drejt saj, e arriti, ngriti këmbët e para dhe ia ngjeshi gomaricës në kurriz.

-Hy! Hy! -Vetëm kaq mundja të dëgjoja zërat e fëmijëve që na ndiqnin pas. "Ngrija bishtin...! - Oh! Oh!...Ja futi...Ja futi! Oh! Oh!" Nuk pata kohë të kuptoja ç'po ndodhte. Papritur e pashë veten në ferra.

Falë çitjanes së nënës, ndryshe do të isha gjakosur keq. Kur erdhën shokët të më nxirrnin vura re që çitjania e nënës ishte grisur në shumë vende. Ndërkohë që mendoja se si do të dilja para nënës, më zuri syri Beson, e kishin vënë në mes dy çuna më të mëdhenj se ne: i ishte mbuluar fytyra me gjak.

- Nuk ke gjë, jo!- thërrisnin shokët për ta qetësuar.

Ishte hera parë që unë shihja kushëririn tim të mbuluar me gjak dhe për çudi, nuk ndjeja keqardhje, duke menduar se kështu s'do të na qortonim për marrëzinë tonë.

"Ç'patët?- tha e shqetësuar nëna, sa na pa te porta.

"Ja, i thashë. -Na mori në qafë gomari i Belulit.

* * *

Dita tjetër gdhiu kristal, pa asnjë re në qiell. Dielli kishte nxjerrë syrin e madh mbi malin e Çikës. Shtëpitë tona të bardha, të fshehura nën agrume, i kishte përmbytur me një dritë të pazakontë Nëna ishte çuar herët ... "Tak!" ma bëri zëmra: " Po sikur ta ketë therë gjelin tonë të dashur?" E kërkova gjithandej, së fundi e pashë tek zbriste shkallët, veshur me një peshli të kuq, kishte veshur fustanin e ri ngjyrë ulliri që e ruante për ditë dasmash. M'u duk shumë e bukur.

-E there gjelin? E pyeta me drithërimë në zëmër.

-E thera dhe e rropa, -tha ajo qetësisht sikur të kishte kryer një detyrë heroike, -Shko shikoje, e ke në tavën e madhe .

Nuk nxora asnjë klithmë. Kjo gjë më ka ndodhur dhe herë të tjera kur gjerat bëhen fakt, kundër vullnetit tim. "Lamtumirë gjel!i thashë me mend. T'u prehtë shpirti në paqe. Në Parajsë...Ose në Ferr. Nëse nuk do t'i quhej mëkat seksi i tepruar me pulat. "

Parajsa dhe Ferri janë për ne. Kush e di? Pulat dhe gjelat s'duhet të kenë jetë tjetër. Jeta e tyre mbaron në tokë, zoti i tyre është njeriu. I teket njeriut dhe e ther. Me kaq mbaron historia e një gjeli. I gjori gjel! Nuk e di pse krejt papritur m'u shua keqardhja për të, mbase ngaqë e pranoi menjëherë dhe pa mëdyshje therorinë e tij, për hir të një çështjeje madhore. Im atë dhe im vëlla e meritonin një pritje

madhështore, nëse mund të quhej madhështore një tavolinë e shtruar me mishin e gjelit tonë të dashur.

I hodha një shikim shkaras nënës, në pritje të burrit i kishte hipur një nur i veçantë. Unë atëherë isha 7 vjeç, në shtator do të hyja në klasën e parë. Gjatë muajve të verës kisha gjetur një abetare dhe kisha mbërritur gjer te germa "Sh".

"Sh" e madhe, "sh" e vogël, bërtisja me të madhe nëpër shtëpi. " *Sh, sh, sh...Shurupi i Shabanit...Shabani pi shurup...Shabani pi shurup me shishe...*"Sa shumë "sh" në një faqe abetareje?

Por ajo ditë do të mbahet mend dhe për diçka tjetër. Sa dola në oborr, Ninua, një shoku im i mëhallës zgjati kokën te porta :

-Eja shpejt , do të lozim "kukamçefti".

U nisa me nxitim pas tij. Kur mbërrita te porta e Ymerajve vura re një vajzë brune, me sy të zezë, e quanin Alime, vinte shpesh nga mëhalla jonë për të luajtur me ne: Në lodra ishte tepër e gjallë , ia shkonte dhe çunave të mëhallës. U ndamë në dy skuadra, katër me katër.

Nisëm vërdallisjen, duke u fshehur pas mureve të vjetra , pas pemëve ose duke u ngjitur në man. Skuadra jonë u tregua më e fortë. Fituam dy herë radhas. Në skuadrën tonë bënte pjesë dhe Alimeja e cila me shkathësinë e vet na dha dorë. Mirëpo, loja nuk zgjati shumë.

Fillimisht dëgjuam potere kalamajsh dhe të lehura qensh. Lamë lodrën dhe dolëm në rrugë. Çunat e mëhallës së përtejme kishin vënë përpara dy qen, të lidhur midis tyre seksualisht. I shtyni të shkonin drejt kalldrëmit tonë duke i qëlluar së largu me gurë. Qeni dhe qenushja ulërinin, pak nga sikleti i saj lidhjeje seksuale, e pak nga që fëmijët i qëllonin me gurë, dukeshin tepër të eksituar, herë u ndërseheshin fëmijëve e herë luftonin për t'u shkëputur nga ajo lidhje e turpshme.

Shokët e mi kureshtar sa dëgjuan ulërimat e qenve dhe klithmat e shfrenuara vrapuan pas tyre. Te sheshi mbetëm vetëm unë me Alimenë (Limen). Ajo hezitoi të shkonte pas tyre ndërsa unë mendova t' bëja shoqëri. Si mund ta lija vetëm?

Rrinim të heshtur , pranë e pranë , pa shkëmbyer asnjë fjalë.

Ndërkohë ajo u kthye nga unë dhe më bëri një pyetje të çuditshme:

"A lozim burrë e grua?"

-Unë nuk e di këtë lojë.-i thashë.

-Ta mësoj unë, - tha ajo.- Po jo këtu, shkojmë aty, mbas gardhit.

Këtu na shohin. Loja "burrë- grua" qenkishte një lojë e fshehtë. I shtyrë nga një kuriozitet i veçantë e ndoqa pas. Kaluam gardhin , një gardh i vjetër e i rrjepur, me drurë të shtrembër. Nuk ecëm më tutje. "Këtu, këtu...tha ajo, zë ulët sikur të kishte frikë mos na dëgjonte njeri. Qëndruam në këmbë, pas gardhit, dy-tri hapa larg rrugës. Sakaq ajo u shtri poshtë këmbëve të mia, ngriti fustanin lart , hapi këmbët... ishte hera e parë që unë shihja me çudi trupin e bardhë të një vajze, pa mbathje...E pashë me kujdes aty poshtë...Nuk kishte bibilush si unë. Te vendi i bibilushit vura re një të çarë të madhe ... Ndërkohë që po vëreja me ndrojtje veprimet e saj ajo më thirri ashpër:

-Ç' pret, hip?!

Unë u hutova fare. Iu binda urdhrit të saj. U ula dhe u shtriva mbi të.

-Dukesh që e paske për herë të parë, - tha ajo. Mos ki frikë. Do të mësoj unë.

Më futi dorën nën pantallona dhe me atë kënaqësinë që provojnë femrat e stërvitura me fillestarët e ndrojtur nisi t'i bëjë vetë dhe veprimet e mia. Kuptohej, ky nuk ishte rasti i saj parë. Ky mendim më dha kurajë dhe trimëri për të mos u treguar fare qullash. Nuk ndjeja asgjë...Kjo më çuditi.

Ç'kënaqësi ndjejnë njerëzit nga ky bashkim i turpshëm ?Ç'kënaqësi ndjejnë macet? Çfarë kënaqësie ndjejnë qentë, kuajt, gomerët, lopët, zogjtë, zhapikët, milingonat, ujqërit, çakejtë, derrat e egër? Çfarë i shtyn drejt këtij bashkimi trup me trup?

Gjendja nuk zgjati shumë: na kishte parë një grua që i ngjitej kalldrëmit e ngarkuar me një thes me miell në kurriz , fillimisht ishte çuditur:"Çfarë bëjnë këta fëmijë kështu?...Kur kuptoi gjithçka lëshoi ca britma alarmante, me të shara banale. Në fund na qëlloi me gurë. Limja kërcëu si ketër mbi trupin tim dhe u largua në drejtim të koshtrave, ndërsa unë mbeta aty.

-Ah! Qenke ti, djali i Vezikos, -tha ajo. Hë ! Ta tregoj unë te Vezikoja...

Kur mbeta vetëm nisa të shqetësohesha seriozisht. Gruaja me thesin e miellit në kurriz ishte kushërira e nënës, sigurisht, do t'i tregonte nënës. "S'do të kthehem në shtëpi" mendova. Do të pres gjersa të shqetësohen e të më kërkojnë vetë. "Po sikur të thërrisja motrën e vogël? Dielli kishte ndaluar në zenit. Vendosa të ngjitem lart, motra më priste te shkallët. Sa më pa nxitoi drejt meje.

-Ka ardhur babi ,- tha ajo e gëzuar, më pas u vrenjt: Po ti, ç'ke bërë me Limen?

-Ah! E kanë marrë vesh... S' pata kohë të gëzohem për ardhjen e babait, një shpullë e papritur më hutoi krejt.

-Kujt i ke ngjarë , o djall!?- më tha nëna duke më tërhequr fort për dore.-Po Limen e ke dhe kushërirë...Hajde tani, të takosh tët atë.

-Nuk vij.- i thashë unë i trembur. U mundova t'ia heq dorën dhe të iki me vrap.

-Babai nuk di gjë, -nxitoi të më qetësonte motra e vogël, ndonëse nga shprehja dukej që s'i kishte ardhur mirë kur kishte marrë vesh që vëllai i saj qenkej imoral.

"Babai nuk dinte gjë?! Kjo kishte rëndësi." I urtë dhe i ndrojtur ngjita shkallët për në dhomën e mysafirëve. Babai rrinte në krye të sofrës, i qeshur dhe babaxhan, pranë tij vinte gjyshi nga nëna, më tutje vëllai i madh, xhaxhai i vogël, dajë Hyseni ...

-Hajde çamarrok, më tha babai. - "S'ditka gjë jo."- mendova.

Më shkëlqyen sytë. I vajta pranë, dhe ai pa u ngritur nga vendi më puthi në ballë. -Hë!? Je bërë ndopak djalë i mirë?...E moj, ti?-iu drejtua nënës me zë të lartë.- Ky djalë ka bërë ndonjë marrëzi?

-Jo. Jo. i tha ajo. Është bërë djalë i mirë...I ka mësuar të gjitha gërmat e abetares .

-Të lumtë, tha babai, -Tani përshëndetu me vëllaçkon.

Duke lozur fëmijën e urtë dhe të turpshëm unë u takova përzemërsisht me të gjithë mysafirët , veçanërisht me vëllanë e madh, për të cilin më kishte marrë malli.

-Shko të hash në kuzhinë.- tha nëna duke më tërhequr për dore.

Tashmë isha unë ai që ia shtrëngova dorën nënës , fort -fort, me mirënjohjeje të thellë. Le ta merrnin vesh të gjithë, veç abetares unë kisha mësuar dhe diçka tjetër. Kisha mësuar të bëj seks.

Dervishi i Gjurës

Bisedonim në një klub të vogël, në qendër të Tiranës, rrufisnim kafënë me një pamje të zymtë e meditative, sikur prej nesh do të vareshin fatet e botës. Tema jonë e preferuar, fati. Personi q' na shoqëronte quhej Jetmir Bugalla, student i vitit të fundit të fakultetit filozofik, djalë i ri dhe energjik, vetullzi, me flokët e rëna mbi ballë, me një veshje sportive, xhakavento lëkure, pantallona blu xhins dhe atlete të bardha...Në pritje të emërimit ai kishte kohë që shoqërohej me ne, i pëlqenin bisedat tona, nuk ndërhynte në biseda, dëgjonte kujdesshëm, e ndjente veten të privilegjuar në shoqërinë me profesorët e tij.

-E çuditshme,- tha Artani duke hedhur vështrimin jashtë dritares së lokalit-Ideja e klonimit shkencëtarit Evans i erdhi përmes një ëndrrë që ai kishte parë, gjatë një bisede me një alien.

-Po dervishët? -ndërhyri Jetmiri në mënyrë të beftë -Në vitin e fundit të shkollës së mesme, kam takuar një dervish.. -Na hodhi një bisht syri për t'u siguruar nëse ngjarja që ai nisi të tregonte kishte rëndësi për ne, hetoi shprehjet tona indiferente dhe mendoi të mos zgjatej në imtësi të panevojshme.

-E quanin Dervishi i Gjurës , vijoi ai,- emrin ia kisha dëgjuar, një mëngjes herët, sikur ta kishte porositur vetë Zoti , më priti udhën në krye të fshatit, më pyeti si quhem dhe i kujt jam, më pas më hodhi një shikim , sikur më përshkoi një dritë...“ Ti, more djalë , tha, do të bëhesh një njeri i madh dhe i pasur.

-“Të faltë Zoti, i thashë. -Tani jam plakur e s' më përfill njeri, -tha ai, duke peshuar mbi një shkop thane. -Ty ta kam njohur dhe babën.... I ri ka ikur ai...I ri do të iksh dhe ti...Bëri një heshtje të gjatë...Do t'i ngjitësh shkallët shpejt, do bëhesh i madh dhe i pasur, por...do të biesh shpejt...”

- Domethënë, ti tani pret t'i dalin fjalët dervishit të Gjurës?

Mendova se do ta miratonte shakanë e Artanit , në vend që të çelej në fytyrë ai u ngrys edhe më tepër.

-Je i sigurt që ke parë vërtetë dervishin e Gjurës ?- e pyeta unë.

-Sigurisht, -tha ai. – Kam fol me të, kështu siç po flas me ju.

- Shkenca e njeh si fenomen.-tha Artani . Njeriut i krijohen vegime, jo vetëm në ëndrra ,por dhe gjatë kohës që është zgjuar.

-Për besë, jo... –nguli këmbë Jetmiri. Pas pushimeve të vitit të parë të fakultetit shkova në Gjurë, me shpresë për ta takuar. I kisha blerë një dhuratë të vogël. U ndjeva keq kur mora vesh që s'jetonte më. Më mbeti peng që s'e takova dot. Atë çast vendosa: Nëse do të dalin fjalët e dervishit te Gjurës , teqenë e Gjurës do ta ngre sërish.

* * *

Atë vit ngjarjet rrodhën me një ritëm të pazakontë. Në kryeqytet pati trazira të mëdha, ju kujtohet dhe ju dy korriku i ambasadave. Jetmir Bugallës iu prish mendja, mendoi të futej dhe ai në ndonjë ambasadë, bie fjala në ambasadën italiane, mirëpo, nuk duhej të nxitohej. Ai tashmë ishte një kuadër i lartë, jurist, shtigjet e karrierës dhe të pasurimit i kishte të hapura dhe në vend, pse jo, mund të emërohej në ndonjë Ministri. Atë ditë u vërtit rreth ambasadave, herë te italiania e herë te gjermania, pa vendosur dot, i këqyrte guximtarët brenda kangjellave të hekurta tek vërtiteshin oborreve, të shkujdesur dhe si të frikur, ndonjërin prej tyre dhe e njihte, shumica i dukeshin të palarë dhe jo të sërës së tij, kështu që, vendosi; “Do të shkoj ca ditë në fshat, të çmallem me njerëzit, më pas shohim e bëjmë.”

Ishte pikërisht ai mëngjes kur Jetmir Bugalla gjatë rrugës për në vendlindjen e vet do të dëgjonte lajmin e çuditshëm; guximtarët e ambasadave i kishin hipur në mesnatë në trena, më tepër se kaq nuk dinte asnjëri. Ngjarja e mbuluar me mister kishte gjallëruar fantazinë popullore; thoshin që i kishin mbytur me gaz helmues në të hyrë të Rrogozhinës, të tjerë që i kishin shoqëruar atë natë thoshin se i kishin nisur me një anije, gjoja për në Itali, por i kishin hedhur në det.

Jetmir iu prish mendja, por nuk e lëshoi veten, vendimi i kthimit pranë familjes ishte marrë në qetësi, në fshat s’ qëndroi as një javë, gjendjen dhe atje e gjeti rrokopujë, ngaqë në fshat lajmet vinin me vonesë, të deformuara e plot fantazi, fshati Kopel ishte një fshat i vogël, i ngritur mbi një kodër, në afërsi të Bllatës, i pashënuar në hartë. Aty dëgjoi që dy kushërinj të tij ishin futur në ambasadën gjermane, e pyetën mos i kishte parë, ai ngriti supet, katër të rinj të tjerë të fshatit, më i riu tetëmbëdhjetë e më i madhi njëzetedy, prej disa ditësh quheshin të humbur, flitej që kishin kaluar kufirin verior, por, kishte zëra që thoshin se kishin ikur me det në drejtim të Italisë... Me që nuk kishte asnjë telefonatë, (le që ku ta gjeje telefonin...) kishte shumë të ngjarë të ishin mbytur. Të tjerë gatiteshin për të ikur në fshehtësi të plotë, pa lajmëruar askënd.

* * *

Muajt e tjerë, Jetmiri i kaloi në Tiranë, kishte nisur një punë dosido, kamerier në lokalin e madh te pallati i madh i Kulturës, banonte në konvikt, godina 12-të, së bashku me dy shokë të tjerë që atë vit kishin mbaruar fakultetin inxhinierisë dhe interesoheshin për ndonjë vend pune në kryeqytet. Ditët e para të dhjetorit në konviktet e universitetit ndodhi një ngjarje e pazakontë, e cila ia ndërroi rrjedhën e personazhit tonë. Kishte

ditë që qyteti “Studenti” zhytej në errësi të për orë të tëra, gjendja u bë e padurueshme , u desh vetëm një çast, u desh një shkëndijë e vetme, që studentët e inxhinierisë të lini fjetoret dhe të dilnin rrugëve të qytetit ”Studenti” duke sokëllitur e duke hedhur parulla. S’durohej më kjo jetë, jo, jo, u kishte vajtur shpirti në buzë, fundja çfarë do të humbnin? Ishte policia që provokoi e para dhe ndezi gjakun e mijëra studentëve apo ishte vetë shpirti rinor që kërkonte dritë, liri dhe një jetë më të mirë për të ardhmen ? Atë natë midis protestuesve ishte dhe Jetmir Bugalla, djaloshi energjik me xhakavento lëkure e me atlete të bardha, i cili dhe për shkak të pjekurisë dhe karakterit impulsiv nuk u ndodh rastësisht në krye të lëvizjes studentore, përveçse vinte nga një zonë e varfër dhe e harruar kishte përjetuar dhe një farë persekutimi , për shkak të një daje, i cili në vitet gjashtëdhjetë kishte tentuar të kalonte kufirin shtetëror. Le t’i shtojmë këtyre fakteve dhe fjalët e dervishit të Gjurës, i cili i kishte parashikuar një të ardhme të shkëlqyer, dhe një vdekje të paralajmëruar.

* * *

Ngjarjet që pasuan i dimë të gjithë, lëvizja studentore dhjetor ’90-të u bë pjesë e historisë së popullit tonë. Në sekuencat filmike të atyre ditëve , sigurisht bardh e zi, midis një grupi të rinjsh universitarë, do të kini parë dhe portretin entuziast të mikut tonë, i dobët dhe i veshur keq, me flokët e gjata gjer mbi vesh, duke folur në tribunë te sheshi i Studentëve, i filmuar një kamera amatore. Në mbrëmjen e ditës së tretë portreti i tij u shfaq mbi të tjerët , në takimin historik të grupit të studentëve me presidentin, e më pas, në fjalimet hip e zbrit, sërish te sheshi “Studenti” , do ta pikasni menjëherë portretin e atij djaloshi energjik, vetullzi, me një xhakavento lëkure e me atlete të bardha, duke folur para studentëve kundër regjimit që i dha bursën dhe diplomën e juristit të lartë.

Jetmir Bugalla nuk i ngjante më atij djaloshit të ndrojtur të katër viteve më parë, që i lëpihej sekretarit të partisë për një të drejtë studimi, as atij studentit që e shihnim në shoqëri me pedagogët e tij, me një mirësjellje të dukshme...(nuk e kam kuptuar asnjëherë në ishte një mirësjellje e sinqertë apo e shtirur.) Ai tashmë ishte bërë anëtar i P. D-së. Një firmë e hedhur mbi një letër të bardhë, midis treqind firmave të tjera, e kishin vendosur atë si përfaqësues i një partie opozitare, heterogjene, populiste, edhe pse pati zëra që thoshin se Jetmir Bugalla natën historike të tetë dhjetorit kishte hyrë rastësisht në gjirin e studentëve dhe rastësisht ishte gjendur në krye të asaj lëvizjeje studentore , pasi

në të kaluarën e tij kishte ngrënë një lugë çorbë dhe ai, në sigurimin e shtetit. Mirëpo, gjithsesi, daja i tij i burgosur për arratisje, me 15 vjet burg, ishte një arsye e fortë për t'i quajtur gjithë supozimet e hedhura, dyshime pa asnjë bazë.

Ju kujtohet edhe ju ai vit i zhurmshëm e plot ngjarje të mëdha. Tre muaj më vonë vendi u përfshi në zgjedhje të parakohshme, në listën e deputetëve të partisë opozitare gjendej dhe emri i Jetmir Bugallës. Kështu, djaloshi energjik, Jetmir Bugalla, s' do të ishte më ai juristi kamerier, i kafes te Pallati i Kulturës. Ëndrra e tij e kahershme për t'u bërë dikush po realizohej me një shpejtësi të paparë, zona elektorale nr. 131 ku ai kishte kandiduar për deputet ishte një zonë e varfër e lënë në harresë. Të gjithë mendonin që Jetmir Bugalla do ta kishte të lehtë fitoren. Në vetëdijen e tij jetonin së bashku të tre profecitë e dervishit të Gjurës, ndërsa dy të parat e nxisnin të ecte para e treta ia frenonte energjitë dhe ia mpinte arsyen, profecia e tretë i dilte dhe në gjumë, e bënte të keq dhe nervoz.

* * *

Në 21 prill të vitit '91 vendi u përfshi në një garë të egër midis dy partive kryesore, P. S.-së së vjetër dhe partisë më të re opozitare e cila kërkonte njerëz të rinj në përfaqësimin parlamentar. Brenda dy-tre muajve Partia opozitare siguroi aq deputetë sa të konturonte profilin e saj, si një parti e re, kështu që, dhe personazhi ynë nuk e pati të vështirë të fitojë lehtësisht në krahinën e tij, në të 12 fshatrat e zonës kufitare. Te listat e deputetëve të P. D-së emri i Jetmir Bugallës ngjallte kuriozitet për të gjithë ata që s'e njihnin : “Kush është ky njeri?”, së fundi të gjithë e panë të ulur në karriget e parlamentit, i veshur shik, kostum blu (P. D), kollare P. D. me këmishë të bardhë, i vendosur në rreshtin e tretë të sallës, nga e djathta. Veprimet e mikut tonë unë dhe Artani i ndiqnim me kujdes, na bëhej qejfi kur mendonim që ish studentin ynë po i ngjiste me kaq shkathtësi shkallët e karrierës politike, se, gjithsesi, e kishim mik, ia çmonim cilësitë dhe praktikizmin e tij.

Në një nga këto ditë deputeti i ri na pa nga vetura e tij, ishim ulur si zakonisht, te kafja jonë, në tavolinat përjashta, pranë drejtorisë së Policisë, zbriti nga vetura dhe ia bëri me shenjë shoferit të mos e priste. U ngritëm këmbë dhe e takuam me një përzemërsi të veçantë, gjë s' ishte në karakterin tonë, e ftuam të ulej, porositëm kamerierin për t'i sjellë një pije freskuese... Po t'ua përshkruaja më në imtësi atë çast do të na gjykonit se jemi treguar dhe pak servil me ish studentin tonë, duke e trajtuar si një person me vlera të veçanta. M'u duk më i shëndetshëm nga

sa e kisha parë herën e fundit, më serioz, dhe më i pjekur në mendime.”Ja, deputetë të tillë na duhen” – i thashë , (e pranoj, pata dhe unë një çast “servilizmi pushtetar”)

“ Kandidimi im ishte një rastësi, -tha ai, -në fakt ju takonte ju të ishit në vendin tim.-na e ktheu komplimentin .- Si na keni thënë ju profesor, m’u drejtua mua, “ Boshllëqet mbushen me ajër.” Ndërkohë që dëgjonim të na fliste për jetën e re , për pagën , për deputetët me të cilët shoqërohej, m’u kujtua historia me dervishin e Gjurës.

-Tani erdhi koha ta ngrësh në këmbë tyrben e dervishit të Gjurës, -i thashë me shaka.

- E mbajtke mend ? -më tha dhe u çel në fytyrë. Të them të drejtën, gjatë gjithë kësaj kohe atje e kam pasur mendjen. Këto ditë kam menduar të shkoj në Gjurë dhe të bisedoj me kryeplakun e fshatit. Teqeja e Gjurës duhet ngritur sërish, sado që të kushtojë. E kam vendosur. Nxori nga xhepi një fotografi bardhezi, të vogël e të zverdhur nga vitet dhe na e zgjati para

-Ja kush ka qenë dervishi i Gjurës?.

Ia mora nga dora dhe e vërejta me kujdes. Një plak i kërrusur nga vitet me pamje prej babaxhani, ngjyra e syve nuk i kuptohej, kishte shikim të qeshur, duhet të ishte fotografuar nga një fotograf diletant. Kishte dalë anës rrugës, i kërrusur, duke peshuar mbi një shkop...

* * *

Parlamenti pluralist ishte bërë një fakt real. Të ndarë në dy reshta dy partitë kryesore gati sa s’rrokeshin për fyti me njëra tjetrën. Kishte disa muaj që gjithë Shqipëria i kishte mbërthyer sytë para ekraneve televizive për të shijuar “lajme me parlament.” Midis kokave të deputetëve, herë pas here, shfaqej dhe miku ynë, i qetë dhe komod, nuk e ngrinte kurrë zërin si të tjerët, nuk e kishte kërkuar kurrë fjalën të ngrihej e të llomotiste nga tribuna. Për sa i përket teqesë së Gjurës, veprën bamirëse të Jetmir Bugallës e mori vesh gjithë Shqipëria. Inaugurimi i teqesë u bë në fillim të shtatorit , para disa kamerave televizive, në prani të qindra fshatarëve dhe autoriteteve zonalë. E mbajti fjalën ,thashë me vete, kur e pashë në krye të të gjithëve, kishte veshur me atë kostumin P.D. që i rrinte aq bukur.

Nga fillimi i muajit tetor rasti e solli të njiheshim me vëllanë e tij: Atë mëngjes ne kishim dalë qysh herët, pasi, do të merrnin pjesë në një simpozium ndërkombëtar në Shkup. Ndërkohë na afrohet një djalosh i dobët, i veshur keq,mbante para duarve mbante një trastë si të ishte një minë, e shtrëngonte fort sikur të kishte frikë mos ia grabitnin. Se nga e kishte marrë vesh që udhëtonim për në Maqedoni dhe na u lut ta merrnim në veturën

tonë. E pranuar pa ndonjë paragjykim. Siç ndodh në raste të tilla , kur ndërmerren rrugë të gjata ,së paku për mirësjellje, i panjohuri duhet pyetur. “Kush je ti, o njeri që udhëton me ne?” Po ne u treguam të vëmendshëm për të mos e shuar kuriozitetin qysh në fillim, do të ishte vetë ai që do të na prezantohej qysh në minutat e para: ”Unë ju njoh ju, -na tha...Ju kini qenë pedagogët e vëllait tim.

-Si quhet vëllai juaj?

-Jetmir Bugalla. Sa mora vesh që do të udhëtonit për në Maqedoni u gëzova pa masë.”

Gjatë rrugës bisedat tona u përhodhën sa andej këtej. Djaloshi me fytyrën me rrudha nuk fliste, vetëm dëgjonte. Në karakter kishte diçka nga miku ynë , kishte një fytyrë zhubra-zhubra, sytë i kishte të kaltër, në gjithë qenien e tij varfëria kishte lënë gjurmë të dukshme.

Postën tonë kufitare e kaluam pa ndonjë problem , por me doganierët maqedonas nuk e patëm të lehtë, na detyruan të zbrisnim nga vetura për të na bërë një kontroll të imët, sikur të kishin të bënin me kontrabandistë.

”Po të kini para duhet t’i deklaroni, -na porositi njeri prej tyre, - ndryshe s’mbajmë përgjegjësi...” Vura re me bisht të syrit sesi miku ynë u vu në siklet. ”M’u afrua dhe më pëshpëriti në vesh : ”Unë kam ca para në çantë. Ç’më këshilloni?” “Duhet t’i tregosh...- i thashë. –Ku i dihet”. M’u duk sikur u bind. Kur i kërkuam të hapte çantën veproji qetësisht. Kur e pyetën se sa para kishte me vete tha ca shifra që na la të pa mend, ne dhe dy punonjësit e postës maqedonase, në atë trastë fshati të vjetër e të pistë ndodheshin jo pak, 150 mijë marka, 100 mijë dollarë dhe rreth 50 milionë dinarë jugosllavë. Nuk u interesuan për t’i parë, mjaftonte vetë deklarimi, kolegu që qëndronte pranë tavolinës i mbajti shënim.

Pjesa tjetër e rrugës, gjer në hyrje të Strugës, kaloi në heshtje, nuk u bëmë kureshtar për të ditur burimin e gjithë asaj valute, as për të mësuar ku shkonte dhe ç’ biznes i rëndësishëm po e priste? Ndërkohë m’u kujtua miku ynë deputet, dhe dervishi i Gjurës...

Atje ku rruga merr kthesën, përgjatë lumit të Radikës, drejt Dibrës së Madhe, na kërkoi ta ndalnim makinën se do të zbriste. I dhamë dorën miqësisht, ndërkohë që po niseshim vumë re, dy persona të mbështetur pranë një bensi të zi ia bënin me dorë.

* * *

Në fund të vitit të parë të qeverisjes së Partisë Demokratike u hoqën tre ministra dhe dy zëvendësministra , një nga shkaqet e kësaj lëvizjeje ishte kritika që u bëheshin disa ministrave për

afera korruptuese. Ministri i Brendshëm ishte akuzuar për lidhje të forta me mafien e cigareve, për Ministrin e Mbrojtjes flitej hapur që kishte lidhje me trafikantët e armëve. Ministri i kulturës u hoq për çështje morali. Ajo që i çuditi të gjithë ishte emërimi i Jetmir Bugallës Ministër i Brendshëm, jo vetëm pse ishte i ri e pa përvojë, por edhe nga që të gjithë i dinin lidhjet e tij me ish Ministrin e mëparshëm. Ky emërim u duk sikur po bëhej për t'i provuar karakterin; a do të pranonte ta zëvendësonte mikun e tij, vetëm për ca fjalë të publikuara në gazeta, të cilat mund të konsideroheshin edhe shpifje ?

Gjithsesi, ngjarjet e bujshme harrohen brenda tre ditëve, edhe emërimi i Jetmir Bugallës në postin e Ministrit të Brendshëm, e meritonte ose jo, dhe a përputhej kjo me moshën dhe moralin e tij, u harrua brenda tre ditëve. Qysh ditën e parë Jetmiri u shfaq para kamerave, me një luk të ri, flokët e qethura fare shkurt, kostumi nuk ishte më blu, e vura re me kujdes gjatë një interviste në televizorin shtetëror, kostumi ri kishte ca rremba ngjyrë ulliri, ndërsa kollarja ishte ngjyrë portokalli. Fliste qetë dhe rrjedhshëm, kishte marrë plotësisht një pamje ministrove. Unë u gëzova, se sidoqoftë, nëse do të kishim ndonjë hall do të na gjendej pranë. Tre profecitë e dervishit të Gjurës më ishin bërë dhe mua fiksim, dy të parat i dolën, larg qoftë e treta, më e rëndësishmja. Karriera e tij ishte diçka e dukshme, e dyta ishte e mbuluar me mister. Nëse do të bënim një lidhje midis trastës së vjetër me para që vëllai i tij i deklaroi në prezencën tonë, në doganën e Qafë –Thanës, dhe lidhjeve të Jetmir Bugallës me ish Ministrin e Brendshëm, mund ta pranoni që dhe paratë nuk i mungonin, pra, së bashku me paratë dhe emrin e lartë në shoqëri, po i afrohej profecisë së tretë.

Gjatë kohës që Jetmiri gëzonte postin e ministrit unë dhe Artani bëmë një rrugë të dytë për në Shkup, në kthim, në të dalë të qytetit të Strugës, aty ku një vit më parë ishim ndarë me vëllanë e Jetmir Bugallës, na zgjatën dorën dy miqtë tanë.”Ku shkoni?” “Në Tiranë” “Do të vijmë dhe ne me ju.” Gjatë rrugës na treguan arsyen e këtij udhëtimi me makina të rastit. “Ishim në Dibër të Madhe, tha Kujtimi, një miku im, inxhinier mekanik, i cili në pritje të ndonjë pune shtetërore e kalonte kohën me biznese të rastit.

-U nisëm për lesh e po kthehemi të qethur,- ia priti Antoni.

Të dy ia plasën gazit, si të çliruar nga një ankth, të lirë dhe të sigurt.

Ç’kishte ndodhur? Dy biznesmenëve u ishte afruar një ofertë biznesi e majme, malli duhet të vinte nga Sofja gjer në Dibër të Madhe, në besë të dërguesit. Për futjen e mallit në kufirin shqiptar nuk mbanin përgjegjësi.

“Mbajmë ne”,- u kishte thënë Kujtimi. “Çfarë malli?”- e pyeta unë.”Cigare o cigare..”tha Antoni me një aksent korçar. Flitej për dhjetë ton cigare, jo pak, me vlerë monetare 600 mijë dollarë..”Se mos i blinim ne. Ishin të tjerë ata që do t’i blinin. Ne do të loznim rolin e ndërmjetësit.”

-Shkuam si cjapi te kasapi, -ndërhyri Kujtimi. Ta themi me dy fjalë, mor vëlla, këto punë duan bythë ... Na ndihu Zoti që, ndërsa ai tjetri nga bullgaria priste përgjigje, u ndodh rastësisht një centralist, djalë i sinqertë, nga Dibra e madhe, i cili pati guxim të na pyeste.”Të kujt jini?”Si të kujt jemi? Të askujt. Ai shqeu sytë, naa! U ngrit nga tavolina sikur ta kishte pickuar miza Ce- ce. Ikim,- i thashë Kujtimit. S’është punë për ne kjo ...Na zuri frika. Gjetëm një furgon dhe përfunduam aty ku na gjetët ju. -Mbrëmë na mori për darkë një shqiptar, tha Kujtimi, kishte qenë dikur njeri me detyra të larta në pushtet, e mbante veten për socialist. Nisi të na bëjë moral; ç’kërkoni ne, dy intelektualë, të përfshiheshim në punë cigaresh. Herë na shihte me dyshim e herë përpiquej të dinte cilat ishin lidhjet tona me Ministrin e Brendshëm. Kur i treguam që kishim vetëm një njohje të thjeshtë na pa me habi.

” Dëgjomëni mua, tha, këto punë nuk bëhen pa pasur dijeni Ministri i Brendshëm. Dhe oficeri i doganës së Bllatës që iu paska dhënë siguri për kalim malli iu ka gënjyer.”

-Flisni për ministrin e ri? -E pyeta.

-Sigurisht, tha Kujtimi. Me sa duket këto lloj lojëra i luan vetë shteti...Ose... Kushedi ç’lojëra luhen? Ç’t’ ju them unë i ziu ? Ne na zuri frika dhe ia mbathëm. Mbase u trembëm kot... I thashë Antonit, kapim një makinë të rastit dhe ia mbathim pa e marrë vesh njeri. Ku i dihej. Gjatë gjithë kohës që qëndronim në pritje të faksit ndërlidhësi i tyre na vërente me dyshim. “Kush ishim ? Kush na kishte dërguar? ”Mos ishim punonjës të inter-polit? Një herë erdhi dhe na tha, s’punon faksi, herën tjetër u zhduk dhe nuk u kthye. Hajde, i thashë Antonit, s’është punë për ne kjo.

* * *

Kafja “Book Hause”, ku takohemi mëngjeseve kundërmon nga lulet e blirit, ne qëndrojmë jashtë, në verandë , kamerierët na njohin, janë mësuar me ne, sa na shohin e sjellin vetë porosinë, na lënë në tavolinë dhe gazetatat e ditës. Atë mëngjes rruftim qetësisht kafetë. Në faqen e parë të gazetës “Shekulli “,së bashku me portretin e ministrit të brendshëm, ekspozuar, nën një titull të madh , shkruar me germa të mëdha, flitej për një aferë korrupsioni, germat e zeza akuzuese ishin në kontrast me portretin e qeshur dhe të shëndetshëm të tij.

U bëra kureshtar ta lexoj.

-E mo, lere, -tha Tani. -Ia futin kot. Duan të bëjnë sensacion. Dhe në ditët e tjera fotografia e Jetmir Bugallës do të na buzëqeshte nga faqet e para të gazetave, në krye të një delegacioni për jashtë shtetit . Javën e fundit të tetorit unë shkova në panairin e librit, në Frankfurt. Në ato ditë të paharruara, vizitoja shpesh një kafe në qendër të qytetit, quhej , “Merkes”, e frekuentonin emigrantë turq por dhe shqiptarë të Kosovës. Ditën e kthimit në aeroport më shoqëroi një mik kosovar, me veturën e tij , i cili ishte dhe mik i Jetmirit, e kishte pritur në Frankfurt dhe e kishte mbajtur disa ditë në shtëpinë e vet. Prej tij mora vesh se Jetmir Bugalla kishte dy fëmijë, djalë e vajzë, djalin nëntë vjeç, vajzën katër vjeçe, gruan e kishte nga Elbasani, ishte martuar gjatë kohës që kishte bërë një kurs një vjeçar në Tiranë, për punonjës kulture... dhe që tashmë banonte në Tiranë, në një vilë dykatëshe, ndërtuar rishtazi, në bllokun e vilave te Selita e Vogël. Miku kosovar kishte blerë një dhuratë për djalin e tij të vogël, ishte një shkop ndalimi nga ato që përdorin policët rrugorë , m’u lut t’ia çoja në shtëpi. Të nesërmen e asaj dite, në mbrëmje, u nisa drejt vilës së tij, këdo që të pyesje , dhe një kalimtar të zakonitë, vilën e Ministrit të Brendshëm do të ta tregonte me gisht. I rashë ziles, doli e shoqja , një bionde e sjellshme , e imët, me flokë të prera shkurt, me veshje shtëpiake, më buzëqeshi sa më pa. “Urdhëroni profesor, -më tha, por...ngriti supet, “Jetmirin s’e keni...Sot u nis për në Amerikë.” I tregova arsyen për të cilën isha munduar, i bëra të falat e mikut tim , i lashë dhuratën në dorë dhe u largova. Gjatë kthimit e vetmja gjë që më vërtitej në mend ishte vila, vila e tij e madhe e stilit gjerman dhe oborri i hijeshuar me vazo lulesh. Si ka mundësi, mendoja me vete, me zilinë karakteristike të të gjithë njerëzve si unë që s’u bënë kurrë të zotë për të pasur një apartament për të qenë . Mirëpo, m’u kujtuan fjalët profetike të dervishit të Gjurës dhe m’u qetësua disi, ambicia prej njeriu të pa aftë, pasi, Zoti t’i jep të gjitha me tepricë, dhe t’i merr të gjitha, kur të dojë. Le ta jetoj gjithë jetën si një qyq , në atë apartamentin tim të vjetër , një dhomë e një kuzhinë, ku të zihet fryma, duke iu lutur zotit ditë për ditë, të më jap vetëm shëndet dhe jetë të gjatë .

* * *

Jetmir Bugalla kishte mbushur vitin e dytë në atë post ministror pa i hyrë gjemb në këmbë, edhe pse emri i tij lakohej në media dhe në gazetatat e përditshme, herë për mirë e herë për keq, por, cili ministër i brendshëm nuk u përfol në këto vite, aq më tepër që Ministria e Brendshme ishte një ministri me shumë probleme,

Jetmir Bugalla në tavolinën e tij të punës kishte gjetur një listë të gjatë kriminelësh që vërtiteshin në liri të plotë, ndërkohë që familjarët e viktimave akuzonin ministrin e brendshëm.

Tashmë nuk ishte nevoja të takoheshim e të bisedonim me të , pasi pushtetarët të mbijnë në sy, çdo ditë , rast e pa rast , i do apo s' do t'i shohësh me sy, të shfaqen në ekran në ato debatet televizive. Ministri i Brendshëm quhej “Dora e fortë” e ligjit dhe e shtetit , Jetmir Bugalla e dinte këtë, ndaj me zgjuarsinë e tij natyrale kishte pranuar ta lozte këtë rol artistikisht. Herë duke u treguar dhëmbët kontrabandistëve e herë duke mos u sjellë aspak tolerant me gabimet e policisë. Mirëpo, thoshin se vëllai i tij merrej me punë të dyshimta, ishte pronar i një lokali në qendër dhe i një pallati tetëkatësh që po ngrihej në fund të rrugës: “Qemal Stafa”.

Sa herë e shihja mikun tim të dilte para kamerave duke folur rrjedhshëm, për gjera të rëndësishme shtetërore, më bëhej fiksion dervishi i Gjurës, po mirë të më bëhej ,vetë ma kishte shtirë ndërmend . Si ka mundësi, një intelektual të mbetet peng i një ëndrre, i profecisë së një fshatari pa shkollë si dervishi i Gjurës?

* * *

Jetmir Bugalla vdiq në 22 tetorit të atij viti, në një aksident automobilistik, gjatë rrugës për t'u kthyer në Tiranë, në mesnatë, në katër rrugët e Shijakut, vetura nga shpejtësia kishte dalë nga rruga dhe ishte përplasur në trungun e një plepi. U bë shumë zhurmë rreth atij aksidenti, u përfol dhe se, së bashku me ministrin kishte vdekur dhe një femër , për shoferin nuk u bë fjalë. Atë mesnatë, e shtunë duke u gdhirë e diel, Ministri kthehej nga një gosti familjare, u përfol dhe se makinën e ngiste vetë.

Pati hamendje të shumta rreth këtij aksidenti të çuditshëm, fillimisht u përfol që ministri kishte qenë në një dasmë, më pas doli diçka tjetër, Ministri kthehej nga një rast gjuetie... Po përse pas mesnate? Po përse makinën e ngiste vet? Mund të kishte pirë pak... Hamendjet zgjatën vetëm tre ditë, ndërsa hetimet zgjatën plot një vit. Ky aksident...nëse nuk do ta quanim aksident, ose një vrasje e studiuar gjer në imtësi nga profesionistë, ka mbetur mister edhe sot e kësaj dite.

* * *

Një javë më vonë unë me Artanin shkuam për ngushëllim në vilën e tij, kur u gjendëm te porta e hapur dykanatësh, e kuptuam në çast që vizita jonë po bëhej në një orë të papërshtatshme. Na doli para vëllai i tij, na kishte parë nga dritarja. E shoqja e veshur

me të zeza, na priti në holl, mobiluar bukur e me shije, me divane dhe kolltukë lëkure.

Në të djathtë të tij të binte sy një tjetër vend pritjeje, më intim me një si bar-bufe familjare. Na falënderuan për vizitën përkujtimore, duke na shprehur konsideratat e rastit, dhe ne, të prekur nga kjo vdekje e parakohshme i shprehëm qetësisht ngushëllimet tona. Nuk dua të zgjatem rreth kësaj vizite të shkurtër , ku çdo lëvizje dhe çdo fjalë mbështillej me një heshtje solemne, veçse dua t'u them se nga gjithë ai takim më mbetën në mend fjalët e të shoqes :“Seç kishte një parandjenjë që do të vdiste shpejt...Kohët e fundit kishte filluar të më linte amanete... Merakun e kishte te vajza e vogël... Para dy muajsh i kishte dalë në ëndërr dervishi i Gjurës, fotografinë e tij s'e hiqte nga xhepi i brendshëm i xhaketës.”

Na përcollën gjer jashtë portës, sipas zakonit. Gjatë kthimit nuk shkëmbyem fjalë , na kishte kapur të dyve një ndjejë fataliteti. Për një çast mendova; mos vallë dhe vegimi i dervishit të Gjurës atë mëngjes, në të dalë të fshatit ka qenë thjesht, një vegim i trurit të tij?

Nusja e Borajve

Nëna qëndronte përballë , thurte me shtiza, ulur në stolin e saj të zakonshëm. Një natë më parë kishte qenë në Boraj. Kishte vdekur një nuse. të premten kishte vdekur e ishte ngjallur të dielën. Ky lajm mori dhenë. Ne i kishim të bënim, kështu që, nëna duhet të shkonte për ngushëllim .Mirëpo, kishte ndodhur një mrekulli e padëgjuar. Të premten në mbrëmje kishte vdekur të dielën në mbrëmje ishte ngjallur. Ndofta dhe më parë.. Nëna shkoi të martën, jo për ngushëllim por, për mirëseardhje.

-Vërtet u ngjall?- e pyeta nënën

-Vërtet,- tha ajo pa i hequr sytë nga shtizat.

-E pe me sytë e tu?

-Me sytë e mi po të kujt?- u përgjigj ajo për të më hequr çdo dyshim se nusen e Borajve nuk kishte parë vet. Vajta vetë aty, dhe e pashë nga afër.

- Sa ditë qëndroi e vdekur?

-Tre ditë. Po ti pse pyet? Je shumë i vogël për t'i marrë vesh këto gjëra.

-Ti vetë ke thënë, se njeriu s' vjen më në jetë, - i thashë .

-Se mos e pashë kur vdiq.... Kështu thanë.

Vizioni i nuses kuçjote, që vdiq dhe u ngjall, si Jesu Krishti dymijë vjet më parë, , më është shfaqur herë pas here, në jetë e në ëndrra. Më pas familja jonë u shpërngul në qytet. Dhe në shtëpinë e re nëna nuk iu nda shtizave dhe luleve, në ca vazo prej balte kishte mbjellë menekshe, manxuranë , borzilok dhe dy vazo me karafila të bardhë. Kur hyra në shtëpinë e prindërve e gjeta sërish me shtiza në duar. Ishte një çast i cili më solli ndërmend nusen e Borajve.

-Të kujtohet ajo i historia e nuses së Borajve?- e pyeta

- Si jo, tha ajo. Atëherë ke qenë i vogël dhe kisha frikë mos trembeshe. Unë shkova në Boraj një ditë pas ngjalljes dhe e kam parë me sytë e mi.

I ishin mbledhur te koka shumë gra dhe e shikonin me habi. Hapnin sytë, na. U dukej një çudi e madhe. Si ka mundësi, thoshin me vete, e kishin qarë dhe e kishin varrosur me kuje dhe ja, ishte ngjallur si Krishti dhe gjendej midis të gjallëve, në atë dhomën e madhe të Borajve , shtruar rreth e qark me qilim leshi. Krevati i saj mbuluar me një velenxë të kuqe flakë.

-E si kishte ndodhur?

-Një bari i fshatit i quajtur Zerbin Gjollma , duke kaluar pranë varrezave kishte dëgjuar një rëngë gruaje... Ishte afruar pranë varrit dhe kishte ndjerë me frikë..."Po. Po. Një rëngë e mbytur vinte nga nëntoka." Bariu ia kishte mbathur vrapit dhe ishte sosur me një frymë në Boraj. Kështu e kështu, u thotë. Dëgjova një rëngë te varri i Dafinës së gJORë. Në çast u shkulën Borajt me gjithë mëhallë e shkuan te varri i saj. Mbajnë vesh...Një zë i

thellë vinte nga poshtë dheut. E nxjerrin arkivolin nga dheu dhe e hapin. E gjora, ishte e gjallë.

Për të gjithë ata që e kanë dëgjuar këtë histori është quajtur si një çudi e madhe, ndërsa për mua që e kam takuar dhe e kam dëgjuar me veshët e mi, s' ka kush të më bindë që ajo ka vdekur dhe zoti e ngjalli përsëri. Paska dhe vdekje klinike... Kështu i thonë, por vdekja e saj zgjati tri ditë. "Mjekësia nuk njih raste të tilla", tha ndihmës mjeku i fshatit, disa ditë më vonë dhe ai ndërroi mendje dhe e quajti një mrekulli të zotit.

- Ke thënë që zgjati tre ditë?

- Këtë e dinë të gjithë,- tha ajo. Tre ditë e tre net.

Vdiq dhe u ngjall. E ktheu Zoti në jetë. Rrinte e gjora në cep të krevatit si e hutuar dhe i shikonte të gjithë, e qetë e me sy kureshtar. "Mos më pyesni se s' më lejohet...", thoshte. Kështu e kishin porositur... Këtë gjë kishte thënë dhe në çastin kur e nxorën nga varri. Fjala u përhap në të gjitha fshatrat.

Kur e mori vesh halla ime "Kiameti! kishte thirrur me zë të lartë.-Ja, këto janë shenjat e para të Kiametit. " Nusja e Borajve është kthyer në jetë si shenjë e Kiametit, me një kusht, të mos tregojë asgjë, çfarë ka parë dhe çfarë ka dëgjuar ato tre ditët e botës së përtejme. "Po të tregoj , u kishte thënë ajo, Zoti më merr sa të hap gojën." Pra, ajo kishte parë diçka... Ajo dinte diçka... të mirë ose të keqe, për vete dhe për gjithë njerëzimin. Ajo ishte e vetmja dëshmitare në këtë botë që kishte parë diçka nga bota tjetër, ishte e vetmja qenie në këtë botë që për një arsye të pashpjegueshme ishte kthyer nga bota tjetër, dhe ishte e para herë në jetë që Zoti bënte një përjashtim. Kthente një njeri në tokë.

Ishte penduar apo çfarë? Halla ngulte këmbë që kthimi i saj po bëhej në kohë, dhe ishte një nga shenjat e para të Kiametit.

E pyesnin,- na thuaj , ishte mirë apo keq?

-Jo, thoshte ajo. -Di shumë gjëra por nuk mundem...

-Na thuaj vetëm ndonjë gjë, ashtu kot.

- Jo. Jo ,thoshte ajo me sytë në tavan.

Njerëzit që e rrethonin digjeshin nga kureshtja për të marrë vesh diçka nga bota e përtejme, edhe duke pranuar që ajo "të vdiste në çast".

Jo vetëm atë ditë por edhe ditët e tjera ajo nuk e hapi gojën. Tmerrohej nga frika se mos i prishnin mënden , mos i bënin magji dhe ajo pa e pasur mendjen në vend, tregonte të fshehtat e botës së përtejme.

Vetë hoxha i fshatit , Hivziu, një burrë i gjatë dhe i fortë si një lis, i cili kishte mbaruar medresenë në Janinë, kishte bujtur në Boraj që atë natë, "na lini pak vetëm, kishte thënë", i kishte kënduar një sure turqisht dhe i kishte bërë ca pyetje si njeriu i besuar i Zotit, por ajo nuk e kishte hapur gojën.

Atëherë ai kishte hapur një qitap të madh e të trashë, thoshin që quhej "Tabir name" e kishte rrëmuar në kodin e shenjave. Në libër shkruhej: "*Njeri i nxjerrë nga dheu, rrezik i madh...*" Po. Po. Një rrezik i madh i kanosej botës....

Lajmi mori dhenë, u përhap në të gjitha fshatrat e Kurveleshit. Ishte e drejta e lajmësve që në këtë histori, kudo që shkonin, të trillonin diçka nga vetja e vetë, dikush duke shtuar elementë nga parajsa e të tjerë duke shtuar elementë nga ferri. Versionet ishin të ndryshme . Në Kallarat flitej sikur, në intimitet, ajo i kishte treguar një kushërirës së vet, se e kishin marrë dhe e kishin shtrirë në një pllakë guri të zjarrtë, "...duhet të ishte ai guri i Xhehenemit?" , i kërkonin t'u fliste për jetën e përkëtej varrit, për njerëzit e tyre të dashur, e më the e të thashë... Kjo gjë mund të ishte e vërtetë. Nusja e Borajve kishte në shpatulla ca shenja të një djegieje të madhe.

Në katundin Vërmik ishin hapur llafe sikur nusja e Borajve ishte kthyer prapë në jetë, thjesht, për të trembur njerëzimin e për t'u kujtuar që Zoti ekziston, që Zoti sheh, që Zoti nuk harron, si mesazh për ata që kishin nisur ta harronin. Nusja e Borajve ishte e bindur se do të vdiste shumë shpejt, ndaj qëndronte si e shushatur, e shtrirë si lehonë, me sytë nga trarët e shtëpisë. Njerëzit që hynin e dilnin i dukeshin si të huaj, edhe nëna e babai të huaj i dukeshin. Pas kthimit të saj nga jeta e përtejme ajo vetë jetonte si e huaj në këtë botë, e huaj dhe e tronditur nga gjithçka kishte parë, ndjerë dhe dëgjuar.

E rëndësishme ishte që nusja e Borajve ruante një sekret. Sekret i saj ia shtonte edhe më shumë misterin e kthimit të frikshëm. Tashmë ajo ishte si të thuash, njeriu më i ditur në gjithë rruzullin. Kishte parë një gjë që e kishte ëndërruar gjithë njerëzimi dhe s'e kishte parë asnjë njeri i kësaj toke Ajo dinte aq sa dinte Jesu Krishti, pas kthimit të tij në jetë.

Atëherë në fshat nuk kishte as telefona dhe as televizorë për ta shpërndarë lajmin në gjithë botën. Po ta dinte njerëzimi këtë gjë do shkuleshin të gjithë televizionet e botës e të vinin aty , në atë fshat të humbur e të harruar nga e gjithë bota.

-Kjo gjë ndodh një herë në dymijë vjet , kishte thënë prifti i Pilurit.-Ndaj mos e prekni. Vajza do të jetë kthyer në një shenjtoje dhe ne nuk e dimë.

Po përse kaq vonë? Dhe përse të kishte lindur në Kuç... në një fshat me barinj ,e që nuk besonin aspak te Zoti?

Po prifti ishte përgjigjur " Janë punët e perëndisë, mbi perëndinë askush kush del"

Versioni i tjetër i djegies në një pllakë bronzi, ndonëse ishte një trillim i pastër, u përhap më me shpejtësi dhe u duk më bindës. Kishte dhe një variant tjetër që pëshpëritej nën zë. Nusja e Borajve, e cila kishte vdekur gjatë lindjes së djalit, në çast kishte

ndjerë zërin e fëmijës që i qante...Të kishte lidhje kjo me kthimin e saj në jetë? Mos vallë, duke dëgjuar zërin e kësaj foshnje të porsalindur, për herë të parë në historinë e tij, Zoti ishte bërë pishman dhe e kishte kthyer?

Në Fterë ishte hapur fjala që nusen e kishin rrëmbyer xhindet, vetëm shpirtin, jo trupin.

Shpirtin e saj e kishin grabitur engjëjt dhe e kishin ngritur gjer në qiellin e tretë, aty ajo kishte dëgjuar dhe gjuhën e engjëjve... ca fjalë që e kishin trembur të gJORËN , aq shumë, aq shumë, sa dhe pasi shpirtin e saj e kishin kthyer brenda trupit, përsëri qëndronte si e tromaksur.

Pëshpëritej nën zë dhe diçka tjetër , më e çuditshme : " foshnja mund të ishte Krishti i ri... " E pse jo? A nuk ishte thënë në Bibël që Krishti do të kthehej përsëri pas 2000 vjetëve? Duheshin dhe 50 vjet? Mbase llogaritë i kishin bërë gabim...Në se kjo ishte e vërtetë, nusja e Borajve ishte si shën Mëria..."

"Për kokën e Bejtos! Përbetohej halla, duke shkuar derë më derë , Kiametin e kemi afër, përgatituni moj gra. Lahuni, pastrohuni dhe vishuni mirë, mos bëni mëkate turpi, dhe prisni, prisni. Mos më thoni s'u kam thënë. Unë i kam ditët të numëruara , mua nuk më zë ajo ditë, unë nuk do ta shoh mynxyrën e madhe që do të shihni ju. Për kokë të Bejtos , nuk iu gënjej. Futeni mirë në mendje këtë që keni parë. Është shenja e parë e Kiametit."

E zeza! Nuk rrojti më shumë se një vit. E kishte të shkruar, me ditë, me orë, me minutë. Pikërisht një vit më vonë, në datën 14 janar të vitit 1956 nusja e Borajve vdiq. Mori me vete dhe enigmën e jetës së përtej varrit.

Madhëria e tij

Unë kisha kënaqësi ta thërrisja "Madhëri!"

ndonëse ato ditë ai kishte mbushur katër vjeç.

Madhëria e tij erdhi me vrik, pas shpinës sime dhe ma veshi me një shuplakë pas veshit.

-Ç'pate?- e pyeta unë për mirësjellje.

-Posi. Kujton ti s'e nuk e dëgjoj unë fjalët që i the nënës.

-E çfarë i thashë?

-I the që këtij fëmije i është mbushur koka me demonë dhe kuçedra...Duhet të mos ia hapim më kompjuterin, as televizorin.

-Po ti si mendon?

-Unë jam komandanti! Unë vendos. Përpoqi këmbët me inat para meje. -Televizorin do ta hap sa herë të dua. Dhe në kompjuter do të loz sa herë të më dojë qejfi.

-Kompjuteri nuk është i këshillueshëm për fëmijët,- i thashë.

-Nuk jam më fëmijë! Unë jam madhëri.-ulëriti ai. -Dhe ti... a nuk më ke thënë që je shërbëtori im?

-Sigurisht madhëri.- i thashë unë me një seriozitet të shtirur. Nga përvoja e fëmijërisë sime, kisha menduar që fëmijët nuk duhet t'i zhgënjesh kurrë, dhe fjala e dhënë duhet mbajtur me çdo kusht, ndryshe, dhe një vogëlimë e rëndomtë mund t'i mbetet në mend për gjithë jetën. Madhëria e tij kishte disa ditë që kishte mbushur katër vjeç, ndërsa unë i kisha premtuar se do të isha shërbëtori i tij besnik, shprehje u huajtur nga ndonjë film vizatimor. Në fakt unë kisha katër vjet që e kryeja një rol të tillë.

Ditën që madhëria e tij mbushi katër vjeç, daja i tij i instaloi në kompjuter Xhek kërcimtarin, një lojë e vështirë për moshën e tij, mirëpo, ai pati ditë të tëra që e ushtroi atë me një zell të pa treguar. Pak nga pak ia mori dorën, sigurisht, edhe me ndihmën e shërbëtorit të tij besnik. Pas çdo fitoreje që ai bënte me armiqtë e dukshëm dhe të padukshëm, me demonët e kuq, me shtrigën dhe gjigandin prej dëbore, me Sfinksin dhe Posedonin, me xhuxhmaxhuxhët dhe merimangat e stërmëdha, lëshonte një klithmë triumfi saqë dridhej gjithë shtëpia."Ha ha!..E vrava! E hodha me b... përperjetë! Mallkuar qoftë ajo ditë që ia mësova atë fjalë të pistë " Një natë, tek më vërtiteshin në ëndrra figurat e shtrigës e të xhuxhmaxhuxhëve sa u zgjova vendosa që Xhek kërcim lartin t'ia heqim nga kompjuteri, mirëpo, në këtë mes nuk isha unë që vendosja, çfarë isha unë, një shërbëtor besnik i madhërisë së tij, një Sanço Panço, në familjen tonë kishte vetëm një njeri që vendoste.

Kur madhëria e tij mbushi tre vjeç, në çastin që po hynte në kuzhinë pa breçka, ime shoqe thirri: Erdhi princi im! Sa herë plaste sherri për çështje që lidheshin me Princin e vogël, ime

shoqe mbante krahun e madhërisë së tij: “Ai vendos! thoshte ajo, ai është komandanti!”

Ofiqin “madhëri” ia kam dhënë unë. Ishte një dite qershori , ndërsa ai lozte në kompjuter, unë iu drejtova me pjatën e ushqimit në dorë : ”Madhëria juaj, erdhi ora t’i kushtoni pak rëndësi dhe ushqimit...”

Ç’është e vërteta, madhërisë së tij, duke parë qindra filma vizatimorë e duke lozur lodra të ndryshme në kompjuter, kishte nisur t’i merrte koka erë, ishte shndërruar në një Don Kishot fëmijë, ndërsa unë, duke i shkuar me zell të tepruar pas fantazive të tij, isha shndërruar në një Sanço plak. Dhe kjo kishte një arsye,se , siç thoshte Sanço Panço, ” *Duke u marrë me fantazitë e madhërisë së tij, jam bërë dhe unë një soj si ai.* ”.

Ne të dy na lidhin shumë gjëra, përveç gjakut të njëjtë që na lëviz në damarë kemi të njëjtat prirje për aventura dhe të njëjtën hobi për t’i hiperbolizuar ngjarjet dhe personazhet. Kur uleshim në gjunjë në mes të kuzhinës dhe loznim me kuba, ose, kur i përplasnim veturat lodra me brohori, ne ndjenim të njëjtin gëzim dhe të njëjtën dashuri për njeri tjetrin.

Në këto raste, madhëria e tij ,edhe pse madhëri, e kishte ngrënë ndonjë shuplakë nga shërbëtori i tij besnik.

Një mëngjes, madhëria e tij më tregoi një ëndërr. Kishte parë në ëndërr një dhelprë. (lerpdh) Ajo ishte shtrirë dhe flinte në mes të rrugës, ndërkohë që i kaloi pranë , si dinake që ishte, ajo kishte brofur për ta kafshuar. Madhëria e tij ishte tmerruar, atë shprehje tmerr mbante dhe në çastin që rrëfente ëndrrën.

-Frikacak! Të trembesh nga një dhelprë? Je dhe madhëri...Po dhelpra nuk të ha...

- E di që nuk të ha, por lerpdha ishte shumë e madhe. Kaq!” zgjati duar për të treguar madhësinë e saj.

-Mos ka qenë ujk?- e pyeta.

-Jo. Jo. E pashë mirë. Lerpëdh ishte.

-Dëgjo tani,-nisia ti shpjegoj qetësisht.. Të rrezikshëm për njeriun janë ujku, tigri, luani. Dhelpra jo. Pra, kur të shohësh në ëndërr ndonjë dhelprë mos ki frikë.

-Po elefandi të ha?-Pyeti ai me seriozitet prej fëmije.

As elefanti nuk të ha.

-Po dragoi?

-Dragoi është fantazi,- i thashë. Nuk ekziston. As xhindet nuk ekzistojnë, as përbindëshat, as sirenat, as zanat nuk ekzistojnë.

-Po mumjet?

-As mumjet.

-Po supermenët?

-As supermenët.

-Po Ufot?

-As Ufot nuk ekzistojnë. Të gjitha këto janë krijime të mendjes njerëzore. Janë fantazira. E kupton ti çdo të thotë fantazi?

-E kuptoj.- tha ai qetësisht.

-E he, ma thuaj çdo të thotë fantazi?-e provokova unë

-E kuptoj dhe s'dua të ta them, -më kundërshtoi prerazi ai.

-Fantazi do të thotë trillim, nisa t'ia shpjegoj unë

-Mua më pëlqen trillimi,- këmbënguli ai.

-Edhe mua më pëlqen trillimi, i thashë unë seriozisht, si të bisedoja për një çështje të rëndësishme me një të rritur, mirëpo, këtu ka një problem.

-Për mua s'ka asnjë problem,- ngriti zërin ai. ndryshe përse i japin në televizor?

Nuk e kundërshtova. Kishte të drejtë. Shumë figura të lindura nga fantazia njerëzore janë pjesë e jetës sonë të përditshme. Pa ekzistencën e këtyre qenieve imagjinare s'do të kishte kuptim jeta. Do të bëhej tepër monotone. Një jetë bosh. Skëterrë e vërtetë. Madhëria e tij, edhe pse ishte i rrethuar me përkujdesje dhe dashuri, mendjen tek filmat vizatimorë e kishte, tek D. V. D-të, videot dhe lojërat elektronike. Ato ia bënin jetën edhe më interesante e plot variacione. Ta jetosh jetën në një suspans, midis njerëzve realë, që të rrethojnë me dashuri , dhe asaj imagjinare, që të lidhin me llambat magjike e zanat , me supermenët e spidermenët, me shtrigat, përbindëshat dhe dragonjtë.

Do të mjaftonte biseda jonë me kaq , sikur të nesërmen e asaj dite të mos kishte ndodhur diçka e pazakontë. Ishim zhveshur të dy dhe rrinim përballë detit.

-Madhëria juaj, -i thashë unë, -mendoni se është koha për t'u zhytur në det?

-Vetëm me një kusht,- u përgjigj madhëria e tij. -Nëse më premtan të zhytemi thellë, gjersa të takojmë peshkun e kuq që jeton në fund të detit.

Mos! gati sa s'thirra unë me zë të lartë. Po bënte dy vjet që ky fëmijë nuk e kishte harruar fantazinë time me peshk të kuq, të cilën e kisha trilluar në çast, për ta vënë në gjumë.

-Peshku i kuq nuk ekziston, është një trillim.- i thashë unë. Atëherë ti ishe i vogël dhe nuk kuptoje.

-Aa! Më paske gënjyer? Gënjeshtar! -nisi të përplasi këmbët në rërë dhe të qajë me dënesë, sikur t'i kishte vdekur njeriu më i dashur.

Nisur nga ky rast, në mesditë plasi një sherr i madh. U mbledh me urgjencë komiteti familjar dhe aty për aty mori një vendim të prerë: "Kompjuterin ta shohë me dylbi...Për moshën që ka i mjaftojnë filmat vizatimorë." I këtij mendimi isha dhe unë. Sigurisht. Madhëria e tij kishte nevojë për ta zbrazur pak hark diskun e vet, të mbushur me lloj- lloj qeniesh imagjinare.

Vizitor në parajsë

...Në parajsë Aureliani mori vesh se fetari
dhe heretiku, ai që urren dhe i urryeri,
akuzuesi dhe viktima, ishin i njejtë njeri.

J.H.Borhes

“Keni qenë në parajsë?” “Po.” Po Parajsa është një trillim poetësh?” Ju them sinqerisht që unë e kam parë parajsën. Mund t’jua përshkruaj saktësisht, veçse, duhet të më kuptoni: Parajsa që kam parë unë ndryshon nga ajo që është përshkruar në Kuran.

Në Kuran thuhet: “...*Aty nuk ka as vapë as të ftohtë, -- Uji dhe gjelbërimi aty është i përjetshëm...kalaveshët e pemëve u qëndrojnë mbi krye , u jepet të pinë pije me aromë të këndshme, u shërbejnë djelmsha që kurrë nuk ndryshojnë...*”.

Parajsa ime ngjante përafërsisht me ca peizazhe të fshatit tim ...Para se të kalojmë tek përshkrimi, dua t’ ju flas për një urë... Para se të mbërrish atje duhet të kaloje një urë, (kështu thuhet në Kur’an) e cila , më tepër se Urës së Sherihatit i ngjan një pike kufitare. Atje bëhej kontrolli i shpirtave që largohen përgjithmonë nga kjo botë. Për identifikimin e kalimtarëve s’ kërkohej pasaportë, as vizë dhe as ndonjë dokument tjetër. Formalitetet ishin njëlloj me ato që kërkohej në pikat kufitare. Punonjësve të shërbimit që qëndronin terk ura, informacioni u vinte i gatshëm, i përpunuar dhe i kompjuterizuar. Punonjësit e pikës kufitare, të cilët ngjanin me doganierë , ishin të veshur me kostume bojë bari. Kishin një pamje ushtarake, seriozë, të matnin me shikim të parë, dhe vendosnin : “Ti .?! Në parajsë...Ti tjetri... në Ferr! ”. S’kishin shumë llafe. Nuk të shihnin fare në sy. Mbase vendosnin, prisnin pak sa të kaloje për t’u marrë me kalimtarin e radhës. Dosjet mbërrinin në çast, në një zyrë tjetër, ndërsa informacioni merrej në çast, nga Libri i Madh i Vdekatarëve.

Atje u gjenda si para një trupi gjykuesish, që nuk kanë asgjë të përbashkët me gjykatat tona. Të sillen miqësisht por s’ të bëjnë favore, as nuk i zvarrisin gjyqet me muaj e vite. Sa vjen vdekatarit , sipas informacionit që iu vjen, vendosin në çast : ‘Ky njeri ka bërë një jetë të ndershme, por tepër të varfër...-Të çohet në parajsë! “

Ky tjetri, bie fjala, ka bërë poshtërsi, për shembull, ka spiunuar njerëz për pakënaqësi ndaj pushtetit.... -”Të çohet në ferr...!” S’ka apelim. “Për sa kohë do të pyesni ju?” Koha është një trillim njerëzor. As në parajsë dhe as në Ferr nuk ka kohë, as orë, as muaj e vite,... as shekuj. Aha! Po kalove urën, harroje kohën.

Mund të rrish atje 50 000 vjet po mund të rrish edhe 500 000 vjet...Asgjë nuk dihet.

Nuk është si në tokë, njeriu mbush 60-70 vjet jetë dhe ikën nga kjo botë, pa e vrrarë mendjen ku shkon . Sikur njeriu i zi t’i mendonte të

gjitha këto , do ta kalonte jetën në varfëri të plotë me shpresë për një jetë më të mirë në botën tjetër, të pa kohë. Imagjinoni dhe ju, çdo të ndodhte në qoftë se 8 miliardë njerëz vendosnin të gjithë njëzëri të jetonin në varfëri të plotë, me dëshirën e vetme, për të siguruar një vend në parajsë ...?!

Tani le të kthehemi tek parajsa.

Ju thashë që në fillim, unë shkoja si vizitor, më ishte bërë një ftesë për të shkruar një reportazh për parajsën... Më sollën dhe garancinë , një fletë e verdhë me vulën e Parajsës. (I ngjante garancive që kërkohen në ambasadën amerikane) Garancia duhej për të qenë i besueshëm, që do të kthehesha sërish në tokë në afatin e caktuar. S'do shkelja vizën asnjë ditë më shumë. Në parajsë ka rregulla , si në Evropë

Dy javë më vonë më lajmëruan të bëhesha gati , pasi çdo gjë ishte në rregull. Kur mbërritëm tek ajo ura që ju thashë , nuk më ndaluan fare. Ndoshta nga që isha i shoqëruar prej dy personave të njohur prej tyre. Po përse shkoja në Parajsë?...Këtë nuk e dija..

Në të vërtetë, dikur, si gazetar i vjetër, kam kërkuar të shkruaj një reportazh për Parajsën me një qëllim të fshehtë dhe djallëzor, pasi të marrja vesh se ç'po ndodhte në të vërtetë atje, të kthehesha në tokë me një synim tjetër. Nëse ai llafi I mëkateve ishte kot, ta shijoja këtë jetë sa t'i luaja fenë. Ndryshe, të mblidhja mendjen dhe të bëja një jetë prej heretiku, sa të më vinte radha për t'u nisur në atë udhë.

Kjo dëshirë e imja, ndonëse me vonesë, ishte miratuar.

Kaq seriozisht ishte marrë vizita ime atje, duke më konsideruar si një gazetar të rëndësishëm, investigativ, saqë autoritetet parajsore më kishin vënë në dispozicion dy shoqërues , të cilët, me sa mora vesh , ishin persona të njohur të Parajsës. Në një moment edhe dyshova: Mos m'i kishin vënë për të më vëzhguar .Çfarë djallëzish nuk na shkojnë në mend ne, njerëzve të Tokës!

Ju thashë qysh në fillim , dëshiroj të jem me ju tepër i sinqertë. Sa i përket motit... Ishte një ditë me ndriçim hënor, as ditë as natë: i ngjante një nate me ndriçim të zbehtë diellor i cilin nuk shihej në hapësirë.

S' më tha askush se ku gjendesha, por unë e mora me mend , pasi të gjithë personat që më zinte syri lëviznin para syve të mi si të ishin hije. Ishin të gjithë persona të njohur që kishin vdekur prej kohësh.

”Ua! Po ky qenka filani...”-thosha me vete. Ua!Po ky qenka fistëku...!?” Më njihnin dhe ata dhe më buzëqeshnin lehtë, në distancë.

Hijet lëviznin si në Hënë. Sa preknin tokën ngriheshin lirisht në ajër. Iknin , vinin ... Nuk mund t'i identifikoja dot .As nga pamja, as nga veshjet, as nga të folurit, as nga ecja. tani që i mendoj , kam idenë që trupat e tyre ishin ,as të veshur as lakuriq. Nuk ecnin, lëviznin si qenie pa peshë, sikur jetonin në një planet plot ujëra dhe gjelbërime që i ngjante tokës , por pa gravitet.

Nuk flisnin. Si duket e kishin të ndaluar të flisnin me njerëzit e Tokës. Qeniet ishin hijet e atyre që kisha njohur dikur, pa mish e pa kocka.”Të gjithë të pavdekshmit ishin të zotë për një qetësi të përsosur”.

Personat që më shoqëronin ishin fare të panjohur për mua. Më respektonin në distancë, kur i pyesja tregoheshin të gatshëm dhe flisnin me radhë, pa i ndërprerë fjalën njeri tjetrit, siç ndodh shpesh në emisionin “Opinion”. Njëri prej tyre kishte njohuri të shumta nga kultura dhe letërsia, mendova mos ishte ndonjë masovik i hershëm kulture, ndonjë drejtor kulture i kohës së socializmit.

Çfarë dëshiron të vizitosh,- më pyeti qysh në takimin e parë.

Fterën ,-i thashë unë.

Kjo dëshirë nuk e çuditi aspak.

Ndoshta ju nuk e dini, Ftera është fshati im i lindjes, të cilin kam mbi 20 vjet pa e parë. U nisëm. Ata të qetë, unë me një ndjenjë malli.

Nuk patëm nevojë për veturë. Tashmë ne ishim qenie pa peshë dhe si të tilla, mund të lëviznim në ajër lirisht. E ngadalësonim ose e shpejtonim shpejtësinë, sipas dëshirës. Gjatë rrugës për në Fterë vura re me keqardhje se ajo qenkej dëmtuar vende-vende. Ishte hedhur një fjalë nga kryeministri, për asfaltimin e saj, por, Ëhë! Kjo kishte ndodhur para ca muajsh, gjatë fushatës së zgjedhjeve. Gjelbërimi, krojet dhe ullinjë anës rrugës ishin po ato...Më kapi një mall i pa përshkruar.

Si në një ëndërr, se si u gjendëm poshtë bregut të Lleshe, nën hijet e rrapeve, ku gurgullonin ujërat...Përshtypja e parë...Nuk m'u duk si Ftera ? Doemos, njëzet vjet pa e parë... Fëmijë dhe gra lëviznin rreth meje tërë gjallëri...Përshtypja e dytë: Ftera qenkej populluar me familje të ardhura nga Veriu, nga Kukësi dhe Tropoja... Kjo gjë më befasoi seriozisht. Njerëzit dhe atje nuk peshonin. Kjo lirësi lëvizjesh më jepte një kënaqësi të veçantë...I shoqëruar nga autoritetet e Parajsës, fluturoja i lumtur.

Ndërkohë, më zunë sytë një grumbull hijesh, ngucur e shtypur pranë njëra-tjetrës. Nuk flisnin, as lëviznin. Shumica më njohën qysh në fillim. ”Ua!Qenka djali i ... “ Po nëna ime ?-mendova.

Kisha një dëshirë përvëluese për ta parë. S ' duhet të nxitohesha. Kisha kohë.

* * *

Në atë çast ndodhi diçka e papritur. Mes grumbullit të tyre më zuri syri një tip...E njoha nga shikimi i tij i frikur dhe tinëzar. Qëndronte mes të tjerëve, i ndërgjegjshëm që midis tyre kishte hyrë kontrabandë. Kur më pa të shoqëruar me autoritetet e parajsës, u

zbeh pak , por nuk e bëri veten. Nuk mund ta kuptoja dot se nga i vinte ajo siguri?

"Po ky pis ç' do këtu? -thashë me vete.- Atëhere , duhet menduar që në parajsë ka diçka që s' shkon!?!...

Kënaqësia e parajsës më iku në çast.

Tipi, të cilit nuk dua t'i përmend emrin, se mbase e njihni dhe ju, më pa me qesëndi : " Të kuptova. -m'u duk sikur më tha.- Ti tani mendosh se si kam ardhur unë këtu? Kam bërë dhe unë një nder diku..." Mendimi i tij u transmetua në trurin tim në një të dhjetën e sekondës.(Kjo gjë ende nuk është shpikur në botën e të gjallëve.)

-Ashtu?- thashë me vete.-Ta tregoj unë nderin ty, mor i pafytyrë .Sa pak vjet jetove në botën tonë dhe sa njerëz more në qafë...Më vonë ,pasi ti kishe vdekur, unë kam dëgjuar se më paske denoncuar dhe mua, gjoja paskam thënë, se: "Realizmi socialist është një thes me gënjeshtër dhe një trastë me të vërteta... " Po Viktorin, more i poshtër, nuk ishe ti që e more në qafë? Nuk e pranon? Hë! Jo. Kësaj here nuk të lë. Do të të denoncoj që tani tek autoritetet e parajsës.

Por ai, në vend që të frikësohej u trimërua dhe më tepër.

- Vërtet nuk kupton gjë, apo shtireshe? (mendimi i tij sërish m'u transmetua në çast. Çfarë mrekuillie. Gjëra që shkenca s'i ka shpikur ende këtu në tokë.)

-Çfarë të kuptoj!.- i thashë me mend -Që pasi përdhose botën tonë të ndyrë, vjen të përdhosësh edhe këtë botë të pastër? Çfarë të kuptoj? Më thuaj?

- Naiv ke qenë,- më tha me keqardhje.- Dhe naiv ke mbetur...Bën poezi ti, bën! Po a ke parë ndonjë poet këtu, mor i mjerë?

-Jo. Po pse?- e pyeta unë.

- Në Parajsë gjer më sot nuk është pranuar asnjë poet. Dhe a e di përse? Se janë naivë... Ja kështu, si ti. Fluturojnë! Fluturojnë! Nuk kuptojnë fare ç'bëhet. Jetojnë me fantazira dhe iluzione...Janë dembelë. Trillojnë gjëra të paqena...Po parajsën? A e di kush e ka trilluar parajsën, mor tutkun !?!... Ja, ca trushkulur si ty e kanë trilluar.

- Pra, ti thua që unë këtu kam ardhur gabimisht? Pra, kjo nuk qenka Parajsa e vërtetë?Nuk qenka ajo Parajsa që njohim ne?

-Ajo Parajsë është, mor teveqel.! Por jo ajo që keni shpikur ju poetët. Ju do të përgjigjeni për ato sajusat tuaja....Se keni marrë miliona njerëz në qafë.

-Po Viktorin e ke takuar?- desha ta pyes. Ndërkohë ai ma kapi mendimin fluturimthi."-Ç'Viktor more kukumjaçkë ! Ku ka Viktor këtu..."

-Po nënën time?"

-Kot që ke ardhur këtu, or byrazer.- (e ndiente veten triumfues.)

- Këtu nuk gjen asnjë nga ata që kërkon ti. Këtë jemi vetëm ne, dora jonë...Të të them dhe diçka që ti ta besosh se sa i rëndësishëm jam unë këtu...? Kur mbërrita tek ajo ura , oficerët dhe doganierët e urës,

sa verifikuan emrin tim, më nderuan me grusht dhe më thanë plot respekt: “ Ju, kaloni!”...Kupton ti çdo të thotë kjo? ...Dhe mos kujto se ata që punojnë tek Ura janë si doganierët tanë...Edhe ndonjë ryshfet mund ta pranojnë, s'them dot... Po të them dhe një sekret tjetër..." -M'u afrua dhe më pëshpëriti në vesh:

“ Mos kujto ti se këtu bëhet rrumpallë. Edhe këtu punohet. ”

-Dhe ti punon?

-Natyrisht.

-E ç'punë bën ?

-Sekret. Kush vjen këtu fillimisht e pyesin: “Ç’ punë ke bërë në botën e të gjallëve...?”

-Ah! Tani e kuptova. Dhe ti u the që....

-More ti..! -m'u kthye me kërsëllimë - Sillu mirë...Se dënimet këtu nuk jepen si në Tokë...Dënimet këtu shkojnë nga një mijë gjer në njëqind mijë vjet...Ee! Ç’thua tani?!

Duke i dëgjuar të gjitha këto gjera u frikësova seriozisht. “M’i thoshte për të më trembur, apo?”

I tmerruar siç isha u ngrita nga krevati vrik. Edhe pse syhapur ende nuk më kishte ikur tmerrri dhe fjalët e tij kërcënuese. "Rri urtë!

Se dënimet këtu nisin nga 100 000 vjet e shkon..."

Më iku e gjithë kënaqësia që kisha parë parajsën.

Gjashtë rrëfime në vetë të parë

Mësuesi i letërsisë:

‘Bensin’ blu 250-sh unë e pikasa i pari. Ai na parakaloi me shpejtësi, na spërkati me pluhur e na bëri helaq. Ai ndali para portës së Naimit. Sa pashë targën “Tr” e mora me mend që ishte Viktori, ministri i Bujqësisë, i vetmi kuadër i fshatit Gropaj me të cilin krenohen të gjithë. U gëzuan të gjithë, unë më tepër, pasi, siç ta paç llafin, të bashkëshorten e Viktorit, Lindën, e kam pasur shoqe kursi në fakultet. Me këtë rast do bisedoja për punën e transferimit tim që është bërë tërkuzë. Erdha për një vit e përfundova, si i thonë: “Nuse ku kalle këmbët të rënçin dhëmbët”. Po, do të thuaç ti, ç’punë ka Linda me transferimin tim? Ka o posi! Një llaf i Viktorit të bitis punë. Se këndezej nga ne kështu bëhen këto punë-o! Viktorin e kisha parë njëherë në televizor. Siç më kanë thënë, ata u martuan fill pas mbarimit të shkollës. Sebe për këtë u bë emërimi i Lindës në Pukë. Atë vit Viktori seç kishte një detyrë në një ministri. Ai ndërhyri dhe atë e mbajtën në Tiranë. Se kështu bëhen punët andezaj nga Tirana, de! Me moshë nuk kanë ndonjë diferencë të madhe, siç më kanë thënë. Viktori është tetë vjet më i madh, e punë e madhe...Ka marrë goxha djalë, inxhinier elektrik biri i botës, tani ministër, hajde tëmën! Ç’qejf që bëjnë njerëzia andezaj nga Tirana, ne këtu në fshat merremi me llafe. Në këtë kohën e demokracisë kështu i emërojnë kuadrot, po je inxhinier të bëjnë ministër bujqësie. Thonë se kur ka punuar në Ministrinë e Energjetikës paska bërë një shpikje që i ka kursyer shtetit njëzet e pesë meleonë lekë... Të vjetra apo të reja, këtë s’ua them dot.

Atë natë në klubin e fshatit bëheshin provat e grupit të folklorit, po ç’ne o, ku u ranë ndër mend këngët dhe vallet tona?.Këngë e aheng, birinxhi vajti gjithë ajo natë te shtëpia e Naimit.

Fatua:

Nusen e kishte trullosur tromopili, s’hëngri fare, moj xhane. Ra dhe fjeti shpejt. Burrat i zgjatën muhabetet gjer vonë. Na erdhi keq për nusen që s’e kënaqëm dot, se Viktori është djalë vendi, prite si të duash nuk ta vë re ai, e zë malli dhe për gurët. Fët ia bën e këtu e lë kokën, te shtëpia prindërve të tij. Me Naimin, jo se janë vëllezër, por shkojnë shumë mirë. Të thuash që Viktori i ka harruar zakonet, s’e thua dot, se ai ulet këmbëkryq, si gjithë të tjerët, nuk më ka qibër fare, moj motër, jo, jo. Le të thotë bota që, po u bë njeriu me pozitë prishet, jo moj motër. Të parin në sofër Naimin uli, pastaj u ul vet. “Lëri këto gjëra, - i tha im shoq. - Lëri ti këto gjëra, ia preu Viktori tim shoqi. Përse vij unë këtu, për këtë vatër që na ka mbledhur gjithmonë”. Për kokë të Gëzos! Viktori s’ ka qibër fare.

Le të thonë bota njerëzit i ndryshon karrigia, Viktorin s'e ndryshon as dreqi. Ja, kemi Dervishin, kryetarin e pushtetit. Foli po deshe. S'i qesh kurrë nuri. Pa le, na mbahet më të madh. Sa u bë kryetar ka filluar të na trashë edhe zërin? Kërkon t'i jap vetes rëndësi, moj xhan, që fundja ç'është, një copë kryetar fshati. Jo. Jo. Viktori sa vjen të pyet për të gjithë: për fëmijët, për të afërmit, për shkollat e fëmijëve..Më mirë që nusen e zuri makina, ndryshe do na ishte mërziur. Më pas lere ç'vajti. Dolli dhe këngë gjer pas mesnate. Njerëzit e nuses nuk i durojnë dot zakonet tona, por ne na pëlqejnë, moj xhane. Jemi mësuar me to, kemi qarë halle, kemi bërë fejesa e dasma.

Naimi:

Mir-o, birinxhi. Po ç'e do....Na e prishi qejfin nusja. As piu, as hëngri. Sime shoqeje aty i mbeti mendja. Viktori-o? Ka ardhur për një mbledhje në Korçë, i la shokët aty dhe vetë ia krisi për te ne. Dhe nusen e ka të dashur e të respektuar. Ka pasur një goxha baba, Zabit Xhabia e quanin, ndoshta ia keni dëgjuar zënë. Gjatë kohës së luftës ka qenë komisar batalioni, në brigadën e tretë sulmuese. Fejesën e Lindës me Viktorin e priti me gëzim. Njeri që ia vinte veshin fjalës, njeriu që të dëgjon, ka vlera. Këtë gjë e kam mësuar nga im atë, që u bënë ca vite që na ka ikur, Zoti i dhëntë dritë aty ku është!

Kur babai mori vesh që Viktori ishte pleksur me një vajzë nga Shkodra, i erdhi keq, por, kur mori vesh e kujt ishte, u gëzua shumë. -I njoh Xhabiajt,- tha, -një prej fisit të tyre e kam pasur në batalion. Dy vitet e fundit të ziun e zuri skleroza. Çorbë i bënte emrat: njëherë thoshte kam qenë në brigadë të pestë, një herë tjetër në brigadë të tetë dhe krushkun tonë, Zabit Xhabian e ngatërronte me Eqrem Çabejn.

Halla e Viktorit:

Qyqja! Ç'nuse. Sa hyri, tërë naze, si ato vajzat e vogla e të përkëdhelura. E qerasa me një pjatë mjaltë s'e vuri në gojë. Po ne këto gjëra kemi, moj shpirt! 'Keni ujë të ftohtë?'- tha. Ku ta gjente ujin e ftohtë halla, se mos kemi frigorifer ne këtu, si andezaj. Po shyqyr, nusja e Zenos e gjeti ujin e ftohtë dhe ia solli te krevati. Në mëhallën tonë vetëm Çerçizi ka frigorifer, se helbete, i ka djemtë jashtë.

Po ne, moj motër, zakonet i kemi të tilla, kur të vjen një mysafir në shtëpi, s'të vjen duarthatë...Sjell ndonjë koçkë për fëmijët, një pako me biskota, a një kutiçkë me karamеле. S'them për peshqeshet e që motit unë, jo me, jo. Ikën ato kohë kur peshqeshet

venin gjer te hallat e stërhallat. Po fëmijët janë fëmijë, moj shpirt. Kur vjen një i huaj, syrin te qerazmat e kanë. Kështu i kemi mësuar vetë, moj xhan. Fshatarë jemi, me këto zakone na kanë mësuar, këto gjëra u mësojmë edhe fëmijëve tanë. Këta të qytetit janë më ndryshe, të thuash që u dhimbset paraja, s'e thua dot. Po mbase dhe paraja u dhimbset, ndryshe, kur i dinë zakonet tona, përse nuk i bëjnë?

S'e kam për Viktorin. Për kokë të Mevlanit! Burrat s'ua vënë veshin këtyre punëve, e kam me atë shkodërjanen që, kur ka qenë puna, edhe qumësht dallëndysheje i kemi gjetur dhe ia kemi çuar. Zakonet tona i di si derri, se s'ka rënë nga qielli. Sa mirë kur u vemi atje? Peshqeshet na i pranojnë. Si m'i thua ti kësaj? Më kalon te dera e shtëpisë dhe nuk më shkel në derë? Jo. Për kokë të Mevlanit, shkodëria më është zënë zët, që kur e kam parë. Në dasmën e saj la nam. Kërce me njërin e kërce me tjetrin. S'la radhë Pa le, kur i thanë për mua, kjo është halla e Viktorit, bëri sikur u gëzua. Kujton ajo se nuk e kuptoj unë kur gëzohet njeriu! Më puthi në faqe sa më leu një okë të kuq buzësh. "Ju jeni halla e Viktorit? Ua!Ua!..Po ju qenkeni shumë e re. Sa sy të bukur keni!" Uu, pika nuses! Shihen plakat nga ngjyra e syve? U bëra kaq e s' më kanë dëgjuar veshët të më thonë të tilla fjalë. Viktorin e kemi flori, por ajo s'ma ka mbushur syrin. Dhe ai...flori jo xhanëm. Gjersa e mban në shtrat. S'ka sy ta shoh se ç'nuse ka?

Po mirë thonë: "Gruaja o ta hap, o ta mbyll derën".

Unë them që ajo ia ka mbyllur derën Viktorit. Shyqyr që vdiq shpejt im vëlla thuaj, e s'ua pati nevojën...Pa mua aq më bën.. Këtë nuse s'ma ka dheksur mideja dhe pikë. Shkodërjanet janë të ftohta. Është me shkollë të lartë, the? E ç'i duhet shkolla hallës? Për hallën s'kishte kohë të qëndronte për të qëndruar në klub, gjysmë ore, iu gjend koha. Kujton ai s'e nuk e mora vesh unë. Në gjashtë e gjysmë dolën nga shtëpia e Naimit, në tetë e gjysmë u nisën për në Korçë. Dhe ti më thua: "Hallë, mos i vë re këto gjëra". Po ç'të vë re halla, moj shpirt? Vetullat e hequra të nuses apo ato këpucët e nipit tim vrima- vrima, si këpucë grash?

Çerçizi:

Me Naimin jemi portë më portë, për çdo hall e vukajet njëri-tjetrin kemi pasur. Zakoni e do që kur të vjen mysafiri, ta çosh edhe te komshiu. Nejsë. Viktorin e kam djalë xhaxhai. Me të vëllanë, Naimin, shkojmë si vëllezër. Qejfi na e kishte të na e shkelte pragun, për dy minuta, sa për adet. Ministër bir i botës, nuk i kërkon dot llogari dhe sikur vëlla te kesh. Gjende mirë ia kaluam. Fëmijët i kaluam nga shtëpia ime, këngë e dolli, gjer pas mesnate.. Viktori ishte në qejf. Më pyeti për cilësinë e bukës së

furrës së fshatit, më pyeti për pemishtet e të mbjellat, më pyeti për blegtorinë e për mullirin e fshatit. Edhe pse kaq kohë i larguar qysh i mbante mend të gjitha? Pyeti për numrin e lindjeve e për shtimin e bagëtive...Po ajo që na gëzoi më shumë ishte kur dha haberin se, sipas një vendimi të qeverisë, asfalti do na vijë shumë shpejt te dera. Viktorin e ka ngritur puna. Si thonë shaka, t'i kursesh shtetit njëzet e pesë meleonë.....Të reja apo të vjetra ? Për këtë gjë pyeta një ditë Naimin, por dhe ai nuk ma sqaroi dot. Të nesërmen e shoqëruam gjer te zyrat e kryesisë.

E kishin marrë vesh që kishte ardhur dhe qysh u shkul gjithë fshati e i preu rrugën? Takohu me një e takohu me tjetrin, Viktori me të gjithë buzagaz, por nusja u mërzit.”Hajde tani,- i tha,- Se s’kemi kohë”, sikur ajo të ishte ministre e ai të ishte një lopçar. Mirë që na doli para mësuesi i leximit, shejtani, njihej me të që në shkollë. U futën në klub dhe zunë muhabetet. Në orën nëntë Viktori duhet të ishte në Korçë, po ku e linin ata: “ Po si i ke fëmijët?... Ku e ke të madhin...? Po të voglin? ... Po puna si të ecën?” Sa mbaronte njeri niste tjetri...”Mirë... Mirë.” - u thoshte Viktori buzagaz. Mirë këta, por ca të tjerë që e shikonin me bisht të syrit. Se ne fshatarët jemi allo soj- o...Po na fole mirë, të hapim namin si njeri popullor e po nuk na fole ti i pari? “Ka ndryshuar ”- thonë. Po pse paska ndryshuar, mor byazer, se s’të begenisi të të fliste ai i pari.? E kam thënë unë, fshatari fshatar mbetet.

Mësuesi i letërsisë:

Lindën e takova në mëngjes para zyrave të kryesisë. U çudit kur më pa. S’kishte ndryshuar fare, veçse flokët nuk i mbante më të gjatë si më parë. Viktori u fut në zyrën e kryetarit ne e pritëm në kafe.

Atë ditë isha bërë gati të kthehesha në Korçë dhe ia thashë Lindës, Linda ia tha shoferit i cili kishte zënë vend në një nga tavolinat pranë nesh së bashku me disa bashkëfshatarë të tjerë: “Ta marrim edhe këtë shokun gjer në Korçë”. ”S’e marrim dot” – tha ai,- bagazhi është i ngarkuar plot..“Me çfarë?” “ Seç ka futur Naimi , - u shfajësua ai.-Më duket nja dy thasë me mollë dhe një damixhan me raki. Dhe një thes me qepë. Damixhanin e futa në fillim, mos na thyhet...Bleva dhe për vetë ca patate...”.

- Është veturë e vjetër,- tha Linda. I kanë thënë se do t’i japin një tjetër, më të mirë, po Viktori nuk e vret mendjen për lukse dhe salltanete. “Mirë është, -thotë.- E bën punën”. E bën punën vërtet, por si e bën se....

-Veturat e vjetra janë si mushkat, - foli shoferi nga tavolina ku rrinte, në malore janë më të sigurtat se këto të rejtat.

Remziu:

“Ka ndryshuar filani...Jo, 0..S’është më ai i pari.” Po njeriu do ndryshojë more burazer. Uji i ndenjur mbetet, uji i pastër lëviz. Kollaj t’i kursesh shtetit njëzet e pesë meleonë-o? Ç’bëri këto vite biri i botës, mos i kaloi në majë të plepit, si unë e ty, apo përmbys përmbi libra? Një natë që qesh në shtëpinë e tij kam parë një bibliotekë. Na.a! Kapicë faqja e murit. Pa libra s’ecën dot njeriu. Jo o, posi!...Fort të lezetshëm ne këndezej. Njëherë po s’e pate mendje e ta përshëndesësh tjetrin, ta vunë vizën...

”Ka ndryshuar! Po. Po. Ka ndryshuar!”- e ngrënë zënë në kup të qiellit. Me që s’ndryshojmë dot unë e ti, kujtojmë se do mbeten dhe të tjerët si ne, pykë në diell. Ndajzaj dhe i ziu Viktor, sa herë na vjen në fshat, u qesh të gjithëve. Cave nga malli e cave nga halli.

Po sikur t’ju them unë që Viktori luan thjatro? Për nder, luan thjatro me atë “popullorçen” tuaj. Ku ta paç fjalën? Hëm! Te biblioteka.. Se unë, mor byrazer, Viktorin e kam të bëj nga ime shoqe. Vjet a parvjet, çova gruan në Tiranë për ta vizituar te doktori. Një telefon i Viktorit më bitisi punë. Kaq do njeriu. Të ketë në Tiranë një njeri për një hall. Viktori duket si cazë i ftohët me njerëzit, por, mos u zëntë halli. Te ai e kemi mendjen. Shyqyr që e kemi, thuaj. E të na rrojë. Atë vetëm kemi. Me atë mburremi. Kur i thua tjetrit jam nga Gropaj, të sheh me respekt..

Thonë se Viktori atje ku rri, e ka bërë shtëpinë, të hysh me mend e të dalësh pa mend. Jo or jo... Ndryshon bota, mor byrazer. Mirëqenia ka ndryshuar kudo, dhe në fshatin tonë..Jo si ne, pykë në diell! Im atë na thoshte shpesh:”Në fshat njerëzia ia dinë lezetin punës, në qytet ia dinë lezetin bythës”. Kam qenë dhe unë në shtëpinë e Viktorit dhe ia kam parë të gjitha...Të të them një gjë unë që ju s’e keni parë as në ëndërr? Në një cep të dhomës ka një gjë që ngjan si televizor. E pra, ai është kompjuter. Një fshatari im më ka thënë njëherë se, kur paska shkuar për vizitë në shtëpinë e Viktorit nuk e paska pritur mirë. E shoqja e tij sa i solli qerasmën, iku e s’i doli më para. As fëmijët s’dolën për ta mirëseardhur.... Mbase dhe juve ua ka thënë këtë gjë. Por, s’ka faj ai mor burazer, ka faj Viktori që nuk ka vënë në derë atë syrin e xhamit që e shohin tjetrin nga brenda dhe, o ta hapin, o të lënë jashtë.

Premtimi

Cukallët ishin një familje e madhe. Fëmija i dytë për nga radha vinte im atë, Shuaip Cukalla. Gjyshi nga babai, disa herë u kishte thënë djemve: “Martohuni, ç’prisni..!” Qysh ditën e parë të dasmës së djalit të mesëm shtëpia e Cukallëve u mbush me dritë. Mersepja ishte vajzë e shkathët dhe punëtore e papërtuar. Ajo futi në shtëpinë e Cukallëve rregull e pastërti dhe krijoi marrëdhënie të mira me plakat dhe pleqtë e familjes. E thërrisnin si me përkëdhelje ”Cepe”, jo “nuse”, që të mos u kujtonte nusen e djalit të madh, Avdulit, që kishte ikur nga Cukallët pa mbushur dy javë pas vdekjes së të shoqit.

Cepes nuk iu ndanë hallet, as në shtëpinë e re. Ishte dy vjeç kur e kishte lënë i ati. Po kulloste bagëtitë në një brinjë mali kur vuri re dy njerëz të panjohur që tërhiqnin zvarrë një dele të kopësë. Armë kishte vetëm stapin e stanarit.. Iu sul të parit, e goditi në kokë dhe e shtriu përdhe. Ata ishin katër... tre të tjerët u hodhën përmbi të dhe e mbytën me duar. Dhjetë vjet më vonë Cepes i vdiq dhe i shoqi duke e lënë me dy fëmijë të vegjël. Vdekja e të shoqit ishte një plagë e rëndë, por ajo nuk kishte kohë të vajtonte. Stërhallë Vikua kishte gjashtë vjet e paralizuar. Pas punëve të shtëpisë, orët e tjera i kalonte pranë saj. I kaloi jeta mbi dybek, rrihte dy-tri galera me qumësht në ditë.

Në atë shtëpi të madhe dhe me shumë vdekje linda dhe u rrita unë, me ndjenjën e dashurisë për të gjithë njerëzit që më rrethonin. Humbjen e babait, ndoshta edhe pse isha shumë e vogël, nuk e përjetova si një ngjarje të madhe, pasi, siç ju thashë, në familjen tonë kishte shumë harmoni dhe kaq shumë njerëz që na rrethonin me dashuri...ishin dajat, hallat, stërhalla, dy gjyshet, katër fëmijët e Asllanit dhe tre fëmijët e Veipit...

* * *

Unë dhe im vëlla u rritëm , krijuam familje, u shkëputëm nga fshati dhe tani jetojmë në Tiranë, ndërsa nëna ime e shtrenjtë ka vite që nuk jeton më... Varri i saj është në hyrje të fshatit tonë, një varr i thjeshtë i mbuluar me barëra dhe krisje. Tani nuk e vizitonte askush. Fisi ynë i madh u largua nga fshati, disa jetojnë në Tiranë, më të shumtët kanë emigruar në Greqi, Itali, Kanada e Amerikë. Fëmijët e mi nuk kanë më nostalgji për fshatin, as për njerëzit e gjakut dhe të fisit. Kemi mbetur vetëm ne, brezi i vuajtjeve të mëdha. Vetëm ne ruajmë ende nostalgjinë për fshatin dhe kujtimin e paharruar të njerëzve që kanë ikur nga kjo jetë.

Kohët e fundit nëna ka filluar të më shfaqet në ëndrra. Më del gjithmonë, e qeshur, fisnike, e heshtur dhe e përmalluar... Nuk mbaj mend të më ketë qortuar ndonjëherë, as kur kam qenë e vogël

dhe as tani që takohemi në ëndrra. Hap derën lehtë, si një mysafire e largët dhe hyn fshehur në korridor. Nuk më faqet për fytyrë, por ndjej shpirtin e saj, kur futet brenda si një puhizë e lehtë...Një natë e kam parë duke më pritur e vetmuar, në cepin e një rrugice të vjetër tiranase. Më ka mbetu në mend ajo ëndërr pasi m'u duk e vrarë në fytyrë, e mjerë, e vetmuar dhe e drobitur...

Sa herë takohem me të, sigurisht në ëndrra, zgjohem me një ndjesi të veçantë, thuajse takimi ynë ka qenë një ngjarje e fshehtë, që e dimë vetëm unë dhe ajo. Sikur jemi takuar vërtet, fshehurazi, (nuk e di pse?) Vetëm unë dhe ajo. Dhe jemi çmallur. Kemi shkoqitur hallet, si dikur në të gjallë. Nuk e di përse më shfaqet pa fytyrë, pa trup, pa formë. E ndjej vetëm si zë dhe mall... Diçka do të ketë... them me vete, sa zgjohem. Ka një hall...Një peng. Më kërkon diçka që unë nuk e kuptoj.

...Njeriu mendon gjithmonë se të vdekurit e tu i ke rreth e rrotull. Jetojnë si erë...Si shpirtra. Sikur vdekja të ishte diçka teatrale. Nuk ikin, por fshihen nga kjo botë, për të mos u dukur kurrë. Herë pas here na vizitojnë në ëndrra, na japin sinjale, na këshillojnë, na porositin. janë ata të parët që e ndjejnë rrezikun dhe na lajmërojnë për të pasur kujdes. Ku hedhim këmbën. Për ku jemi nisur.. Edhe pse nuk i shohim gjatë ditës, ata nuk na mungojnë. Na rrinë roje. Nuk bëjnë gjumë. Na afrohen në ato çaste gjumi. Ndryshe përse i kemi ëndrrat?

* * *

Një natë e pashë në ëndërr, kështu, si të shoh ty. Ecte ngutshëm midis një turme njerëzish, në trotuar, e veshur si mos më keq, me çitjanet e saj të zeza, si në ato vite. Flokët i kishte mbështjellë me një shami të bardhë. Bënte figurë midis kalimtarëve të rastit edhe për shkak të ecjes së saj të hutuar. M'u duk se kërkonte dikë, midis kalimtarëve të tjerë.

-Cilin do kërkonte ajo, veç meje? - mendova e merakosur.

E ndoqa pas. "Nëno!Nëno!- i thirra. Më pa dhe nuk deshi të më fliste. Nxitoi të fshihej mes kalimtarëve. Përse e bën një gjë të tillë? U trishtova shumë. Sigurisht në ëndërr. E ndoqa pas, e pashë, e arrita dhe e kapa nga krahu. "Po ti, - i thashë, gjithë nerva, - pse bën sikur s'dëgjon? Lash nam duke të thirrur me zë të lartë..." Ajo ktheu kokën, më pa dhe tentoi të largohej

- Ç'ke kështu? Nuk të shoh mirë, - i thashë.

- Nuk kam gjë, - më tha, - Por nxitoj. Kam marrë leje vetëm për dy orë. Sa të takoj tim vëlla... Se më ka marrë malli.

Kaq tha dhe u zhduk mes kalimtarëve. Sa u zgjova solla ëndrrën nëpër mend.

Kujt i kishte marrë leje? Po ç' ne? Daja im i vogël, Asllani, kishte vite që kishte vdekur. Mos ishte kjo një ëndërr qortimi nga që s' kisha shkuar te varri i dajës së vogël? Çudi, edhe të vdekurit zemërohen? Ose, ëndrra do të ishte një pengu im. Sa herë përgatitesha për të shkuar në varreza, te varri i dajë Asllanit, do më dilte një punë...Kohët e fundit i kisha rralluar vizitat dhe për tek im vëlla. Shpeshherë nervozohem me të.

S'i u bëmë kështu,- i them. Vërtet s'na lënë punët, por jo kështu de? Me nënën kam gjetur një mënyrë tjetër.

Kur më merr malli vendos që të mos flasë me njeri, gjatë gjithë ditës. I lutem Zotit të ma sjellë në ëndërr. Këtë gjë ma ka mësuar hoxha i Fterës. Do ti, lutjet e mia Zoti m'i ka dëgjuar gjithmonë.

Herën e fundit m'u shfaq në ëndërr në një mënyrë krejt të çuditshme:

* * *

Isha duke ecur në një nga rrugicat e Tiranës së vjetër. Nuk e di çfarë kërkoja atë mbrëmje në atë rrugicë? U afrova pranë një porte druri të vjetër dhe i rashë ziles. Për çudinë time nga pas portës nxori kokën nëna.

-Ç'bën këtu ti, nëno?- i thashë e çuditur.

- Shëët! - ma bëri ajo duke vënë gishtin mbi buzë. I hodhi një vështrim rrugicës si të kishte hyrë ilegalisht në atë shtëpi, mbylli derën dhe, fësht, u fut brenda. Prita pak çaste e shqetësuar.

U hap sërish porta dhe nëna nxori vetëm kokën. Pas saj ishte babai. Babai fytyrë vrerët, ajo si e trembur.

-Dëgjo këtu, - më tha duke më qortuar me gisht, siç e kishte zakon në raste të tilla.-Të kujtohet ajo nata kur ktheheshim nga dasma e Beqos ?

- Po, - i thashë. Ajo mbrëmje më ishte ngulur përjetësisht në kujtesë. Isha shtatë vjeç. Te porta e Demirajve na u vërsul qeni i tyre i zi, fillimisht iu hodh nënës, ia shqeu çitjanet e ia bëri copë e çikë.

- Atë natë sikur më premtove diçka...- më tha...- Më the se kur rriteshe do më blije një çitjane me pika të kuqe...

-Më fal nëno, i thashë. Nuk e kam mbajtur fjalën.

Më doli gjumi si me magji. Vura duart pas kokës dhe mbeta disa minuta e tronditur, me shikim në tavan.

“Si janë ëndrrat. Të zgjojnë nga harresa një premtim që ke bërë gjysmë shekulli më parë...Unë nuk e kisha harruar këtë premtim fëmije. E kam sjellë ndër mend si diçka të bukur, si një peng.Ka qenë një bisedë që s'e ka ditur askush veç meje dhe nënës. Çitjanet e kaltra me pika të kuqe kanë qenë një ide e cila më lindi aty për aty. U mërzit shumë. Atë çitjane kishte pasuri. Atë çast unë

i premtova sinqerisht. Me kalimin e viteve ai premtim m'u shndërrua në një fiksion, në një peng që s' munda t'ia plotësoj sa qe gjallë. Çitjanet u hoqën nga përdorimi, kur unë isha vajzë e re. Rinia e fshatit nisi t'i kritikojë nuset dhe gratë që visheshin "ala turka" Një nga arsyet qe dhe kjo, të blije basmë për ta bërë çitjane ishte sa për të bërë katër fustane. Kur isha e vogël çitjanet më pëlqenin shumë, më pas e kuptova që ajo ishte një veshje e shëmtuar, edhe pse çitjaneja i kuq nënës i shkonte shumë. Nënëzeza! Çitjanen e kuq nuk i veshi kurrë nga që nuk iu ndanë vdekjet.

Gjithë atë ditë vrava mendjen për të deshifruar kuptimin e asaj ëndrre.

Nëna ime e mirë, ti për mua kushton më shumë se ai premtim fëmijërie. Ç'mund të bëja unë tani që ajo nuk jetonte më!

* * *

U nisa kuturu drejt tregut të çamëve, u vërtita rreth një orë nëpër kioskat e ngushta ku të zihej fryma, duke parë për ndonjë cohë mëndafshi ose tafta, veç të ishte me pika të kuqe. Më pëlqeu një cohë mëndafshi, si në çivit, por pa pika të kuqe. Nëna kishte lindur në muajin mars, sipas horoskopit, ngjyra e preferuar e t lindurve në muajin mars është, çiviti, gurkali. I thashë shitësit të më priste katër metro nga ajo basma me ngjyrë gurkali. Shitësi ishte një burrë i sjellshëm, hodhi topin e madh në tavolinën para tij, mati katër metra, i preu dhe ma ambalazhoi cohën me kujdes, si të ishte një mall me vlerë të veçantë. E solla në shtëpi me një frymë dhe e fsheha në raftin e dytë të komodinës.

Një ditë ime bijë hapi komodinën dhe u çudit:

- Ç'është kjo cohë mëndafshi mami? -më pyeti. Unë heshta. Nuk e quajta të arsyeshme t'i tregoja atë histori që e ruaja të fshehur në zezmën time.

Po vajza ime ngulmoi të merrte vesh të vërtetën.

-Vërtet, përse e ke blerë këtë copë mami?...Sikur do të qepësh një çitjane...

Vajza i kishte rënë pikës. Copa që kisha blerë dhe e ruaja si një kujtim të shtrenjtë në sirtar, ishte taksur për një çitjane dhe kishte masën e një çitjaneje.

Me që të vdekurit nuk kanë nevojë për rroba coha prej mëndafshi qëndronte në sirtarin e komodinës si një premtim i vonuar.

Plazhi nudo

Kisha ëndërruar prej kohësh të vizitoja Ulqinin. Nga ky qytet në vitet e kaluara unë ruaja histori të trishta keqtrajtuesh, mirëpo, qysh në postën kufitare kuptuam se diçka kishte ndryshuar. Përfundimisht u binda kur sportelisi i hotel “Albatros”, një nga hotelet më të bukura të Ulqinit, i ngritur mbi një kodër, rrethuar me pisha, sa na pa duke hyrë me çanta në duar, na buzëqeshi për zemërsisht:” Urdhëroni! Jeni të mirëpritur!...Ja çelësat. Dhoma 104. kati i shtatë. Ju kemi dhënë një dhomë me pamje nga deti.” Ne ishim dy poetë të ftuar nga Shqipëria në takimin e poetëve ballkanikë që do të zhvillohej në kalanë e Ulqinit me shtëpitë kulla, të stilit venecian. U ngjitëm lart, me ashensor, hymë në një dhomë plot dritë dhe flakëm çantat mbi krevate, duke bërë në këtë mënyrë dhe zgjedhjet tona. Kur dola në ballkon pata ndjesinë që ndodhesha në Sarandë. Ngjashmëria midis dy qyteteve bregdetare më krijoi një gjendje lumturie të heshtur.

Miku im, Sandri, që ato ditë do të festonte pesëdhjetë vjetorin e lindjes, ishte tepër i emocionuar. Shtatë vjet i kishte tretur nëpër burgjet e Shqipërisë dhe kishte dalë shëndoshë e mirë, me amnistinë e vitit 1982, me një problem prostate, atë vit kur Mehmet Shehu vrau veten. (u vra apo e vranë?) Nga vitet e burgut ai mbante mend vetëm gjashtë muajt e hetuesisë. Hyr e dil, nga biruca në zyrën e hetuesit, në mëngjes, në mesnatë, duke dëgjuar të njëjtin refren: “Me kë ishit atë natë? Çfarë të tha, çfarë i thatë? Po ai? Po ajo? Po ky? Po kjo? Mustaqet e prera spic si të Hitlerit, i kishte në kujtim të atyre ditëve të frikshme. Si doli nga burgu mësoi të fliste pak dhe të shihte punën e vet si disenjator i Mjeteve Mësimore..Të këndellur në ballkonin lozhë na dukej vetja sikur e shihnim detin nga një lartësi avioni. Ishim nisur nga Tirana në orën tetë, dhe në mesditë kishim përfunduar në atë liman paqeje dhe qetësie, nën zagushinë e ditëve të gushtit.

* * *

Sandri zbriti gjer poshtë, në verandën e hotelit, unë ndeza televizorin e dhomës, riti im i zakonshëm për të parë lajmet. Më pas zbrita dhe unë, e kërkova Sandrin në verandën ku shërbeheshin pije freskuese dhe te kafja e madhe. Ndërkohë sportelisi i hotelit ma bënte me dorë:”Atë shoqin kërkoni? E

kini në det.” Zbrita rrugës me asfalt, qarkuar me pisha bregdetare, ndërkohë sa nuk u përplasa tek një tabelë e shtrembëruar e ngritur buzë rrugës, ku ishte shkruar në një dërrasë druri me ca germa shkarravinë: “Plazh nudo”. Nudo në Ulqin?! Për një çast u befasova. A thua ta gjeja atje dhe Sandrin? Dhe pse nga dhoma doli pa rrobat e banjës, do të ishte bërë kureshtar për të parë femra nudo. Si vjen puna! thashë me vete.-Të niseshe me gëzim drejt një takimi poetik dhe papritur të përfundosh në një plazh nudo. U joshja dhe vet nga një përfytyrim lakuriqësie. Ja pse ne poetëve na duhet përfytyrimi.. Në fakt isha kureshtar, nuk kisha parë kurrë një plazh me plazhistë që laheshin lakuriq, gra dhe burra me hallate jashtë. Pa të zbres dhe unë ,mendova, të shoh ç’bëhet atje poshtë. Justifikimi ishte gjetur: “Në kërkim të Sandrit.”Kureshtar dhe me një ndjenjë turpi, rrëshqita përmes një tërthoreje të mbuluar me pisha të reja. Papritur m’u lëbyrën sytë nga një ndriçim i fortë dielli përzier me miliarda luspash deti. Mbi pjerrësinë e ca pllakave verbuese vegjetonin qenie njerëzore që, në pamje të parë u ngjanin fokave.

Sandri më buzëqeshte nga një zgavër uji llokoçitëse duke ma bërë me dorë. Kapërceu midis fokave me ca lëvizje djaloshare dhe më erdhi pranë: ”Zhvishu shpejt “ -më tha gjithë gjallëri. Uji është i shkëlqyeshëm!?” Sikur e kisha hallin te temperatura e ujit.”

Këtu të gjithë lakuriq janë. “ Ndërkohë që po zhvishesha për t’u futur në det, së bashku me Sandrin, se nga erdhi një pallosh i gjatë dhe, me një shqipe copë-copë, më qortoi zë ulët: “Nëse s’ keni ndërmend të hiqni të mbathurat, largohuni! ” Hodha një shikim rreth e rrotull , vura re që askush nuk e kishte mendjen tek unë dhe u qetësova. “ Mësohesh. Dëgjo mua. -Më fliste te veshi Sandri.-Vetëm në fillim të bën përshtypje, më pas s’të bie ndërmend nëse je i veshur ose lakuriq. Ja, shihi të tjerët.”

Edhe pse askush nuk u tregua kureshtar për lakuriqësinë time, nuk ndjehesha mirë. Më pas vëmendja u shpërqendrua në biseda të ndryshme. Dhe ai, Sandri, ku e gjeti vendin dhe kohën për të më treguar histori me burg. Imagjinoni dhe ju, dy njerëz lakuriq të bisedojnë për jetë burgjesh , ndanë llokoçitjeve të valëve, pranë dy grave të bëshme dhe një vajze brune që... s’ më lë etika t’ua përshkruaj me imtësi gjithçka pashë me sytë e mi, në ato çaste. Veshët te fjalët e Sandrit e mendja në të tjera hapësira. S ' kishte asgjë për t’u çuditur, nëse ca qenie njerëzore ishin kthyer të shijonin njeriun në krijimin e botës, në epokën e Adamit dhe të Evës. Ja kështu, Adami me Evën, do të jenë shtrirë lakuriq, pranë

madhësisë së detit. Me këmbët e zhytura në ujë , qëndronim veçuar të tjerëve.. Unë isha kureshtar të dëgjoja ndonjë fjalë shqip, për të marrë vesh nëse plazhe të tilla frekuentoheshin prej shqiptarëve. “ A e di ti?- tha Sandri, ndërsa kisha përhumbur shikimin në sfondin e mjegullt të detit,- Hetuesi im, në një nga seancat më ka lexuar një poezinë tënde.” Ktheva sytë dhe e pashë me çudi . Si janë njerëzit! Këmbët në det e mendjen njëzetepesë vjet të shkuara.

* * *

Kur binte mbrëmja me atë Hënë mesdhetare, të argjendte, sipër kullave të saj, kalaja e Ulqinit të dukej sikur hyje në mesjetë.. Ato çaste të paharruara, kur ne u ngjitëm në skenë njëri pas tjetrit, për të deklamuar poezitë tona, unë i përcolla me një ngazëllim të veçantë. Ne ishim ambasadorët e parë të asaj miqësie që kishte nisur të lulëzonte midis shteteve ballkanike. Fillimisht në skenë u ngjit Sandri. I bënë një prezantim madhështor, sikur të ngjitej në skenë vetë Mesia. Kishin marrë vesh që kishte bërë tetë vjet burg dhe ishte poet disident. Sandri deklamoi një poezi me burg, kinse e kishte shkruar në qeli. Më pas nuk e pyeta nëse deshi të na mashtronte të gjithëve atë natë , për t’u bërë dhe më i lavdishëm. Unë deklamova një poezi me kufij shtetesh. Më pas në skenë u ngjit një poeteshë nga Kosova , veshur me ngjyrat e flamurit, kuq e zi, bionde, e shëndetshme, e gjallë dhe e çlirët.. Ajo deklamoi një vjershë dashurie. Më pas në skenë u ngjit një poet serbo-malazes, i gjatë sa s’bëhet. Ai deklamoi një poezi të rimuar me katër vargje, më bënë përshtypje vargu i dytë me të katërtin që rimonin me fjalët :“merd” dhe smjert”. U përcoll me duartrokitje të thata, mbase nga që shumica e spektatorëve ishin shqiptarë. Nga të gjithë poetët dhe poeteshat e saj mbrëmjeje, vëmendjen ma tërhoqi poetesha nga Shkupi, u ngjit në skenë me frikë, kish mbështjellë kokën me një shami ngjyrë vjollcë, duke lënë të dukshme fytyrën dhe sytë . Mbas darke ishim ftuar të gjithë në restorant “Albatros”. Surpriza e asaj mbrëmjeje të paharruar ishin sërish dy poeteshat, me të cilat na ra shorti të darkonim së bashku në të njëjtën tavolinë. Bjondinka nga Prishtina erdhi e veshur krejt ndryshe, ndërsa poetesha nga Shkupi nuk e kishte ndryshuar veshjen. Qysh në prezantimin e parë unë e kuptova që dy poeteshat kishin një mentalitet të ndryshëm për jetën. Poetesha e mbështjellë me shami e cila erdhi dhe m’u ul pranë me një mirësjellje të heshtur, studionte për teologji. E quanin Lule. Fliste pak. Preferonte

biseda serioze. Poeteshën prishtinase e quanin Mediha, shkurt Medi. Jepte lëndën e letërsisë në një gjimnaz të Prishtinës, ishte ndarë nga i shoqi prej gjashtë vitesh, jetonte në një apartament në qendër të Prishtinës së bashku me dy vajzat gjimnaziste. Më pas, kur Sandri nisi të tregojë një barsoletë banale ajo ia krisi gazit me zë të lartë. Në sektorin e barsoletave Sandri e ndjente veten zot të tavolinës. Tregoi dhe një të dytë , më banale se e para, dhe një të tretë... Ai trego e ajo kukuriste me lot. Unë dhe Lulja si dy njerëz seriozë , atë mbrëmje e kaluam me biseda serioze, biseduam dhe për ditën e fundit Kiametit. Unë e pyeta atë, se si e përfytyronte ajo zotin. ”Zoti është një inteligjencë supreme brenda nesh.- tha ajo. Më pas shtoi: Nuk i fshihesh dot. Vetëm asaj nuk i fshihesh dot.” Nuk e kuptova dot pse në fillim shqiptoi Zotin,(mashkull) më pas tha “asaj”? Të ishte fjala për “inteligjencën supreme”?Veç për t’i bërë qejfin, unë i tregova asaj disa vargje nga “Ajete Qyrsia” të cilat më ishin ngulitur në mend qysh nga fëmijëria. Fillimisht u befasua, më pas qeshi me gjithë zëmër. Duhet t’i kisha shqiptuar fjalët gabim. Dhe kështu, atë mbrëmje pati ç’të bisedohej. Për ta përzier bisedën me çiftin gazmor, unë i tregova Medit historinë e plazhit nudo. ”Sandri sa erdhi në Ulqin përfundoi në një plazh nudo?” “Ani,- pohoi Medi natyrshëm. –Në atë çast unë isha në plazhin nudo të grave. ” “ Paska plazh për gra?”-shprehu habinë Sandri.”A ke qejf me na pa?”- e ngacmoi ajo . “Si jo...”-tha ai. ”Do të kisha ftuar me gjithë qejf, -ia ktheu Medi, por, s’lejohen meshkujt.” “Atëherë më fto në dhomën tënde.”.Nuk e di si ia dha mendja t’i kapërcente kufijtë e një shakaje. Po Medi bënte shaka edhe më të rënda. “Kur të dush ...”-ia ktheu qetësisht.- A do qysh sonte?” Për një çast u bë një pauzë e nderë. Unë ktheva sytë nga Lulja. Më mirë që nuk dialogu i tyre nuk kishte mbërritur në veshët e saj.“Po më provokon?”-e pyeti Sandri duke marrë një pamje prej guhaku. “Aspak!- ia ktheu qetësisht dhe e sigurt ajo.-Ti e meriton një natë të tillë. Poet disident...Kushedi sa duhet të kesh vuajtur në burgjet e Komunistit.” “Të lumtë! Fitove!” – i tha ai , duke e konsideruar këtë përgjigje një tërheqje taktike. ” “Fitova? – ngriti supet ajo. Aa..Nëse ti quan fitore guximin tim për të të bërë një ftesë serioze...” Sandri ngeci keq.“Je vërtet e lezetshme. Për ideal të Partisë! ”

Ishte koha për të marrë një vendim. Ta merrte seriozisht ofertën e saj?

Pas mbrëmjes kur dy mikeshave tona u thamë “natën e mirë”, u befasuam që dhe dhomat e fjetjes i kishim pranë. Sandrit s’i rrihej në dhomë. “Po dal të bëj një shëtitje anës

detit.”- Më pas ndërroi mendje. Doli në ballkon. Kishte blerë një paketë “Slims”.Ai që s’kishte haber si mbahej cigarja, nxori një fije dhe e vuri në buzë. Pas tij dola dhe unë në ballkon. Ishte një ballkon lozhë.“Sa femër e lezetshme. E pe si më provokoi? “.Donte mendimin tim. “ –Ty e more për provokim , - e ngacmova unë. Në fakt ajo të bëri një propozim.” I ndritën sytë.”Dhe m’ua ashtu m’u duk.”-tha. - Ishte pa komplekse. Pikërisht për këtë gjë ishte ndarë me të shoqin, i cili jetonte si emigrant në Gjermani.

* * *

Kishte kaluar mesnata. Bisedonim me dritë të fikur,të shtrirë në krevatet tona .Nuk na zinte gjumi. Sandrin e kishte kapluar nostalgjia e dashurive të tij. Ndarja me të shoqen, një vajzë e pashkollë nga Elbasani, kishte ndodhur në ditët e hetuesisë, kur kishte lënë mustaqet spic, si të Hitlerit. Kishte dy vajza të martuara, të dyja në emigracion. Ato ishin të lidhura shumë me nënën dhe asnjëra s’kujtohej të merrte në telefon. Pas burgut kishte tentuar disa herë të martohej, por nuk kishte gjetur njeriun e duhur. “Si të duket Medi?” Pyetja e tij m’ u duk e befasishme. S’kishte tre katër orë që njiheshin,kishin shkëmbyer vetëm ca shakara banale dhe kishin kërcyer dy - tri herë.

“Po shkon ca si larg. ” -i thashë. Në çast mendova Lulen. Lulja po, ajo ia vlente. Vajzë serioze. Inteligjente, shkruante poezi...Mund të ishte vërtet një shoqe jete. Paksa e trishtë. Dhe e frikur.”Vetëm asaj s’i fshihesh dot...”E kishte fjalën për Zotin. Po pse “asaj”? Brenda veshjes së saj prej besimtareje duhet të fshiheshin hiret e një femre të jashtëzakonshme. Kjo ide ma nxiti dhe më tepër dëshirën për të parë se ç’fshihej poshtë të linjtave të saj. Duke vënë në veprim përfytyrimin poetik nisa t’i heq fillimisht shaminë ngjyrë vjollcë. Ia hoqa të linjtat dhe i hodha mbi tapetin e dhomës sonë. Çfarë guximi imagjinar! Ashtu e zhveshur , s’ di pse më ngjasoi me tezen time të vogël.... Cili psikanalist mund ta shpjegonte një dukuri të tillë palimpsesti? Ideja për të parë te Lulja femrën kishte lindur.

* * *

Me ndjesinë që e krijon vetëm prania e detit u zgjuam të dy atë mëngjes. Zbritëm poshtë dhe u futëm në restorant. Poeteshat kishin zbritur para nesh dhe na prisnin. Të sistemuara në një tavolinë pranë verandës, na bënë shenjë me dorë. Porositëm gjerat e zakonshme mëngjesore. Imtësitë tona të atij mëngjesi i ngjanin imtësive të çifteve të dashuruara të cilët ia marrin fjalën nga goja njeri tjetrit.

-Do të shkojmë sërisht në plazhin tonë?- i bëra Sandrit një pyetje të paramenduar."Unë po." nxitoi të përgjigjej Medi."Unë mezi e pres..." -shtoi Sandri. Mbetej për të reaguuar Lulja.

-Eva para Adamit rrinte gjithë frikë- nisi të arsyetonte ajo,- edhe pse trupin e kishte mbuluar me gjethe fiku.

-Jo gjithë trupin.-tha Medi me shaka

-Kush i ka parë.-Ndërhyri Sandri.

-Sidoqoftë. Nudizmi kolektiv është një shfaqje eksibicioniste, -ndërhyra unë në mbrojtje të shoqes sime.

-Ne kemi shijet tona ju mbani shijet tuaja.-tha Medi me shaka. Kundërshtimet konceptuale të dy çifteve nuk ndikuan në shijen e atij mëngjesi të gëzueshëm.

Lulja nxori nga çanta e saj prej lëkure të zezë, dy librat e saj me poezi, njërin ma la mua mbi tavolinë, me përkujdesje, tjetrin ia zgjati Sandrit me mirësjellje. Sandri e shfletoi nxitimthi, lexoi dedikimin dhe e falënderoi. Medi na i kishte dhënë librat qysh natën e parë. Atë mëngjes Medi kishte veshur një bluzë sportive ngjyrë portokalli, ngjante si fanse e skuadrës holandeze.

Lulja, me atë shaminë e mëndafshtë ngjyrë vjollcë, më kujtonte vitet e fëmijërisë, kështu e mbaja mend nënën time me shami, të ulur paksa mbi ballë.

Dolëm nga restoranti dhe menduam të bëjmë një shëtitje të shkurtër. Medin dhe Sandrin i lamë të na parakalonin, gjersa na humbën nga sytë. Në mesditë i pritëm në restorant "Albatros." Në ato çaste Sandri më dha lajmin më të çuditshëm. "Medi më ka ftuar të shkoj në Prishtinë." "Të shkosh, patjetër. - i thashë. "Pas Prishtinës do të kthehem në Tiranë. Ajo vdes për Tiranën... tha ai.- Ti mund të të duket e çuditshme. Hë? Si mund të lidhen dy njerëz kaq shpejt...

Këtë njeri e kam pritur prej gjysmë shekulli. Është e çlirët dhe inteligjente. Ie që ka qejf gatimin... Ta dish ti sa më janë neveritur restorantet. Më ka marrë malli të ha njëherë gjellë shtëpie."

* * *

Medi erdhi në mbrëmje e veshur me një bluzë dekolte ngjyrë vishnjë dhe pantallona ngjyrë veze. I rrinin ngjitur pas trupit. Flokët ngjyrë kashte i kundërmonin erë shampo. Dukej seksi. Lulja, e heshtur dhe trishtuese, dukej si një lule e këputur nga kopshtet e bukura të “Bahçe Sarajit”. Atë mbrëmje Sandrit i kishte hipur nuri i një dhëndri të vonuar. Cigaren e mbante në mënyrë demonstrative, në dy gishtat e dorës së majtë, si një djalosh që provon për herë të parë të thith nikotinë. E nxirrte tymin shtëllunga- shtëllunga, për qejf të vet. Pesëdhjetë vjetët mbi supe, mustaqet spic si të Hitlerit dhe ajo cigare demonstrative, të krijonin përshtypjen e një burri tradicional

Në çastin që po binim në ujdi për të darkuar në një restorant luksoz pranë detit, se nga na erdhi si një xhind sipër kokave tona një njeri që s’e kisha parë kurrë. Mbante një mjekër të kuqërremtë, drudha-drudha, si lesh deleje. Lulja sa e pa u ngrit në këmbë si me sustë, njihuni, na tha, i fejuari im. Prezencës së tij të papritur Sandri me Medin nuk i dhanë rëndësi. U ngritën në këmbë dhe e takuan përzemërsisht, ndërsa për mua ky njeri do të quhej “e papritura zhgënjyese.” Lules nuk i bëri përshtypje as shqetësimi im as ardhja e papritur e “mjekroshit”, i cili gjatë atyre pak çasteve pati një mirësjellje të shtirur dhe një buzëqeshje të kontrolluar. Çfarë t’i kishte pëlqyer këtij njeriu, mendova. Besimi i përbashkët tek “inteligjenca supreme” ishte futur thellë në shpirtin e saj, me me makth dhe frikë, ajo do ta shoqëronte gjatë gjithë jetës. Lulja u nda prej nesh qysh në atë çast, ndërsa Medi me Sandrin nuk e prishën planin.

Gjatë gjitha asaj nate me një hënë të trishtuar ulqinake, unë përdridhesha e përdridhesha në krevat i shqetësuar. Në çaste të tilla ngushëllimi im i vetëm janë përfytyrimet. Nëse dikush nga ju do të më kërkonte të zgjidhja një nga të dyja, o kujtesën o përfytyrimin, unë padyshim do të zgjidhja përfytyrimin. Dhe a e dini pse? Se kujtesa, mik vëllai, i përket së kaluarës, ndërsa përfytyrimi i përket së ardhshmes. Përfytyrimi, të jep krahë, të bën të lirë, përfytyrimi të largon mërzinë dhe trishtimin.. Doni të ndjeheni sikur jeni duke lundruar sipër një jahti? “Hapu susam!”

Doni mund të shijoni erën e njelmët të detit? Përse të udhëtoni, në Madrid, në Berlin, në Persi, në Kinë, në Polin e veriut? Kudo që të gjendeni s’do të jemi gjëkund tjetër veç brenda ndjesive tona.

Dëshironi të gjendeni në një nga kafet e shumta të Parisit, përgjatë bulevardit “Shamp d’ Elise?” ”Bon jour! Desidere

vu?!” Në atë çast unë e ftova Lulen në dhomën time plot dritë Hëne.

E solla ndërmend dhe ajo doli nga llamba magjike e Aladinit , e veshur me një tyl të tejdukshëm najloni. I zbardhëllonin cilësitë femërore me një ndriçim verbues. Në ato pak çaste të lumtura përfytyrimi , ajo më dha çka s’do të guxonte askush ta përjetoja as në ëndërr. Le të hidhej përpjetë tani ai mjekrosh kuqalashi. Unë mbarova punë me “shoçen” e tij , me të cilën ai ishte lidhur sipas ligjeve të shenjta të Sherihatit. O krijesë hyjnore përfytyrimi, që nuk na le kurrë në baltë , që nuk na lë kurrë në trishtim e pa shpresë, na bën të ndjehemi zot të vetvetes, zot të sendeve , zot të njerëzve të kësaj bote dhe zot të natyrës që na ngazëllon me begatitë e saj. Ti ndez orë e çast ndjesitë tona të tulatura dhe shfryn nëpër ditë ndjesitë tona të plagosura.

* * *

Të nesërmen në mëngjes rrugët tona do të ndaheshin. Çifti i ri do të nisej për në Prishtinë. I ndoqa me sy kur hipën në autobusin e linjës, u ulën në vendet pas shoferit dhe më përshëndetën me dorë. Ngjasonin me një çift që nisej drejt muajit të mjaltit. Ja ç’mund të ndodhë kur takohen katër poetë.

Hallë Memeja

Shtëpia e Gëdajve qëndronte përmbi shtëpitë e të tjera si një hije e vjetër e ogurzezë, e ngritur mbi masivin shkëmbor, me dritare guri të ngushta që shikonin nga deti

Në oborrin me avlli hidhte shtat një fik i vjetër e degëgjërë, me trung të shkurtër; ca shkallë druri që kishin nisur të kalbeshin e të breheshin nga krimbat të çonin në katin ku ishte dhoma dimërore e Memesë.

Ne atë e thërrisnim "hallë", pa e ditur se çfarë e kishim në të vërtetë.

Më kujtohet si tani një natë dimri, kisha shkuar për të fjetur në shtëpinë e saj. Gjatë gjithë natës nuk më zuri gjumi nga vetëtimat dhe bubullimat. Kërcisnin mbi shtëpi me një zhurmë shurdhuese, sikur bëheshin bombardime.

Pas çdo vetëtime ngrija kokën nga nën jorgani, i lehtësuar. As hallë Memenë nuk e zuri gjumi. Sa herë krisnin vetëtimat ajo thoshte nën zë: "Subuhan allah!". Kur u zgjova pashë mbi krye zemërmirën Meme, me një tas me qumësht të ngrohtë. "Çohu, të keqen...më tha,-Të ka bërë halla mëngjesin... U ngrita me dëshirën që, sa të haja mëngjes të fluturoja te shtëpia ime. Hëngra përsheshin me qumësht përzier me bukë misri, preka vetëm pak nga pjata me mjaltë dhe arra, që s'i kisha parë as në ëndërr në shtëpinë time, dhe i lashë pendët shtëpisë së Gëdajve. Nënës ia tregova të gjitha; i tregova dhe për tmerrin që kishim ndjerë gjatë natës.

-Shtëpia e Memesë është në rrezik, Ka shumë plasaritje dhe mund të bjerë. Sikur halla të vijë të jetojë te ne?

- I është lutur yt gjysh, -tha nëna,- por nuk dëgjon. -Këtu do të vdes, thotë.

Memeja kishte hyrë në atë shtëpi qysh në moshën 15 vjeçe. Kishte pasur dhe ajo dy ditë burrë. Ishte bërë dhe një dasmë.(Dasmë i thënçin!) Asaj i takonte një dasmë e madhe, si motra më e vogël dhe me shumë vëllezër. Por asaj i duhej të shkonte në Gëdaj sa më parë, me që Qerim Gëdua shkonte nizam, në Jemen.

Qerimi iku dhe nuk u kthye më. Erdhi mandata në fshat. U fol se kishte dezertuar në një betejë dhe sipas ligjeve turke ishte dënuar me vdekje. E qanë fshatçe. Në 17 vjeçe Memeja u vesh me të zeza. Dy vjet më vonë vdiq vëllai i madh i Qerimit. Një vit më vonë i vdiqën të dy prindërit, njeri pas tjetrit. Më tepër nga hidhërimi se nga ndonjë sëmundje. Familja e Gëdajve u shua nga faqja e dheut. Gëdajt mbaheshin mend si një ndër familjet më të vjetra të fshatit, i numëronin gjer në trembëdhjetë breza. Kujtesa arrinte gjer te Mërtir Gëdua i parë, pas tij pema gjenealogjike e Gëdajve vazhdonte me emra myslimanë. Një Hasan i parë që kishte pasur tre djem, Beqon, Sejkon dhe Ismailin.

Me kokëfortësi të dhimbshme Memeja e mbante hapur portën e Gëdajve. Vetëm ngrysej e vetëm gdhihej. Vetë punonte tokën në arat e Gëdajve, vetë shtynte parmendën duke i qëlluar qetë me thupër si një bujkeshë i vërtetë. Në pranverë vetë mbillte grurë, në verë korrte e shinte me dharte, në lëmin e Gëde, në vjeshtë shkundte ullinjë , netëve po vetë i shtypte në koritën e saj.

Sa herë që vinte në shtëpinë e gjyshit, gjithmonë në muzg: "Ja, erdha, t'ju shoh, thoshte, se kam qenë sëmurë..."

" Qysh kështu, moj Meme...?!"- e qortonte nëna, ndonëse ishte së paku 50 vjet më e vogël se ajo.-"Kështu si bën ti do të ikësh nga kjo botë e s'do marrim vesh gjë..."

Rrallë zbriste te dyqanin e fshatit, vetëm kur i mbaronte kripa për dhinë ose kur bluante në mulli. Në raste të tilla kthehej dhe nga shtëpia jonë me që e kishim afër mullirit . Nuk vinte kurrë duar bosh. Nga xhepat e çitjanes nxirrte o çepele o bukëfiqe ose nga ato arrat kokërrmëdha të Gëdajve... Ulej në cep të divanit si qyqare, m'u afër derës , na gëzohej ne fëmijëve me një dashuri të përvuajtur.

-Të të bëj një kafe, hallë?

-Jo. Jo. Meazallah, s'e pi kafën unë.

-Atëherë të të nxjerr një gliko.. ?

-Jo. Jo. Mos e bëj dëm për mua.

-Atëherë merr një karamele...Mos më rri kështu si e huaj, moj e zezë. Je në shtëpinë tënde.

Karamelen e merrte si me turp, vetëm një, dhe atë ma zgjaste mua fshehurazi. Nuk dihej qyshkur e kishte fituar këtë mënyrë sjelljeje, ta trajtonte veten e huaj në shtëpinë e vet...Nuk e kam kuptuar dot asnjëherë pse kishte vendosur që të përballonte me modesti çdo trajtim njerëzor.

Tek e vështroja ashtu atë qenie kokë ulur e me pamje burri, mendoja që kulla e Gëdajve dhe ajo kishin diçka të ngjashme midis tyre . E lashtë dhe shterpë si ajo, e vetmuar dhe e braktisur si ajo, e plasaritur nga goditjet e jetës si rrudhat e saj, të dyja të forta e të gatshme për t'u përballë me vetëtimat dhe bubullimat dimërore. Në ato çaste këmbente dy fjalë me nënën , me të cilën i hahej muhabeti, (më tepër i qante hallin si grua me shumë fëmijë) më pas ngrihej në këmbë: "Ika unë!".

-Prit dhe pak... Hallë ëë!- i lutej nëna,- s' të qajnë fëmija..."

-Më qan Lara- thoshte ajo, - Ka nisur e më kërkon...E kam lënë jashtë dhe do ta ketë marrë uria.

Lara ishte macja e saj e vetme, një mace e urtë , qimebardhë, me një tufë qimesh të zeza përmbi ballë, me një shikim të heshtur e të zgjuar. Lara ishte bërë si të thuash shoqja e saj intime. Përkujdesej për të gjatë gjithë ditës. E ushqente me kujdes, i mësonte si të shkonte vetë në banjë...I tregonte histori , në prani të saj shpesh herë filozofonte për jetën, kujtonte të vdekurit, i

merrte Larës ndonjë mendim, pa pritur prej saj përgjigje. Lara ishte qenia e saj më e dashur . Bashkë hanin, bashkë flinin. Prania e saj e gëzonte sa herë kthehej e lodhur nga punët e vështira të ditës.

Kur vonohej e gjente në mug te lesa e oborrit. Lara sa shihte Memenë nxitonte t'i dilte përpara, seç kërkonte t'i thoshte me ca mjaullima të zgjatura. Kohët e fundit ajo kishte nisur të filozofonte shpesh për vdekjen. Me sytë e saj të xhamtë e mospërfillës, Lara vetëm e dëgjonte, por nuk shqetësohej aspak për fatin e Memesë. Vetmia kishte krijuar te ajo zakonin e kuvendimit me zë të lartë.

Veç Larës kishte nëntë dhi të cilat i hanin pjesën më të madhe të ditës. Gjithmonë kishte pasur nëntë dhi, asnjëherë dhjetë. E dhjeta shkonte në thikë. U kishte vënë emra të gjithave , për t'i dalluar nga njëra tjetra..

Brihalën e kishte caktuar prej kohësh si komandante pasi ajo i dukej më zellshme në të ngrënë, më e respektueshme se të tjerat dhe më e shkathët për të gjetur ushqim. Brihala kishte një prejardhje fisnike. Ishte marrë nga një racë e veçantë, kishte një shikim sorkadheje, me qafë të hollë e me brirë të gjatë dhe të mprehtë. Brihala kishte dhe një shikim të zgjuar prej fëmije, të kuptonte vetëm nga mimika, kishte reflekse që do t'ia kishte zili çdo qenie njerëzore.

Gjatë viteve ajo kishte pasur shtatë dhi të këtij lloji dhe të gjitha i kishte quajtur "Brihalë".Pastaj vinte Brikena, Bardha, Murra, Kena, Kërruta,...Emrat e të tjerave nuk i mbaj mend.

Herët në mëngjes mezi prisnin të dilnin në liri.

Shtyheshin qysh te dera, kush të dilte e para, pastaj vraponin drejt kripës, u tundeshin zilet tinguj holla tek mbllaçiteshin, secila duke lëshuar tinguj të veçantë.

"Dhe dëgjo këtu, ti Brihalë...,- e porosiste hallë Memeja komandanten e tyre. -Sa të më dëgjosh zërin , merr shoqet e nxito për në shtëpi...-Dhe kujdes Kenën. Mos e lër të afrohet buzë shkëmbit..." Brihala e shikonte drejt e në sy me padurimin e një fëmije çapkën e i dhënë pak si tepër pas lodrave.

Gjatë ditës i linte të lira të bridhnin duke i ndjekur përmes tingujve të veçantë të zileve. Në mbrëmje i priste në oborr me tepsinë me lënde lisi, duke i thërritur me atë zërin e hollë:

-Briha-a-la-a!...Kruta-a-a! ...Kena-a-a!

Sa dëgjonin zërin e hallës dhitë nxirrnin kokën sipër shkëmbinjve, duke tundur zilet në qafë nga kënaqësia e bredhjeve të ditës. Ajo i ndillte në oborr duke tundur tepsinë me lende. Ato vinin drejt saj me kërcime të gjata, ndiqnin njëra tjetrën si në një lojë, kush e kush të mbërrinte në oborr e para.

* * *

Por ajo ishte një shtëpi me krisma të mëdha.. Priti rrufe në mote, së fundi u dorëzua dhe ra. Ishte një mëngjes me shi kur pamë gjysh Ismailin të hynte i shqetësuar në oborr.

-E morët vesh? Ra shtëpia e Memesë!

-Korba! -klithi nëna,-Ç' më the!... Sot e kishim lënë me të të shkonim nga ullinjte.

Kur shkuam te shtëpia e saj nuk pamë as shtëpi as hallë. I thërrisnin dhe nuk e gjenim gjëkund.

-Ku je, moj ? Po ku je moj?!...

Zërin ia dëgjonim ...Një zë i mekët, i këputur , si një kuje. Sikur fliste nga nëntoka: "Jam këtu...Jam këtu...!"

Së fundi e pikasi gjyshi. E kishte zënë nën vete një tra i madh, gjithë blozë. E nxorën me vështirësi trupin e saj me rrobat gjithë gjak, e hodhën në një sixhade të saj dhe e shtrinë sa gjatë gjerë në hyrje, te lesa.

'Më çoni në Mitaj...' Vetëm kaq mundi të shqiptonte me vështirësi, si në përçartje, duke bërë me dorë nga shtëpia më e afërt që ishte në krye të fshatit.

Jo, motër,- tha gjysh Ismaili. Do të të çojmë në shtëpinë tonë.

-Nuk besoj të arrij Do t'u vdes në rrugë...

Tek mundohej të fliste, merrte frymë me vështirësi dhe i përhidhej zëmra në gjoks.

"-Të m'i zini të gjitha dhitë... t'i therni..." -nisi të linte amanetet e fundit ..Si i duronte gjithë ato dhimbje? E për më tepër gjente forca për të lënë dhe amanete...."Mishin ndajeni për ahiret... Në çdo derë të fshatit....Në kamare kam ca vezë...Jepuani fëmijëve...Janë dhe tri pula që mblidhen nën shegë... therini dhe ato...Më zunë kolonat që kam prurë nga Vënjat...I kam ngritur me krahët e mi. I kishte porositur Rabil al Emimi që të më zinin nën vete ..."

Pastaj iu kthye gjyshit: " Mos shko të m'i mbledhësh dhitë tani se tremben. ...Shohin muret e rëna dhe ikin...." Rrotulloi syrin e vetëm që i kishte mbetur i hapur, duke e ndaluar nga pak te të gjithë, sikur na përshëndeste për të fundit herë, sikur përfalej me secilin në veçanti. Pastaj tha:

"Mos lini njeri në fshat që të mallkojë : *Të zëntë shtëpia si Memenë...!*"

Kërkoi t'i jepnin pak ujë. Ia sollën por gotën nuk arriti ta vinte te buza. I plasi gjaku nga goja dhe...mbaroi. Pak metra më tutje, nga furra e saj prej balte vazhdonte të ngrihej avull nga dheu.

Nëna kapërceu trarët e mëdhenj dhe pas pak nxori nga furra një tavë me kunguj. Ishte ende e nxehtë, e përzier me dherat dhe gurët që i kishin rënë sipër. Tezja kur pa tavën me kunguj nisi të

qante me dënesë, ndërsa nëna u përkul mbi tavë dhe lëshoi një klithmë të zgjatur, ngjethëse.

Ç' kanë qarë të gjithë atë mëngjes! Të gjithë , pa përjashtim. Qanin me dënesë mbi trupin e saj .Ndërkohë që kufomën e ftohur e çonin në derë babe, nëna ime u ngjit në kopshtin mbi shtëpinë e Gëde dhe nisi të thërriste: "Briha-a-alë! Bri ha-a-alë!"

Zërin e saj të hollë grykat e maleve e kthenin në formë oshtime. Brihala nxori kokën pas një shkëmbi, ndoshta e kuptoi që zëri nuk ishte i Memesë, dhe u fsheh përsëri.

"Hajde të ikim!- tha nëna.-Vijmë t'i mbledhim më vonë."

Andej nga muzgu u ngjitëm sërish te sheshi i Gëdajve. Nëna mbushi një tepsi plot me lënde dhe, duke imituar Memenë, nisi ta tundte në duar:

Briha-a-ala...? Kena-a-a...! Kru-ta-a-a!... Brihala sa dëgjoi ta thërrisnin zgjati qafën e hollë pas një shkurreje, poshtë shpellës së Gjolekës. Si të ishin marrë vesh me njëra-tjetrën, u varën poshtë, njëra pas tjetrës, pa ndonjë dëshirë për t'u kthyer në vathë. Ecnin ngadalë, si të brengosura ,sikur ta kishin parandier mynxyrën që u kishte pllakosur me humbjen e nënëmadhes së tyre.

Kur u afrua dhe ca Brihala ndali , ngriti veshët dhe pa nga ne, me dyshim dhe habi...Nuk e di ç'ka ndjerë në çastin që pa banesën e saj gërmadhë...Duke gjykuar nga ky rast kam menduar se edhe dhitë janë si njerëzit, paçka se u mungojnë fjalët.

Sikur ta kishin kuptuar gjëmën që kishte ndodhur, nisën të blegërinin në kor. Ulërinin me zëra fëmijësh...Si tani e kam parasysh atë skenë të çuditshme. Na vërenin me sy të pikëlluar dhe s'guxonin të na afroreshin. Dukeshin sikur pyesnin:

"Ç' qe kjo gjëmë e zezë? Po halli ynë si do të vejë? Kush do dalë të na mbrojë tani që iku nënëmadhja...?"

Brihalë...!Brihalë...!- I thirri nëna ëmbëlsisht komandantes së tyre. Në vend që t'i afrohej ajo lëshoi një blegërimë të zgjatur e të çjerrë, sikur na kërkonte llogari; ç'i kishim bërë Memesë? Nisën të blegërinin në kor dhe dhitë e tjera, më tepër se blegërima ato ngjanin me zëra fëmijësh. T'i dëgjoje si qanin..Të këputej shpirti. Qanin si fëmijë. Nëna ime la tepsinë mbi mur dhe nisi të qante dhe ajo, me dënesë. Më pas ia krisi vajit tezja. Vetëm unë s'qaja. Rrija si i shushatur. Hoqa një thupër nga gardhi dhe me të në dorë u dola dhive nga pas...Yha! U thirra. Nisa t'i trembja për t'i zbritur teposhtë kalldrëmit, për në Mitaj.

Dhe ato...Çudi e madhe. Vendosën t'i nënshtroheshin fatit të tyre të zi. Nisën të lëvizin nën komandën time në grumbull. Sikur ta dinin që atje poshtë, në oborrin e Mitajve, t'i priste thika.

Asnjëherë nuk kishin zbritur atij kalldrëmi dhe nuk dinin asgjë për kasapin e fshatit me emrin Bahri, i cili kishte kohë që i priste me thikë në dorë, në oborr, nën një fik degëgjërë.

Të gjithë sa i panë u çuditën. Të trembura nga shikimet e njerëzve që vinin për ngushëllim, kaluan kalldrëmin qetësisht. Si e gjetën udhën gjer në oborrin e Mitajve dhe si vajtën e ndaluan drejt e nën fikun degë gjerë!? Sikur ta dinin se çfarë i priste tani që dhe engjëllin mbrojtës nuk e kishin më.

Të therje nëntë dhitë e hallës... O tmerr! Dhe çfarë dhish...Dhi që na shikonin dhe na kuptonin si të ishin njerëz. Të therje nëntë dhitë e saj tani që dhe ajo kishte vdekur, do të thoshte që dhimbjes t'i shtojë një dhimbje tjetër edhe më të madhe.

Plaka çame

Ne jemi pjesa e gjallë e Zotit

Niko Kazanzaqi

Kam shumë kohë që mendoj të rrëfej historinë e një plake çame që iu vranë tre fëmijë nga një bombë që ra në oborrin e shtëpisë së saj. Pas kësaj tragjedie ajo jetoi edhe tridhjetë e dy vjet të tjerë, sigurisht, duke zvarritur këmbët, për shkak të djalit të saj të vogël, Gëzimit, i cili i kishte shpëtuar vdekjes, i fshehur në furrën e bukës. Thanë se atë çast nënën çame e la mendja për fare, vetëm një pjesë e trurit i punonte sa për të nxjerrë një ulërimë të mbytur: Gëzo! Gëzoo..! Sikur ta dinte që djali i saj, i vogël, pesëvjeçar, i kishte shpëtuar kësaj mynxyre. Kur e pa tek nxirrte kokën nga furra iu sul si ajo kllaçka që u sulet zogjve të vet.

Nëna Gania, kishte lindur gjashtë fëmijë: vajzën e madhe e kishte martuar në Elbasan me një inxhinier mekanik, i parafundit i kishte vdekur qysh në lindje, tre të tjerët, siç ju tregova, i përpiu dhe brenda atij çasti të mallkuar, i gjashti për nga radha vinte Gëzimi.

* * *

Kur Gëzimi mbushi gjashtë vjeç dhe hyri në klasë të parë, nënë Gania pa një fëmijë të vogël, katër-pesëvjeçar, shtrirë në mes të rrugës, që qante me dënësë. Ajo iu afrua, i përkëdheli flokët butëbutë dhe e pyeti ku i kishte prindërit Vocërraku veç qante. Ajo nuk mundi ta linte në rrugë atë vocërrak të braktisur. E rroku në duar dhe e çoi në shtëpinë e vet. “Gëzo, - i thirri të birit, - të kam sjellë një vëlla”. Atë mbrëmje dy fëmijët luajtën së bashku gjer në orët e vona. Fjetën si dy vëllezër, në të njëjtin krevat, njëri me flokë të verdhë e sy të kaltër e tjetri i zeshkët e me flokë sterrë të zinj. Të nesërmen kur prindërit e djalit trokitën te dera, ajo mori vesh gjithçka për të. Djalin e quanin Stalin. Ishte fëmija i shtatë i një familjeje tepër të varfër. Ata jetonin në një barakë prej llamarine, siç jetonin shumica e racës së tyre, të lënë pas dore nga shteti. Prindërit e Stalinit e njihnin nënë Ganon. E kush nuk e njihte plakën e gjorë çame, lidhur kokën gjithmonë me një shami të bardhë, e shkurtër dhe e kërrusur, me fytyrën zhubra-zhubra. Prindërit e Stalinit, edhe pse pa asnjë të ardhur, fillimisht hezituan, por nuk mundën t’ia kthenin fjalën. Edhe Stalinit i pëlqeu shtëpia e re, Gania dhe shoqëria me Gëzimin.

Gropa e madhe që u hap në oborr nga bomba u mbyll, ndërsa gropa e hapur në zemrën e Ganos së gjorë qëndroi edhe 32 vjet e hapur. Sa herë gjente kohë, sidomos të dielave paradite, ajo e

ndalte vrapin te varrezat e qytetit. Zëri i saj si një drithërimë ngjitej në qiell. Thoshin që e kishte lënë mendja, por, edhe pse ditë për ditë i mbushte dhomat me lot, ajo kishte një shpresë se fëmijët e saj diku jetonin. Në një vend që e dinte vetëm Zoti. Si ishte ai vend? A binte shi? A frynte erë? A kujdesej kush për fëmijët e saj? Unë që e njihja nga afër kam menduar që jetën e saj, edhe pse shumë të trishtuar, ajo ka pasur arsye ta jetojë, sidomos pas birësimit të Stalinit. “Fëmijë është, se vap bëj...E bëra këtë gjë që edhe Zoti kujdeset për fëmijët e mi”. thoshte ajo.

* * *

Ditën e Bajramit të Madh nëna ime më dërgoi te Ganoja për t’i çuar një kile mish. Në ato vite, edhe ne, si gjithë bota, ishim keq ekonomikisht. Kalova oborrin e saj dhe u futa në korridor. Nënë Ganoja ishte ulur në gjuhë në mes të kuzhinës, me kurriz nga dera. Nga pëshpëritjet e saj kuptova që ajo po bisedonte në intimitet me vetë Zotin. Fjalët e saj, më tepër se një pendesë, ishin një lutje e gjatë me ca fjalë të thjeshta që të këputnin shpirtin. “Zot!O Zot i madh! Ti që na sheh çfarë bëjmë e ti që dëgjon çfarë themi, ti që na shpërblen nëse veprojmë mirë e ti që na ndëshkon nëse nuk të bindemi, askush veç teje, në tokë e në qiell, nuk e di të fshehtë e fëmijëve të mi. Të lutem o Zot, më fal nëse të shqetësoj përsëri... Por syri më pikon lot dhe zemra më çahet nga dhembja, sa herë kujtoj që pëllumbthat e mi s’i kam pranë. Janë të vegjël e pa njeri... O zot o madh! O zot i madh dhe i vërtetë... Hidhu një sy e shikoi si janë... E ku janë...Se vet m’i more. Po s’them gjë unë, e varfra. Ti i di punët e tua... Ti na ke Jaredis. Dhe ta dish ti o Zot, se që nga ajo ditë sterrë më është bërë kjo jetë. Po ç’të bëj?”

“Nënë Gano!- i thirra zë ulët. Nuk duhet të më kishte dëgjuar, pasi nuk e ndërpreu rrëfimin.

“Mbase do e kesh marrë vesh, - i fliste ajo Zotit, duke iu lutur, - Stalinin e mora dhe e bëra fëmijë për shpirt, që edhe ti të kujdesesh pak për Dallëndyshen, për Luton dhe Isanë...U korba...! Harrova Dritanin e nënës...”

Nënë Gano! - thirra unë me zë të lartë. Ktheu kokën qetësisht.

“Më dërgoi nëna, -i thashë duke i treguar napën që mbaja në dorë.

- Të solla pak mish për Bajram..”

-I kujt je ti?- më pyeti

-I Vahidesë.- i thashë

-Ua! Ua! - u kujtua dhe i ndritën sytë. Më kapi për mënge dhe nuk më la të ikja. Hapi dollapin dhe u ndje shumë keq kur pa ia kishin përllarë kamelet.

Qysh prej humbjes së fëmijëve të saj ajo jetonte me ndjesinë që ata jetonin diku. Nisur nga kjo ide ajo ndiente shumë nevojën e

pranisë së Zotit, edhe pse nuk e kishte fort të qartë çfarë ishte ky Zot. Zoti kishte zbritur në tokë ta dëgjonte: Zoti i ajrit dhe i zjarrit, Zoti i tokës dhe i ujërave, Zoti i njerëzve dhe i gjallesave, Zoti i shpirtave dhe i gjithçkaje të zjarrtë që vërtitej në qiej..

* * *

Në mbrëmjet karakteristike sarandjote, kur qytetarët shëtisnin ndanë detit, midis tyre vërtitej edhe nënë Ganua duke ndjekur pas Gëzon dhe Stalinit: “Gëzo! Staliin...!” thërriste me zë të lartë, pa u shqetësuar prej kalimtarëve që e ndiqnin me kureshtje. Nuk shihte ku e hidhte këmbën, e merakosur për fëmijët e vet që vraponin të gëzuar duke ndjekur njëri-tjetrin, si dy qenushë kur dalin në liri. Staliin...!(një emër që e bënte të gajasej gjithë qytetin) Kishte frikë për pëllumbthat e saj, bardh e zi, mos i rrëshqitnin nga bordura e shëtitores dhe i binin në det. Çitjanet e bardha i fryheshin si kacakë .Ajo vet dukej si një cung druri tek i cili ishin lidhur dy balona dyngjyrësh. Mbrëmjeve në shëtitore dëgjohej vetëm zëri i saj: “Gëzo...Mos shko nga deti!...Stalin! Më lodhe...! Qytetarët e Sarandës e dëgjonin qetësisht këtë refren çdo mbrëmje, gjersa një ditë Gëzimi mbaroi klasën e dytë fillore dhe Stalini u fut në klasë të parë. Të dhënë pas mësimëve dy vëllezërit bardh e zi nuk kishin më kohë të dilnin anës detit. Qysh në muajin e parë të shkollës Stalinit ia ndërruan emrin dhe e quajtën Nini. Kur u rrit dhe ca ai u bë një fëmijë i shëndetshëm, gjithmonë i qeshur, i shoqërueshëm me shokët dhe mësuesit, veçanërisht me nënën e vet, Gano zezën e cila i rriste dy fëmijët e saj me një pension të vogël dhe me pak para shtesë që merrte nga pensioni i të shoqit të saj, Novruzit, që i kishte vdekur në një aksident pune..

* * *

Vitet fluturonin. Mes gëzimeve dhe halleve plaka çame një ditë përcolli Gëzimin ushtar, dy vjet më vonë Nini mbaroi gjimnazin dhe u fut në punë, furnitor në fabrikën e pastave, që i kishte zyrat pranë shtëpisë. Me vajzën e madhe që kishte tre vjet pa parë, merrej vesh vetëm me letra. Në vitin e tretë të ushtrisë. Gëzimi u njoh me një vajzë shkodrane, simpatike, të sjellshme dhe të edukuar. E quanin Gjylsana Lohja. Lohajt njiheshin në të gjithë Shkodrën për veprime bamirëse. Nëna e Gjylsanës shkonte çdo të shtunë te porta e shtëpisë vorfënore dhe merrte një ose dy syresh për t'i kaluar fundjavat së bashku me fëmijët e vet. Gëzimit i pëlqeu jo vetëm Gjylsana, por dhe kjo familje e madhe, pas mbarimit të ushtrisë ai nuk u më kthye në Sarandë, gjeti një punë

me pagë të mirë në mirëmbajtjen e linjave telefonike, në qytetin e Shkodrës. Nënë Ganua u pikëllua pa masë. pas kësaj gjithë dashurinë e saj e hodhi mbi Ninin. Diçka e pabesueshme, por e vërtetë. Në moshën tetëmbëdhjetë vjeç Nini u bë një bulldog i lezetshëm, tetëdhjetë e dy kilësh, faqe petull, gjithmonë i qeshur, i papërtuar në punë...Ai ia mbushte jetën me gëzim nënë Ganos, por atë, sa më tepër kalonin vitet, aq më tepër e merrte malli për tre fëmijët. “I deshi Zoti”, ngushëllonte veten, “ndryshe përse të m’i merrte?”. Vit pas viti, varrezat e qytetit mbusheshin me të ikurit e kësaj bote, vetëm nënë Ganon nuk po e lajmëronte xhebrail Emiri për t’u bërë gati për në rrugën e madhe. Ajo vazhdonte të shkonte çdo të diel në mëngjes në varreza. Një mëngjes nëna ime e kishte parë tek qante e lebetitej mbi varrin e tjetërkujt.

“Ganon e ka lënë mendja fare, -tha nëna kur u kthye në shtëpi. - Ishte ulur në gju dhe qante me ligje mbi varrin e hallës sime”.

* * *

Sa më shumë ulej në gjuhë dhe i lutej Zotit, aq më shumë i zgjatej jeta plakës së gjorë. Zoti i dëgjonte lutjet e saj, por zëri i saj përzihej me zërat e miliona dhe miliarda njerëzve të kësaj bote. Ndryshe s’ kishte se si... A mos vallë Zoti ynë, nuk e kuptonte të folurën e saj çamërishte me “kl” dhe “gl”?

Heshtjen e tij e arsyetonte me gjithfarë mënyrash. Ai ishte i zënë me punë të mëdha e s’i shkonte mendja për hallin e plakës së gjorë. Po sikur t’i kishte kthyer një përgjigje? Po sikur mendjelëna atë çast nuk e kishte pasur mendjen?

Nënë Ganua ishte rritur në një derë me besim fetar mysliman, sigurisht, nuk i ka njohur “Dhjetë urdhëresat e Biblës”. Ato edhe mua më ranë në dorë shumë vonë, kur nisa t’i lexoo, mëu kujtua nënë Ganua, e cila, edhe pse nuk kishte haber nga dhjetë urdhëresat e librit të shenjtë, prej tyre kishte zbatuar dy më të rëndësishmet: e para “të duash Zotin” dhe “të duash njeriun”.

Ndaj dhe Zoti ia zgjati jetën.

”Asgjë njerëzore nuk është e pafund, gjithçka është një hiç, dhe dhembja jonë është brenda këtij hiçi”.

* * *

Nënë Ganua jetoj edhe 32 vjet të tjerë, një jetë si një ëndërr, një jetë pa kujtesë. Vdiq ditët e para të majit të vitit 1975, një muaj para dasmës së Ninit, i fejuar një vit më parë me një vajzë të bukur të racës së vet. Në varreza e përcollën Nini me të fejuarën e tij, kryeplaku i lagjes, disa kushërinj të largët që i erdhën posaçërisht

nga Markati, komshinjtë e saj, njerëzit e familjes natyrale të Ninit dhe nëna ime.

“Ishte e lodhur shumë e varfra, nuk kishte ç’të bënte më në këtë jetë”, - tha nëna kur u kthye nga varrezat. Fëmijët e saj kishin kohë që e prisnin në botën tjetër. Dy muaj para se të vdiste i kishte dalë nëna në ëndërr. I kishte hyrë te dera duke i folur me zë urdhërues: “Kam ardhur të të marr.” “Mirë do të bësh, - i kishte thënë ajo.- Ka shumë kohë që e pres këtë ditë... S’kam ç’të bëj më në këtë jetë?”

Njeriu te kthesa

E shikoja gjithmonë në të njëjtin vend, në mëngjes kur nisesha në punë dhe mbas dite kur kthehesha nga puna. Qëndronte indiferent, te kthesa e rrugës që të çonte për në ndërmarrjen time, i ulur mbi një gur, me duart e mbështetura si gjithmonë mbi gjunjë, me një pamje të qetë . Në pamje të parë të dukej një njeri i ngeshëm e i papunë, që e kalonte kohën duke te kthesa e rrugës duke vërejtur kalimtarët e rastit...Ose thjesht, për të kaluar kohën. E vëreja me kujdes. Nga qëndrimi i shpenguar dhe shprehja e fytyrës, s'të jepte përshtypjen e një lypësi dhe as të njeriu të rëndomtë.

Shpesh herë zhdukej me ditë të tëra, atëherë unë shqetësohesha për të, ashtu kot, si për një njeri me të cilin të është mësuar syri ta shohësh në të njëjtin vend. Kushedi si e ka hallin, thashë .Pas ca dite kishte dalë sërish në të njëjtin vend...I njëjti qëndrim, e njëjta pamje... Pinte cigare si një njeri i qetë dhe pa andralla. Dukej sikur priste Godonë. E përshëndeta. Më ktheu një përshëndetje indiferente. Atë ditë kishte ndodhur diçka; dhëndëri me të cilin atë ditë punonim në saldimin e një makinerie, bëri një gabim fatal që desh i kushtoi jetën. Preku me dorë telin e korrentit. Falë kujdesit tim, u dogj vetëm saldatriçeja. Kur kalova pranë tij nxora nga xhepi një dyqind lekëshe dhe ia zgjata para.- Pse po ma jep?- pyeti me indiferencë. -E kam si zakon, - i thashë. Kur më ndodh gjë fal diçka.

Nuk u bë kureshtar të dinte çfarë më kishte ndodhur, dyqind lekshin e mori pa ndonjë kënaqësi të veçantë pa thënë as faleminderit. I dhashë dorën dhe u largova me biçikletë.

Ditët e tjera nuk e pashë më. "Çfarë t'i kishte ndodhur?

Një mbas ditë u nisa për në varreza te varri i tim ati, isha tepër i lodhur, në një çast, m'u duk se më kaloi para meje njeriu që priste Godonë. Nxitova ta arrij. Çuditërisht m'u zhduk. Nuk e kuptova si ... Më humbi nga sytë apo ishte thjesht një vegim ?

Vëreja gjithandej, në afërsi dhe në largësi...Sigurisht, do të ketë qenë një vegim?- thashë me vete. I lodhur nga puna...Rruga para meje ishte e shkretë. Përveç dy grave të moshuara të cilat ecnin qetësisht dhe njëtrajtësisht.

Kaloi disa kohë që njeriu e kthesës nuk e pashë .Cilin të pyesja? Emrin nuk ia dija. Përse nuk dilte më te kthesa? Një natë e pashë në ëndërr."Isha duke shkuar në punë, si zakonisht, me biçikletë. Ishte një mëngjes i jashtë zakontë, me një diell të bukur, çuditërisht të shndritshëm, dhe unë isha çuditërisht i lumtur.Dikush më thirri në emër: "Besho! O Besho!...Ndala biçikletën dhe konstatova me gëzim se qenkishte njeriu i kthesës. Erdhi drejt meje duke vrapuar. Ishte veshur thjeshtë dhe bukur, i ishte shterur nga fytyra ajo çehrja e kotësisë. "-A e di pse të thirra, -më tha. Nxorri nga xhepi një dyqind lekëshe letër,

të pazhubrvitur, dhe ma zgjati para. Unë refuzova t'ia merrja,"Nuk t'i dhashë për të m'i kthyer "- i thashë. -E di, e di.- tha ai. -Ishin pikërisht ato lekët e tua që më dhanë fat. Kam gjetur punë." "Vërtet? Po ku?"-A ju kujtohet? Qysh atë ditë që ju më dhatë ato lekët , unë gjeta punë. – tha ai. -Duhet të m'i kini dhënë me gjithë shpirt. Çdo gjë që bëhet me shpirt sjell fat? "S'të kam parë më të dalësh te kthesa.- i thashë unë, për të vazhduar bisedën. "Nuk jam në Tokë, -tha ai...Ishte një përgjigje që do të çudiste çdo njeri të arsyeshëm. Ai e kuptoi habinë time dhe vijoi -Duhet shumë kohë për të ta sqaruar këtë gjë.- vijo i ai. E unë kam marrë leje vetëm për dy ditë A të kujtohet...? Atë ditë që u ndamë së bashku, sa ike ti kaloi një veturë me shpejtësi pranë këmbëve të mia dhe më mori me vete. A e di ku jam tani?... Ku?- e pyeta unë duke e parë me dyshim.

-Punoj në një zdrukthari. Prodhojmë lodra druri, për fëmijë. Pse çuditësh? Të duket punë kotë, hë!/? E ke gabim. Është një punë që të jep kënaqësi. Të shkon mendja të dish pse të thirra? -Jo- iu përgjigja. Lejen e mora për të mbyllur ca punë të lënë përgjysmë, njëra prej tyre është kthimi borxhit që të kam ty. -Mua? dyqind lekëshi që të dhashë nuk ishte borxh, -i thashë, për t'u larguar sa më parë nga ky njeri misterioz.,- ishte kënaqësia ime. Ti e di pse e bëra...-E di, e di. -tha ai. Duke më futur dyqind lekët në xhep. Dukej tepër i gëzuar ...dhe pak i përmalluar. Në ndarje më thirri sërish:" Harrova të të them më të radhe diçka...Babanë e ke mirë... Punojmë së bashku në prodhimin e atyre lodrave që të thashë. Më porositi të të bëj të fala."

Kur hapeshin Portat e Qiellit

*Nëse ti do njohësh ligjet e qiellit, ligjet e
Zotit me qartësinë e mendjes, përqendrohu
në qiell, aty ku yjet lidhen me një paqe kozmike.*

Boeti (524)

Ajo ishte një natë e pazakontë. Ne fëmijët kërkuam nga gjyshja të flinim në lëmin mbi shtëpi, te ai shtrati thurur me thupra, njëra anë rëndonte mbi degën e qershisë, tjetra mbi grumbullin e druve. Shtrati ishte primitiv, me dyshek kashte. Gjatë muajve të verës aty flinte vetëm gjyshi për të ruajtur arën me misër, nga derrat e egër. Pritëm e pritëm me sytë në yje. Të lodhur nga lojërat e ditësh, askush nuk rezistoi dot për ta parë atë çast magjik. Në mëngjes pyesnim njëri-tjetrin, kush i kishte parë portat e qiellit.

Të katër fëmijët e Bezhanajve, përfshi dhe mua, kishim bërë gjumë qengji, në pritje të një mëngjesi që po vonohej. Kur e kuptuam se asnjëri nga ne nuk kishte qëndruar dot zgjuar, nuk e di pse na hipi dëshira të gënjenim njëri-tjetrin.

Besoja hodhi një mufkë të padëgjuar kurrë, kinse vetëm ai i kishte parë Portat e Qiellit.

-Çfarë pe?- e pyeta unë

-Pashë një njeri me mjekër të bardhë... shumë të gjatë... si babaxhan, që u shfaq papritur në qiell...

-Edhe unë i pashë!- thirri Lani. Ku duronte dot ai t'i dilte njeri para? Nisi të dërdëllisë edhe ai gjëra pa kuptim dhe pa asnjë lidhje.

- Unë pashë... ..në fillim unë pashë një qiell me yje, pa mbarim, pastaj yje...Prapë yje...Yje pa mbarim...

- Po pastaj? - e ngacmova unë për ta ngecur. Budallallëqet e tij s'kishin mbarim. Ai nisi të fliste shpejt, sikur shpejtësia do t'i vinte në ndihmë për t'u bërë më i besueshëm.

- Pastaj pashë një tigër..., -thirri me zë të lartë si të kishte zbuluar diçka, - Një tigër të kaltër....

- Si i kishte sytë? - e pyeti Besoja për ta çorientuar.

- Sytë? Sytë i kishte të zjarrtë...

-Po krifën?

-Krifën e kishte, e kishte...Nisi të picërronte sytë me kokën ngritur lart, sikur kërkonte t'i kujtohej ngjyra.

- E mjaft, se na gajase,- ia preu në mes fantazinë Arzikoja, motra madhe e Besos.

Ndërkohë edhe ajo nisi të fantazojë për qejf të vet:

- Unë pashë një re të madhe, një re e cila fillimisht ishte e trëndafiltë, më pas u nxi, më pas u shndërrua në një shtëllungë të zezë, sa nxu gjithë qiellin...

Kur më erdhi radha mua, unë sajova një variant më të besueshëm, tregova që kisha parë ca porta të larta, të larta...por vetëm për një çast...

- Fytyrë njeriu, të them të drejtën nuk pashë, - u thashë. Me këtë të fundit mendova se do të bëhesha më i besueshëm dhe më realist. Prita të më kundërshtonin, por askush nuk foli. Qysh në atë çast të jetës sime kuptova se unë duhet të kisha aftësi për trillime të besueshme, pasi trillimi nuk ka asnjë kuptim nëse nuk është dhe i besueshëm.

Bisedat vinin nga vinin, mendja na mbetej te Portat e Qiellit. Shkuam dhe pyetëm gjyshen. Mos vallë i kishte parë ajo?

- Mbrëmë nuk u hapën. - u shfajësua ajo.-Po ju mos u shqetësoni. Sigurisht do të hapen sonte. Orën s'jua them dot. (dukej ashiqare që edhe gjyshja ia fuste kot)

Në ato vite ne jetonim me frikën e xhindeve që vërtiteshin jashtë shtëpisë sonë, por Portat e Qiellit ishin ndryshe, atë na e kishin nxitur shumë kureshtjen...

* * *

Dhe nata tjetër na kaloi me sy në yje. Unë për asnjë çast nuk e ndava shikimin nga qielli. Humba në blunë e pafund. Më trembte largësia e yjeve..Çfarë kishte pas yjeve...? Përsëri yje...Po pas yjeve të tjerë? Përsëri yje...Pati një çast që m'u duk vërtet sikur i pashë diçka të pazakontë, sikur ajo porta që prisnim të hapej, në një të dhjetën e sekondës u hap dhe u mbyll....Kjo gjë m'u duk se ndodhi ka shpejt dhe në mënyrë të beftë sa që nuk pata kohë të kuptoja në kisha parë vërtet diçka apo ishte një sajim i trurit tim. Gjithmonë e kam menduar atë çast : I pashë të hapen portat vërtet apo ishte një iluzion i çastit? Këtë enigmë as sot e kësaj dite nuk e kam sqaruar dot. Nëse do të kishte ndodhur kjo gjë atëherë unë duhet të isha njeriu i vetëm në këtë botë që Zoti kishte vendosur t'ia plotësonte dëshirën, duke i shfaqur para syve, vetëm për një çast, atë që njerëzimi s'kishte mundur ta shihte as në ëndërr.

-Kush numëron gjer në njëqind yje... - tha Arzikoja.

Unë! –thirrëm të tre njëzëri.

U vumë në garë. E provuam disa herë, por unë nuk shkëlqeva. Hutohesha nga largësia e yjeve. Në ato çaste veten e ndieja si një pupël zogu që vërtitet në ajër. Unë i vogël, i vogël, yjet të mëdhenj, qielli i madh,i madh. I madh dhe të pafund.

Një hënë e madhe dhe e bardhë lundronte në qiell, e shoqëruar nga një yll i vogël. Lëvizte hëna, lëvizte dhe ylli, si roja e saj.

75... 76...77 ... numëronte Besoja për të përzënë gjumin.

79... 80...81... e ngrinte zërin Lani mbi të tjerët. Zëri i Arzikos ishte i hollë dhe i tingullt. Për një çast pllakosi qetësia.

- Po fle...? –Jo, -tha Besoja në gjysmë dremmitje.

- As unë,- tha Lani.

Nuk e mbaj mend mirë kur na zuri gjumi dhe kush fjeti i fundit.. Kur hapa sytë dhe pashë përreth, vura re me trishtim që në krevatin e thurur me thupra kisha mbetur vetëm unë.

E humba shansin, mendova me keqardhje, por isha i sigurt që askush nga kushërinjtë e tjerë nuk e kishte parë hapjen e portave të qiellit.

* * *

Në mëngjesin tjetër sa u takuam nisi përsëri avazi i vjetër.

-Unë i pashë, - tha Besoja.

- Edhe unë, - ia futi mufkës Lani, si zakonisht. Po kush e besoi.. Kur unë i thashë Besos të bënte be “Për kokë të nënës!” ai e mbylli squpin. Ashtu siç ishim, shkuam te gjyshja për ta akuzuar dhe atë si mashtruese.

- Do të kem ngatërruar përsëri datën, - u justifikua ajo...- Mos ma vini re se edhe mendja më ka lënë... Zotit nuk i kërkojmë dot llogari, ai i di vetë punët e tij. Nëse do t’i hapë, i hap. Nëse nuk do t’i hapë, nuk i hap! Unë di t’ju them vetëm kaq, sipas Kur’anit Portat e Qiellit hapen në datat tre-katër- pesë gusht të çdo viti. Katër gushti kishte kaluar, mund ta provonim edhe njëherë. Punë e ngatërruar. Hajt të qëndroje dhe një natë tjetër zgjuar...Zgjidhjen për mua e bëri fare thjesht nëna. Hyri me nxitim në oborr kur ne ishin duke luajtur kukafshehthi duke më kërkuar mua. Unë isha fshehur pas trungut të ullirit. Ajo më gjeti dhe më kapi për veshi:

- Kështu i dëgjon këshillat e mia? Të dhashë leje vetëm për një natë , ke tri ditë e tri net që nuk mblidhesh në shtëpi. S’ta ka qejfin njeri të të mbajë me bukë.

Ajo mërzitej shumë që unë nuk shqitesha nga shtëpia e gjyshërve. Unë atëherë nuk e kuptoja arsyen. Ajo nuk donte që në atë shtëpi të varfër e me shumë fëmijë të bëhesha barrë edhe unë.

Atë ditë ajo bëri llafe dhe me gjyshen:

- Mos e përkëdhel, përzëre!- i tha në formën urdhërore.- Pak halle keni. Do të mbani me bukë dhe bizdrëngun tim?

Më mbërtheu prej dore dhe më tërhoqi zvarrë. Turivarur shkova pas saj duke mallkuar fatin tim të keq që kisha ardhur në jetë nga një nënë autoritare dhe e pashpirt. Në të vërtetë fjalët e saj përputheshin me shikimin e sikletosur të gjyshes, sa herë që ajo do të na mblidhte para sufranit bosh.

Megjithatë, nëse ka një çast në jetën time që unë e kam ndier veten të lumturuar dhe të sigurt, kanë qenë pikërisht ato çaste varfërie në shtëpinë e gjyshit: Katër lugë të uritura në duart e katër fëmijëve, të ulur fisnikërisht para një kuvshi të drunjtë me përshesh... në

gjunjë, sikur t'i faleshin atij mëngjesi varfanjak, bekuar nga sytë e qeshur të gjyshes që na qëndronte mbi krye si një engjëll mbrojtës. Atë natë në shtëpinë time unë iu luta mamasë të flija pranë dritares. Gjatë gjithë natës qëndrova si kukudh, nën dritare me sytë drejt qiellit. "Diku, në ndonjë yll, duhet të jetojnë njerëz, mendoja, diku në ndonjë yll sigurisht jetojnë të vdekurit... E cili prej nesh, në një natë të qeruar gushti si kjo, qoftë dhe njëherë në jetën e tij, nuk ka qëndruar me sytë drejt qiellit?"

* * *

Jo vetëm atë natë, por edhe disa net të tjera unë qëndrova në dritare, me sytë nga yjet, gjersa erdhi një ditë që u mërzita me kokën lart dhe e harrova fare dëshirën për të parë portat e qiellit. Ndoshta, në ato net yjore unë, sigurisht, duhet të kem parë dhe duhet të kem kuptuar diçka. Edhe nëse nuk kam parë e nuk kam kuptuar çka fshihet pas asaj që s' shihet dot me sy, kam përjetuar ato net të ëmbla gushti, të mbështjella me vellon e ndritur të yjeve. Kam parë netët e zjarrta të gushtit, që s'kam mundur t'i harroj kurrë.

P. S. Natën e dhjetë gushtit astronautët e kanë quajtur; "Nata e meteorëve". Gjatë rrotullimin të vet, toka futet në një zonë ku çdo kureshtar mund të shikojë rënien e meteorëve. Një spektakël qiellor i jashtëzakonshëm. Në vegjëlinë e saj gjyshja kishte përgjuar rënien e yjeve. Ku ta gjej tani atë gjyshe të dashur, jo vetëm pse më ka marrë malli, por edhe për treguar të vërtetën e atyre portave qiellore.

Mevlani

Ka njerëz që ikin nga kjo jetë pa u ndier, pa lënë gjurmë, pa lënë miq e pasardhës e pa bërë ndonjë gjë për t'u kujtuar. Por, njerëzit si Mevlani vijnë rrallë në jetë. Prindërit e kishin lënë jetim qysh në moshë të vogël, atë dhe motrën e tij, Merxhanen, e cila ishte martuar, me djalin e madh të hallës sime. Mevlani mbeti i vetëm në hauret e vjetra të Goxhajve, as mungesa e motrës dhe as skamja e madhe nuk i shtuan asnjë brengë dhe nuk ia hoqën dot atë ndriçim fëmijëror. Kur mbërriti në moshën që duhej të vinte brisk në faqe e kuptuan të gjithë që s'do të bëhej burrë...Më tepër u shqetësua Merxhania, me që tani e tutje dera e tyre quhej e mbyllur.

Mevlani këto gjëra s' i shkonte ndërmend; ai sfidonte fshatarët e tjerë me atë entuziazmin e tij të veçantë. Ecte rrugëve të fshatit krenar, nuk e di nga i buronte gjithë ai ngazëllim?...ndonëse e dinim të gjithë që "prej mëshirës së të pamëshirshmëve" gjallonte. Për të kujdeseshin burra dhe gra, pleq dhe fëmijë. Sa herë do të therej ndonjë gjë e gjallë, hoxha i fshatit merakosej më kot: "I çuat gjë Mevlanit?" Për të kujdeseshin të gjitha gratë e fshatit, njëra i çonte ushqime, tjetra një palë pantallona, një tjetër këmishë, sikur ishin vënë në garë, kush e kush t'i përkushtohej më shumë këtij njeriu pa njeri.

Por edhe ai bënte shumë për ato. Shkonte me gratë për të bërë dru në Korita. Priste dru,i ndihmonte të ngarkoheshin , i shoqëronte monopateve ... Ngrihej herët për të nxjerrë dhinë në kullotë, thurte gardhet e nomeve , rregullonte ledhet dhe varret, u siguronte hejë dhive, ndreqte muret e rrëzuara,ose, më e madhja, shkonte ca ditë me dhi në mal , për të zëvendësuar ndonjë çoban .

"Mevlan!- Shko na mblidh ca hejë.

-Faleminderit!-përgjigjej ai.

Pse thua faleminderit?

-Qysh të mos e them. Ju më mbani me bukë.

Ne ishim tre fëmijë. Ndodhte që mushka jonë grivë të mos kthehej në mbrëmje. Nëna ime dilte në prag të derës duke zvargur zërin e hollë: :Me vlaaan! O Me vlaaan!"

Kur ta shikoje, Mevlanin si lugat te porta.

-Do shkosh të na gjesh mushkën .Hë të keqen! -Shkoj u... Posi. - Burrërohej Mevlani.- E gjen o në Shesheza, ose në Bërdë...

-Ku e dërgon djalin natën? -e qortonte nënën halla.

-Pusho ti, ia kthente nëna.-Vetëm Mevlani mund ta gjejë...

Nënës sime nuk ia prishte kurrë. Merrte fenerin dhe nisej . Pas dy-tre orësh dëgjohej zëri i hollë i Mevlanit:"Merreni, ua solla, ...e gjeta në Gomareza..." Shpërblimi i jepej në natyrë. Nëna ime herë do t'i jepte ndonjë kapotë të babait e herë ushqime, si, miell, vaj ulliri, djathë të njomë, vargje me fiq e çdo gjë tjetër që tjetër që na gjendej në shtëpi. Shpesh herë i lutej të ulej në sofër me ne.

"Jo.Jo se kam ngrënë, kam ngrënë..."- thoshte ai dhe ikte i frikësuar mos e ulnin të hante me zor. Nëna ime ia njihte mirë huqet."E di që ke ngrënë , i thoshte, dy të ngrëna nuk të bëjnë gjë."Kur arsyetime të tilla nuk e bindnin ,ajo bënte sikur i lutej: "Epo ulu,de, e bëj sikur ha...(i afrohej te veshi dhe i thoshte me zë të ulët) Ulu... se nuk më hanë fëmijët pa ty."

-Aa, po qe kështu, po. -Lozte heroin ai duke më thënë mua:

-Haje se ta hëngra! Nëna bënte lojë të dyfishtë. Më thoshte në vesh "Bëj sikur ha që të hajë dhe Mevlani."-Nuk më hahet! Bërtisja unë.

-Fute lugën në gojë!- bërtiste Mevlani, pa e kuptuar pse gajaseshim me të madhe. Jo vetëm nëna por dhe gratë e tjera të fshatit e mbanin për drekë o për darkë dhe e përcillnin me çarë të kishin në ato shtëpitë e tyre.

-Mevlan, nesër do të shkojmë në Galisht.-i thoshte halla.-Do të korrim grurin, pastaj do ta shijmë... do të rrimë atje disa ditë, sa ta ngarkojmë në mushka e ta zbresim poshtë. Me një fjalë, do të kemi shumë punë.-Peqe!-përgjigjej Mevlani.

Ditët tona më të bukura kanë qenë ato kur flinim në mal. Mevlani kornte grurë së bashku me gratë si një kafshë e gëzuar. Bëhej ujë në djersë. E shikoja tek rrëzonte përtokë kallëzat e grurit me një të goditur dhe nuk e kuptoja nga i buronte gjithë ajo energji dhe gjithë ai gëzim pune? Ndjente kënaqësinë e punës apo punonte për t'u hyrë në zëmër grave?

Kënaqësia më e madhe për ne fëmijët ishte çasti magjik, kur ndizeshin yjet e qielli dukej një saç i kaltër. Flinim së bashku, në një shtrat me thupra, ngritur mbi degët e një lisi të moçëm. Jorgan kishim një çadër ushtrie , mbeturinë e luftës Italo- Greke. Mevlani flinte së bashku me ne. Futeshim në garë , kush të gjente më shumë yje, në këtë garë ai ishte më i dobëti.

-Kush do të na tregojë një përrallë? Na drejtohej gjithë gëzim. Sa herë dëgjonte përralla qeshte me zë të lartë, si një fëmijë i lumtur, edhe në se ia përsërisje çdo natë të njëjtën përrallë ai do ta dëgjonte si për herë të parë. Sa mbaronte së treguari përralla e parë kërkonte një të dytë, një të tretë...

Ndërsa ne rriteshim ai sikur mbetej në vend. Atëherë unë nuk e kuptoja dot arsyen, pse ky njeri i shkurtër, i fuqishëm e shpatullgjerë , kishte mbetur përjetësisht në moshën dhjetë vjeçare?! Këtë gjë unë do ta kuptoja pas shumë vjetëve, kur të kthehesha përsëri në fshat dhe ta takoja me aq shumë mall e nostalgji mikun tonë të fëmijërisë. Më njohu, ndonëse nuk u tregua aq i përmallur, u gëzova që pas kaq kohësh më mbante mend emrin.

-Ika, më tha, hodhi çantën e postierit në krah dhe çau tutje .Kishte mbetur po ai Mevlani i dikurshëm, i sëmuri entuziast.

- Aa, Mevlanin e kemi postierin tonë shembullor, -tha kryetari i këshillit të komunës.-Eshhtë i papërtuar, u bie fshatrave pash më pash, s'e dëgjon kurrë të thotë "u lodha".

Kryetari i komunës ishte një njëri i ardhur, nuk dinte asgjë për Mevlanin. I kishin thënë : "Postier më të përshtatshëm se Mevlani nuk gjen". "Lajmërojeni të fillojë punë ."Lajmin për fillimin e një detyre shtetërore e priti me gëzim. Pranë zyrave të komunës i caktuan një dhomë për të banuar, një magazinë e mbetur pas prishjes së kooperativës së bashkuar, poshtë zyrave të kryesisë.

I gatshëm dhe i papërtuar, merrte letrat dhe gazetat në postë dhe nisej fluturim për në Fterë, zbriste lumit dhe ngjitej me një frymë në Çoraj, si mbaronte punë në Çoraj, i binte shpatit e shpatit të malit , zbriste në ngushticën e lumit, nën kalanë e lashtë të Sopotit , për të mbërritur në Qeparo. Mbrëmja e zinte në Borsh. Dimër e verë, në shi e në erë, në ditë të nxehta dhe në ditë me dëborë, bënte të njëjtën rrugë.

Kohët e fundit sikur kishin ndryshuar njerëzit, dukeshin më të ngutur në punët e tyre dhe më të ftohtë me hallet e të tjerëve. Vetëm me Mevlanin ruhej i njëjti qëndrim miqësor dhe familjar. Kur kalonte pranë disa shtëpive të vetmuara, midis fshatrave, do të dilnin gratë:"Mevlan, të keqen! Me që shkon në Çoraj merrma dhe këtë trastë me patate, ta shpiesh te Nestor Kopali. -E di, e di, thoshte ai. Çantës së postierit i shtohet dhe trasta me patate.

-Mevlan, të keqen! Me që shkon në Fterë, duku nga Bezhanajt , se do të japin një thes me qepë ...

-Peqe! Thoshte ai. Një fjalë e huaj që ende s'e di ç'do të thotë.

* * *

Erdhi koha e lëvizjeve demokratike. Djemtë e fshatit kishin marrë rrugët e kurbetit, kështu, iu shtua puna. Edhe pse këmbët nuk e kishin më atë gjallërinë e dikurshme e trupi kishte nisur t'i tretej ai bënte çdo ditë të njëjtën rrugë, i ngarkuar me porosi, me gazeta, letra e ngarkesa të rastit. Nganjëherë çonte dhe para...

Ndjente një kënaqësi të madhe që tashmë ai ishte një njeri me rëndësi i komunës. "Mevlan, do të shkosh urgjent për në.. ""Peqe!" thoshte ai, dhe fluturonte rrugëve si një njeri i rëndësishëm i pushtetit të ri demokratik. Dëgjonte ankesat e të tjerëve mërzhitej si fëmijë, madje u jepte edhe zëmër: "Do të bëhet edhe më mirë!"

Thoshin për të me shaka, se në ato votimet e para, kishte votuar gabimisht për P. D-në. "E kush votoi për P. D.-së ? Ja, vetëm Mevlani" Kur e pyesnin: "Për kë votove Mevlan" u përgjigjej: "Për kë më desh qejfi."

Mëngjeseve fluturonte monopateve për të dëgjuar cicërimat e gëzuara të zogjve që harliseshin nëpër degë ullinjsh. Kohët e fundit

kishte nisur dhe një avaz tjetër. Kishte qejf të këndonte, sidomos, kur mori përsipër të shpërndante lekët e emigrantëve që i dërgonin dorazi nga Greqia. Risku i takonte Mevlanit, për t'i shpërndarë nëpër fshatrat e tyre. E kishin këshilluar të kishte kujdes. Nga kush të kishte frikë? Mevlani, i njihte me gisht të gjithë njerëzit e këtyre fshatrave. Ai ishte njeriu- postë i komunës. Gratë e fshatit Krizë, gjithsej, katër shtëpi, sa dëgjonin zërin e Mevlanit dilnin në rrugë: "Do të kthehesh të hash diçka, Mevlan?"

-Jo. Jo. - u përgjigjej ai me seriozitet prej zyrtari të rëndësishëm.

-Atëherë, merri me vete. Kohët e fundit edhe ai kishte filluar të mos bënte shumë naze, kur i jepnin për të ngrënë.

Për Mevlanin qëndronin të hapura dyert e shtëpive midis fshatrave. Sa nuhasnin erën e Mevlanit edhe qentë e staneve pushonin së lehuri.

* * *

Lajmi i vrasjes së Mevlanit u përhap me shpejtësi. " Kanë vrarë Mevlanin! ...Kanë vrarë Mevlanin!...", "Kur? Po pse?..." Kujt i bëri dëm fakiri?! Askush nuk do ta besonte një lajm të tillë. Ishin mësuar me të si me njeriun e shtëpisë.

"Pra, fjalët që fliten se kanë filluar të lëvizin rrugëve njerëz të dyshimtë, nuk janë kot" -tha kryetari i Komunës.

Vrasësi nuk e kishte prekur fare çantën e postierit, i kishte shqepur vetëm astarin e xhakoventës. Ka pasur dijeni jo vetëm për paratë por edhe ku i mbante të fshehur. Sigurisht, vrasësi duhet të ishte një njeri i huaj." Kush do ta vriste Mevlanin? Veç ndonjë dorë e huaj, që e ngrëntë mortja, o zot!"

Më tepër nga të gjithë u prek kryetari i Komunës. Gjithë atë ditë nuk e mblodhi veten. Vuri në lëvizje drejtorinë e policisë së Sarandës, mori në telefon edhe komunat e tjera.

-Varrimin ia bëri Komuna. Një varrim madhështor që do të mbahet mend në historinë e atyre fshatrave .

U lajmëruan kryepërgjigjet e fshatrave të vinin në varrimin e tij. Atë ditë në Sarandë u porositën 15 kurora dhe u sollën në qendër të Borshit qysh atë mbrëmje.

Kurora të mëdha që u bëheshin vetëm udhëheqësve të shtetit, qarkuar me shirita të kuq e të shkruara me varak: "Për vëllanë tonë të dashur „Mevlan", "Për bashkëfshatarin tonë të shtrenjtë, Mevlan."..."Në kujtim të njeriut tonë të dashur dhe të paharruar, Mevlan..."

Një kurorë e veçantë ishte porositur nga kryetari Bashkisë së Sarandës. Zyra e funeralit të Sarandës mori përsipër që shpenzimet e varrimit t'ia bënte falas.

Në orët e para të mëngjesit sheshi para zyrave të Komunës ishte mbushur plot e përplot me të afërm të tij, të njohur e të panjohur, njerëz të shtetit dhe të ardhur nga fshatrat për rreth , nxënës të shkollave fillore dhe të shkollës bujqësore të Borshit. Një karvan tjetër zbriste rrugës së Fterës, çoriotët kishin preferuar të vinin nga lumi, për ta mbërritur orën e varrimit. Kishin ardhur nga Piqerasi e Sasai, nga Kudhësi e Qeparoi. Një autobus i kuq i zbriti të ardhurit larg qendrës së komunës, dy gra të veshura me të zeza nuk i mbanin dot lotët.

-Ç'bëhet kështu , mor jahu?! Ftera e gjithë ishte shkukur e kishte ardhur në Borsh. Veturat dhe furgonët kishin bllokuar rrugën nacionale. U dha urdhri t'i parkonin në rrugën e Fterës,ndërsa kafshët t'i zbrisnin nën rrugë.

Pas pak karvani i gjatë i funeralit u shndërrua në një lum të përmortshëm që rrëshqiste ngadalë në drejtim të varrezave. Arkivolin me trupin e tij e mbanin ca djem trupfortë.Një karvan i madh dhe i paparë në ato anë, lëvizte ngathët, si në një film pa zë. Në sytë e të gjithëve ndihej dëshpërimi.

-Ç'paska bërë ky njeri që e përcjellin kaq shumë njerëz ?!-Dhe udhëheqës të kishte qenë...-Udhëheqës ka qenë! –u dëgjua një zë mes turmës së kortezhit.- Tërë jetën rrugëve është ropat ...?!

Ceremonia mortore nisi me fjalimet e rastit dhe mbaroi me kurorat e vendosura mbi kopicën e dheut të shkrifët. Të gjitha fjalët që u thanë në atë ceremoni mortore nuk e mbanin dot peshën e madhe të dhimbjes për ikjen e një njeriu të thjeshtë.

Të tjerat janë heshtje. Të tjerat janë heshtje dhe për miliarderët e biznesmenët, dhe heronjtë e profetët, dhe për kryeministrat e presidentët... Të tjerat janë heshtje dhe për shkrimtarët dhe shkencëtarët, dhe për mua e ty, i dashur lexues.

Khaxhai

Jeta e njeriut zgjat sa një ide...

Khaxhai është në prag të vdekjes, tha nëna, e arrijmë a s'e arrijmë të gjallë. Pashë orën. Duhej dhe gjysmë ore të nisje autobusi i linjës. Vesha pallton e madhe dola me ngut në rrugë dhe u drejtova për nga agjencia.

Në familjen tonë ne e thërrisim të gjithë *khaxha*, edhe pse që i vogël e kisha marrë vesh që ishte vëllai i gjyshit, nga nëna.

E quanin Hivzi. Pas studimeve të larta teologjike, me nota shkëlqyeshëm kishte lënë Stambollin e madh dhe të zhurmshëm dhe ishte kthyer në fshat të punonte arat me parmendë. I kishte kapërcyer të tetëdhjetat. Jetonte moshën e atyre njerëzve të cilët për kushedi çfarë arsyesh i kishte harruar dhe vdekja. Në të vërtetë vdekja nuk e kishte harruar dhe as anashkaluar. Sa herë që i rastiste të kalonte pranë banesës së tij, në fshat, i bënte paralajmërime serioze. "Hoxhë Hivzi...Ç'kemi? ! Bën ç'të bësh dhe bëhu gati. Nuk i dihet kur vij herë tjetër."

E shoqja, Manua, i kishte vdekur para gjashtë vjetësh dhe e kishte lënë të vetmuar, si kërcu zjarri, në banesën e tij të fshehur midis pemëve, në atë fshat të rrethuar gjithandej me male. Hoxha Hivzi e varrosi të shoqen në një zallishte, pa ceremoni, në Ngurza, trekatër metra përmbi rrugën automobilistike. Pas vdekjes së saj ai mori një lopatë dhe një kazmë dhe pranë saj hapi edhe një gropë tjetër. Gropën e varrit të tij. Njerëzit që kishin mbetur në fshat, u habitën. Përse e bënte hoxha Hivzi këtë gjë? Të tjerët i përcillte me temena në varrezat e fshatit, ndërsa varrin e së shoqes dhe gropën e vet e hapte larg varreve, në një zallishte?

- E bën këtë gjë se i ka frikë krimbat, - kishte thënë një i afërmi ynë. - Duke e vendosur arkivolin brenda një zallishteje, krimbat nuk do ta preknin kufomën e tij pas vdekjes. Mund të vdiste i qetë. Kohët e fundit xha Hivziu kishte nisur edhe një avaz tjetër. Bënte punët përgjatë ditës, pa shkëmbyer asnjë fjalë me njeri duke pëshpëritur sure, të cilat i premtonin t'i sillnin njerëzit e tij të dashur në ëndrra. Ëndrrat e mëngjesit ishte mësuar t'i zbërthente pa ndonjë vështirësi. Po të shihte ndonjë nga miqtë e tij të vdekur që e thërriste në atë botë, të nesërmen u dërgonte telegram dy djemve dhe vajzës, "Ejani të më takoni. Exheli më ka trokitur te dera." Dy djemtë që jetonin në Tiranë dhe vajza që jetonte në Vlorë herën e parë u shqetësuan seriozisht. Morën një furgon të komunales, morën motrën në Vlorë dhe, në mbrëmje, pas 11 orësh rrugë, pa ndalur gjëkund, kur mbërritën në fshat e gjetën hoxhën duke mjelë dhinë në vath.

-Ja, erdhëm e të takuam baba, - i tha vajza, - Mirë bëmë që erdhëm. Por mendo dhe për ne... Tjetër herë kur të shohësh ëndrra me exhel nuk të vijnë më dot...

-Eja në Tiranë,- i tha djali i madh. Dhe për shëndetin tënd dhe për ne do të ishte më mirë. Mjekët i ke te koka.

Të nesërmen ata u nisën qysh herët. I lanë ushqime, para... (djali i dytë i la dhe pallton e tij, vajza i la një çantë me ndërresa të brendshme).Herën e dytë, pas lajmërimit “babai është rëndë”, erdhi vetëm vajza. E kishte marrë më seriozisht se herën e parë. U përplas te porta me ulërime... U qetësua kur e gjeti të shtrirë te dritarja. Kishte marrë një ftohme atë ditë që shkoi nga Ngurzat.

Ç’i duhej që ngrihej ditën me shi për të rregulluar varrin e Manos? Herën e tretë nuk erdhi asnjë telegram. Pati vetëm një fjalë të Hyseinit që kishte ardhur në Sarandë për një gjyq toke.. “ Ëhë...Hoxha këtë herë s’besoj ta kalojë.”-i kishte thënë babait. Nëna ime, si të gjitha nënat,më shumë u besonte ëndrrave të natës se atyre që shihte ditën me sy. U ngrit ën mëngjes e tronditur. Kishte parë një ëndërr sikur në shtëpinë e xhaxhait bëhej dasmë si e qëmotit: Me mishra të therura, këngë e valle. Dasma ishte e vajzës së xhaxhait, e asaj që banonte në Vlorë, e që ishte martuar njëzet e ca vjet të shkuara. Papritur, në mes të gjithë atij gëzimi, dasmorëve u kishte rënë çatia mbi kokë. “Shenjë e keqe, safi, - i tha ajo babait. - Do nisem patjetër. E gjej a s’e gjej të gjallë..” telefona nuk kishim , as në qytet. Rrofshin ëndrrat! Nuk qullosoi gjë me babanë dhe u fut në dhomën time.- Hidhu një çikë nga fshati, “shatii...”?! - m’u lut si në vaj...Ma hiq këtë siklet.

Në fshat mbërrita në mbrëmje. Xha Hivzinë e gjeta të shtrirë në shtatin e tij, pranë dritares me kangjella druri, të cilat i mbante gjithmonë mbyllur , si në çastin kur njeriu i mbyll pamjet e jetës dhe bëhet gati për në një udhëtim të errët. Sa dëgjoi derën që u hap, ngriti sytë. Më njohu me një të parë. U mat të ngrihej, por unë nuk e lashë.

-Të ka dërguar Vahidea? E ka zemrën flori jot ëmë. – më tha. -Më ka dashur gjithmonë... Është kujdesur për mua, herë me ushqime e herë me ndonjë rrobë...Edhe unë e kam dashur veçan nga të tjerët. E kapi një kollë e fortë sa ia shkallmoi mushkëritë.

- Për të ngrënë ke atje, - më tha duke drejtuar dorën nga dollapi ku mbante ushqimet. Hapa dollapin. Kishte mjaltë, bukëfiqe, qumësht, gjalpë, vezë...- Ke edhe një byrek. E ka bërë Pashakua.

U kujtova që kisha pa ngrënë që në mëngjes, ndaj mora një copë byrek. Ishte i prerë thela-thela, vendosur në një tas.

Më tërhoqi tasi me mjaltë, mora një lugë, mbante erë trëndelinë mali. Vajtja ime e gjallëroi . Kishte ditë pa shkëmbyer fjalë me njeri. I vinte Pashakua për t’i bërë ndonjë punë, e për t’i sjellë ndonjë gatim, po ç’mund të bisedonte ai me një grua fshati? Njeriu në prag të vdekjes ka dëshirë për të bërë biseda filozofike, si për shembull: Nga vijmë? Ku shkojmë?

Atë natë qëndruam gjer vonë pranë vatrës duke kujtuar njerëzit tanë, të gjallë e të vdekur. Unë ngrihesha herë pas here dhe i

hidhja dru zjarrit. Dritë s'kishte... Shiu trokëllinte mbi një llamarinë, që e kishte vënë në çasti, në vend të qeramidheve të thyera. Bubullimat sa vinin e bëheshin më të frikshme. Në një rën anë të dritares qëndronte shtrirë xhaxhai, në tjetrën unë. Unë tetëmbëdhjetë, xhaxhai tetëdhjetë e tre. Po kalonte mesnata. Fjalët nisën të na koteshin. Xhaxhai fliste me një zë si në përrallë, sikur të fliste me Zotin... Më tregoi hollësi nga jeta e Isait dhe Muhametit që nuk i kisha dëgjuar kurrë. Më foli për shpirtrat e mirë dhe shpirtrat e zjarrtë që lëvizin në gjithësi, dhe rreth nesh. Më tregoi për Mekën, ku kishte qenë edhe vetë dikur.

“Jeta e njeriut zgjat sa një ide...”, nuk e di se ku e kam lexuar?

Më foli për sirrën...(Zotin e fshehur prej nesh) Më foli për pamatësinë e pafund të hapësirave. Më tha dhe një gjë origjinale për Zotin, që e kam mbajtur mend: “Zotin tani e shohim përmes një pasqyre, në terr, por më vonë do ta shohim sy ndër sy”. Më citoi arabisht “Ajeti Qyrsinë” dhe m'u lut ta mësoja përmendsh.

-Mësoje, -më tha, - se një ditë do të të hyjë në punë. ”Bismillah rahman e rrahim....Allahu la i lah, ilahu vel...Mbajta mend vetëm fillimin e asaj lutjeje e cila, sipas xhaxhait, thuhet me mend kur je për rrugë.

-Ti je i ri, do të jetosh gjatë. Në të vërtetë njeriu nuk vdes..., - tha, - ndërron vetëm banesë.

Bisedat tona ndërpriteshin herë pas here nga krismat e vetëtimave. Gjumin ma nxori një gjel tenor, që herët në mëngjes. Ishte gjeli i xhaxhait. E dridhte dhe e zgjaste zërin për ta dëgjuar dhe gjelat e tjerë të fshatit, sikur tani të ishte ai komandanti i gjelave. Kishte marrë vesh që xhaxhai ishte i sëmurë, dhe i dukej se kishte marrë ai frenat në dorë. Sikur hoxha t'ia kishte lënë atij të gjitha punët që lidheshin me qiellin dhe fshehtësitë. Gjelit të xhaxhait iu përgjigjën në çast, dy-tre gjela të tjerë. Dy ishin bas, e çirrnin zënë si këngëtarë modernë, njëri ishte soprano kolorato.

U hap dera dhe erdhi Pashakua. Ajo e vizitonte çdo mëngjes. Sa më pa mua u gëzua. Më pyeti për nënën dhe u përmallua...Nisi të më tregonte histori, kur shkonin për dru me mamanë.

- Megjithëse ngarkoheshim si gomare, do t'i mbaj mend ato ditë e ato shakara që bënim ... Ishim të reja. Na kishte lezet edhe puna, edhe rritja e fëmijëve. Po tani... – Nisi të përlotej .

Gjatë kohës që flisja me Pashakon, xhaxhai ishte ngritur në këmbë, ishte veshur dhe ishte bërë gati për të dalë.

- Je gdhirë mirë?- e pyeta.

- Mirë. Ja ,erdhe ti dhe më ngrite në këmbë. Kur do të niseshe?

-Do pres postën e Vlorës, - i thashë, - mbase do ketë vende.

-Unë dua të shkoj nga varri i Manos (Mano i thërrisnim dikur dhe ne fëmijët gruas së tij, Manushaqes). Gjithë natën mendjen aty e kam pasur. Ka rënë shumë shi dhe do jetë është mbushur me ujë...

Ti po pate kohë hajde, në mos të takohemi që tani...

-Po vij me ty, -i thashë. Si mund ta lija vetëm.

Nuk bëri zë. Kur dolëm jashtë, ai u fut në katoq dhe mori lopatën .
- Derën lere siç është, - tha. - Nuk na hyn njeri. Zbrita dhe unë shkallët e gurta dhe u nisa pas tij. Te porta u përul me vështirësi për të marrë një kovë që e kishte lënë nën strehë, për të pritur pikat e shiut. Ia tërhoqa nga dora. Ai para unë pas tij, ecnim me të njëjtin ritëm. Mos do të shohë për të fundit herë arat, burimin, varrin e së shoqes? -mendova. Në atë çast m'u kujtua një citat i lexuar në një libër: "Hapat që bën një njeri, prej ditës që lind gjer në ditën e vdekjes, vizatojnë në kohë figura të pakonceptueshme. Vetëm inteligjenca hyjnore e kap këtë figurë të pakonceptueshme..."

Kur mbërritëm në Ngurza ndaloj hapin, tre-katër hapa larg. Mbi rrugë dukej një pìrg me guralecë, rrethuar me gurë më të mëdhenj, në krye ishte vendosur një rrasë pak më e madhe. Ishte varri i Manos. Desha t'i puthja rrasën te koka e varrit. Isha i përmalluar për atë grua fisnike, por më tërhoqi vëmendjen një gropë me ujë. Ishte varri që kishte hapur xhaxhai për vete. I hodha një vështrim të shpejtë, më duhej të llogarisja kohën që më duhej për ta zbrazur ujin plotësisht. Nuk duhet të vonohesha. Posta e udhëtarëve kalonte andej pari rreth orës nëntë.

Ktheva kokën. Xhaxhai rrinte përkulur mbi varrin e së shoqes, sikur përfalej me shpirtin e saj .Pas pak u ngrit si me mundim dhe ma tërhoqi kovën nga dora.

- S'ke ardhur për punë këtu! ...- më tha. E mbushi kovën përplot dhe e zbrazi mbi zallishte. Mbush e zbraz, mbush e zbraz...Gropa duhet të ishte e thellë rreth një metër. Kur ndjeva që nisi t'i vështirësohej frymëmarrja, ia tërhoqa kovën nga dora, me përkujdesje. Nuk më kundërshtoi. U ul në gjunjë pranë gropës së vet. Dukej i kënaqur .Kishte mundur të vinte për herë të fundit gjer këtu. Po rregullonte për së gjalli banesën e vet të përjetshme. M'u kujtuan fjalët e tij: "Njeriu nuk vdes, vetëm ndërron banesë".

Shkoi dhe u ul mbi një gur, hodhi sytë poshtë arave , u kaloi një vështrim të shpejtë ullinjve, më pas shikimin e hodhi larg, matanë maleve, pas të cilave gumëzhinte deti i madh dhe i pagjumë.

-T'u thuash të gjithëve ..., - më porositi. - Kur të vij në, këtu do të më gjejnë. Bëri me dorë zallishten që shtrihej rreth nesh.

Pas ca javësh morëm vesh lajmin e hidhur: Hoxha ndërroi jetë. "Njeriu nuk vdes... ndërron vetëm banesë".

Vdekja ime e sajuar

Mëngjeseve më merr i pari në telefon , si më i vogël që është, (vetëm pesë ditë) “Takohemi sot?”-pyet. Vetëm kaq, vendin e takimit e dimë vetë, kemi kaq kohë që nuk e ndërruar, Beson e kam jo vetëm kushëri të parë, por dhe diçka më shumë. Nënë tona shkonin si motra, ne jemi rritur nën një çati. Unë kam lindur në krevatin e babazotit, pranë dritares me karafila e borzilok, Besua në kanapënë e mëmëzotes, poshtë dritares së saj ndihej era e bletëve.

Biseda jonë e preferuar mbetet fëmijëria dhe fshati

Fjalët tona venë e nga venë dhe ngecin tek e njëjta brengë: “Këtë vit do t’i ngremë patjetër muret e shtëpisë së Bezhanajve...” Një ditë Besoja tha: "Të kujtohet kur gjetëm në Varre një bombë dhe e sollëm gjer te porta e shtëpisë suaj ?

Si kemi shpëtuar atë ditë! Për fije të perit. Fillimisht na u duk si lodër. Mirë që na pa xha Nafizi dhe na shpëtoi jetën. Të kujtohet? Sa më pa na duke lozur me të erdhi e ma hoqi me rrëmbim nga dora duke e flakur në kopshte. E mban mend si plasi në ajër duke bërë zhurmë...? –E ej, a të kam thënë se këtë ngjarje e kam bërë hartim, dhe kam marrë notën dhjetë.

Mua nuk m'u duk një fakt që duhej mbajtur mend, për Beson ky kujtim lidhej me hartimin e tij të dikurshëm, pesëdhjetë vjet më parë.-Ta kam treguar, sigurisht.-tha ai. -Mundet,-i thashë, s'e mbaj mend.-Si nuk e mban mend? E shoh që të ka lënë kujtesa. Në atë hartim unë mora dhjetë. Hartimin e kisha titulluar: “Vajtim për Mënon”.-E kush na qenka ky Mënu? – e pyeta unë. -Ti ore. – tha ai . -Unë? Ha ha! Ah, po. Kështu më thërrisnin të gjithë kur isha i vogël.- E ç’na paske shkruar në atë hartim që të paska mbetur kaq gjatë në mend?

- Historinë e asaj bombës lodër,-tha ai...Ja nisa , vër e vër, mbusha katër faqe brenda një ore.

-S' më duket ndonjë subjekt kush e di çfarë , - i thashë për t'ia ulur pak tonet ekzaltuese.

- Se mos e shkrova si ndodhi.-tha ai..Xhaxhin s’e futa fare si personazh, u mora vetëm me vdekjen tënde...Sikur gjoja... Unë kisha bombën në dorë, ti ma more nga dora, si trazovaç që ke qenë, dhe nise ta zbërtheje, ndërkohë ajo të plasi në dorë...Pastaj ti vdiqe. Të coptoi bomba ...Pastaj sikur i gjithë fshati u mblodh përpara portës së shtëpisë suaj. Nisën të qanin me kuje...Të nesërmen të varrosëm....Rrugës për në varreza unë nuk pushoja së qari. Sikur, varrin tënd e hapëm pranë varreve të vjetra, nën ullinj të tuaj . Hartimin e dorëzova në kohë. Ditën që kishim orën e korrigjimeve, profesori sa hyri në klasë thirri : -“ Të lumtë djalë! Ke bërë një hartim të shkëlqyer!”.

Hartimi u lexua para klasës. Po dëgjo më të madhen, disa nga vajzat e klasës, u prekën aq shumë sa nisën të qajnë me zë të

lartë. M'u mbushën sytë me lot, edhe pse të gjithë këtë histori e kisha trilluar.-...." Paskë pasur dell shkrintari, he dreq!- më tha miku im, Kasemi.- Tani e tutje dhe hartimet e mia ti do shkruash."

-Domethënë më paske vrarë?- thashë unë

- Të vrava ,tha qetësisht ai. Nëse nuk do të kisha vrarë hartimi nuk do të kishte pikë vlere. Nuk do të ishte aq prekës. - Mos të të vijë keq që po ta them. Në fëmijëri ke qenë pak trazovaç... Të kujtohet si ma rrëmbeve bombën nga dora? -Ndaj më vrave ? - Eh! Trillova edhe unë një herë,- tha duke më parë djallëzisht. -Ti ke një jetë të tërë që trillon lloj-lloj gjërash, nëpër libra, dhe ne s'të themi gjë... U ndryshon emrat bashkëfshatarëve tanë , hallë Havanë na e bën Meme, Salihe Konden na e bën Hamo, gjyshen time nga nëna, më keq akoma, ma ke bërë qorre, dhe që hante me sy... Dhe unë s'të kam thënë gjë. Kur më thonë "Ai kushua jot në filan tregim ia ka futur kot." "Jo u them unë. Ai shkruan letërsi. Vetë letërsia çfarë është? Trillim fund e krye. Fantazi... Ti tregon një të vërtetë, s'të beson askush. Trillo që të të besojnë të gjithë.

Ikja e arbëreshëve

23 të vrarë brenda një dite...Një gjëmë e tillë nuk ishte dëgjuar kurrë, në 14 fshatrat e Himarës. Atë mbrëmje kur Gjon Mirëshpia hyri në kishën e shën Mërisë, at Moshora kishte kohë që kishte rënë në gjuhë, përballë ikonës së shën Mërisë dhe i lutej me zë të ulët: Ç 'mëkate të paskemi bërë, o Zonjë e rëndë, që na dënove kaq shumë!..."

Dhesperina e Vranareve qëndronte te dritarja e kishës, në gjendje alivanie. Kishte veshur një fustan të gjatë kadife , jeshile e thellë. Graria kishte rënë në gjuhë, me pamje përdëllimi, drejt ikonës së shën Mërisë... ulërinin, çirnin faqet me thonj, i binin kokës me grushta. Shën Mëria e Mesosporites i dëgjonte britmat e grave himarjote me qetësinë e gruas së ngrirë në ikonën shumëgjyreshë.

-Rrugë tjetër veç detit s' ka!- tha at Moshora .

Fjalët e tij rrëqethëse dhe tonet e tij profetike krijuan një pështjellim të madh. Të lije shtëpitë, arat, ullishtat...e të ikje, të ikje kuturu nëpër natë, pa ditur se ku? Fjalën e mori dhespoti i Skutarasë, Gjon Mirëshpia.”-Jo o at!-tha ai. -Ka dhe një rrugë tjetër për ne që kemi gjë e bagëti...Shpellave do të fshihemi e me egërsirat do të mësohemi të jetojmë, por trojet s'do t'i lëmë nën të tjerë...”

-Deti është harrim!- thirri dikush.

-Deti është shpëtimi ynë...!tha një tjetër.

-Të ikim ,o atë, të ikim!...

-Këtu do të rrimë!...

Kupola e lartë e kishës mbushej me kakofoni zërash. Askush prej të pranishmëve nuk mendonte me arsye të ftohtë. Ose malin ose detin!Askujt nuk i shkonte ndërmend te një ndarje e përjetshme. Shekujt që do të vinin do t'i shumëzonin dhe do t'i përtërinin brezat larg njeri tjetrit.

Brezat që do të vinin do t'i zgjasnin duart e përmalluara drejt njeri tjetrit. Po do t'i ndante një det i kripur lotësh dhe malli.

* * *

Atë mbrëmje at Moshorës i ishte ndezur i gjithë trupi nga një flakë profetike. E ndjente veten si të ishte Moisiu i shqiptarëve që i printe popullit të vet drejt tokës së premtuar.

Dërgoi dy djem të rinj në të tri lagjet e Skutarës për të lajmëruar orën e nisjes. Në gjirin e Jalit, te bregu i detit, e prisnin gjashtë galera. Duke ecur nëpër dhiaren e bregut të lagjes së Thopajve ai dëgjonte si në ëndërr zëra, britma e të qara fëmijësh të posa zgjuar nga gjumi, që nuk kuptonin ç' po ndodhte.

Shtorrajt e kishin shtëpinë poshtë kishës, ku zinin udhë kopshtet me portokajtë lulëzonin lulet e qershive. Anës shtëpisë së tyre kalonte kalldrëmi që të çonte te Kroj i Nuseve. Shtëpia e tyre ishte dykatëshe, e lartë e me dritare të gjera, me qemerët e lyera me gëlqere. Atë natë ajo zbardhte nën Hënë me një bardhësi mermeri. Sakaq një rëngë e thellë gërvishti natën. Ishte Politja, e ëma e Milo Shtorrit që kishte mbetur atë mëngjes në luftë. Dhimbja e saj, peng i një klithme të zgjatur, i ngjante klithmës së një shpendi të egër.

Dhesperina e Vranareve qëndronte te koka e të zotit të shtëpisë, me një vaj të heshtur në sy. Qetësonte Politenë, ndërkohë që zëri i saj, dukej se vinte nga një botë tjetër...I largët dhe i deformuar. Pas vdekjes së Milos pak rëndësi kishte, iknin ose qëndronin. Dhesperina e vranarajve ruante në bark kujtimin e Milos... Këtë gjë nënë Politeja duhet ta dinte. Ajo mendoi se nuk ishte koha për të treguar gjëra të gëzueshme. Nuse dhe vjehërr e zbritën kufomën e Milos te kopshti me portokaj, poshtë shtëpisë, hapën një gropë, tre-katër metra larg trungut të hardhisë dhe trupin e tij e shtrinë brenda me lebeti.

* * *

Dhesperina qëndroi pak çaste në kopsht. Donte të përfalej vetëm për vetëm me kujtimin e të shoqit të vet. E kishte pushtuar një si ndjenjë alivie. Çfarë ishte kështu kjo natë? E kujshme, me qershie të lulëzuara dhe hargalisje zogjsh?! Vërtiti në mendje Milon e saj. E kishte takuar për herë të parë, te mulliri, hipur mbi një kalë të bardhë, shpatullgjerë e trup lastar. Ajo kthehej nga mulliri, e ngarkuar me një thes me miell. Ai ndali kalin dhe i tha vetëm dy fjalë zëmre...më pas çau tutje mbi kal, iku si era.

-Dhesperina!...Dhesperina!... e thërrisnin lart.

Aj nisi të falej me drurët e qershive si të ishin trupa të dashurish, të shndërruar në drurë të lulëzuar. Eci nëpër kopsht si një fluturzë e lehtë duke prekur me dorë çdo trung qershie, si të falej me to për të fundit herë. U përkul, mori pak dhe nga dheu i kopshtit të saj, e hodhi në përparëse dhe u ngjit lart me nxitim.

Nuk e kuptonte dot si iu mpi gjer në eshtra dhimbja e asaj dite.

E mbuloi malli dhe nostalgjia për shtëpinë që po linte:

Shtëpitë...kopshtet...vreshtat...ullishtat...deti...dhe ata, njerëzit e saj të dashur, të shndërruar në drurë të lulëzuar.

U ndal te gardhi që ndante shtëpinë e saj me atë të Balajve, mbajti frymë thellë dhe ndjeu se si u lehtësua papritur.

Iu duk dhe asaj vetja si një qershie e lulëzuar, po tepër e vetmuar nën dritën e Hënës.

I duk vetja anije me vela që era e shtynte në një det të hapur në drejtim të pacaktuar. Nisi t'i vajtonte zëmra ca vargje.

Nuk kishin ndonjë kuptim të qartë dhe as e dinte se ku i kishte dëgjuar... Apo i krijonte ajo për herë të parë?

Mizore, kur të të marrë malli për mua

dil e më prit në shend Ili.

Më thirr, dhe unë do të përgjigjem nga nëntoka...

-Dhesperina!...Dhesperina...!-Dëgjoheshin zërat që e kërkonin nëpër natë.

* * *

Lamtumirë dheu im,

të përshëndes se po të le...

Anija e parë u mbush plot me vajza dhe nuse të reja. U hepua një çast, pastaj mori drejtimin drejt detit të errët. Mes tyre ishte dhe Dhesperina e Vranareve. Me pamje të tronditur e me një mandil të zi që kishte lidhur flokët e saja të gjata.

Anija u lëkund mbi valë. Asaj nisën t'u lëkunden brigjet e dashura. Iknin malet apo iknin vet ato, në një udhë pa kthim?

Qëndronin të ngjeshura bri njëra tjetrës, të plandërosura e të shushatura si mbas goditjes së një rrufeje, shihnin me mall si u largoheshin nga sytë brigjet e vendlindjes.

Anija e parë nisi të çante me lehtësi në ujëra të qeta, ndriçuar nga feneri i argjend i Hënës.

Nga deti dukeshin më mirë zjarret e garnizonit turk.

Tani vendi ishte nën të tjerë.

Ata që iknin mblidhnin pamjet e fundit për t'i ruajtur përjetësisht në kujtesë.

Ata që do të vinin... Do të flisnin një gjuhë tjetër e do të mësonin qysh fëmijë historinë e gjysh-stërgjyshërve që morën rrugën e detit për të mbrojtur lirinë dhe dinjitetin e arbëreshëve të pafat

Ëndrra

*"Bisedat e mia që zhvillohen në ëndërr kanë
realitetin e vërtetë dhe rëndësinë e duhur."*

F. Pessoa

Pak para se t'i dilte gjumi, Arjola Kote, emigrante shqiptare, me banim në një qytezë të vogël në afërsi të Detroitit, pa në ëndërr diçka të pazakontë: pa të atin, që i mungonte prej shumë vitesh, të ri, veshur me uniformën karakteristike të pilotëve. Ëndrra i la një ndjesi të mirë, edhe pse në ato pak sekuenca ëndrre ai seç kishte një merak në sy.

Arjola kishte vite që jetonte larg vendit të saj, e rrethuar nga njerëz të panjohur, të ftohtë dhe indiferentë: I ati i saj, ish pilot i njohur, e kishte mbyllur karrierën e tij me gradën e kapitenit të parë, në moshën dyzet e dy vjeçare. Varri i tij gjendet poshtë rrugës, te parcela e tretë, në të varrezat e Sharrës. Të gjithë varret e tjera vizitohen rregullisht, sidomos të dielave, u vënë lule të freskëta mbi mermer dhe u derdhnin te koka lot mallëngjimi, përveç varrit të Përparim Dervishit, të cilin, nuk e viziton askush. Familjes Kote i kishte dalë lotaria amerikane dhe ishin nisur me ngut drejt atij vendi ku thoshin se jetonin njerëz të lirë dhe të gëzuar.

Arjola Dervishi, (Kote) kishte pamjen e një zonje që sa ka mbushur të dyzetat, ish mësuese e frëngjishtes s shkollës "18 shtatori" në qytetin e Tiranës, e qetë dhe paqësore, e pavetëdjshme për bukurinë dhe për vlerat e saj njerëzore, në shkurt të 97-ës u largua rrëmujshëm, pa e kthyer më kokën pas , me shpresë se do të kthehej shpejt dhe do ta tërhiqte dhe nënën.(vëllai i saj i vetëm kishte kohë që jetonte si emigrant ekonomik ,në Itali. Po ngjarjet e jetës shpesh nuk ndodhin siç i shpresojmë ne.

"Ç'e kam këtë ndjesi lumturie?" Pyeti veten sa kapsalliti sytë dhe vuri re që drita e një dite të re kishte prekur perdet e dritares së dhomës së gjumit. U ngrit e lehtë si një flutur. I shoqi i saj, Artan Kote, ishte ngritur para saj, Ah! po. Iu kujtua ëndrra e atij mëngjesi që i ishte këputur në mes, pak sekonda më parë... I ati i saj i ri, si në vitet e rinisë, si e gjeti derën e apartamentit të saj në këtë qytet kaq larg vendlindjes ?

"Erdha vetëm për të të parë. Dhe të të them..". fjalëve të më tejme nuk ua vuri veshin, pasi e kishte marrë kaq shumë malli..."Si? Të vish nga kaq larg dhe të mos futesh brenda?"

"S'kam kohë, i tha ai.- Ktheu kokën pas sikur të merrte aprovimin e një njeriu të padukshëm i cili e priste pak metra larg tij.

Në çast njeriu- hije ia bëri me shenjë , dhe pamja e të atit të saj u shkri.

U zgjua me një ndjesi të bukur, edhe pse i mbeti në mend ajo ardhje e beftë.

Ç'ishte kjo ëndërr? dhe ç'është kjo ndjesi lumturie?

Vrau mendjen më kot, për këtë vizitë të çuditshme, edhe pse ajo vet, nuk u kishte dhënë kurrë rëndësi ëndrrave.

”Kam ardhur të të them...” Çfarë më tha...? Si u hutova dhe nuk ia vura veshin fjalëve të tij? Sigurisht, ndonjë brengë e madhe ose ndonjë porosi e rëndësishme na i kthen të vdekurit pranë nesh, - mendoi ajo. Kur doli në korridor pa Tanin në banjë, para pasqyrës, me furçën e rrojës në dorë, dukej si një dervish. Iu afrua dhe e puthi lehtë. Tani u çudit, por s'bëri zë. Kishte parë në ëndërr babin e saj të dashur. Ajo do të dëshironte ta ruante sa më gjatë në mendje, babin e vet, ashtu, të ri, të gjallë dhe të shëndetshëm.

Ende nuk ishte shkëputur nga mbresat e atij takimi të shkurtër, Solli ndërmend fjalët e tij. “Dhe të të them se...” Si dreqin! Ku dreqin e pata mendjen?! Po ta kisha dëgjuar me kujdes do ta kisha marrë vesh arsyen e kësaj vizite të beftë. Pamja e tij e tronditur shprehte diçka jo të zakonshme..”Pa orën mbi komodinë dhe u shqetësua. Ishte bërë vonë për në punë.

* * *

Ishte ditë e hënë, rrugët e gjera të qytetit zhurmëronin tërë gjallëri. Midis lumit të veturave rrëshqiste dhe shevroleti i ri i Artan Kotes, Arjola Kote, e ulur krah të shoqit të saj, risolli ndërmend atë vizitë të shkurtër te dera e apartamentit të saj. Vramendi dhe njëherë amanetin e tij, por më kot. Pas fjalëve “Dhe të të them se...” fjalët e tjera ishin mbuluar përjetësisht me haresë dhe errësirë.

E shoi nga mendja përfytyrimin e të atit me shpresë se në një çast të mundshëm, mbase kur ajo të gjendej te tavolina e saj e punës, në sallën e madhe dhe plot dritë të punonjësve të “Citi Bank”, përballë kompjuterit, sigurisht, do t'i kujtoheshin fjalët e tij të cilat përbënin sekretin e kësaj vizite. Mirëpo, ngjarjet shpesh nuk ndodhin ashtu siç i shpresojmë ne, pasi, as në ato çaste monotone dhe mërzie kur ajo ndodhej pranë kompjuterit, madje gjatë gjithë asaj dite, edhe pse u mundua të sillte ndërmend fjalët e fundit të të atit, ishin shuar nga hark disku i trurit të saj.

Atë ditë, por edhe në ditët e tjera, fjalët e të atit iu bënë fiksim. Një ditë mori guximin dhe ia tregoi ëndrrën mikeshës së saj të punës, Adelin Hjuston, me të cilën e ndanin vetëm dy metra katrorë. Kur dëgjoi shqetësimin e shoqes së saj Adelin Hjuston buzëqeshi hidhur, amerikanes së bukur, praktike në jetë dhe indiferente ndaj ëndrrave të natës, iu duk i çuditshëm shqetësimi i shoqes së saj. Dhe asaj i kishte vdekur ia ati herët, dhe e ëma, diçka e natyrshme, po kurrë nuk përmendeshin në bisedat e tyre. Kjo gjë tregonte që shoqet kishin mentalitete të ndryshme për jetën.

Arjola e kuptoi drejt buzëqeshjen e saj, dhe reflektoi në çast.
Është e vërtetë, tetë vjet janë pak për të menduar si një amerikane.

* * *

Ishte një mëngjes i zakonshëm pune kur ajo la ashensorin e katit e trembëdhjetë dhe u drejtua drejt sallës së madhe me xhama. Në ato çaste të shkëmbimit të përshëndetjeve mëngjesore me koleget e saj të punës, Arjola mori vesh lajmin e hidhur, Adelin Hjuston, shoqja e saj me të cilën i ndanin vetëm dy metra katrorë , që nuk besonte në profecitë e ëndrrave, gjatë kthimit të asaj të diele, pas mesnate, nga një vizitë të shkurtër te gjyshja e saj, kishte pësuar aksident automobilistik dhe kishte vdekur në vend.

Një njeri i rëndësishëm

Kujtoni thelbësoren; porta është e hapur.
Schopenhaur.

Gjyzel Kurdari e quante veten njeri të rëndësishëm pa çka që i kishte kaluar të gjashtëdhjetat pa bërë ndonjë gjë të rëndësishme, nëse do të përjashtonim postet e tij në ushtri dhe gradën e kolonelit me të cilën kishte dalë në pension.

Rondokop, me trup mesatar e pa qafë, koka e tij e madhe dukej si e zhytur brenda trungut trupor, kishte pamjen e një njeriu të edukuar i cili, me indiferencë prej aristokrati pranonte të mirën dhe të keqen. Kohët e fundit, në mungesë të fëmijëve dhe nipërve, të emigruar në tre shtete të ndryshme, e ndjente veten tepër të braktisur, jo vetëm nga fëmijët, por, dhe nga e shoqja, e cila nuk ia varte më si më parë.

Kur mbetej vetëm, mes katër mureve, në apartamentin e tij të bollshëm, e kaplonte një mërzi e madhe, në një nga këto çaste atij i shkoi ndërmend se, mund ta kalonte kohën duke hedhur në letër kujtimet e vegjëlisë. Sa herë që Havaja vonohej nëpër vizita, nxirrte një copë letër dhe ia niste me kujtimet e fshatit, kishte shkarravitur disa faqe, ndërkohë që dhe vet e kuptonte se pena nuk i rrëshqiste, fjalitë i dilnin konfuze, pa fillim e pa fund. “Kush do t’i lexojë kujtimet e mia?” Iu ftoh dëshira për të treguar vuajtjet e fëmijërisë, mirëpo, kjo gjë nuk ia uli vetëdijen se kishte jetuar një jetë me dinjitet, në shoqëri dhe në familje, duke e mbyllur jetën shoqërore me gradën e kolonelit në pension. I vetëdijshëm për vlerat e tij, edhe pse kohët e fundit i dukej vetja i nëpërkëmbur dhe nga banorët e pallatit, kishte kohë që s’ i drejtohej askush me fjalët: “Shoku Gjyzel..!” “Mirë mëngjes shoku Gjyzel! Mirë mbrëma Gjyzel...” Iku respekti për të moshuarit, së bashku me socializmin.

Në një nga këtë mëngjese e mori në telefon një mik i tij i ushtrisë, me të cilin tallej shpesh duke e quajtur. “Tersi i Pojanit. “-Po ku je o krushk..?. Po ç’u bërë o Krushk?!... Dil o derëzi, dil të pimë një kafe. Dëgjo. Të pres, atje ku e di ti, te lulishtja “1 maj! ..” Ofertën e krushkut e priti me entuziazëm. Vasili ishte një burrë i gjatë dhe i pashëm, hokatar, kishin shkuar mirë gjatë kohës që kishin punuar së bashku. Ishte pikërisht ai mëngjes kur gazetarja e problemeve shoqërore, do ta merrte Vasilin në celular, dhe, me një zë si në të qarë, do t’i kërkonte për ta shpëtuar nga një telash i madh. “Xhaxhi, të lutem, më duhen tre intervistues, një e kam gjetur, -i thoshte e mbesa Vasilin në telefon.” “Të nxjerr xhaxhi nga kjo situatë,- iu përgjigj Vasili pa mëdyshje “Të jem e sigurt?” “Plotësisht” “Regjistrimi bëhet të

martën, në ora tetë e tridhjetë.” “Në tetë na ke te dera”iu përgjigj Vasili.” Mbylli celularin dhe iu drejtua Gjyzelit: :”Është mbesa. Punon në TV.” -Do të vemi, hë? Dua të na shohin fëmijët, por dhe miq e shokë, prit kur të thonë : ”Pa shiko, pa shiko, gjallë qenkan këta të dy .”

Pas gjithë asaj zallamahie fjalësh, krushkut në çast iu ndez dëshira e tij e fjetur për t’u bërë njeri publik. Televizioni shtetëror ndiqej me interes në disa vende , në Greqi po se po. “Do të lajmëroj vajzën e madhe, mendoi Gjyzeli,- do t’i bëj surprizë.

Problemit për të cilin do të diskutonin nuk i kushtuan vëmendje, as ai as Vasili. Gjyzelit nuk i ishte bërë një ofertë e tillë, as kur kishte kuadër i lartë i Ministrisë së Mbrojtjes. Solli ndërmend djalin dhe i lindi një dëshirë e flaktë të dinte, nëse valët e T. V . Klanit shkonin gjer në Sent Luis , në qytetin ku ai jetonte.

* * *

Mbase keni rastisur të takoni dhe ju njerëz të tillë, të rrumbullakët e shëndet plotë, me moral të lartë e të plotësuar në gjithçka. Refreni i përditshëm i jetës së Gjyzelit: “Njeriu kështu, njeriu ashtu...” Duke u dhënë të tjerëve mësimë morali , e kapte dhe vetë një dalli misionari:

“Njeriu duhet të bëjë... Njeriu duhet të ketë...Njeriu duhet të sillet...Njeriu...Njeriu...Njeriu,... Me shprehje të tilla moralizuese fëmijët e tij e kishin mbushur kaploqen qysh në fëmijërinë e tyre të hershme, ndonëse Gjyzeli s’kishte ndodhur asnjëherë t’i puthte në faqe. ’është ajo! Kurdarët nuk i kishin zakon puthjet as në fis. Morali dhe drejtësia e shoqëronin personazhin tonë si një re e zezë , kudo që gjendej, sa që unë që e njihja mirë, një ditë djallëzisht, imagjinova si mund të sillej në krevat me të shoqen e vet , Havanë, atë grua të ngjallur si një fokë.

Në orën tetë fiks, ata hynë në studio si sqapi tek kasapi. Tre përballë tre kamerave, të cilat, Gjyzelit iu dukën si tri gryka mitralozash. Një vajzë e re, e llangosur keq me një manikyr ngjyrë vishnjë u ul në tavolinën përballë dhe nisi të prezantojë të ftuarit, hodhi një shikim nga kamerat e më pas u përqendrua te pyetjet: ” Ja pra, erdhi çasti të diskutojmë rreth një çështjeje, e cila dikur ka qenë tabu...Sot do të flasim për puthjen.” Fjalët e saj të para Gjyzeli i dëgjoi si i çmeritur. “Ç’ po flet kështu, moj çupë e babait?! Nisi të djersitej e të përdridhej në karrige, balli i gjerë iu mbush me bulëza djerse, çliroi kollaren, duke e ndjerë veten të kapur si miu në çark. Sikur të ngrihej e të ikte ? Pa nga Vasili me nervozizëm, ndërkohë që ai kishte marrë një pamje të qeshur. O pikë e zezë!O pikë e zezë!

Kush e do fjalën iu drejtua gazetarja Vasilit.. “Për sa i përket puthjes së parë,- e theu heshtjen Vasili, unë mendoj se, çdo njeri ka se çfarë tregon. Puthja e parë mbetet në kujtesë...Nisi të tregojë për eksperiencën e tij të parë me të shoqen e vet..” Projektorët lëshonin një dritë të fortë shoqëruar me temperaturën të lartë. Gjyzelit i duk vetja brenda një llave, nxori shaminë nga xhepi i xhaketës dhe fshiu me të bulëzat e djersës

-Po ju, ç’mendoni? –iu drejtua gazetarja Gjyzelit..

- Po të flisje për gjëra të tilla në kohën tonë, ta bënin me gisht. -i tha ai gazetares.

-Kohët kanë ndryshuar, -iu përgjigj gazetarja me buzëqeshje, - Rinia sot flet lirisht për seksin.

-Lere mos e pyet,-ndërhyri Vasili. -Tani femrat kanë qejf t’i quash “seksi”. pa nga Gjyzeli dhe e ndërpreu fjalën..

Pati një çast që u bë një pauzë e vogël ,të cilën gazetarja e shfrytëzoi për të lexuar statistikat e ndarjeve të çifteve gjatë atij viti, në njëmijë martesë ishin ndarë 495 çifte, një shifër befasuese, e cila s’besoj të kishte lidhje me sasinë vjetore të puthjeve. Më pas gazetarja iu drejtua personit të tretë i cili kishte dijeni të plotë për temën dhe foli me kompetencë për puthjen e parë, pa i bërë tërr syri.

* * *

Kur dolën nga ambientet e televizionit dhe i treti, s’di qysh erdhi e s’di qysh iku, Gjyzeli u grind keqas me Vasilin.

Ç’ na bëre, o krushk, ç’na bëre!,- iu kthye me tërsëllimë.

Ç’të bëra,-iu përgjigj ai qetësisht. - Ku e dija unë i ziu se mbesa ime do të na merrte për specialistë puthjesh.

- Më keq akoma. Si pushta!

-Ti s’ke pse mërzhitesh,- deshi ta qetësojë Vasili.- Mirë fole. Po unë...S’e mos e dija unë i varfëri? – mendohej të justifikohet Vasili duke e ndjekur nga pas.

-E ke ditur dhe s’ke dashur të më tregosh. Rrezil! Kokë kungull! Karagjos...Brashnjar! Mirë ta kanë ngjitur nofkën, Terssi i Pojanit.-Nisi ta shajë me të gjitha fjalët që i vinin ndërmend atë çast.

-Për ideal të ... deshi të betohej Vasili , fjalën “ parti “ e kapi në çast dhe e rراسi brenda gjuhës. Kishin ardhur kohë të tjera dhe çudi, askush s’kishte menduar për betime bashkëkohore. Kur dolën në rrugë, Gjyzeli u nda nga Vasili pa i dhënë as dorën, po ku e linte krushku të ikte ashtu.

-Se mos na pa njeri... Për besë! Se mos i sheh njeri emisionet e mëngjesit.

Po ku qetësohej ai... Në një çast i shkoi mendja te vajza e madhe që jetonte në Athinë dhe e kapi një ndjenë ankthi... Doemos, kishte nxituar kur mori vajzën e madhe në telefon, ndërkohë që të shoqes nuk ia kishte zënë me gojë, duke menduar se do ta gëzonte disi, pas sikletit që kishte hequr nga operacioni në gji. Si u nda me Vasilin gjithë shqetësimin e pati te e shoqja, kur hyri në korridor dhe e pa duke larë pjatat qetësisht, në Kuzhinë, u qetësua. “S’ më paska parë. Gjysma e së keqes. Ç’ më duhen mua të tjerët.” Në çast ra çërrja e celularit. Pati një parandjenjë se do të ishte ndonjë nga ata që kishte parë emisionin dhe nuk u gabua. Personi që nisi të qeshte me të madhe nga ana tjetër e celularit ishte një tip hokatar, shoku i tij i fakultetit: ”Na kënaqe... Për besë, na kënaqe! Kur të pashë në televizor mbeta u mahnitur. Gjyzeli? thashë. Për nder, Gjyzeli..! Gjyzeli specialist puthjesh!? Ti s’je shquar kurrë për këto punë...” Ndërkohë që ai fliste duke u gajatur së qeshuri, në dhomën e tij hyri me rrëmbim Havaja, duke menduar se fliste me ndonjërin prej fëmijëve. Nuk e kishte mbyllur ende celularin kur ra zilja e telefonit fiks. Dorezën e telefonit e ngriti Havaja. Ishte vajza e madhe. Fliste nga Greqia. Kishin babanë në emision familjarisht dhe ishin skandalizuar. Sa dëgjoji zërin e së ëmës vajza e madhe e zbrazti të gjithë nervozizmin mbi atë. “Ç’bën ashtu yt shoq? A është në mendje apo ka lajthitur në pleqëri?” “Pse mojt, çfarë paska bërë?- u alarmua Havaja, duke parë me frikë nga Gjyzeli.”Ç’ke bërë mor ditëzi?” “A ç’ më çan kokën!”- u nervozua Gjyzeli duke ia rrëmbyer nga dora dorezën e receptorit, ndërkohë që nga ana tjetër e telefonit dëgjohej vetëm një pipi e zgjatur.

* * *

Ditën e parë u mbyll dy ditë në dhomën e tij të gjumit dhe s’doli që andej as kur e thirri e shoqja për të ngrënë drekë. Vetëm ditën e tretë vendosi të dalë nga shtëpia, gjer aty te lulishtja, pranë pallatit, ku mblidheshin pensionistët e moshës së tij dhe loznin me letra.

Ecte ngadalë sikur të kishte bërë një faj të rëndë, gjithë sy e vesh, me mendimin se duhet të ishin të shumtë njerëzit që e kishin parë atë emision të mallkuar. Sakaq vëmendjen ia tërhoqën dy gra të moshuara, të cilat ishin ulur në një nga stolat e lulishtes dhe bisedonin me nge me njëra tjetrën, kur u kaloi përbri, seç i çuquritën në vesh njëra tjetrës.

“ Më paskan parë...” mendoi me vete ai dhe ngau tutje, me duart e lidhura pas shpine, si ai njeriu që nuk i bëjnë përshtypje fjalët e botës, mirëpo, nuk e la kureshtja për të mësuar të vërtetën,

ktheu kokën dhe shikimi i tij u ndesh me shikimin e njëjës prej tyre, në një çast kakarisje.”Më kanë parë....Sigurisht.” Ky mendim e ndoqi pas gjithë atë paradite , dhe do t’ ngulitej në tru si refren ,dhe në ditët që pasonin. Rasti tjetër u përsërit të nesërmen, te stacioni i autobusëve të Unazës, pa dy të rinj që ia kishin ngulur sytë dhe po e ndiqnin me vëmendje...”Më paskan parë...tha me vete. “Dhe këta më paskan parë...”

Ditën e pestë,. U ngrit qysh herët, Havasë nuk i kishte thënë asnjë fjalë se do të nisej në fshat te vëllai i vogël, veshi kostumin e ri, lidhi kravatën që ia kishte dërguar vajza tjetër, nga Gjermania, dhe doli në rrugë. Vetëm nga mbas dita Havaja mori në telefon motrën e Gjyzelit, ta pyeste ,ç’u bë ky burrë, por nuk gjeti në shtëpi. Në mbrëmje vonë e morën në celular nga fshati dhe e njoftuan që xhaxhi ishte shëndoshë e mirë në shtëpinë e tyre. Iku vetëm për ca ditë. Kur kaloi java dhe ai nuk u kthye, Havaja nisi të shqetësohej seriozisht, bleu ca dhurata për fëmijët e vajzës së vëllait të Gjyzelit dhe vendosi t’i vente pas, mirëpo, qysh atë mbrëmje, mori lajmin e hidhur: “ Gjyzeli na la shëndënë...”I kishte rënë një infarkt i fortë ndërkohë që kishin dalë në ballkon me të vëllanë , dhe ishin duke kthyer nga një gotë raki “U shtri për tokë dhe nuk u ngrit më. Ja, kaq!” I tha , kunati në telefon me zë të mekur.

E varrosën te varrezat e fshatit. Në çastin e fundmë , mbi varrin e tij u lexua një nekrologji e shkurtër, mbushur me fjalë lavdëruese. Fjalën e rastit e mbajti kryeplaku i fshatit: ” Po i japim lamtumirën e fundit bashkëfshatarit tonë... Gjyzel Kurdarit...Gjyzeli lindi në një familje të varfër fshatare... Gjyzeli shtatëvjeçaren e mbaroi shkëlqyeshëm, në shkollën e fshatit... Gjyzeli mbaroi shkëlqyeshëm dhe shkollën ushtarake “Skënderbej”. Gjyzeli akademinë e mbaroi me medalje të artë.... Gjyzeli gjatë jetës së tij kreu shumë disa detyra të rëndësishme shtetërore... Gjyzeli rriti dhe edukoi tre fëmijë me edukatë të lartë... Gjyzeli doli në pension me gradën e kolonelit...”

Të gjitha këto merita të jetës së tij nuk ishin pak, ndonëse tregonin për aktivitetin e një njeriu të zakonshëm. Ato që nuk u thanë ishin ca gjëra që s’varehin prej tij, si: Gjyzeli nuk arriti gjer në gradën e gjeneralit? Gjyzelit nuk iu realizua ëndrra për t’u bërë mjek? Gjyzeli nuk shkroi kujtimet e fëmijërisë? Gjyzeli nuk qe i zoti t’i mbante fëmijët në Tiranë, Gjyzeli i la të ikin nga sytë këmbët, etj. etj.

Gjithmonë më ka shqetësuar tema e njeriut që ikën nga kjo jetë pa realizuar disa dëshira elementare, mirëpo, të jemi të arsyeshëm, nëse është fjala për Gjyzelin nuk është pak ajo çka ai bëri në jetë. Le të themi më të rëndësishmen, jetoi një jetë pa vese, dhe rriti tre fëmijë me një moral të lartë. Nuk është pak.

Apo jo? Në ditën e gjykimit të fundit, nuk do të na pyesin për romanet e shkruara, as për ndonjë zbulim shkencor që mund të kemi bërë gjatë jetës, vendimin për të na pranuar në parajsë ose për të na degdisur në ferr, merret nga disa persona të paanshëm dhe që s'kanë habere nga letërsia dhe shkencat natyrore, ata duan të dinë vetëm nëse ti ke bërë një jetë pa vese dhe ke zbatuar ligjin e riprodhimit hyjnor.

Gjyzel Kurdari qysh në vegjëli u edukua me një disiplinë të rreptë ushtarake, duhan nuk pinte, as kafe, më të rrallë kthente ndonjë gotë, me miq e shokë. Morali i njeriut i i ngjan moralit të lartë të bletëve që, sipas Heksameronit të Ambrosios, vetëvriten kur kanë kundërshtuar ligjet e mbretëreshës së tyre, dhe misioni i njeriut i ngjan misionit të një blete punëtore, e cila i shkrin të gjitha energjitë brenda misionit kolektiv. Ç'mund të bëjë njeriu më shumë? Çfarë bënë gjyshërit tanë dhe gjyshërit e gjyshërve tanë? Çfarë po bëjmë ne, më shumë? Sall atë çka është dashur të bëjmë.

Në çastet e fundit njeriu duhet të kujtojë fjalët e Schopenhaurit: Kujtoni thelbësoren; porta është e hapur.”

Zonja me kone

*Njerëzit gëzojnë informacione të pakta mbi
motivet e thella të sjelljes së tyre.*

Whitman

Janë disa gra, të cilat e kalojnë ditën në shoqëri me një kone. Arsye për t'u trishtuar ka plot, por dhe për të jetuar ka plot arsye, vetmia është një interval, midis asaj çfarë je dhe çfarë duhet të jesh, një shkëputje ndaj një jete të largët, ose, ndaj një pjese të vetvetes.

Për historinë e kësaj zonje nuk dija asgjë, as emrin nuk ia kisha mësuar edhe pse, ç' prej disa muajsh jetojmë në të njëjtin të një pallat, në plazhin e ri. Të mbash një kone të vogël s'të kushton asgjë. As kohë e as mundim, veç kënaqësisë që ndjen kur vëren që të ndjek pas si fëmijë i bindur. Ti ulesh në një bar dhe porosit kafe me qumësht, ajo vjen e të struket nën këmbë, të shikon me ata sy të xhamtë, duke lëvizur bishtin dhe veshët. Kur ke nevojë për heshtje ajo të kupton nga sytë, dhe hesht. Kur ti i bërtet ajo e kupton shpejt gabimin, dhe të kërkon falje duke u shtrirë në këmbët e tua, konet si Xhixhi nuk dinë as ç' do të thotë ushqim i zgjedhur, vetëm njerëzit ta përplasim pjatën në fytyrë.

Kur zonja e nderuar, e veshur me të zeza, vendos ta nxjerrë për në shëtitje, mua më krijohet përshtypja se në apartamentin ngjitur jeton një fëmijë zhurmëmadh i cili kërkon të rrëzojë gjithçka që i gjendet përreth. Liria e Xhixhit është e lidhur ngushtësisht me lirinë e zonjës. Ju mbase do të kërkonit që nga apartamenti përballë të dëgjohej zëri i një fëmije, ose, zëri i ndonjë njeriu të afërt të saj, mirëpo, kujdes! Mark Tuen ka thënë; asgjë s'mund të jetë më e keqe se raca njerëzore.

Këto ditë plazhi mua më është bërë zakon të çohem herët në mëngjes, të hap televizorin për të marrë vesh të rejat e ditës, më pas shkoj te dritarja, që gjendet nga ana e detit për t'u përshëndetur me horizontin e pafund... Bash në atë çast Xhixhi nis refrenin e lehjeve, të cilat variojnë nga lutje të përvajshme gjer te kërcënime kryeneçe, i bën presion zonjës që të kryejë edhe këtë mëngjes ritin e zakonshëm të shëtitjes anës detit. Pasa pak ato marrin rrugën e detit, zonja para, e qetë, meditative. Litarin konia e ka të gjatë, mund të lëvizi lirisht, të kthehet pas e të nxitojë, gjithmonë në distancën disa metra larg zonjës, lëkund bishtin pa prerë nga gëzimi, fut hundët gjithandej, diku vetëm sa nuhat, diku ndal dhe nis të gërryejë me putrat e para të këmbëve në ca plehra të gjetura nën një trung pishë. Zonja ndal hapat, e pret, nuk shqetësohet. Ajo është mësuar me huqet e Xhixhit, nuk shqetësohet as kur Xhixhi ngre njëren

këmbë lart për të urinuar, as kur fut noçkën nëpër grumbuj pislleqesh. Kur litari i tërhiqet me rrëmbim kjo është shenjë që zonjës i ka humbur durimi. Në kësi rastesh Xhixhi nuk bën fjalë, e ndjek pas e bindur, duke lëkundur bishtin, e lumturuar.

Duke parë këtë çift që e kalon jetën në një harmoni të përmbajtur, mendja më shkon te disa familje, me fëmijë më me kulturë se Xhixhi dhe më inteligjente se Xhixhi, por që s' dinë të sillen si Xhixhi, as të zemërohen sinqerisht si Xhixhi, nuk dinë as të falin si Xhixhi dhe nuk kanë as atë përkushtim dhe besnikëri që ka Xhixhi.

Xhixhi është e kënaqur me fatin e vet, edhe pse truri i saj s' besoj të kuptoj se ç'nder i madh i është bërë. Si një qenie njerëzore e vras mendjen dhe për gjëra të kota, duke menduar që kjo zonjë e nderuar nuk duhet t'i ketë kaluar të gjashtëdhjetat, ndërsa Xhixhi, nuk duhet t'i ketë kaluar të dymbëdhjetë muajt, ja pesëmbëdhjetë, ka një vështrim melankolik si e zonja, për shkak të pushit të saj të zi të duket si e mbështjellë me gëzof të zi e të ndritshëm. Çfarë i ka pëlqyer kësaj zonje kjo kone qimezezë? I tillë tipi jam unë, kureshtar në kulm. Më fiksohet një gjë dhe aty më kullot mendja. Te qimja e saj e zezë... dhe fustani i zi prej mëndafshi i zonjës...Rrekem të kuptoj se kush ka qenë "e ëma" e konës dhe kush ka qenë i shoqi i zonjës; mendimet shkojnë dhe më tej; ngase ka vdekur i shoqi i saj?

Në ditët që pasuan do t'i merrja vesh të gjitha; konen qimezezë asaj ia kishte falur fqinja e saj që banonte në një shtëpi private, poshtë pallatit të saj. Zonja me të zeza quhej Meliha, dikur kishte qenë mësuese e rusishtes, pas heqjes së rusishtes nga shkollat kishte unuar në administratën e shkollave. Xhixhin e kishte marrë fare të vogël, për shkak të ngordhjes së nënës së vet... le të gjejmë një fjalë më njerëzore për të ëmën e cila i kishte vdekur gjatë lindjes. Më mirë që qentë nuk kanë kujtesë. Ç'u duhen nostalgjitë? Konkluzioni: Më mirë të jesh një qen.

P.S.

Sot mora vesh diçka të rëndësishme të cilën s'mund të rri dot pa jua thënë: Vetëm me një shishe birrë i dhashë lulishtarin plak dhe ai u hap me mua, si vaji në lakra, duke më treguar lloj-lloj historish. Midis të tjerave më tregoi dhe diçka për zonjën të cilën unë fillimisht nuk e besova, gjoja ai na paska parë me sytë e tij se si një mbrëmje drita e kuzhinës së saj kishte qëndruar ndezur gjer në mesnatë E çfarë pastaj? Kulmi ishte kur ai ngulte këmbë për miqësinë e saj me hidraulikun e pallateve, me atë katundarin prej Kavaje, që kuturbon erë djerse, nga mëngjesi në mbrëmje.. Për një çast mendova të paguaj dy birrat, të ngrihem e të ik.

“Vetëm ti nuk e paske marrë vesh që Meli qenin dhe zinë i ka si mbulesë.”-tha ai. E dini pse në atë çast nuk ia hodha birrën në fytyrë? Të them të drejtën e besova...Nuk është çudi. Pse jo?

Më shkoi mendja te ai studimi i mjekut Xhonson ,”Seksi te të moshuarit.” , i shkruar kohët e fundit. Para se të lexoja këtë libër edhe unë, ashtu si ju mendoja , s’mundet kurrë, një grua pas të pesëdhjetave të ndjejë më seks, mirëpo ja që doktori sillte fakte që seksi lind dhe vdes me njeriun. Më mirë të mos i lexosh libra të tilla, ta bëjnë kokën dhallë.

Në raste të tilla dhe hidrauliku do të ishte një zgjidhje, nëse zonjën nuk e trazojnë erërat . Ndodhi, si jo..? Bravo zonja! Se, të thuash të vërtetën, çfarë emri mund t’i vësh deklaratës së aktores 74 vjeçare, Alisa Pornas, e cila doli në televizor para ca ditësh dhe deklaroi pa pikë turpi që bënte seks dy herë në javë?

Rast i veçantë? Dakort. Përse të mos e quajmë dhe rastin e kësaj zonje të nderuar si një rast të veçantë? Konkluzioni;”never sed never”

Shkon i vdekuri ndër të gjallë

Ajo që ndodhi atë mëngjes ishte diçka e çuditshme, para syve të saj iu u ngjall vëllai i vdekur 20 vjet më parë. Ishte një mëngjes me një shi të vazhdueshëm, Dhora K., mësuesja e letërsisë së shkollës së mesme “Konstandin Kristoforidhi” i hipi autobusit të unazës, atë ditë kishte dy orë me klasat e treta, në ditët me shi autobusët e unazës mbushen përplot me qytetarë të nxituar, të cilët, edhe për shkak të shiut të dendur, qëndrojnë te platforma, pa u shtyrë para, shtypur dhe ngjeshur me njeri-tjetrin.

Dhora K. zbuloi një hapësirë, sakaq i rroku syri një njeri të njohur, sy kaltër, në kokë mbante një kapele të bardhë doku me strehë, ulur mbi ballë, sikur t’u përvidhej shikimeve të qytetarëve.”Kush qenka ky njeri që më vëren ngulazi, dhe në mënyrë provokuese? “Ua!...” Gati sa s’thirri me zë të lartë, gjaku i vërshoi me vrull nëpër damarë, pati një ndjesi se po i zihej fryma, diçka i krisi përbrenda...”Ua!Ua! ...Mblidhe veten moj grua... Yt vëlla ka njëzet vjet që ka vdekur.” i shqiti sytë prej shëmbëlltyrës së vëllait të vet, por, tundimi i atij çasti qe aq i fortë, s’rezistoi dot pa ia ngulur sytë përsëdyti, kësaj here frikshëm Dhe çfarë ngjashmërie!? Ngjyra e syve...shikimi i përmallur..(Ua!Ua!) Dhe kapela me strehë e ulur mbi sy, shkundi kokën lehtë, po ta këqyrte sërish, për herë të tretë, e të katërt, sigurisht, mund të gjente shenja dalluese, të cilat i njihte vetëm Dhora K. aq do t’i duhej për ta qetësuar zemrën e saj që gjëmonte si tokmak, ndryshe, me ç’të drejtë ky njeri do t’ia ngulte sytë përmallshëm kësaj gruaje në moshë të thyer e të veshur me të zeza? I hodhi një shikim tjetër, të shpejtë dhe qortues: “Kush je ti që guxon të më buzëqeshësh në atë mënyrë?” Ngjashmëria me vëllanë e saj nuk vihej më në dyshim, dhe moshja, dhe ngjyra e syve, dhe ajo buzëqeshje e lehtë.

”Qetësohu moj grua...- Ç’është kjo punë me ty...” shikimin e gozhdoi jashtë dritareve - Edhe pse mori një vendim të prerë për të mos i hedhë më sytë sozisë së vëllait të saj, s’kishte Zot ta qetësonte zemrën e alarmuar.

* * *

Autobusi urban ndali plogët në stacionin më të parë, rrëmuja e hyrjedaljeve të qytetarëve nën shiun e dendur ia humbi nga sytë vegimin e Kostandin K. të kthyer nga vdekja, që gjendje çuditërisht, në një autobus urban midis të gjallëve.

Dhora K. zbriti nga urbane dy stacione më tej, me hapa të shpejtë u nis drejt shkollës së saj paksa e hutuar, pamja e njeriut që ngjasonte me vëllanë e vet, i dënuar me vdekje plot 20 vjet më parë, i kishte krijuar një dhimbje në zëmër. “E pranoj, kishte një ngjashmëri të çuditshme, mund t’i ndodhë gjithkujt, përse duhet të shqetësohesha kaq shumë?”

Nuk ishte e rastit, një shofer i ambasadës sonë në Romë, me origjinë nga Fieri, kishte përhapur fjalë se në një shëtitore të Romës kishte parë shokun e tij të fëmijërisë. “E ndoqa pas,- i kishte thënë në intimitet, një njeriut të vet , - U pamë sy ndër sy...E njoha dhe më njohu, nuk e di përse iu përvodh shikimit tim , nxitoi e u fut midis kalimtarëve.” Një fakt që të linte pa mend, në takimin me motrën e vet e kishte mohuar në vend. ” Kam thënë që, kam parë një njeri që i ngjante Kostës. Vetëm kaq...”

Qysh nga ajo ditë Dhora K. edhe pse e dinte se vetëm në legjenda ngjallen të vdekurit, i ishte mbushur mendja top se Kosta, vëllai i saj duhet të ishte i gjallë.

Gjatë gjithë rrugës, nga stacioni i autobusit gjer te porta e shkollës ajo nuk e mposhti dot dyshimin, sa më tepër i mbushte mendjen vetes se ajo që kishte parë në autobus ishte një iluzion optik, aq më kokëforte bëhej dëshira mbushamendëse se ajo kishte parë në mes të ditës vëllanë e vdekur. Solli ndërmend turli njerëzish, të njohur e të panjohur, qysh nga fëmijëria e largët, e gjer në dyert e fakultetit Histori-Filologji, ku ajo kishte mbaruar 26 vjet më parë., e më pas, në vitet e punës, si mësuese e gjuhë- letërsisë, 26 vjet punë, nga njeri gjimnaz në tjetrin, mijëra persona kishte regjistruar në memorie por, s’kujtoi asnjë pamje që t’i ngjante Kostës sa ai njeriu i autobusit, kështu do ta quajmë këtë njeriu enigantik, gjersa të mësojmë diçka për të..

* * *

Pas vdekjes së Kostës Dhora K. e ndjente veten si një degë e prerë , e hedhur pamëshirë mbi trotuar. Me lindjen e dy vajzave, njëra pas tjetrës, iu përkushtua familjes, jeta e saj kishte një qëllim , të rriste Dorën dhe Estelën, me përkujdesje dhe dashuri, dhe t’i vinte në ndihmë të shoqit të saj, Vasilit , kishte mbaruar në Leningrad për inxhinieri ushtarake dhe punonte në repartin 6, në periferi të Tiranës.

Dhora K. ishte një grua e bukur, pas lindjes së Estelës ajo shtoi dhjetë kile në peshë , u bë dhe më e bukur, shëndeti i saj i nxori në dukje huret e një femre të pjekur dhe serioze, një mësuese që dinte të sillej me takt me të gjithë , paksa e distancuar , ndonëse në raste mbrëmjesh, përvjetorësh dhe ditëlindjesh përshtatej aq bukur në shoqëri saqë shoqet ia kishin zili artin e komunikimit. Gjithë kjo përvojë marrëdhëniesh në familje dhe shoqërore i ishte e diktuar nga një disiplinë e trashëguar familjare dhe nga rrethanat e jetës, por, ajo që do të ndikonte më së shumti ishte ikja e Kostës në moshë të re, 32 vjeç.

Pas ikjes së Kostës, tetë muaj më vonë i vdiq nëna, kështu që Dhorës iu desh të përballej dhe me hallet e familjes prindërore, vajza e Kostës, Anila atëherë ishte tre vjeç , Miriami gjashtë muaj, dy vëllezërit e saj,

Vangjeli , gjimnazist, në vitin e fundit, Cifja (Josifi) sa i kishte mbushur të pesëmbëdhjetat.

U zgjata pak rreth historisë së familjes së saj që të na kuptoni më mirë se pse Dhora K. vazhdimisht, në familje dhe në shoqëri, madje dhe në natën e gëzuar të vitit të ri, përshkohej nga një pezm i lehtë, nuk ishte as humbja e nënës, as vështirësitë familjare, me ikjen e Kostës të saj të dashur iu duk sikur u përmbys një mal dhe ra para këmbëve të saj, i dukej çdo gjë shkretëtirë, pas ikjes së tij ajo ecte gjithmonë sy ulur, jeta e saj i dukej pa shije, një jetë pakuptim.

* * *

Kostandin K, u ekzekutua në mesnatën e 17 prillit të vitit 1961. Ngjarja për të cilën gjykata ushtarake vendosi ta dënojë, fillimisht me tetë vjet burg e më pas me vdekje, mbeti një enigmë e madhe që nuk është sqaruar as sot e kësaj dite. Kostandin K., ish partizan, një nga atentatorët e parë të qytetit të Fierit, me prejardhje nga Gjirokastra, i ati i tij merrej me tregti stofrash, pas luftës ushtarak i lartë në Ministrinë e mbrojtjes, në 13 dhjetor të vitit 1961, pas prishjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik, akuzohet si një agjent rus, së bashku me gjeneralin e flotës ushtarake detare, A. M, katër muaj në hetuesi, në dhjetëra seanca hetimi, ai asnjëherë nuk pranoi që akuzën që i ishte ngritur nga kolegët e tij të punës. Kostandin K, njihej për një lidhje të vjetër, qysh gjatë viteve të studimeve në shkollën ushtarake në Itali, si shok kursi me Ministrin e brendshëm, i cili, çuditërisht, në ato çaste e tij më të vështira heshti , e braktisi, ose të themi, nuk reagoi fare ndaj akuzave të ngritura. E mbajtën të izoluar në qelitë e hetuesisë, gjer në ditën e vendimit. Ndërkohë u krijua një shpresë e vaktë për një dënim të zbutur në bazë të ca rrethanave lehtësuese, mirëpo, për fatin e tij të keq, prokurori vuri veton. Gjatë atyre muajve të hetuesisë pati një shurdhëri të vërtetë, nuk u lejua askush ta takonte. Vetëm pasi gjykata shpalli vendimin me vdekje, i lajmëruan njerëzit e familjes për t'i dhënë lamtumirën e fundit. Në takim shkoi vetëm Dhora, motra e tij tre vjet më e vogël se Kosta, babai kishte gjashtë vjet që kishte vdekur , nëna sa mori vesh dënimin e tij zuri krevatin dhe nuk u ngrit më...U bë një takim i shkurtër, rojet i lanë të shiheshin në distancë, motër e vëlla prapa hekurave, për pak minuta.

Atë çast Dhora K. e ka ngulur në kujtesë si me gozhdë, Kostandin K. u shfaq para saj i shoqëruar nga dy roje burgu., iu drodhën gjunjët sa e pa, iu duk i tretur dhe i zbehtë , në ato pak minuta ajo shkëmbeu me të vetëm lot, kur e kapën për krahësh, lehtësisht , për ta futur brenda, ai tha ca fjalë të rëndësishme, të cilat asaj por dhe rojeve që e shoqëronin, iu dukën dhe të çuditshme..Ishin këto, fjalët e tij të fundit të tij, që Dhora K. do ta linin pa gjumë për vite të tëra, me një shpresë të çmendur.

* * *

Në çastin që gardianët iu afruan Kostës për ta shoqëruar në qeli “*Mos më qani...i kishte thënë ai , qetësisht dhe qartazi. “nëse nuk kthehem edhe pas njëzet vjetëve atëherë më qani. Thua ja dhe nënës.!*” Porosinë për nënën e shqiptoi me zë të lartë, sikur kërkonte t’ua bënte të ditur dhe dy gardianëve , dëshmitarë të atij çasti. Dhora K. në atë çast nuk ishte as në qiell as në tokë, u këput dhe ra, pranë hekurave, zëri i tij i erdhi si jehonë, si në ëndërr, të fundit fjalë do ta sillte ndërmend një ditë më vonë, dhe në të gjitha ditët e tjera që do të vinin. Një javë më vonë së bashku me vajzën e tezes, bashkëmoshatare , shkoi përsëri para dyerve të burgut, për të tërhequr rrobat, një dyshek pambuku, dy batanije dhe një pallto ushtarake angleze e ruajtur qysh nga koha e luftës. Atë ditë ajo u interesua të mësonte emrat e dy gardianëve, me mendimin që, pasi të ftohej plaga për vëllanë , të mund t’i takonte, së paku njërin , sa për të mësuar ndonjë hollësi më shumë rreth ekzekutimit të tij, dhe t’i pyeste, nëse iu kujtoheshin fjalët e tij të fundit..”

Çfarë do të thoshte ai me ato fjalë..?Pas njëzet vjetësh të më qani? Një kumt ? Një profeci? Diçka që mund të ndodhë veç në legjenda? Po pse pas njëzet vjetëve? Ndërkohë që në legjendën e Kostandinit dhe Dhoqinës pritja zgjatej vetëm tre vjet.

“Kostandini i vdekur, tre vjet i patretur...”

Legjenda e Kostandinit njihej në gjithë Ballkanin si legjenda e besës së dhënë, ajo mburrej me faktin që legjenda e besës së dhënë i përkiste fisit të saj ilir. Dhe ja tani ç’na ndodhte, një mësuese letërsie bëhej personazh legjende, futej brenda lëvores së një legjende. Dhe emri i saj, Dhora, një shkurtim i emrit Dhoruntina... Çfarë ngjashmëri?! Amanetin e tij ajo ia transmetoi të ëmës qysh atë ditë. Nuk e di pse më tha , nëno, ta qajmë jo tani, por pas njëzet vjetësh? Po nëna e saj nuk ishte në gjendje t’i kthente përgjigje, pasi, në ato çaste pulsi i kishte shkuar 86 rrahje në minutë.

* * *

Ditët e tjera, në shtëpinë e tyre erdhën për ngushëllim fare pak njerëz, ca komshinj e të afërm të tyre nga babai, hynin e dilnin si hije, tepër të frikur, mos i pikaste kush gjatë ngjitjes së shkallëve. Dhora i priste dhe i përcillte si zonjë shtëpie, e veshur në të zeza, kokulur, çfarëdo që të thuhej rreth ikjes së tij të përjetshme i dëgjonte qetësisht. Mos vallë në prag të ikjes së tij të përjetshme ka dashur të na lehtësojë dhimbjen? Dhe pse pas njëzet vjetëve, kur dihet , çdo dhimbje , sado e madhe qoftë , tretet brenda dyzet ditëve? Muaj më vonë, kur plaga e saj do të zinte kore dhe ikja e Kostës do të shndërrohej në një realitet të

dhimbshëm, ajo filloi t'i rikujtojë fjalët e tij të fundit me një logjikë pak më të ftohtë.

I tha për të qetësuar nënën?! Shqetësimi ia brente mendjen në heshtje si krimbi i mëndafshit, veçanërisht netëve, kur kërkonte të ëndërronte diçka të bukur për ta zënë gjumi.. A mund të ndodhte që, tashmë, kur të gjithë e dinin të vdekur, ai jetonte si një person tjetër, me një pasaportë tjetër dhe me një mision tepër sekret. Brenda apo jashtë vendit? Dhora K. dëshironte të besonte, gjithmonë sipas supozimit të saj, se ai duhet të gjendej jashtë shtetit. Në Itali?!Dhe mundet?! Në Greqi, në Rusi..?! Amerika ishte më pak e besueshme, ndonëse ideja e Amerikës e joshte më së shumti fantazinë e saj. “Së paku ta dimë që jeton.” e ulte pak entuziazmin , -“ ç’rëndësi ka ku ndodhet, rëndësi ka që ekziston, është gjallë, ka një shpresë..”

Historia e Kostës do të ishte fashitur me kohë nëse nuk do të kishte ndodhur diçka, krejt e pakuptimtë, Evanthia sa kishte kaluar Urën e Tabakëve, sakaq ndjeu një burrë që e ndiqte nga pas, i gjatë si i shoqi, me syze dielli....Kush është ky njeri që po më ndjek? Përse? Ajo nuk të linte përshtypjen e një gruaje që i tërhiqte meshkujt, pas vdekjes së të shoqit e çuan punëtore me tre turne , në kombinatin e tekstileve, në ecje , në veshje, madje dhe në pamje kishte tiparet e një gruaje hallexheshë... Njeriu i panjohur, kur i kaloi pranë e kishte pyetur: “Përse u martove?! Në çast ajo ndaloi hapin dhe ktheu sytë nga i panjohuri i cili u largua me nxit..”Dëgjova zë apo më bënë veshët”, mendoi ajo e çuditur, sigurisht do më kenë bërë veshët. Atë ditë ,sa u takua me Dhorën, duke ditur që dhe atë e torturonte dyshimi për vëllanë e saj ,ia tregoi ndodhinë, në çast në fantazinë e Dhorës u gjallërua sërish vëllai i saj, jo vetëm i gjallë por dhe në mes të Tiranës..

* * *

Dhorës i ishte krijuar bindja se, Kosta jetonte dhe duhet të ishte në Itali, dhe fjalët e shoferit të ambasadorit tonë që kishte qenë në Itali...Kosta dinte italisht., thua shtetit jonë e ka nisur me një mision tepër sekret? Nëse jetonte diku...në Amerikë, Rusi.. Kanada,, stacioni i parë duhet të ketë qenë Italia... E këndellur në fantazira të tilla ajo vriste mendjen, kujt mund t’ia besonte këtë sekret përvëlues për t’i marrë një mendim , të shoqit ia kishte përsëritur disa herë aq sa ai një ditë i tha:”Grua, mblidhe mendjen. Nuk ka bërë vaki të ngjallen të vdekurit. Dhe nëse është ashti si thua ti, më keq akoma.”.

* * *

.Nga viti në vit Dhora K nisi t’i ndrydhte dyshimet thellë qenies së saj. “ Ti mendon gjera të rrezikshme...” -e qortoi një ditë vëllai i saj,

Vangjeli.- Nuk paska pasur sigurimi i shtetit kuadro të specializuara që t'i besonte një njeriu të dënuar me vdekje. Veçse...Në qoftë se...?"

Dhora K. mendonte se sekrete të tilla i dinte vetëm Ministri i Brendshëm i atij viti. Mehmet Shehu dhe drejtori i burgut i atij viti, Agush Bejko, pensionist, të cilin e njihte i ati i Verës, shoqja e saj që jepte lëndën e anglishtes.

Një ditë Dhora mori kurajë dhe i tregoi Verës në formë shakaje se, vëllai i saj, Kosta, Mund të ishte gjallë. "Paske parë shumë filma me agjentin 007."- ia ktheu ajo. Rasti e solli që Dhora K. një mbrëmje të gjendej në shtëpinë e saj me rastin e ditëlindjes, e pritën me ngrohtësi dhe përkujdesje. Historinë e vëllait të saj e kishin mësuar të gjithë njerëzit e familjes së Verës. Ajo kishte pyetur të atin dhe nëse mund të ndodhte që një njeri i dënuar me vdekje ta dërgonin jashtë shtetit me shërbim sekret. "Mbylle gojën..." i ishte përgjigjur ai ashpërsisht i ati. Atë mbrëmje, në prani të njerëzve të familjes, i ati i Verës e këshilloi Dhorën miqësisht: që për gjëra të tilla të mos fliste me asnjëri.

* * *

Ku të shkoj? Kujt t'ia hap zëmrën? Kush mund të më ndihmojë? Gjatë kthimit për në shtëpi ajo e torturonte veten me pyetje të tilla , në një çast ndjeu dhimbje koke, mendoi se mund t'i ishte ngritur tensioni, kohët e fundit për shkak të mbipeshës kishte nisur t'i luhatej tensioni nga 14 në 18-të . nëna e vet kishte vuajtur nga luhatjet e tensionit qysh në moshën dyzet vjeç, ajo po shkonte pesë dhjet e dy. Në shtëpi s'gjeti askënd, shyqyr, mori në telefon vajzën e madhe, atë mëngjes Enon e vogël e kishin çuar në kopsht me temperaturë , zëri i vajzës së saj vinte i qeshur, pra, vogëlushi ishte mirë. Duhet të gatuate për ditën e nesërme, mirëpo, iu kujtua që s'kishte përgatitur planin mësimor. Të premtet kishte pesë orë mësim, hapi fletoren dhe konstatoi me një gëzim të papërshkrueshëm, se tre nga pesë orët e mësimin ishin orë folklori, dhe çfarë rastësie...! Do të komentonte baladën "Kostandini dhe Dhoqina". Dhimbja e kokës i iku si me magji, në ditar shënoi vetëm dy rreshta: "Mbajtja e besës së dhënë...", kaq. Pa asnjë koment.

Të nesërmen u nis drejt shkollës me një drithërimë në zemër, sikur të shkonte në takim me vëllanë.

Sa herë që Dhora K. komentonte baladën e Kostandinit klasa zhytej në një heshtje varri, në ato pak çaste të paharrueshme ligjërimi i saj dilte nga përmasat reale, zëri i saj melodik kridhej në një botë mistike dhe imagjinare, pasi , kishte vite që Kostandinin e baladës e njësonte me Kostën e saj të dashur.

"Kostandin i vdekurith, / tre vjet i pa treturith..." vargjet i pëlqente t'i recitonte në variantin e lashtë gjuhësor, me prapashtesat "ith", që kishin dalë prej kohësh nga përdorimi gjuhësor. Edhe pse këto dy

vargje i pëlqenin pa masë, e shqetësonte fakti që pritja e Dhoqinës ishte vetëm tre vjet, ndërsa pritja e Dhorës po i kalonte të njëzetat.

* * *

Gjatë orëve të shkollës nuk pati kohë të kujtonte çfarë kishte menduar atë mëngjes, kishte vendosur të shkonte te Ruka, një fallxhore e moshuar e cila sa kishte dalë nga burgu, edhe pse e ndjente se ky vendim ishte në kundërshtim me kulturën e saj si mësuese letërsie “Po shkoj tek ime kunatë, mendoi . E shoqja e Kostës, Evanthia, e kishte shtëpinë pranë Rukës, një mur i vjetër i ndante , në rrugicën përballë “shkollës së Kuqe”. Ruka kishte bërë gjashtë muaj burg me motivacionin “Përfitim me anë të mashtrimit” pas daljes nga burgu, me kusht,, Ruka, kishte përzënë shumë gra hallexhesha që i trokisnin te porta për të parë fatin e tyre në filxhan.

Dhora K. ngriti telefonin dhe e pyeti kunatën, nëse kishte kohë të shkonin dy minuta te Ruka. “Dhora paska një hall”.mendoi ajo. “Ti hajde njëherë këtej, -iu përgjigj - kafet i pimë këtu, Rukës i çojmë filxhanët.” Evanthia nuk i kishte ndërprerë për asnjë rast lidhjet me Dhorën dhe me dy vëllezërit e Kostës. Dy vajzat e saj, ishin të rritura, e madhja me fëmijë, e dyta, e porsa martuar. Dhora e gjeti Evanthia në aneks, duke larë pjatat, deshi t’ia heq nga duart, por në çast ra zilja e derës, ishte mbesa e saj për të cilën kishte një dashuri të veçantë. U puthën e u përqaftuan, u ulën në kanape të kapura për dore, si dy motra, pa nënën në aneks duke larë pjatat , shkoi dhe ia hoqi nga dora.” Dhora në cep të kanapesë, siç e kishte zakon, sa herë vinte për vizitë në shtëpinë e kunatës, Evanthia në divanletin përballë zunë nga muhabetet, vetëm kur ajo u solli kafet në një tabaka të vjetër prej druri, u kujtuan për Rukën. Në orën gjashtë e tridhjetë minuta dy kunatat trokitën te porta e jashtme e Kollozëve, doli një vajzë e imët , paksa e frikur, sa pa Evanthinë u çel në fytyrë Ruka u ngrit nga krevati vetëm kur i thanë që kishte ardhur Evanthia me kunatën e vet, Kollozët ishin familje e vjetër Dibrane , ardhur në Tiranë para viteve tridhjetë. Ruka i priti me përzemërsi në dhomën e pritjes, një dhomë e rrënuar, me orendi të vjetra, dukej e heshtur dhe fytyrëngrysur, pas fjalëve të rastit Dhora K. nxori filxhanët nga çanta , në çast fytyra zhubra-zhubra e fallxhores u përflak nga një dritë profetike, fillimisht tërhoqi filxhanin e Dhorës, i hodhi një shikim të shpejtë si profesioniste, e përhodhi filxhanin nëpër duar, më pas nisi ta këqyrë me kujdes, në largësi e në afërsi... “Në punë je mirë..” Sytë i mbante picërruar përfund filxhanit.

” Dy fëmijë kini? ” ”Po. Dy vajza...” “Dhe fëmijët mirë i paske...Pa të shohim brenda shtëpisë...” Belbëzoi zë ulët, sikur të fliste me veten e vet. “ Shpirtin e ke qelibar...Gëzon respekt në familje dhe në shoqëri... Sëmundje nuk shoh...” Dy gratë ia kishin ngulur shikimin

frikshëm. Në dhomën e pritjes zotëronte një heshtje varri. Ajo bëri një pauzë të gjatë sikur të kërkonte të deshifronte diçka të rëndësishme që jepte shenja përmes dy rrëkesh të bardha në anët e filxhanit...” Të mundon një siklet i madh...S’ të hiqet nga mendja...” Herë pas here i hidhte Dhorës një vështrim rrëshqitazi, për të ndjerë reagimin e saj.

”Eh, ia bën , dhe kur të thonë “shëndet.” Hoqi sytë nga filxhani dhe ia shtyri sytë Dhorës në mënyrë qortuese ...” Ke disa kohë që ha vetën nga brenda... Një hall që ke s’guxon t’i thuash njeriu... “

”Për këtë gjë kemi ardhur.” – u përgjigj Evanthia në vend të saj. “Mirë. Unë do ta përplas këtë filxhan për tokë nëse filxhani nuk thyhet rrini e qetë.? -Pyeti Evanthia Ta hedh? “

”Hidhe, hidhe!” I dha kurajë ajo.” Në çast e vërviti filxhanin në dysheme...Filxhani bëri ca rrokullima të shpejta mbi qilim dhe u përplas në mur, pa u thyer. ”Mirë...” tha e qetësuar ajo...Dy kunatat kishin ngrirë në vend, ia kishin ngjitur sytë Rukës të sugjestionuara nga veprimet e saj të çuditshme.

”Ta provoj dhe njëherë?” Evanthia pohoi me kokë, ngriti filxhanin nga toka dhe ia afroi te dora, sakaq, filxhani i Dhorës bëri disa rrokullima të shpejta në qilim dhe u përplas përsëdyti pas murit.”Mirë...Mirë...” konstatoi ajo. “ Mos prisni të vijë dikush nga larg.” Një pyetje e çuditshme e cila kishte qëlluar rastësisht në shenjë. Dhora shqeu sytë me habi. “Si ka mundësi?”Ajo kishte njëzet vjet që priste dikë, të vinte nga larg, ky merak e sjellë gjer këtu.. –“Fol pa droje ...Këtu jemi në familje, s’na dëgjon njeri...” e shtyu me krah Evanthia kunatën e vet. Ndërkohë që ajo fliste Ruka e përplasi filxhanin edhe një herë , për çudi, as herën e tetë filxhani nuk pësoi gjë.

-“Mirë është!” – e siguroi ajo . Dhora u përflak në fytyrë, nuk e priste atë përgjigje të drejtpërdrejtë, trupin ia përshkuan mornicat.

Edhe pasi kishin lënë një pesëqind lekëshe mbi tavolinë dhe kishin dalë në rrugicë në mendjen e Dhorës bubullonte vetëm një fjalë: “Gjallë! Gjallë! Gjallë!”

* * *

Të enjten në mëngjes Dhorën e thërritën në drejtori, duhet të linte orët e mësimt dhe të paraqitej në Komitetin e partisë së Rajonit. E kërkonte sekretari i parë. “Për çfarë?” “Nuk di gjë.”- ngriti supet drejtori i shkollës” Kur ishte në korridor, mësuesja e anglishtes ,Vera , i dha kurajë ,”shpresoj të na vish me një lajm të mirë..” Kur hipi në autobus e kapi një ndjenjë ankthi, “Përse më kërkon?”asaj nuk kishte rastisur kurrë të shihte derën e seksionit të arsimit, jo më atë të Komitetit të partisë së Rajonit nr. 3. Në qendër pyeti një kalimtar ku gjendej selia e Komitetit të partisë së rajonit 3, “pesëqind prej këtej, një ndërtesë trekatëshe”. Shkallët i ngjiti nxitimthi, në hollin e katit të

parë s'pa njeri, brenda një dhomëze prej xhami, nën shkallë, nëpunësi i rojës ia bëri me dorë të afrohej.

"Jam një mësuese letërsie, më quajnë Dhora K. -u prezantua ajo,- më ka kërkuar shoku Karafil..." Nëpunësi i rojës u lidh me kabinetin e sekretarit të parë, e pyeti dhe një herë për emrin, më pas i tregoi katin dhe derën ku duhet të trokiste. Shkallët i ngjiti thujse nxitimthi. Karafil Guga, një burrë shtatlartë e vetulltrashë, me moshë sa duhet të ishte Kosta K., po të ishte gjallë, u ngrit në këmbë dhe i zgjati dorën përzemërsisht, e ftoi të ulej në këndin me kolltukë lëkure, ku pritëshin vetëm persona të veçantë..

"Ju jeni motra e Kostës? Dhora nuk e priste këtë hyrje, -Kostën e kam pasur shok, -vijoi ai. - Gjatë kohës së luftës kemi qenë në të njëjtin batalion. Ka qenë burrë. Njeri me karakter...Po dhe trim. Ruaj kujtimet më të mira për vëllanë tuaj.

-Besoj e dini ..? Ajo nuk e kuptoi s'e çfarë dinte ai...Karafil Gugës iu ravijëzuan dy rrudha të thella mbi ballë "E dini përse ju kam thirrur? Kohët e fundit, me ca veprime të pa menduara mirë, keni futur në siklet Partinë dhe shtetin....Dhe veten tuaj."

Dhora K. e pa me frikë, po ai nuk e la të mendohej gjatë.

-Ke hapur fjalë se paske parë Kostën, të gjallë... I hodhi një shikim zhbirues.-A e di çdo të thotë kjo? Kjo fjalë ka shqetësuar jo vetëm sigurimin e shtetit dhe partinë, por vetë kryeministrin...Ai ka dhënë urdhër t'i shkohet çështjes gjer në fund, dhe të sinjalizohet sa më parë. Ai kërkon të dijë, kush e ka përhapur këtë fjalë. Sigurisht, s'besoj se jeni ju?

Dhora K. u përflak në fytyrë, çështja ishte një rëndësie të jashtëzakonshme.

-Nëse është fjala për një bisedë që unë kam bërë si me shaka, me një shoqen time, nisi të shpjegohej ajo...Eshtë e vërtetë që, një mëngjes, duke shkuar për në shkollë, kam parë një njeri që i ngjante aq shumë tim vëllai. .

-Nuk është kaq e thjeshtë, -ndërhyri ai me tone më të ashpra. -Sipas informacionit që na kanë sjellë ju keni vite që mendoni se Kosta është gjallë.-Nuk duhet ta mohoni, as këtu dhe as në ndonjë vend tjetër, kur të të thërrasin, pasi ,ka dhe dëshmi të tjera, tepër tronditëse, të cilat kanë dalë nga goja juaj

-Goja ime?

-Po. Po. A e dini çdo të thotë kjo? Në vitin që është vrarë Kosta, Ministër i brendshëm ka qenë kryeministri ynë. E kuptoni pse është shqetësuar vetë kryeministri i vendit? Çështja është shumë e thellë, dhe me pasoja të paparashikueshme....-Fjalë të tilla mund të përhapen vetëm nga një i çmenduar, ose nga ndonjë armik i rrezikshëm.

Pas këtyre fjalëve Dhorës iu duk sikur po i rrotullohej zyra ku ajo gjendej.

-Ti nuk e ke parë Kostën. Kështu, apo jo? Vijoi ai ,duke e zhbiruar në sy.

-Si ta shoh? Ku ta shihja? Veç të isha e çmendur.

-Po pra. - u duk sikur uli zërin ai. Ju dukeni e lodhur. Mos vuani nga shfaqje vegimesh?

-Jo, -iu përgjigj ajo me naivitet. Gjer më sot s'kam pasur shqetësime të tilla.

-Gjithsesi, unë mendoj të bëni një vizitë te mjeku psikiatër.- Intonacioni i zërit të tij kishte një nuancë këshilluese, por qartësisht urdhërues.. -Po. Po. Unë ju këshilloj të shkoni te një mjek psikiatër, urgjentisht, para se t'ju thërrasin diku.

Ndërsa ai fliste Dhora K. e ndjente veten sikur të kishte rënë papritur në një humnere të thellë. Mos ishte në ëndërr?

-Zoti sekretar, ju mund të më mendoni një grua naive, që nuk di ta mbrojë veten...

-Ju kam thirrur këtu për t'ju ndihmuar..- thirri ai.- Dëgjojini mirë këto që do t'ju them. Uli zërin për të kuptuar se çdo gjë që thoshte më pas ishte tepër sekret :

” Vetëm me një raport mjekësor ju mund t'i shpëtoni hetuesisë. Ndryshe...” Nisi të tundë kokën në mënyrë ndjellakeqe.

* * *

Mëngjesin tjetër një furgon policie u shfaq në oborrin e shkollës “Kostandin Kristoforidhi.” Kërkuan drejtorin, më pas, me urdhër të drejtorit, Dhora K. la mësimin dhe u paraqit në drejtori. Përveç pastrueses dhe portierit të shkollës askush nuk e pa mësuesen e letërsisë të dilte atë mëngjes nga dera e shkollës e shoqëruar nga dy policë, pranë furgonit e prisnin dy policë të tjerë për ta shoqëruar në hetuesi, fillimisht i thanë “vetëm për ca sqarime të nevojshme”, vetë ata do ta sillnin përsëri në shkollë. Vetëm kur pa derën e spitalit psikiatrik kuptoi me tmerr rrezikun që i kanosej, me një urdhër të posaçëm po e shtronin në spitalin psikiatrik.

Dhora K. qëndroi shtatë ditë e mbyllur në një dhomë të katit të katërt të spitalit psikiatrik të Tiranës. Gjatë atyre ditëve nuk lanë askënd të takohej me të, askush nuk e mori vesh kush e kishte dhënë atë urdhër. Njerëzit e familjes së saj , kërkuan ta takonin qysh atë ditë por nuk e lanë...Të shoqin e saj e thirrën në hetuesi dhe e mbajtën rreth dy orë. Para se ta thërrisnin në hetuesi ai u përbetua se , si ushtarak që ishte do të ngrinte gjithë shtetin në këmbë, por doli nga hetuesia si një pulë e lagur. E pyetën nëse dëshironte ta shoqëronin me makinën e shefit të tyre, jo,u tha , kam nevojë të ec në këmbë. Bisedat e shkëmbyera në hetuesi s' ia tregoi askujt. .Eshhtë një keqkuptim, u tha fëmijëve atë mbrëmje, por mos u bëni merak, Ditën e tetë e lajmëruan të gjendej para portës së spitalit, fiks në orën nëntë të mëngjesit. Gjysmë ore para një taksi e verdhë ndali në oborrin e spitalit psikiatrik, dhe pyeti për

pacienten që do të dilte atë mëngjes, “po vishet”, i thanë. Pas pak ai pa të shoqen duke zbritur shkallët ngadalë , e zbehtë dhe e rrënuar. Ditën e parë e kishte vizituar grupi i mjekëve të psikiatrisë, dhe ajo, duke sjellë ndërmend fjalët e Karafil Guga, kishte pranuar të thoshte se kishte vite që i dilte para syve hija e vëllait të saj, dhe se ajo kishte vite që fliste me hijen e tij .

Ia kishin këshilluar ta lozte me detyrim rolin e një të sëmure mendore dhe ajo gjatë atyre ditëve, duke mos pasur rrugë tjetër ishte munduar të luante këtë rol të vështirë, kishte pranuar të provonte elektrohokun dhe dozat e përditshme të Piramidolit, me frikën se dhe një ditë më shumë po të kishte zgjatur kjo torturë, ajo do të ishte çmendur vërtetë. Në shkollë u paraqit dy ditë më vonë , shokët dhe shoqet e saj edhe pse dinin gjithçka rreth fatkeqësisë së saj, askush nuk ia zuri në gojë, bënë sikur s’ dinin gjë dhe prisnin t’ua thoshte ajo vetë “Ç’pate? –e pyesnin me një interesim të shtirur,-ne menduam të të vinim për vizitë në shtëpi por, na thanë që ishte shtruar në spital për të bërë analiza...Vetëm drejtori i shkollës ishte në dijeni të plotë për gjithçka kishte ndodhur. Mësuesja e anglishtes u përpoq të përhapte një variant tjetër, sikur kishte pasur shqetësime psikike për shkak të ndërprerjes së menstruacioneve, dhe... e kishin shtruar në spital pa dëshirën e saj. Ndryshe si mund të justifikohesh furgoni i policisë në dyert e shkollës të cilin e kishin marrë vesh të gjithë kolegët e saj? Gjithsesi, paraqitja në Komitet të Partisë dhe ditët në spitalin psikiatrik i kishin shtuar dyshimet se më Dhorën po luhej një lojë e madhe, të cilën e dinin vetëm disa pushtetarë të rëndësishëm.

Dy javë më vonë ndodhi një ngjarje që tronditi gjithë vendin. Kryeministri i Shqipërisë i gjendur në këtë post prej tridhjetë vjetësh u vetëvra në mesnatë. Asnjë sqarim më tepër Gjatë gjithë asaj ditë te vrenjtur dhjetori Radiotelevizioni Shtetëror dha vetëm muzikë mortore. Në lajmet e orës tetë u mor vesh se kryeministri i vendit kishte vrarë veten pas një mbledhjeje maratonë të Byrosë politike, ku ai kishte bërë dhe një autokritikë të gjatë në lidhje me një martesë të dyshimtë të djalit të tij me një vajzë simpatike nga një shtresë e deklasuar. Dy ditë më vonë pati thashetheme se nuk ishte vetëvrasë por e kishin vrarë...Gjëra të çuditshme kishin nisur të ndodhnin në Bllok, një vrasje enigmatike si në tragjeditë Shekspiriane. Nisi të pëshpëritej në popull se do të kishte ndryshime..ndërkohë që Enver Hoxha doli në ekran me një pamje të zbehtë e disi të çoroditur. Pra, po ndodhte diçka e pa parë...Njerëzit pëshpëritin vesh më vesh, nisën të gjallëroheshin qytetarët dhe thashethemet rreth ngjarjeve të fundit. Kishte ardhur një kohë ndryshimesh...Dhora K. as gëzohesh as hidhërohej nga ngjarjet e fundit. Gjatë atyre ditëve të spitalit ajo e kishte çuar ndërmend disa herë kryeministrin e vendit, përse të shqetësohej aq shumë nga ngjallja e Kostës? Përse i trembej ai fantazmës së vëllait të saj të gjallë. Historia e vëllait të saj a kishte lidhje me vetëvrasjen e kryeministrit? Atë vit kryeministri kishte qenë Ministër i brendshëm, sado e

çuditshme të të dukej, lidhja e fakteve të çonte te një enigme të cilën kryeministri e kishte marrë me vete në varr

* * *

Tashmë, askush nga njerëzit e afërm të familjes së tij nuk vinte në dyshim se Kosta K. ishte gjallë, e kundërta kishte ndodhur me Dhorën, ishte tmerruar aq shumë nga ato ditë ferri që kishte kaluar në spitalin psikiatrik, saqë kishte besuar dhe vet se duhet të ishte një e sëmurë psikike, kishte marrë një pamje të rrënuar, nuk i hiqeshin nga mendja ato ditë torturash , ndonëse, hera-herës në trurin e saj shkëndijonte një llambushkë e vogël për të ndriçuar enigmën e njeriut gjysmë i gjallë e gjysmë i vdekur. Me ndryshimet demokratike, dhe Dhora nisi të gjallërohej, tashmë kishte dalë në pension, dhe kishte kohë për t'u marrë me dosjet e pronave të familjes së saj, në arshivën e shtetit, dhe dosjen sekrete të dënimit të vëllait të saj, në arshinë e Ministrisë së punëve të Brendshme. Për pronat gjetën disa dokumente arshive, ndërkohë që dosja e dënimit të Kostës në arkivin sekret të Ministrisë së Brendshme e kishin zhdukur. Ky fakt e rriti dhe më tepër dyshimin se me jetën e tij diçka kishte ndodhur. Kishin kaluar tridhjetë e dy vjet nga ikja e tij....E shoqja e Kostës, vdiq atë vit që ndodhën trazirat në Shqipëri, nuk arriti t'i gëzonte ndryshimet demokratike. Dhora K. vdiq Sigurisht ata që e kishin dashur aq shumë, dhe e kishin pritur për së gjalli e kanë takuar me shumë mall në botën tjetër. Vetëm legjenda e Kostës ka mbetur ende gjallë, si legjenda e Kostandinit dhe Dhoqinës, se njerëzit vdesin, por legjendat nuk vdesin kurrë

.....

Njeriu me dy emra

Do t'ju rrëfej shkurt, fare shkurt, historinë e një mikut tim nga komuna e Pejës. Në fund të viteve 40-të ai kaloi kufirin dhe u hodh në Shqipëri. Përse e la vendin e vet të lindjes dhe përse u detyrua të kalojë vijën kufitare, duke provuar rreziqet që e prisnin në kufirin midis dy shteteve, për një trill, apo duke e ëndërruar vendin amë si kep in e shpresës së mirë?

Në atë mëngjes shtatori, rojet tona kufitare e kishin pikasur djaloshin e ri në çastin tek flinte paq, në një lëndinë të bukur, rrethuar nga të gjitha anët me pisha.

Djaloshi kosovar, i lodhur, dhe i stresuar nga emocionet dhe tmerr i kalimit të vijës kufitare, kur ndjeu që gjendej në tokën shqiptare, u shtri mbi qilimin e barit dhe kishte bërë një gjumë të ëmbël, plot ëndrra. Rojet kufitare e prisnin të zgjohej, të ulur aty pranë. ai hapi sytë nën një diell verbues, u ngrit në këmbë, atë çast iu kujtuan vargjet të Naimit... "O malet e Shqipërisë dhe ju o lista e gjatë..." të cilat kishte dashur t'i recitonte me zë të lartë, vuri re që iu afruan dy roje kufitare, të cilët, qetësisht dhe me mirësjellje e pyetën për emrin, i kërkuan ndonjë dokument identifikimi, ishte ai çast fatlum që djaloshit nga Strella ia dha truri të trillojë një identitet të rremë i cili do ta ndiqte pas gjithë jetën.

Në moshën njëzet vjeçare Jeton Shatri ishte një djalosh biond, me vështrim të vendosur e me trup atleti, vëlla i dy motrave dhe tre vëllezërve, të rritur para kohe me urrejtje ndaj pushtuesit serb, edhe për shkak të vrasjes së të atit të tyre tre vjet më parë. Sipas thënieve të një dëshmitari që i kishte shpëtuar masakrës së Tivarit, Ramadanin, partizan i orëve të para dhe pjesëmarrës i mbledhjes së Bujanit, e kishin qëlluar me plumb pas shpine dhe e kishin hedhur në lumë, në të hyrë të Shkodrës.

Ishte pikërisht kjo ndjenjë hakmarrjeje me të cilën po rriteshin pesë fëmijët e familjes Shatri, por, vetëm njeri prej tyre do të thurte plane në fshehtësi për t'u hakmarrë ndaj njerit prej vrasësve të atit të vet, i cili, sipas po atij dëshmitari që kishte denoncuar vrasjen e Ramës, kishte nxjerrë emrin e Milla Cerковиçit, tashmë komandant i garnizonit të Komunës Pejës që merrej me rekrutimin e ushtarëve të rinj.

I vetmuar dhe në një fshehtësi të plotë Jeton Shatri kishte ndërmarrë dy herë rrugën për në Pejë, i shtyrë jo vetëm nga ndjenja e hakmarrjes por dhe kureshtar për ta parë në fytyrë njeriun e zi i cili e kishte hedhur trupin e të atit të tij në ujërat e Bunës. Rrugëtimi i parë gjer në Pejë kishte shërbeu për ta parë së largu dhe për të fiksuar në mend zyrën e tij e cila gjendej në katin të parë të një ndërtese private, e sekuestruar nga shteti pas çlirimit të Jugosllavisë. Hera e dytë nuk i shkoi kot, me vrasësin u përball aty te kafja e vogël përballë Komunës, atë e shoqëronin dy punonjës civilë, në kafe ata zunë një tavolinë përballë, ai u ndesh me shikimin e tij të qetë. Nuk do të

ndizej gjaku, nëse në atë çast nuk do të përfytyronte të atin e përgjakur.

* * *

Atë mbrëmje ai u kthye në fshatin e tij Strellë e vogël, i çliruar nga ai makth vitesh që e kishte zënë për gryke, kishte parë vrasësin e të atit. Ishte muaji maj, prag provimesh. Edhe në intervalet midis provimeve të maturës ai shkoi dy herë në Pejë, me autobusin e linjës, vërtitej rreth ndërtesës së garnizonit pa u vënë re, duke përcaktuar në detaje vendin nga ku i duhej të shtinte, çastin kur Milla Cerkoviç vinte në punë, rrugën nga vinte, orën kur dilte për të pirë kafën e mëngjesit...në një nga ato çaste, duke qëndruar në një distancë rreth njëzet metra larg dritares së zyrës së tij, pa sërish atë figurë të urryer duke thithur cigaren, dritarja e zyrës që binte mbi lumë ishte lënë hapur. I gjendur në atë çast te cepi i urës i lindi ideja se, varianti më i mundshëm për të qëlluar në drejtim të tij ishte pikërisht ai vend. Gjatë kthimit për në Strellë nëpërmendi dhe variante të tjera, revolverin e kishte siguruar prej kohësh, vendin e dinin dhe dy vëllezërit më të mëdhenj. Shqetësimi i tij nuk ishte vrasja, por pasvrasja. Peja nuk është fort lart nga kufiri shqiptar shtetëror, mirëpo, në raste të tilla do të ishte marrëzi të zgjidhje si shpëtim kalimin e kufirit.

Në ato katër muaj pritjeje të nderë, urretja ndaj vrasësit piquej ngadalë, siç piquet fryti në degë. Erdhi ai çast kur nga variantet e mundshme triumfoi vetëm më i sigurti, më i shpejti, më reali dhe më i arsyeshmi.

Kishte dhe një arsye tjetër për të përmbushur para kohe betimin e tij, dy ditë para se të kryente atentatin i erdhi fletëthirrja për ushtar? Nuk pati kohë të mendohej gjatë, mendja e tij i punonte për një çështje madhore.

Në gjithë këtë histori ka një detaj jo pa rëndësi, Jeton Shatri ishte një lexues i pasionuar, Dostojevski ishte autori i preferuar, kryeveprën e tij mbante romanin “Krim e ndëshkim”

Në ato ditë mëdyshjesh, i shkrepiti një paragraf i tij ku thuhej; “*Nëse do të fshehësh diçka, fshihe në një vend të rëndomtë, që të mos i shkojë mendja askujt, si për shembull nën një gur... në mes të fushës.*

..Ky vend i rëndomtë për Jeton Shatrin ndodhej përballë ndërtesës së Garnizonit, nga ana tjetër e lumit, nën ca hedhurina të vjetra, ndër të tjera dhe një kapotë e vjetër ushtarake, nën një plep te vetmuar. Pa më thoni tani, cili ekspert kriminalistike mund të mendonte që vrasësi, në rastin konkret vet hero i ynë, si të kishte qëlluar mbi Milla Cerkoviç, s’do të lëvizte nga vendi i krimit?

Një fshehje e tillë gjithkujt do të dukej diletante. Jetonit kjo gjetje iu duk gjeniale, Ja, pra pse them unë që te hero i këtij tregimi, nën

ndikimin e disa romaneve që kishte lexuar, kishte ndodhur ajo që i kishte ndodhur dikur heroit të Mançës..

Vrasja u bë në 14 shtator, në çastin kur në qendër të Pejës ishin ndezur dritat, dhe Milla Cerковиç , për fatkubin e tij do të shfaqej te dritarja e zyrës, me cigare në buzë. Pragmbrëmja e atij 14 shtatori do të mbahet mend nga të gjithë banorët e qytetit të Pejës, ishte hera e parë që dëgjonin një vrasje aq të bujshme, dora vrastare nuk do merrej vesh kurrë.

* * *

Jeton Shatri e kreu atë vrasje me një vetëdije të ftohtë, por, s'mund të them gjer në çfarë shkalle kjo ndjenjë ka qenë e vetëdijshme. Janë disa persona te të cilët drejtësia shndërrohet në një instinkt, mund të them me bindje se ai kishte lindur me instinktin e drejtësisë, i cili mund ta çonte gjer në flijim. Tek disa persona, instinkti i drejtësisë çliron një energji e cila, gjen kohën të kthehet në Bumerang. Të shkosh me vetë dijë drejt një qëllimi, si drejt një dritëze që fërgëllon në fund të një labirinti të errët, qoftë dhe duke shkelur mbi kufoma.

Jeton Shatri, shkeli vetëm mbi kufomën e vrasësit të të atit, nuk shkeli, e la aty, të përgjakur, dhe iku , pa asnjë alarm në sy, iku si ai njeriu që pasi kryen detyrën e vet e hedh armën për tokë, as armën nuk e hodhi për tokë, e futi nën këmishë. Dyzet e tetë orë qëndroi pa lëvizur nën ca lecka, dhe atë kapotën e grisur ushtarake edhe pse iu tha buza për një pikë ujë, të pasnesërmen në mesnatë, do ecte anës së lumit, sipas koordinatave të sakta të studiuara kohë më parë, doli nga lumi, më pas iu ngjit Bjeshkëve të Nemuna nga ku do të kalonte kufirin për t'u hedhur në Shqipëri.

I kishin treguar se për t'u hedhur në Shqipëri, duhet të ngjiteshe në Bjeshkët e Nemuna, ishte një dhiare e cila zbriste malit thikë , pa u pikasur nga rojet kufitare, nëse kalimi bëhej natën, ishte pikërisht ajo dhiare e bekuar nga zoti, ku s'mund të dëgjohej thirrja e frikshme. "Ndal! dhe breshërima e plumbave. Ishte një natë pa hënë, në çastin që ai mendoi se ndodhej në tokën shqiptare, e kapi një drithërimë gëzimi, e ngriti revolverin në ajër dhe e flaku larg, shumë larg, si të ishte një send pa vlerë.

"O Zot më fal,- tha në atë çast me vete, -por ai e meritonte."

* * *

Ndofta do të bëheni kureshtar të dini ç'ndodhi më pas. Imagjinoni edhe ju çdo të thotë një njeri i vetmuar , pa shtëpi e pa njeri, të vërtitet në një qytet të cilin e ka parë në ëndërr, kryeqytetin e atdheut të tij amë. Pas ndjesisë së mirë që i lanë atë mëngjes dy rojet, ushtarë të rinj të shërbimit kufitar, siç mund të kishte ndodhur të ishte dhe ai në ato caste, të tjera emocione do të përjetonte në zyrën e komandantit të

degës së Punëve të Brendshme të Shkodrës. Qysh kur e pa, para tavolinës së tij të punës, fytyrëngrysur e me një shikim të dyshimtë, i shkoi mendja për keq, marrëdhëniet e shtetit shqiptar me atë jugosllav aso kohe ishin në muajin e vet të mjaltit, mos vallë ky njeri që kam përballë di gjithçka, ka marrë vesh gjithçka ndodhi atë mbrëmje në qytetin e ftohtë të Pejës? Pyetjeve të tij iu përgjigj shkurt. me po dhe jo.. Arsyen e vërtetë përse e kishte kaluar kufirin e shpjegoi si një ëndërr e ushqyer në vite, për të qenë vazhduar studimet në Universitetin e Tiranës, në degën e letërsisë. Pyetjes nëse kishte njerëz të afërt në Shqipëri iu përgjigj duke mohuar me kokë. Emrin e një djalë xhaxhai që punonte në organet e sigurimit të shtetit nuk e përmendi fare, para kryetarit të degës përsëdyti dhe njëherë emrin e tij të rremë, pra, tani e tutje, e mbase gjatë gjithë jetës së tij ai do të quhej Jeton Shatri.

* * *

Vetëm dyzet e tetë orë e mbajtën në zyrat e degës së punëve të brendshme të Shkodrës, gjatë atyre orëve ai hapi çantën ku mbante vetëm libra, ndërmjet syresh dhe romanin e preferuar të Dostojevskit, „Krim e Ndëshkim”, të cilin e tërhoqi dhe nisi të përqendrohet nëpër paragrafët që ai kishte nënvizuar me bojë të kuqe. Në mbrëmje ai u mor në pyetje nga një oficer i moshuar të cilit i kishte takuar roja e shërbimit të asaj nate. Ditën tjetër e mori në pyetje një hetues ushtarak i veshur civil, i cili kishte ardhur enkas nga Tirana. Quhej Shezai Dorsi, një djalosh i ri, kishte një të folur të qetë me zanore të zgjatura në rrënjët e fjalëve, karakteristikë e të folmes labe.

Edhe pse hetuesi i ri u tregua i njerëzishëm me të ardhurin nga Kosova, prej tij u dëgjua i njëjti refren: „Kam ardhur veç për me vazhdue studimet e larta... E kam pas andërr me studju për letërsi në Universitetin e Tiranës.” Shezai Dorsi kishte mbaruar fakultetin Juridik dhe ishte emëruar Jurist në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ai kishte dobësi për Kosovën dhe kosovarët, në fytyrën e tij u shfaq asnjë grimë dyshimi, ai kishte pasur një xhaxha që gjatë viteve të para kishte punuar si arsimtar, në komunën e Ferizajt, dhe ishte ndarë prej andej me përshtypjet më të mira. Dy ditë më vonë erdhi vendimi nga Tirana për ta lënë të lirë. Nga zyrat e degës së brendshme e përcollën me respekt të veçantë. E pyetën ku dëshironte të sistemohej. Në Tiranë, -tha ai pa hezitim. Atë çast falënderoi me mend hetuesin e ri, i cili i kishte lënë adresën e vet, duke i thënë: „nëse vjen në Tiranë, për çfarëdo problemi që do të kesh kërko mua.”

Harrova t’ju them, çanta me libra ndikoi për mirë në opinionin që u krijua për të. Kur i bënë kontrollin e trupit i gjetën në xhep 1000 dinarë jugosllavë, të cilat nuk do të hynin në punë për asgjë, në çastin e përcjelljes i dhanë 2000 lekë shqiptare, pare xhepi.

Ishte ora dhjetë kur doli nga ndërtesa e Degës, gjatë gjithë asaj dite u end në qytet, kishte dëgjuar shumë histori për Shkodrën e Migjenit e të Fishtës, Shkodrën e Dasho Shkrelit, Shkodrën e shkodranëve të qytetëruar, e kishte ëndërruar këtë qytet verior ta shihte një ditë, dhe ja, si në një ëndërr të bukur kjo ditë kishte ardhur,, nuk u besonte dot syve që gjendej në Shkodër, dhe shëtiste i lirë dhe i shpenguar nga çdo brengë rrugëve të saj.

Qëllimi i tij i mbramë ishte Ura e Baçallëkut, nuk mund të ikte nga Shkodra ashtu, pa parë vendin ku kishin hedhur trupin e të atit të gjorë. Kur ra mbrëmja dhe ai u gjend më së fundi te vendi i krimit, pati ca të rrëqethura në trup. Më pas e ndjeu veten si të mpirë. Fakti që gjendej shumë pranë eshtrave të të atit nuk i zgjonte asnjë ndjenjë... Eshtrat e tij kishin përfunduar në det...po shpirti i tij endej akoma në atë vende, shpirti i tij ishte shndërruar në frymë, në ndjesi. ”Baba, e mbajta fjalën.” tha me gjysmë zëri të dridhshëm.

* * *

Dita e parë në Tiranë takoi një mesditë diellore. Sa pa Sahatin e madh, që larg, dhe iu drodh zëmra. Tirana që kishte ëndërruar. Kryeqyteti i vendit amë... Tirana ime e dashur. Më ke pritur? Të erdha... Nuk i durohej sa të mbërrinte në qendër, sikur ajo të ishte pikëmbërritja e ëndërruar dhe arsyeja e kalimit kufitar, dhe i të shtënave mbi trupin e komandantit të garnizonit të Pejës. Kur u gjend në qendër të Tiranës i tërhoqën vëmendjen fotografët e shumtë, i dolën para me aparate në dorë duke i propozuar me mirësjellje për ta përjetësuar atë çast, sikur ta dinin që Jeton Shatri vinte nga një botë tjetër. Nuk bëri një por tri poza në tri pozicione të ndryshme, në çastin që po merrte faturën i shkoi ndërmend të pyeste për kushëririn e tij. Fotografët e qendrës kishin informacion për gjithçka mund të kërkonte një i huaj. “ Haki Pejën? -tha më i moshuari, - si nuk e njohim. Punon në Ministri të brendshme. Banon në pallatet Shallvare. E ke tek ajo ndërtesa atje.”

Jetoni u nis drejt ndërtesës portokalli, e cila në pamje të parë nuk i la ndonjë ndjenjë të frikshme. E pati të vështirë të komunikonte me rojën, i cili nuk të shikonte në sy, i priste të gjithë hundë e buzë duke iu përgjigjur prerë: “Nuk është...”Nuk ka pritje...”Eshtë i zënë...” Jetoni iu duk se po e rrente kur i tha “Nuk ndodhet në zyrë”. U vërtit pak kohë, kur u kthye sërish ,roja ngriti kokën, nga e folura mendoi se do të ishte njeriu i tij, “Nuk vjen sot.” i preu shpresat Jetonit me një vështrim dashamirës.

Në atë çast Jetoni mendoi se do të ishte më mirë t’i shkonte mbas dite në shtëpi. Haki Peja ishte i vetmi kushëri i tij, njeri i tij me influencë në shtet, ish partizan, pas çlirimit kishte veshur uniformën e oficerit dhe ishte emëruar në Shqipëri, fillimisht në ambasadën Jugosllave, më

pas në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Askush nuk e dinte hollësisht me çfarë punësh të brendshme merrej.

U vërtit i lumturuar rrugëve gjersa vuri re dy akrepat e Sahatit të madh të puthiteshin te numri gjashtë. Natyra kureshtare ia tërhoqi këmbët gjër te ato ndërtesat me tullë të kuqe të shallvareve, ndërkohë që kishte rënë plotësisht mbrëmja dhe mbi shtyllat e neonit nisën të fërgëllonin dritat si krahë pëllumbash, pa disa fëmijë që loznin me potere “Kukamshehti” te sheshi brenda pallateve.

Jeton Shatri nga natyra ishte dyshues, një dyshues i qetë, i hollë dhe i vëmendshëm. Nuk jam në Jugosllavinë e Titos, mendoi, jam në Shqipni. Iu afrua vajzave të vogla që loznin te shkallët e hyrjes së pallatit dhe pyeti për familjen Shatri..

Një vajzë e hollë dhe e gjatë, me fustan përmbi gju u ngrit në këmbë dhe i tregoi dritaret e apartamentit të katit të tretë. Atij i erdhi mirë që kushëriri i tij ishte një njeri i njohur dhe i respektuar në ambientet ku banonte. Shkallët i ngjiti ngadalë... Sikur ta shtynte dikush nga pas. Në sheshpushimin e katit të tretë ndaloi, mori frymë thellë dhe i ra ziles. Doli te dera një fëmijë me shikim të çuditur, u tremb nga i panjohuri dhe hyri brenda duke e lënë derën gjysmë të hapur. Atë çast doli një grua e bëshme, me veshje shtëpie.”Kë kërkoni? e pyeti duke e hetuar në fytyrë atë farë djaloshi shtatgjatë që nuk e kishte parë kurrë. “Zotin Haki...- i tha Jetoni . Gruaja e bëshme e cila duhet të ishte e shoqja qëndroi në mëdyshje, i hodhi dhe një shikim të dytë të panjohurit dhe u fut dhe ajo brenda, duke e lënë në pritje . Vonesa zgjati vetëm pak sekonda ndërkohë që Jetonit iu duk se po qëndronte aty, në errësirën e sheshpushimit, në një pritje pa fund. Pas pak ajo u kthye për t’i thënë se i shoqi nuk ndodhej në shtëpi, dhe për të mbyllur derën. “Nuk ndodhet në shtëpi?- mendoi Jetoni duke zbritur shkallët.- Atëherë përse duhet të më linit të prisja? Përse nuk ma thatë qysh në fillim? Edhe pse e kishte kapluar një nervozizëm i brendshëm, e ndjente veten të qetë. Atë mbrëmje ai pati shumë hamendje për atë qëndrim fyes dhe poshtërues, por shkaku e vërtetë s’ do ta mësonte kurrë.

Ishte ajo fjala “zotni”, e hequr prej kohësh nga fjalori i shqiptarëve, që e bëri atë të largohej papritur? Mos vallë, roja te hyrja e Ministrisë i ka bërë një përshkrim të saktë portretit tim dhe ai ka menduar ...

I sistemuar në hotel “Çajupi” kaloi sërish në filtrin e një arsyeje të ftohtë lloj –lloj dyshimesh.Konkluzioni:Sa mirë që s’e takova ! Me këto mendime në kokë u vërtit dhe pak çaste në krevatin e drunjte të atij hoteli të vjetër, mbi të cilin binin dritat e llambave të bulevardit, gjersa e zuri gjumi.

Të nesërmen u ngrit qysh herët, kishte vendosur të takonte një mik e atit i cili jetonte në një fshat të Lushnjës. Kur zbriti te stacioni i trenit dhe pyeti ku ndodhej katundi Savër, mori vesh se nuk ishte aq afër sa i kishin thënë. Dy tre orë të mesditës i kaloi me dorën lart , në kryqëzim të rrugëve, ndodhi që kaloi një zetar i cili shkante në Savër, “Hip!” i thirri shoferi, një djalosh vetullzi, i cili kur gjendej në timon kishte

dëshirë të këndonte këngë qaramane. Gjatë rrugës, pasi mori vesh pse kosovari shkonte në Savër, ai i tha; “ Do t’i prishësh punë vetes dhe atyre fakir fukarenjve.” Fjalën “fakir” Jetoni nuk e kuptoi, por fjalën fukara e njihte mirë.

Zetoristi e zbriti në fushë të hapur nga ku dukeshin ca shtëpiza të ulëta, të mbuluara me kashtë e të thurura me kallama e të ngritura nëpër fushë pa asnjë rregullsi.. Re të zeza ishin ulur mbi fushë. Jetoni qëndroi pak çaste në cep të udhës, për t’u orientuar me këtë pamje apokaliptike e cila i dukej si fundi i botës. Një vajzë me fustan basme i kaloi pranë, po kthehej nga shkolla e mbrëmjes, me çantë nën sqetull. Iu afrua dhe me mirësjellje e pyeti nëse e njihte një kosovar me emrin Bislam Gjinovsi. Po, tha ajo dhe u tregua e gatshme për ta shoqëruar gjer tek banesa e tyre njëkatëshe e ndodhur anës rrugës, duke ecur krah tij , ajo i hidhte të huajit, herë pas here, një bisht-syri të frikur. Te lesa e banesës së tyre vajza ndali dhe thirri emrin e një vajze që quhej Ferinaze. Nuk iu përgjigj kush. Sakaq , një plakë e rrëgjuar doli te dera, vuri dorën mbi sy, pa të panjohurin, u tremb dhe u fut brenda, më pas doli një fëmijë kureshtar i cili s’pati kohë të shihte të panjohurin pasi u tërhoq me forcë, nga brenda. Në atë çast Jeton Shatrit iu kujtuan fjalët e zetoristit,” Do t’i prishësh punë vetes dhe atyre fakir fukarenjve...”, i ktheu shpinën dhe u kthye nga kishte ardhur. Pasi u nda me vajzën dhe u ngjit në rrugë, ktheu dhe një herë kokën dhe vuri re të gjithë familjen e madhe të Gjinovsëve, të mbledhur grumbull kishin dalë te dera duke e përcjellë me sy largimin e tij.

Atë çast ,sikur ta kishte prurë zoti vetë atë lushnjarin me zetor. Zetoristi e kishte parashikuar këtë pritje,ai kishte menduar dhe që të huajin s’ duhet ta linte në Savër, hodhi thasët me bukë tek dera e kooperativës dhe në kthim frenoi me zhurmë pranë këmbeve të tij. “Ee...?”i tha .-A s’të thashë?”Hip shpejt ,se do na zërë nata në Savër.”

* * *

Ju premtova që s’do të zgjatem në imtësi të panevojshme, mirëpo, kur gjendesh para letrës së bardhë, idetë fshihen nga të gjitha anët dhe ngjarjet nisin të sulmojnë njëra tjetrën, sidomos kur ke të bësh me ngjarje të një të kaluarë të largët...Nuk jam i qartë nëse gjatë shkrimit jam duke ndriçuar çfarë është me rëndësi, për ta ditur dhe ju, dhe çfarë duhet të shtyj në harresën e përjetshme. Në vitin e parë të fakultetit Jeton Shatrin unë e kam pasur në kurs. Nga gjithë ai vit mbaj mend një grindje që ai pati me profesorin e lëndës “Hyrje në gjuhësi” e cila u bë shkak për ta lënë fakultetin. Profesori, një shkurtabiq me pamje të zbehtë si negativ filmi, “sytë e tij ngjanin me sytë e një njeriu të varur, ndonjëherë me një lloj shtrese të hollë gjumi.”

“Po të krijoj mundësinë e fundit,- iu drejtua Jetonit,- Shiroka në poezinë e tij si e përdor fjalën shpresë?”

-Shpënesë,- iu përgjigj Jetoni i sigurt.

“Ik!”- thirri ai, sikur në atë çast të ishte zgjuar nga gjumi.

Jetonit i hipi gjaku në kokë, bëri një gjest, i cili, mua që në atë çast isha dy hapa larg tij, m’u duk se mund ta qëllonte me grusht. Dora e tij ishte zgjatur për të mbledhur librat e shpërndara mbi tavolinë: “Po iki. – i tha.-S’mund të rri ulur në një tavolinë me poshtërsinë. “ Iku dhe nuk u kthye më, as në vjeshtë dhe sa në dimër.

Dikush kishte hapur fjalë se ishte arratisur, në Jugosllavi: Legjenda e arratisjes arriti të besohej dhe nga vet ata që e kishin trilluar. ...Dikush tha që kishte përfunduar në Amerikë dhe kishte nisur punë në një garazh makinash luksoze ku paguhej mirë. Historinë e vërtetë do ta merrja vesh në prag të vitit të ri, ditën e fejesës së vajzës së hallës sime, Artës , me hetuesin Shezai Dorsi. Fejesa u bë në 25 dhjetor, natën e Krishtlindjeve, e festuam së bashku, në familjen e Mevlud Zenelit, oficer i lartë në aviacionin ushtarak..Arta, ishte studente në vitin e fundit për mjekësi. Atë mbrëmje ajo pati kënaqësinë e madhe të më njihje me Shezaiun. E njoh, i tha Shezaiu, sa më pa, jeni student i letërsisë. Në kursin tënd kam pasur një mik kosovar... Edhe unë e njihja Shezaiun, madje e dinim të gjithë që ai ishte hetues dhe punonte në Ministri të brendshme.

U bëra kureshtar, prita rastin kur nisën të këndonin labçe, dhe iu afrova pranë. Në atë kohë, të uleshe në tavolinë me një hetues të Ministrisë së brendshme ishte privilegj. “Jetonin e kam njohur një ditë pasi ai ka hyrë në Shqipëri, -tha ai. Një javë më vonë më erdhi në zyrë. E mora për krah, dolëm jashtë dhe u ulëm në një kafe. Kishte nevojë për para. I propozova të punonte ca kohë në sharrat e Llogorasë. “Të mendohem.”- tha. Në Llogora kisha vëllanë e madh, te brigada e sharave.“ A ke ardh me njoh Shqipinë?- i thashë. Vendosi të shkojë. Në ndarje më rroku për krahësh fort,”Shqipinë e njoha, tha, -Shqipnia je ti...” –Ishte njeri punëtor, dhe me karakter.” Ndezi cigaren dhe bëri një pauzë të gjatë.

-Tani dhe mund të thuhet ca gjëra, -shtoi ai . -Nuk janë më sekrete. Pas prishjes me Jugosllavinë ai s’ kishte pse prezantohej me një emër të rremë..

* * *

Atë mbrëmje bisedat tona bëheshin me ndërprerje, herë pas here duhet të merrnim pjesë në bisedat e të ftuarve. I erdhi radha të ngrihej dollia e dhëndrit. Në atë çast dollibashi u ngrit në këmbë me gotë në dorë dhe i bëri një vlerësim të lartë. Edhe pse i ri në moshë, detyra e hetuesit i kishte dhënë një hije të ngrirë, Shezaiu ishte i vetmi që nuk e hoqi kollaren as kur u ngrit të vallëzojë me Artën e ne na binin djersët çurk, në atë dhomë të vogël apartamenti .

“Në muajin tetor na erdhi një informacion i cili m’u caktua për ndjekje të mëtejshme.- vijoi ai pa pak. -Në Shqipëri ka hyrë një kosovar i cili dyshohet për një vrasje. E quanin Azem Syla. Një nga më të kërkuarit nga prokuroria jugosllave. Me që ai ishte nga Peja, mendova, Jetoni duhet ta njohë. Në informacion thuhej shprehimisht;”dyshojmë që gjendet në Shqipëri” Informacione të tilla na vinin shpesh, ne ishim mësuar me blofe të tilla, për më tepër, shumica e të kërkuarve ishin të rinj kosovarë, të cilët i kishim mirëpritur dhe i kishim sistemuar në punë.

U nisa qysh atë ditë për në Vlorë. Do t’u bëja një vizitë të shkurtër prindërve, më pas Jetonin, me këtë rast takoja dhe tim vëlla.

I gjeta të dy. tërhiqnin një trung pishë tek vendi i sharrimit. U gëzuan shumë kur më panë. Me Jetonin u përqaftuam si dy miq të vjetër. Shkuam tek restoranti nën pisha, zëmë një tavolinë një qoshe, me pamje nga pylli, porositëm birra dhe pritëm sa të vinte dhe Rushani.

Pas pak erdhi im vëlla. ”Na e ke bërë shumë qejfin, tha.- Këtu vetëm me ujqërit mund të bisedojë njeriu...

Kur e pyeta Jetonin për Azem Sylën ai u rrudh në fytyrë. Kjo më bëri të besoj që ai e njihte. Fillimisht bëri sikur nuk kuptoi, më pas pranoi që e njihte. Gjashtë muaj më ka sjell vërdallë ai njeri.. hajde sot, hajde nesër...Për më tepër , isha unë që kisha biseduar me shefat për ta hequr nga sharrat e për ta sjellë me punë në Tiranë. Një javë më vonë u nxeha keq me të... “Kam filluar të dyshoj tek ti.- i thashë.

“Azem Syla punon te NISH. Tulla 3.” më tha. -Shkova te NISH Tulla 3 dhe takova drejtorin. “Nuk kemi asnjë punëtor me këtë emër.” -tha ai. Të nesërmen më mori vetë në telefon: “Në orën gjashtë e gjysmë Azemin e ke te kafja. ”-më tha. Në atë takim unë shkova me vonesë: Priti, prit dhe iku.-tha. -Nesër e sjell sërish, “Ku punon?”- e pyeta. “Në Guroren e Dajtit.” Në gurore kishte një Azem, por me mbiemër tjetër. Kisha nisur të dyshoj seriozisht tek ai...Duhet të vendosja ç’qëndrim duhej mbajtur me të në ditët e më pasme. Ishin ato ditë që radio Tirana buçiste orë pas ore për tradhtinë e Titos, dhe prerjen e marrëdhënieve me Jugosllavinë titiste. Atë mbrëmje takimin e kishim lënë tek ajo kafja e vogël , pas ish Komitetit Ekzekutiv. E pashë që sa hyra.

I vetëm. Iu ula përballë, hoqa çantën nga krahu dhe e lëshova mbi karrigen bosh. Më pyeti çdo të pish. Një çaj , i thashë pa i ngritur sytë. Do t’i thosha vetëm, një fjalë të cilën ende nuk e kisha formuluar qartë dhe do të ikja. Erdhi kamerierja dhe solli la porosinë.

-Ku e ke Azemin?- i thashë prerë.

-Azemin ? tha ai pa më parë në sy. -Azemi jam unë.

Tërhoqa karrigen pas duke e parë me habi...

* * *

Kur mendon të shkruash një histori, ndër mend ke të tjera gjëra, kur gjendesh para letrës së bardhë mendimet bëhen rrokopujë. Në çastin e krijimit është dikush që dikton e që mund të t'i bëjë lesh e li faktet dhe ngjarjet. Jua them këtë pasi dua të jem i ndershëm me ju, me ju dhe me veten time, dhe me ngjarjet që i kam njohur ose përjetuar.

Pas prishjes me Jugosllavinë, në rangjet e larta të partisë dhe të shtetit u duk sikur ndodhi një tërmet. U shkarkuan shumë kuadro të larta të cilët punonin në punë të rëndësishme, pati të tjerë, më pak të rëndësishëm, që mbulonin marrëdhëniet midis dy shteteve tona të cilët u hoqën përgjithmonë nga Tirana, me gjithë familje. Ministri i brendshëm i asaj kohe u dënua me pushkatim. Kjo valë e kishte kapur dhe Haki Pejën, i cili merrej me problemet e Kosovës. Ai vetë u dënua me 10 vjet burg, ndërsa familjen ia internuan në Belsh të Elbasanit. Në situata të tilla ndryshimesh ndodhin ngjitje dhe zbritje. Për fat të mirë ose të keq të Jetonit, në këtë kohë ndryshimesh u krijua një sektor i ri, pranë Komitetit Qendror, detyrat e të cilit mbaheshin tepër sekret. Në listat e reja që do të punonin në organet e sigurimit ishte propozuar dhe emri i Jetonit. Ndoshta ka qenë një rastësi, kanë parë kartelën e tij dhe faktin që dinte serbisht, dhe, ai më i madhi, i cili vendoste për këto punë, ka thënë, thirreni dhe merrini një mendim. Propozimin e tyre Jetoni e konsideroi si një nder që i bëhej nga partia dhe shteti. Pra, ai nuk ishte një njeri i panjohur, madje, ishte piketuar për të punuar në një sektor sekret, në marrëdhëniet e reja që duheshin të bëheshin tashmë, vetëm me Kosovën. Do të shkonte në Kosovë me identitet të rremë. Azem Sylja kishte vdekur njëherë e përgjithmonë. Në lëkurën e Azem Sylës jetonte një farë Jeton Shatri."Partia ka besim tek ty." i kishin thënë kur e kishin thirrur për t'i marrë mendim për detyrën e re, kjo ishte një formulë e njohur për të gjithë ata që i thërrisnin për të punuar në detyra sekrete.

"Të mendojem, - kishte thënë Jetoni. Dhe kjo, ishte një formulë që përdorej në raste të tilla. Nuk duhet të thoshe jo, por dhe s' duhet të tregoheshe as shumë entuziast, entuziazmi i tepërt krijonte dyshim. Sa zbriti shkallët e Komitetit Qendror fluturoi drejt zyrës së Shezos.

"Është një nder që të bëhet, - i tha ai. Partia ka nevojë për njerëz si ti. U. D. B-ja ka qenë ulur këmbëkryq në Shqipëri, tani na ka dalë një punë e madhe...

-Nëse do të më kërkohet të loz spiunin,- kanë gabuar.-tha Jetoni. Nuk jam unë i këtyre punëve.

-Është hapur një sektor i ri për Kosovën, -i tha ai, me seli pranë Komitetit Qendror, i cili do të merret me çështjen shqiptare.

-Çështja shqiptare i pëlqen çdo kosovari, - i tha Jetoni. Pra, ai po thirrej në një detyrë të re, për të shërbyer çështjes së madhe.

Mos vallë flitej për ëndrrën e të atit të tij të kahershme, për bashkimin e trojeve shqiptare?

* * *

Para se të nisej për në Kosovë, ai bëri një muaj përgatitje teorike, praktike dhe fizike, së bashku me disa të rinj të tjerë me biografi të mirë, të zgjedhur për këtë punë, aty ai mori vesh se përzgjedhja e tij ishte bërë për shkak të njohjes së gjuhës serbe. Ndër çështjet më kryesore ishte ruajtja e sekretit. Hyrje- daljet në Kosovë do të bëheshin në fshehtësi të plotë. Edhe pse do të hynte e do të dilte nga Kosova, edhe në qoftë se do të gjendej shumë afër shtëpisë së tij, ai duhet t'u shmangej të njohurve. familjarëve, miqve dhe shokëve , do t'u kalonte pranë si një hije, s' do takonte kurrkënd, as nënën , as vëllezërit as motrën e tij të vogël; as motrën tjetër që ishte e martuar dhe jetonte në Prishtinë...Kësaj i thoshin; shko gjer te burimi, dhe mos pi ujë. E keqja tjetër e kësaj pune ishte ajo që, çdo lëvizje duhej të bëhej në prani të kolegut, ata të dy s' duhet të ndaheshin as në gjumë. Pyeti për kolegun e tij, i thanë është një ish partizan nga Librazhdi, i martuar, me fëmijë. E quanin Stilian Koçibellit, shkurt e thërrisnin Lili.

U njohën me njeri tjetrin kur i thirri ministri në zyrën e tij. Ministri e njihte Lilin qysh nga koha e luftës. “Ti Lili e ke armën, dhe veshjet, i tha ai, -Për ju, kam dhënë urdhër t'ju pajisin me armë.”-iu drejtua Jetonit miqësisht. Kolegu i tij Jetonit nuk i pëlqeu. Ju duk një tip i vrazhdë dhe i mbyllur. Me tipa të tillë s' di njeriu ç'të flasë, po ç'rëndësi kishte kjo, ata ishin thirrur për një çështje kombëtare. Kur dolën nga zyra e ministrit dhe u ulën në një kafe, mori vesh që këtë detyrë Lili nuk e kishte për herë të parë. Atje në kafe ai ndërroi mendim, iu duk njeri i drejtë dhe i vendosur, sakaq i kapi syri një shikim të dyshimtë... Qenka nga ta njerëzit që të studiojnë tinëzisht. Po ç'rëndësi kishte dhe kjo, para çështjes kombëtare? Atje ata të dy do të takonin dikë... Do të linin diçka dhe do të merrnin diçka. E gjitha kjo punë për dy-tri ditë.

Nga Tirana u nisën një të shtunë, në mëngjes herët, qëndruan në Tropojë gjersa ra mbrëmja, gjatë gjithë asaj dite Jetonit i hidhej zëmra peshë. Po kthehem në Kosovë! Po kthehem në Kosovë! Gjatë asaj dite Jeton Shatri krijoi një mendim më të zbutur për kolegun e tij, edhe pse fjala “parti” ishte ulur galiç në trurin e tij. Kur ra mbrëmja u futën në një xhips ushtrie i cili i përcolli gjer në afërsi të pikës kufitare të Çeremit. Nga ana tjetër e kufirit, në një bregore, dukej karakolli i Koshares. Komandanti i postës sonë, një djalë i ri nga labëria, ishte në dijeni të këtij kalimi, ai i priti vet me një ushtar tjetër, poshtë postës, dhe i shoqëroi me sy gjersa kaluan brezin e ftohtë.

Sa preku me këmbë tokën mëmë Jetoni ndjeu një drithërimë. O Zot i madh! – tha me vete.-Ç'lidhje paska njeriu me tokën e vet? Ishte një ndjesi të cilën mund ta përjetoje vetëm në ëndrra. E përshkoi një erë malli përzier me flladin e ngrohtë të një nate hënore, kundërmim i pishave përzier me aromën e mollëve të kodrave të Strellës. Ishte fryma e shpirtrave të stërgjyshërve të tij a çfarë tjetër , ky fllad nate,

me ndriçimin e ngrohtë të Hënës dhe yjeve të vendlindjes, i cili trupin ia bënte më të lehtë, këmbët më të shpejta,, drejtpeshimin më të bukur e brengën më të hënëzuar? Këtë gjendje nuk e kishte përjetuar as në ato çaste kur kishte qëndruar mbi urën e Bunës dhe kishte biseduar me frymën e atit të vet , të gjorë.

Para tij ecte Lili. Për shkak të ndriçimit të plotë të Hënës, zbritën në një përrua me ujë kristal, dhe ecën përgjatë përroit me lisa të zhveshur. Pati një çast që Lili i kërkoi Jetonit t'i printe para. Toni i zërit iu duk në formë urdhri. Mos jam nën kontroll?-mendoi. Jeta e kishte mësuar të ishte dyshues tek çdokush e në çdo gjë, gjer në atë masë ku s'ndërhynte fantazia e tij e zhvilluar Ai kishte lindur si një dyshues i fshehtë, i heshtur dhe i vëmendshëm , ndaj çdo gjesti, fjale ose tonaliteti. Si një i verbër që ka të zhvilluar ndjesinë e lëvizjes së erës, dhe ai, me ndjesinë e erës, mendoi se mund të kontrollonte lëvizjet e shoqëruesit .

Atë natë e kaluan në Kullën e vetmuar të Zenunajve, e ndërtuar me gur të lëmuar, me dritare-frëngji, në një bregore mbi rrugë, poshtë Koshares së Egër. Plaku i shtëpisë ishte lajmëruar qysh atë mëngjes se do t'i vinin mysafirë nga Shqipnia. Një fishkëllimë e lehtë sipër rrugës, dhe ata shkuan pas saj. Duhet të kishte kaluar mesnata, por plaku i Zenunajve kishte disa orë që priste zemërngrirë, te dritarja-frëngji e katit të sipërm. Tokën duart burrërisht. Plaku e pyeti Lilin nëse gjatë udhës kishin pasur ndonjë shqetësim, më pas i ftoi të uleshin mbi ca shilte, gratë u sollën për të ngrënë. Djali i tij i cili me kaq mendonte se e kishte kryer detyrën i kërkoi të atit leje për t'u larguar. Në atë çast, plaku i Zenunajve ngriti sytë nga Jetoni dhe i hodhi kutinë e duhanit para këmbëve.

Nuk e pyeti nga ishte, as si quhej. Kulla e Zenunajve kishte qenë në çdo kohë, derë e hapur për mysafirët e ardhur nga Shqipnia. Nga kjo familje ishte derdhur shumë gjak për çështjen kombëtare. Në një çast plaku i Zenunajve pyeti: “Qysh e kam Enver Hoxhën? Mirë , i tha, Lili, sikur të jetonin së bashku, nën një çati.

Plaku ishte gëzuar shumë që shteti shqiptar më së fundi e kishte kuptuar kush ishte serbi. Ai kishte humbur një djalë gjatë luftës, edhe pse e kishte qortuar Shefqet Peçin ku e kishte takuar:

“ Ç'djall iu lidhi me serbin!?” djalin e dytë ia dha me vete, për ët pësuar atë që pësoi, u vra dy orë më vonë në betejën e asaj dite.

Për bisedat e tjera të asaj mesnate, s' besoj të jeni të interesuar...Plaku i Zenunajve i dinte punën e veta..

Dhe dita tjetër, nga mëngjesi gjer në mesnatë, kaloi në kullën e Zenunajve, frëngjitë e saj si dy sy të vegjël shikonin Erenikun.

Jeton Shatri ishte nisur nga Tirana, i vetëdijshëm se gjendej para një prove, por s'do t'i shkonte mendja kurrë se prova e tij e vërtetë ishte ajo që përjetonte në ato çaste. “Të gjendem kaq pranë nënës dhe të mos mundem ta takoj? Vetëm për një shenjë që ajo të kuptojë që unë jetoj.

Po përsëritej legjenda e Kostandinit. I vdekuri ishte ngritur nga varri dhe kishte mbërritur te dera... Po përsëritje legjenda me pak ndryshime në kohë; i vdekuri nuk e kishte emrin Kostandin por Jeton ,dhe kthimi nuk ndodhte në një natë me hënë por në një mesditë me diell. Sa do të dëshironte që atë çast të ishte te porta e tij e drunjtë, bravëshqyer, e brejtur nga mizat, vetëm për të parë nënën, nga krisa e portës. Ja ajo tek zbret shkallët e gurta, për t'u hedhur pulave thërrime.

Ishte pikërisht ai çast, i ndryrë në atë kullë, kur i shkrepri kjo ide të cilën s'do të guxonte ta besonte as në ëndërr. Po sikur...?

Sikur t'u hidhte një copë letër në oborr? Do ta gjenin, sigurisht, dhe do ta hapnin. Ai ose ajo që do ta hapte atë copë letër , kur të shikonte shkrimin e tij do të lëshonte një ulërimë : Azemi është gjallë! Azemi është gjallë! Kjo ide s'ishte gjë tjetër veçse pjellë e fantazisë së tij të zhvilluar, pasi Azem Syla kishte vdekur qysh në atë çast kur ajri i mbrëmjes përcolli në qytetin e Pejës pesë të shtënat e tij mbi trupin e Milla Svetkoviçit.

* * *

Misioni i tyre u quajt i përmbushur vetëm me çfarë thanë dhe çfarë lanë në kullën e Zenunajve. Në mesnatë u kthyen sërish nga kishin ardhur. Kufirin e kaluan pa problem. Ato pak orë që u kishin mbetur gjer në zbardhjen e ditës së re fjetën në postën Kufitare të Poçemit, në mëngjes formuluan shpejt e shpejt relacionin, i cili do të dorëzohej po atë ditë në zyrën sekrete të Komitetit Qendror. Lili e dinte mirë se çfarë kërkonin shefat: A kishte pakënaqësi në popull për prerjen e marrëdhënieve? Ç'mendonin bashkëpunëtorët? A duhej zëvendësuar ndonjëri, si i dyshimtë?

Kur ndodhin ndryshime dhe përmbysje të mëdha midis dy shteteve fqinj, si ajo që ndodhi midis dy shteteve tona me një Kosovë të zënë rob nga ana e kundërshtarit, detyra e informatorëve ishte sqarimi në popull, duhet të dihej nga të gjithë që prishja kishte ardhur prej palës Jugosllave, dhe se ishte Stalini që e kishte denoncuar këtë tradhti, Stalini, miku i madh i shqiptarëve dhe shpresa e vetme për të ardhmen.

Në muajt që do pasonin ata e shkelën dhe dy herë të tjera kufirin Jugosllav. Jeton Shatri me intuitën e vet kishte vënë re se në këtë lloj pune, e cila kishte lidhje me çështjen kombëtare, kishte diçka që nuk shkonte, sikur i mungonte ideali, pasioni dhe entuziazmi. Dhe kur ata të dy ishin gjendur te ajo zyra e Komitetit Qendror dhe tek ajo e Ministrit të Brendshëm, kishte vënë re diçka protokollare, ftohtësi gjer në dyshim, sikur dhe shefat e tyre e kryenin këtë detyrë pa dëshirë, si të shtyrë nga një dorë e huaj, të alarmuar...Në udhëtimin e tretë, ndodhi diçka e pazakontë, pasi dolën nga zyra e Ministrit të dy njëherësh, ministri e ndali Jetonin te dera për pak çaste, kinse do ta

pyeste për punën e strehimit të tij, në fakt e kishte pyeturi nëse kishte pasur ndonjë shqetësim nga kolegu i vet. Sa doli nga zyra e tij, por dhe më vonë, ai e vrau mendjen gjatë, ku donte të dilte Ministri me ato fjalë?

Pasndarja me Jugosllavinë i ngjante një kanceri i cili zhvillohej heshtazi dhe dalëngadalë, brenda trupit të shtetit dhe të njeriut, pa dhimbje. Në të tilla raste dyshimi i ngjan ajrit, ai hyn kudo, në çdo skutë. S'i mund t'i shmangeshe dot dyshimit? Si mund t'i shmangeshe dot ajrit? Dyshimi rriste dyshimin. Dyshimi nxiste dyshimin me dyshim. Nëse ti bëje një punë me ndershmëri dhe pasion, nëse ti arrije një sukses, do të shpërbleheshe me smirë, me ndonjë intrigë, dhe me thashethemet e kolegëve. Jeton Shatri ishte ndeshur disa herë me shikimet e kolegut të tij, po ç'të bënte? Një ditë i kishte thënë shefit të tij për ta transferuar në një detyrë tjetër. "Këtu do të vdesim, unë dhe ti! – I ishte përgjigjur shefi me arrogancë. – "Te kjo punë do të vdesim të gjithë. A e dini pse-në!?" "Defans des savoir."- ishte përgjigjur në një gjuhë që Jetoni nuk do t'ia merrte vesh kuptimin.

Një muaj më vonë jetonin i ndodhi diçka e pazakonte. E caktuan të shoqëronte për ca ditë një grup studentësh kosovarë. Në ato pak ditë, një prej studentëve, duke e ditur detyrën që kishte, i kishte kërkuar diçka të çuditshme. Ai donte të takohej urgjentisht me Enver Hoxhën. I kishte treguar se ishte pjesëtar i një organizate revolucionare shqiptare..."Dua ta takoj shokun Enver për një çështje me rëndësi." Jetoni atij nuk i dha asnjë përgjigje, ndërkohë që sinjalizoi shefin e sigurimit të turizmit. "Kush të ka autorizuar ty të bësh biseda të tilla?- i ishte përgjigjur ai.

Kur studentët kosovarë ishin larguar ai bëri një relacion të shkurtër, dhe për drejt, në atë relacion futi diçka të pamenduar mirë e cila më vonë do ta linte disa net pa gjumë.

Kërkesa e studentit kosovar dhe atij vetë i kishte mbetur enigmë "Çfarë ishte ai informacion i rëndësishëm që ai kërkonte vet Enver Hoxhën?" Ishte pikërisht ky relacion i cili do t'i krijonte ngatërresa të mëdha, dhe shefin e sigurimit të turizmit do ta pushonin nga detyra..

* * *

Në fillim të shtatorit, kur po kthehej në banesë, në oborrin e shtëpisë private ku rrinte me qira, u ndesh me dy persona të panjohur. S'pati kohë as për t'u çuditur e as për t'i pyetur; kush jeni ju.

"-Kemi kohë që ju presim." -i tha njeri prej tyre duke iu afruar me mirësjellje.

-Kemi urdhër të vini me ne, - shtoi tjetri, duke e kapur për krahu.

Në kryqëzim, në vend që të merrnin për nga rruga "Qemal Stafa"te Pazari i Ri, u kthyen nga drejtoria e Sigurimit, gjoja për t'i rënë më shkurt. Polici roje, sa i pa nxitoi të hapte portën.

Ishte hera e parë që Jeton Shatri duke ndjerë rrezikun mendoi se mund të bënte diçka, ndërkohë që shoqëruesit e tij , të stërvitur për raste të tilla, e kapën për rrobash . E shoqëruan në një dhomë të errët, në mes të së cilës kishte vetëm një tavolinë dhe një karrige hekuri , në të cilën ishte ulur një oficer i ri, kapelën e kishte lënë përmbi tavolinë ku kishte një telefonon dhe ca letra të shkruara, të shpërndara gjithandej.

-E keni kontrolluar ? Pyeti oficeri qetë.

-Jo, shoku kapiten. – i tha shoqëruesi me qëndrim gatitu.

-E kontrollojmë tani! – i tha tjetri.

Kapiteni miratoi me kokë. Nisën t’i më bëjnë një kontroll të imët, nëpër xhepa, ndërmjet këmbëve, sendet që gjenin, i vendosnin pa kujdes mbi tavolinë.

-Hiqi këpucët! Ulu ! -urdhëroi oficeri.

-Dhe tani, a ka mundësi të më thoni, përse ndodhem këtu?

- Doni të dini përse jeni këtu? U ngrit në këmbë:

-Ngrihu në këmbë dhe merr këpucët. -foli ashpër njëri nga shoqëruesit.

E nxorën nga zyra dhe e shoqëruan përgjatë një korridori të errët.. Atë natë ai fjeti në një birucë të errët e me një dritare frëngji fare pranë asaj zyrës ku e kishin bërë kontrollin fillestar. Nuk dëshiroj të zgjatem rreth gjendjes së tij shpirtërore të atij çasti dhe të asaj nate të parë që nuk mbylli sy. Histori të tilla, të trishtueshme, janë bërë të zakonshme në letërsinë tonë.

Gjashtë muaj në birucë. U ndërruan katër hetues. Javën e parë e vizitoi Shezaiu, një vizitë pa buzëqeshje. E pyeti nëse kishte ndonjë ankesë nga trajtimi i atyre ditëve? Me përkujdesjen e tij sikur donte t’i thoshte, s’kam ç’ bëj më shumë. Në sytë e tij kishte qortim dhe mirësi, dyshim dhe porosi, “Hapja zëmrën Partisë, në do të kesh lehtësira.” Ishte pikërisht njeriu i cili dikur e kishte ndihmuar.

Gjashtë muajt në hetuesi nuk kam ndërmend t’i përshkruaj, veçse dua t’ju tregoj se si dosja e tij e cila kishte nisur vetëm me dy fletë të shkruara nga një dorë analfabeti,do të bëhej 394 faqe. Dëshmia që do t’i rëndonte më shumë ishte ajo Lili Koçibellit, ku i kishte sajuar ato dy fletë të shkruara në një dialekt verior, pa “ ë-të”në fund të fjalëve, e me germa të mëdha në mes të fjalëve? Në këtë dëshmi hidheshin dyshime të rënda; Jeton Shatri i panjohur në fshatin e vet të lindjes, ishte një agjent i U. D. B-së.

* * *

Nata e parë iu duk e gjatë gjer në pambarim. Netët e tjera u kthyen në përmasat e veta reale. Gjatë atyre orëve pati kohë të sillte ndërmend disa biseda komprometuese me miq e shokë. Nuk kishte pasur kurrë armiq, as njerëz të dyshimtë që t’i vërtiteshin rreth vetes. Thua të ishte një kurth? Thua të kishte rënë në grackë? Nga kush? Përse? Kush

ishte ky Lili Koçibelli që ia kishin ngjitur nga pas? Thua pas tij të fshihej dora e zgjatur e U-D. B-së? Pikërisht kësaj ia kishte pasur frikën gjithmonë, qysh se ishte hedhur në Shqipëri, mirëpo, përse kaq me vonesë? Vendimi i asaj nate ishte i prerë. S'do të pranoj asgjë. Asgjë. Asgjë.

Gjyqi i tij u zhvillua në ditët e para të marsit, në një kinema të vjetër, me dyer të mbyllura. Gjatë atyre gjashtë muajve hetuesie ai kishte qëndruar gojë kyçur, nuk kishte pranuar asgjë dhe nuk kishte firmosur asgjë. Akuzat e prokurorit atë mëngjes i mohoi me përbuzje, duke përsëritur të njëjtat fjalë që kishte thënë dhe para hetuesve. "Nuk di asgjë... Nuk kam bërë asgjë... Janë të gjitha trillime... Nuk më dënon shteti im, por më dënon U. D. B -ja jugosllave. Në gjithë këtë histori ka gisht U. D. B-ja . Kërkojeni. Agjentin e kini midis jush." Emrin e Lili Koçibellit nuk e përmendi as në hetuesi dhe as para prokurorit, me që vendimin për të e kishte marrë në heshtje.

Prokurori kërkoi dhjetë vite burg, gjykatësi e zbriti në gjashtë. Gjashtë vitet e burgut i bëri kokërr më kokërr, në Burrel, në Spaç, në Qafën e Barit...dy vitet e fundit në burgun e punëtorëve te kodrat e Saukut, në ndërtimin e Sanatoriumit të Tiranës.

Një vit më parë se të lirohej nisi një kurs anglishteje. Lili Koçibellin, nuk e kishte harruar. U gëzua shumë kur, aty në burg, mori vesh që e kishin zhveshur nga detyra dhe e kishin transferuar me gjithë familje në Elbasan, në qytetin e së shoqes. Askush nuk e dinte shkaku e saj saktësisht. I interesuar për të marrë vesh ndonjë hollësi më shumë, kur i duheshin dhe gjashtë muaj për t'u liruar nga burgu, nga një oficer i ri me të cilin kishte një farë miqësie, mori vesh se Lili Koçibelli mund ta hante dhe më keq nga ç'e kishte ngrënë...Dhe se pas lirimit kishte nisur të pinte. Një tjetër i kishte thënë se Lili ishte në vëzhgim... Ishin punë më të thella. "Më prit." - kishte thënë me vete Jetoni, një muaj para lirimit

* * *

Si mund të kalojnë gjashtë vite burg nëse njeriu nuk e vret kohën me përfytyrime të bukura për ditët në liri? Lavdi ti o Zot që na ke dhënë artin e përfytyrimit. Me përfytyrime njeriu mund të shkojë në New jork, në Paris, në Malburn, në Toronto, në Majami, në Palma de Malorka dhe kur ai gjendet në një qeli të errët. Përfytyrimit s'i vë kush fre...Me përfytyrime njerëzimi ka bërë dhe punë të dobishme dhe të pista. Përfytyrimi është bukuria e vërtetë e jetës. Përfytyrime të bukura mund të quheshin dhe skenarët e Jeton Shatrit për zhdukjen artistike të Lili Koçibellit. Ju thashë, mikun tim e kishin prishur librat që kishte lexuar, qysh në rininë e vet, me të kishte ndodhur ajo që kishte ndodhur shekuj më parë me sojliun e Mançës. Vrasja është art,- mendonte ai. Vrasja duhet të jetë art, si gjithë artet e tjera. Sidomos kur ka brenda një ide progresive... Sidomos kur vrasja nisët nga një qëllim fisnik, për t'u pastruar rrugën brezave që vijnë. Ndaj

jeta është e bukur. “Kush të godet pas shpine e bën sepse s’do kishte guximin ta bënte përballë.” Një burracak i tillë dhe tinëzar ishte Lili Koçibellit. Njerëz të tillë të tillë duhen ndëshkuar, pasi në këtë mënyrë pastrohet raca njerëzore, mendonte ai.

Koha e ngjarjes- pasburgu. Vendi...? Këtu merrte krahë fantazia e tij. Variantet ngjanin si ato të një loje shahu ku ai kalonte shpesh kohën në ato vite burgu. Në shah mbretin mund të zësh rob vetëm me një lëvizje, kur e gjen të zbuluar.

Lili Koçibellit tashmë gjendej i zbuluar ,sidomos para gotës së rakisë. Pas largimit të tij nga detyra dhe largimit nga Tirana, në qytetin e Elbasanit, ai quhej një figurë e djegur, një figurë e dështuar, një burracak që të godiste pas shpine, një njeri i dyshimtë.

Variante të mundshme kishte plot, si për shembull; në ndonjë përvjetor, në ndonjë ditëlindje, në ndonjë dasmë, në ndonjë festë jubilarë, në ndonjë darkë në fshatrat e Elbasanit, të Dumresë, të Çermenikës , të Librazhdit, të Sopotit, të Prenjasit, të Martaneshit ose të Gjinarit. Krahina e Elbasanit kishte plot vende piktoreske, me blerim e ujëra. Lili Koçibellit ishte në një moshë që duhej të kujdesej për shëndetin, sidomos në raste të tilla ku derdhej rakia lumë. Të gjashtëdhjetat sa i kishte mbushur, me zëmren kishte probleme...Dhe tensioni kishte nisur t’i lëvizte.

Një vdekje para gotës së rakisë mund të quhej një vdekje e bukur. Mirëpo, vdekja është vdekje.

Shpesh herë në jetë gjërat nuk ndodhin si i dëshirojmë ne.

Kush mund të mendonte që Lili Koçibellit do të kishte një vdekje të lumtur, mes miqsh e shokësh? Kush do ta mendonte se Lili Koçibellit në atë mbrëmje të gëzuar, me rastin e synetllëkut të djalit të Isuf Kuqit , do të ulte bukur kokën përmbi tavolinë, duke u lënë lamtumirën dashamirëve që e rrethonin?

Askush nuk dyshoi tek ndonjë dorë vrastare. U përfol për një vdekje të papritur dhe natyrale. Në fund të fundit, natyrale janë të gjitha vdekjet, gjersa njeriu është i përkohshëm tek kjo botë, Lili Koçibelli kishte probleme shëndetësore, pra, nuk i kishte faj njeri, duhej të ishte treguar më i kujdesshëm atë natë. Ai nuk i ishte përmbajtur këshillave të mjekut të zëmres. Qesh e bot, qesh e bot...Pi dollinë e njërit e kthe dollinë e tjetrit...

Dhe hajde më thuaj tani, se Jeton Shatri me ato fantazitë e burgut nuk do t’i kishte rënë pikës, kur pranoi variantin e vdekjes së tij natyrale.

“E gjeti nga perëndia.” -tha dikush, në kësollin e një njeriu të zi, sakaq u dëgjua një pëshpërimë: ”Perëndia, Perëndia...Por duheshin dhe duart e mia.”

* * *

Jeton Shatri kur doli nga burgu u interesua për të gjetur një punë. Nuk e priti askush. Duke lëvizur nëpër Tiranë, në një kryqëzim rruge ai

takoi rastësisht një mikun e tij të ditëve të burgut, Pehlivan Kuqi, nga Gjinarit i Elbasanit, i dënuar për plagosje pa dashje të një fshatarit të vet, u ulën në një berrari dhe kujtuan ato vite burgu. Pehlivan Kuqi punonte sharrëxhi në sharrat e Gjinarit, kur mori vesh që miku i vuajtjeve ishte i papunë, e ftoi të punonin së bashku. “Si jo.” – tha Jetoni gjithë gëzim. Ishte një punë që e njihte mirë. U nisën së bashku qysh atë mëngjes tetori. Ajër i pastër, ujë i ftohët, dritë, gjelbërim. Tre muaj i kaloi duke parë si rrezoheshin pishat e larta me kokë në yje. Vitin e ri e festuan së bashku. Ditët e para të janarit i dha lamtumirën Pehlivanit dhe u nis për në Shkodër. Askush nuk e di saktësisht kush e ndihmoi për të kaluar Bunën me not, në ato ditë të ftohta janari. Në Mal të Zi qëndroi vetëm një vit. Më pas në Itali. Fundi i tij...Në vitin 1961 i hipën avionit Romë- New jork. Në qoftë se dikush nga ju është i interesuar të pijë një kafe me zotni Jeton Shatrin, (këtë emër mban dhe sot) le ta kërkojë në qytetin Boston, në këtë adresë; Avenju 6 .str. 3 1453 D . Atje banon dhe sot , në moshën 75 vjeçare, shëndet të plot, si një zotni barkmadh, i martuar , me pesë fëmijë...Vetëm sytë e tij të ndritshëm ruajnë akoma kujtimin e atij Jeton Shatrit të dikurshëm i cili, në moshën 20 vjeçare u nis si i verbër pas një ëndrre. Pas shumë peripecive në jetë, ai takoi ëndrrën e vet kur zbriti në tokën Amerikane.

Kanë kaluar shumë vite qysh nga ajo kohë, por mua ende më ka mbetur enigmë vdekja e papritur e Lili Koçibellit: Si ka mundësi që Lili Koçibelli t'i mbyllë sytë përgjithmonë në fshatin Gjinar, te familja e Isuf Kuqit, kushëri i parë i Pehlivan Kuqit? Si ka mundësi që në darkën e shtruar me rastin e synetllëkut të djalit të vet të parë, Jeton Shatri me Lili Koçibellin të ndodheshin kaq pranë..Kaq pranë? 20 metra larg. Aq sa ç'mund të ishte distanca e tytës së revolverit të tij me cigaren e Milla Cërkoviçit.

Çfarë rastësie!? Çfarë rastësie!?

